RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

"Auditim Financiar dhe i Përputhshmërisë"

Tiranë, tetor 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**4**
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit....	4-5
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	5-7
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	7-9
II.	**HYRJA**	**13**
1.	Objektivat dhe qëllimi	13
2.	Identifikimi i çështjes.....	13
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	14
4.	Përgjegjësitë e audituesve.....	14
5.	Kriteret e vlerësimit.....	14
5.	Standardet e auditimit.....	16
7.	Metodat e auditimit.....	16
8.	Dokumentimi i auditimit.....	17
III	**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**	**19**
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	19
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	**19**
2.1.	Auditimin mbi kontrollin e brendshëm financiar publik	**19**
2.2.	Auditimin mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.....	32
2.3.	Auditim i llogarive vjetore. Auditimin e vlerësimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2025, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, përformancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2015 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".....	50
2.4.	Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.....	65
2.5.	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.....	109
2.6.	Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).....	115
2.7.	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e Pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.....	122
2.8.	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....	128
2.9.	Të ndryshme të dala gjatë auditimit.....	145
IV	**REKOMANDIME**	**145-167**

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
MF	Ministria e Financave
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i Bashkisë Gjirokastër:

Bashkia Gjirokastër, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji Nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" dhe Ligji Nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar dhe përputhshmërisë të Bashkisë Gjirokastër për periudhën e aktivitetit 01.01.2025 deri 31.12.2025, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Buxheti i Bashkisë Gjirokastër si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transferta e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transferta specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave kombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të Ligjit Nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "*Për financat e qeverisjes vendore*" neni 50 "*Auditi i jashtëm*" pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: "*1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose audituesë të tjerë ligjorë".* Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Gjirokastër si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

Periudha e auditimit, është nga data 01.01.2025 deri më datën 31.12.2025.

Objektivat e auditimit, sipas drejtimeve të auditimit, janë si vijon:

- Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik;
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit;
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2025, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi;
- Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe

zbatimin e kontratave të punimeve;
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV);
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM;
- Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.
Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:
Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 37 gjetje dhe ka dhënë 40 rekomandime, nga ku masa organizative 27 gjetje me 29 rekomandime, masa për shpërblim dëmi 4 gjetje me 4 rekomandime, masa për elimimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, të ardhurat e munguara 6 gjetje dhe 6 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:
-Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Gjirokastër së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2025, ka devijime me vlerën e planifikuar.
Për vitin 2025, planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken ka vlerën 1,251,601 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 979,538 mijë lekë ose në masën 78.2%.
Për vitin 2025 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 270,781 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 252,127 mijë lekë ose në masën 93%.
Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real.
Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2025 investimet me të ardhurat e veta dhe transfertat janë planifikuar në vlerën 305,514 mijë lekë, realizuar 181,907 mijë lekë, ose në masën 59.5%.
- Nga auditimi i llogarisë 101 "Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar" u konstatua se, më datë 31.12.2024, kjo llogari paraqitej në vlerën 2,502,712 mijë lekë. Gjatë vitit 2025, llogaria është kredituar me shumën 397,284 mijë lekë dhe debituar me shumën 161,059 mijë lekë, duke rezultuar në shtesa neto në vlerën 236,225 mijë lekë. Nga analiza e kreditimeve/debitimeve dhe çeljes së vitit ushtrimor, llogaria 101 "Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar" duhej të paraqitej në vlerën 2,738,937 mijë lekë. Referuar pasqyrës së pozicionit financiar, kjo llogari është kontabilizuar në vlerën 2,775,368 mijë lekë, duke rezultuar e mbivlerësuar me shumën 36,430 mijë lekë. Sa më sipër veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*", i

ndryshuar pika 1.1 trajtimi kontabël dhe funksionimi i klasës 1.
- Nga auditimi i llogarisë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* për vitin 2025 janë kontabilizuar detyrimet sipas llojit të taksave dhe tarifave vendore.
Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit ka dërguar në Drejtorinë e Financës shkresat nr.2536, datë 17.03.2025 dhe nr.2968, datë 28.03.2025 për kontabilizimin e debitorëve.
Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave dhe Performancës me shkresë nr.783/1 prot, datë 18.03.2026 ka dërguar për kontabilizim debitorët për abonentët biznes për vitet 2015-2024, lista analitike nuk është bashkëngjitur në shkresën përkatëse por është dërguar elektronikisht.
Kjo listë nuk është kontabilizuar nga Drejtoria e Financës në llogarinë 468 por gjendja është e mbartur e vitit 2024. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me udhëzimin nr.5 "*Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09/03/2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*
Për debitorët familjarë nuk është përcjell informacion nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomi, Bujqësis, Taksave dhe Performancës. Sa më sipër llogaria 468 *"Debitorë të ndryshëm"* për shkak të mospërcjelljes së plotë të informacionit nuk pasqyron gjendjen reale të debitorëve në Bashkinë Gjirokastër.
- Nga auditimi i pasqyrës së konsoliduar të Bashkisë Gjirokastër gjendja e llogarive 230 "*Investime për aktive afatgjata jo materiale*" dhe 231 "*Investime për aktive afatgjata materiale*" në datën 31.12.2024 paraqitet në vlerën 484,104,004 lekë. Gjatë vitit 2025 kjo llogari është pakësuar për vlerën 104,880,862 lekë dhe në datën 31.12.2025 është kontabilizuar në vlerën 379,223,142 lekë.
Referuar udhëzimit nr.5, datë 21.02.2022 *"Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* këto llogari paraqesin vlerën e investimeve në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 "*Aktive afatgjata materiale*". Nga auditimi u konstatua se 25 (njëzet e pesë) investime për aktive afatgjata materiale të cilat janë kontabilizuar në llogaritë 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione"* dhe 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* vazhdojnë të jenë të kontabilizuar edhe në llogarinë 231 "*Investime për aktive afatgjata materiale*" të cilat kanë sjellë mbivlerësimin e kësaj llogarie.
- Në 4 (katër) nga 9 (nëntë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", të specifikuara në aneksin nr. 2 "për prokurimet", është konstatuar se, disa prej kritereve për kualifikim rezultojnë të paqartë apo të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe/ose të ekzagjeruar dhe/ose të argumentuara mbi bazën e parakushteve jo realiste. Në lidhje me këto kritere, njësia e prokurimit (NjP) është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos marrë parasysh natyrën dhe vlerën e kontratës. Mungesa e një argumentimi teknik, i cili do të justifikonte dhe ligjëronte vendosjen e secilit kriter të kërkuar, vjen si rezultat i moszbatimit të plotë të kuadrit ligjor, në fazën e hartimit dhe argumentimit të kritereve nga personat përgjegjës, në kundërshtim me nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", (i ndryshuar), si dhe nenet 2, 40, 39 dhe 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.
- Në 2 (dy) nga 9 (nëntë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", konkretisht në procedurat e prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2025 me objekt "*Blerje automjeti zjarrfikëse*" dhe atë me objekt "*Blerje automjeti*", është konstatuar se, nga anëtarët e Komisionit të Përcaktimit të Specifikimeve Teknike, si rezultat i neglizhencës në zbatimin e plotë të kuadrit ligjor, edhe pse specifikimet janë përcaktuar në

mënyrë rendore dhe variabile (me marzh), ato janë të shoqëruara me një argumentim ligjor por jo me atë teknik, në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".

-Në 4 (katër) raste mbi auditimin e kontratave për punë publike, u konstatuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zëriet e punimeve, me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Gjirokastër, në vlerën **(1,203,695) lekë pa TVSH.**

- Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve biznes që kanë ndaj Bashkisë Gjirokastër konstatohet se deri në datë 31.12.2024, borxhi tatimor është në vlerën 61,793 mijë lekë. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, janë paguar nga debitorët biznes detyrime të prapambetura në vlerën 12,248 mijë lekë dhe është krijuar borxhi tatimor në vlerën 7,526 mijë lekë për abonentët biznes. Borxhi tatimor progresiv për abonentë privatë në datë 31.12.2025, është në vlerën **57,071 mijë lekë** dhe i përket 834 bizneseve.

- Nga auditimi i dokumentacionit të administruar nga Drejtoria e Urbanistikës lidhur me legalizimet e ndërtimeve pa leje, si dhe listat për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton se Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Dega Gjirokastër, ka përcjellë zyrtarisht listat e qytetarëve të pajisur me leje legalizimi. Gjatë vitit 2025, detyrimi i krijuar për këtë taksë është në vlerën 3,709 mijë lekë. Më datë 31.12.2025 gjendja debitorë totale është 5,534 mijë lekë, shumë e cila përfaqëson të ardhura të pa arkëtuara për Bashkinë Gjirokastër. Nga dokumentacioni i paraqitur u konstatua se nga Bashkia Gjirokastër për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë, si dhe nuk u evidentuan raste që institucioni të jetë drejtuar ASHK-së Dega Gjirokastër, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore.

- Nga auditimi i pagesave për licencat e subjekteve të hidrokarbureve, rezultoi se 11 (njëmbëdhjetë) subjekte kanë kryer në total pagesën në vlerën 1,000,000 lekë, 1 (një) subjekt nuk ka kryer pagese ndërsa 3 (tre) subjekte kanë kryer pagesa pjesore në kundërshtim me VKM nr. 344 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj".*

- Agjencia e Tatim Taksave, Bashkia Gjirokastër, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 2,050,000 lekë për subjektet.

- Nga regjistri elektronik i biznesit të madh u audituar ngarkesa fiskale për biznesin e madh për tarifat vendore (pastrimi, ndriçimi, gjelbërimi) të miratuara me paketën fiskale me VKB nr.82, datë 05.12.2024. Nga 191 raste të audituara biznes i madh u konstatua më 6 raste nuk janë tarifuar në përputhje me paketën fiskale të miratuar me VKB nr.82. Raste analitike gjenden në tabelën nr. 8. Diferenca e vlerës së mostarifuar është 425,000 lekë.

- Nga auditimi i taksës së tokës bujqësore u konstatua se gjendja debitorëve e abonentëve për taksën e tokës bujqësore në datën 31.12.2025 është në vlerën 18,940 mijë lekë gjatë vitit 2025 ka pasur shtesa në vlerën 4,620 mijë lekë dhë pakësime në vlerën 5,174 mije lekë. Gjendja debitore në datën 31.12.2025 është në vlerën 18,386 mijë lekë dhe i përket 3,446 abonentëve. Për vjeljen e taksës së tokës bujqësore është vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 *"Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve proceduriale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore" kap II. "Veprimet paraprake të mbledhjes së detyrimeve tatimore vendore me masa shtrënguese".*

- Për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2025, Bashkia Gjirokastër ka shpenzuar vlerën 938,169 lekë e cila i përket vendimit nr. 533, datë 28.09.2017 me paditës shoqërinë "F." SHPK.

Vlera totale 938,169 lekë e shpenzuar për periudhën 01.01.2025 - 31.12.2025 nga Bashkia Gjirokastër, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet.

Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprime këto në kundërshtim me UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, pika 60*.

- Në 1 (një) nga 9 (nëntë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", konkretisht në procedurën e prokurimit të zhvilluar gjatë vitit 2025 me objekt "*Blerje automjeti zjarrfikëse*", është konstatuar sa vijon:

-Në fazën e vlerësimit të kësaj procedure, operatori ekonomik "SI & CO C" SHPK, ka paraqitur dorëheqjen nga gara në datën 20.06.2025. Në kushtet kur braktisja e garës nga operatori ekonomik është kryer pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave (19.06.2025) dhe për sa kohë nuk rezulton që OE të jetë tërhequr përpara këtij afati, KVO-ja duhet të kishte kërkuar konfiskimin e sigurimit të ofertës, çka nuk e ka kryer. Nga neglizhenca e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, është shkaktuar mungesa e përfitimit dhe cënimi i ekonomicitetit të buxhetit të bashkisë në vlerën **219,666 lekë** (vlera e sigurimit të ofertës). Mosveprimi i sipërcituar bie në kundërshtim me nenin 83, pika 3/a të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" dhe nenin 30, pika 6/a të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

- Drejtoria e Financës në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Gjirokastër, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime reale. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.
- Drejtoria e Financës të kryejë sistemimet kontabël të llogarisë 101 "Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar" për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave dhe Performancës në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të marrë masa për evidentimin, rakordimin dhe përcjelljen periodike të të dhënave të plota analitike mbi debitorët e taksave dhe tarifave vendore.
- Drejtoria e Financës të marrë masat për analizimin e investimeve të kontabilizuara në llogaritë 230 "*Investime për aktive afatgjata jo materiale*" dhe 231 "*Investime për aktive afatgjata materiale*" duke kryer sistemimet përkatëse dhe transferimin e vlerave të investimeve të përfunduara në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata.
- Autoriteti Kontraktor, Bashkia Gjirokastër (*grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës*), në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave, specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, duhet të argumentojë teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter të vendosur, duke përdorur vetëm ato kritere të cilat janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe duke i dokumentuar ato në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.
- Autoriteti Kontraktor, Bashkia Gjirokastër (*grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës*), në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të

specifikimeve teknike, përveç renditjes dhe argumentimit ligjor të tyre, duhet të shoqërojë këto të fundit edhe me një argumentim teknik.
- Nga ana e Bashkisë Gjirokastër, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej vlerën 1,203,695 lekë pa TVSH, nga sipërmarrësit e kontratave për punë publike, përllogaritur si pagesa për punime të likuiduara, por në fakt të pa realizuara.
- Agjencia e Tatim Taksave, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat administrative e ligjore, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 57,071 mijë lekë për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.
- Drejtoria e Urbanistikës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Prokurimeve Publike dhe Agjencinë e Tatim Taksave për subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale", të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara me vlerë 5,534 mijë lekë.
- Agjencia e Tatim Taksave, Bashkia Gjirokastër, të marrë masat për rillogaritjen e detyrimeve për subjektet e tarifuar me diferencë nga paketa fiskale si dhe ndjekjen e procedurave për arkëtimin e vlerave të papaguara.
- Agjencia e Tatim Taksave, Bashkia Gjirokastër, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 18,940 lekë për debitorët për taksën bujqësore.
-Kryetari i Bashkisë Gjirokastër të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore.
Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen e çështjeve gjyqësore, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.
-Autoriteti Kontraktor (*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave*), për çdo procedurë prokurimi me fond limit mbi atë të "Blerjes me vlerë të vogël" që do të zhvillojë në vijim, të marrë masa për konfiskimin sigurimit të ofertës nga çdo operator ekonomik, i cili tërheq ofertën e tij pas afatit përfundimtar për paraqitjen e tyre.

2. KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT

OPINIONI I AUDITIMIT.

I. Opinioni i pasqyrave financiare:

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduar të Bashkisë Gjirokastër për vitin e fundit ushtrimor 01.01.2025 deri më 31.12.2025, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinioni:

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Gjirokastër nuk paraqesin në mënyrë të drejtë disa elementë të përshkruara në paragrafin "Baza për Opinionin e Kualifikuar", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar, e shprehur kjo në bazën për opinionin.

Baza për opinionin e kualifikuar me rezervë:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 19,591 mijë lekë

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale por jo të përhapura, ato prekin disa prej llogarive financiare dhe sipas gjykimit tonë, kanë efekt në rezultatin financiar të Bashkisë Gjirokastër. Për këto arsye kemi dhënë opinion të kualifikuar, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

Nga auditimi ka rezultuar se në disa raste, nga Drejtoria e Financës janë kryer veprime kontabël që kanë sjellë pasqyrim jo të drejtë të këtyre ngjarjeve, konkretisht:

-Llogaria 101 *"Teprica",* është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 36,430 mijë lekë.

-Llogaria 85 "Rezultat i veprimtarisë ushtrimore" është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 37,137 mijë lekë.

-Llogaria 26 *"Aktivet financiare",* është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 7,151 mijë lekë.

-Llogaria 231 *"Investime për aktive afatgjata materiale",* është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 322,612 mijë lekë.

II. <u>Opinion për përputhshmërinë</u>:

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Bashkia Gjirokastër për periudhën 01.10.2025 deri më 31.12.2025, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky raport auditimi realizon qëllimin e tij, në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Gjirokastër.

Opinioni:

"Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Gjirokastër janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur *janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar*, e shprehur kjo në bazën për opinion.

Baza për opinionin të kualifikuar:

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Bashkia Gjirokastër, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", ISSAI 4000 dhe ISSAI 100. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 217, datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga Bashkia Gjirokastër dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e opinionit të **kualifikuar**[1] .

[1] Opinioni i kualifikuar, jepet kur: *-audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura;-audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të*

Opinionin e dhënë e mbështesim në parregullsitë e konstatuara, si më poshtë:
- Në 4 (katër) nga 9 (nëntë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", është konstatuar se, disa prej kritereve për kualifikim rezultojnë të paqartë apo të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe/ose të ekzagjeruar dhe/ose të argumentuara mbi bazën e parakushteve jo reale. - Në 2 (dy) nga 9 (nëntë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", konkretisht në procedurat e prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2025 me objekt "*Blerje automjeti zjarrfikëse*" dhe atë me objekt "*Blerje automjeti*", është konstatuar se, nga anëtarët e Komisionit të Përcaktimit të Specifikimeve Teknike, si rezultat i zbatimit të kuadrit ligjor, edhe pse specifikimet janë përcaktuar në mënyrë rendore dhe variabile (me marzh), ato janë të shoqëruara me një argumentim ligjor por jo me atë teknik, -Në 4 (katër) raste mbi auditimin e kontratave për punë publike, u konstatuan punime ndërtimi të pakryera, të përfshira në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Gjirokastër, në vlerën **1,203,695** lekë pa TVSH.
- Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve biznes që kanë ndaj Bashkisë Gjirokastër u konstatoua se deri në datë 31.12.2025, është në vlerën **57,071 mijë** lekë dhe i përket 834 bizneseve.
- Nga auditimi i dokumentacionit të administruar nga DPZHT lidhur me legalizimet e ndërtimeve pa leje, si dhe listat për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezultoi se Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Dega Gjirokastër, gjatë vitit 2025, detyrimi i krijuar për këtë taksë është në vlerën **3,709 mijë lekë**, ndërsa më datë 31.12.2025 gjendja debitorë totale është 5,534 mijë lekë, shumë e cila përfaqëson të ardhura të pa arkëtuara për Bashkinë Gjirokastër.
- Nga 191 raste të audituara biznes i madh u konstatua në 6 raste nuk janë tarifuar në përputhje me paketën fiskale në vlerën **425,000 lekë**.
- Në 1 (një) nga 9 (nëntë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", konkretisht në procedurën e prokurimit të zhvilluar gjatë vitit 2025 nga AK nuk është kërkuar konfiskimin e sigurimit të ofertës nga braktisja e garës në vlerën **219,666 lekë** (vlera e sigurimit të ofertës).

---

përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 515/2, datë 14.05.2026 "*Auditim financiar dhe Përputhshmërie në Bashkinë Gjirokastër*", të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin "*Bashkia Gjirokastër*", nga data 15.05.2025 deri në datën 30.06.2026, u krye "*Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë*", për periudhën nga data 01.01.2025 deri në datën 31.12.2025 nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. Z. S.K., Përgjegjës grupi
2. Z. K.T., Auditues
3. Z. K.H., Auditues
4. Z. P.Xh., Auditues

1. OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

Objektivat dhe Qëllimi i auditimit

- Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2025, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.
- Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me veprimtarinë e subjektit.
- Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.
- Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

2. Identifikimi i çështjes.

Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 "*Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi*", duke ofruar raporte të besueshme nëse fondet janë administruar siç duhet dhe nëse të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi. Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Gjirokastër, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me

korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.
Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.
Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Gjirokastër.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Gjirokastër, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*", i ndryshuar, Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", etj.

4. Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t, të cilat kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.
Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo Ligji i prokurimit publik, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e mëparshme;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.
Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Gjirokastër, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

5. Kriteret e vlerësimit.

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji Nr. 154/2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*";

▪ ***Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:***

- Ligji Nr. 84/2022, datë 24.11.2022 "*Për buxhetin e vitit 2023*", Ligji Nr. 97, datë 07.12.2023 *"Për buxhetin e vitit 2024"* dhe aktet normative që kanë ndryshuar këto ligje.
- Ligji Nr. 9869, datë 04.02.2008 "*Për huamarrjen e qeverisjes vendore*"
- Ligji Nr. 48/2014, datë 24.04.2014 "*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*" ndryshuar me Ligjin Nr. 24/2015, datë 19.903.2015;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 35, datë 5.11.2008 "*Për zbatimin e Ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 "Për huamarrjen e qeverisjes vendore*";
- Udhëzimi i MF Nr. 8, datë 29.03.2012 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*" i ndryshuar, për kontabilitetin;
- UMFE Nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", etj;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 5, datë 27.02.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*" ndryshuar me udhëzimin Nr. 5/1 datë 21.05.2014.
- Udhëzimin e Ministrisë Financave Nr. 22, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore*",
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë Financave, Drejtorit të Përgjithshëm të Radiotelevizionit Shqiptar Nr. 29, datë 18.12.2014 (Agjenti tatimor OSSHE faqe 4, "*Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive*"), Fletore zyrtare 196/2014;

▪ ***Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:***

- VKM Nr. 510, datë 10.06.2015 "*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*";
- Udhëzimi i MFE Nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar me UMFE Nr. 5, datë 21.2.2022, etj;
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave Nr. 3237, datë 16.07.2015 "*Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial*".

▪ ***Në fushën e prokurimeve publike:***

- Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar;
- VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar;
- Udhëzimi Nr. 5, datë 25.06.2021, i Agjencisë së Prokurimit Publik "*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*", i ndryshuar;
- UMF Nr. 57, datë 12,06.2014, "*Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë*".

▪ ***Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:***

- Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në RSH*", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9632, datë 30/10/2006 "*Për sistemin e taksave lokale*", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9975, datë 28.7.2008, "*Për taksat kombëtare*", i ndryshuar
- VKM Nr. 1064, datë 22.12.2010, "*Për disa ndryshime në VKM Nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave*" i ndryshuar;
- Udhëzim i MF Nr. 24, datë 02.9.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar;

▪ ***Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit:***

- Ligji Nr. 10279, datë 20.05.2010, "*Për kundërvajtjet administrative*";
- Ligji Nr. 10433, datë 16.06.2011 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*";
- Ligji Nr. 10448, datë 14.7.2011, "*Për lejet e mjedisit*";
- Ligji Nr. 107/2014, "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*";
- Ligji Nr. 44/2015 "*"Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë",* ";
- VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", e përditësuar;
- VKM Nr. 894, datë 4.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*";
- Udhëzimi i KM Nr. 1, datë 18.7.2012 "*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*" dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

▪ ***<u>Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:</u>***

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar
- Ligji nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar;
- *Rregullore e brendshme "Mbi procedurat e auditimit në KLSH";*
- *Rregullore e brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLS-së";*
- *Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.*
- *Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;*
- *Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.*

6. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 "*Udhëzues të auditimit financiar*";
- ISSAI 2300 "*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*";
- INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi standardet e kontrollit të brendshëm për sektorin publik"* si dhe INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*";
- ISSAI 400 "*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*", i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 "*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*";
- ISSAI 4200 "*Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*";
- INTOSAI "*Për implementimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit, ISSAI mbi auditimin e përputhshmërisë*"; etj.
- Standardet kombëtare të kontabilitetit;
- Standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare tëkontabilisteve IFAC;
- Manuali i auditimit financiar dhe i përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i auditimit të brendshëm, etj.
- Standardet ndërkombëtare të auditimit mbi raportimin e audituesit të pavarur, (IFAC);
- Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

7. Metodat e auditimit.

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me eficencë dhe efektivitet, duke u fokusuar

në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik dhe,
- Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin:

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësonjnë si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik*

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt nuk u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

- *Kontrolli i vlerësimeve*

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmimi nga të tretët*

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

- *Kontrolli sipas një treguesi*

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- *Intervista*
- *Raporte dhe Informacione*
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK*

8. Dokumentimi i auditimit.

Mbi bazën e pyetësorëve dhe testeve përkatëse të miratuara në manualet e auditimit financiar dhe përputhshmërisë, nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për

të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartuan Akt-Konstatimet, Akt-Verifikimet dhe Projekt Raporti i Auditimit, u përgatit ky Raport Përfundimtar i Auditimit dhe Opinioni i Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm.

Gjirokastra si qytet është qendra më të rëndësishme administrative, kulturore dhe ekonomike e rajonit jugor të Shqipërisë. Qyteti i Gjirokastrës është qendër e bashkisë, rrethit, qarkut dhe prefekturës me të njëjtin emër. Bashkia e Gjirokastrës shtrihet në një sipërfaqe prej 469.25 km². Sipas të dhënave zyrtare të Regjistrit Civil, territori i bashkisë numëron 52,054 banorë, ndërkohë që në njësitë administrative qëndrore jetojnë rreth 23,270 banorë.

Në këtë qytet funksionojnë disa institucione, agjensi dhe drejtori rajonale, si spitali rajonal "Omer Nishani", Drejtoria Rajonale e Monumenteve të Kulturës, Drejtoria rajonale e Bujqësisë dhe Ushqimit, Agjensia e Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria Rajonale e Arsimit, etj.

Në qytetin e Gjirokastrës prej më shumë se 40 vjetësh funksionon institucioni më i madh arsimor-akademik,Universiteti Publik "Eqrem Çabej" me 18 degë dhe programe mësimore

Pranë Gjirokastrës ndodhet Pika Kufitare dhe Doganore e Kakavies, që është pika kufitare me fluksin më të madh udhëtarësh dhe mallrash mes Shqipërisë dhe Greqisë. Gjirokastra si rreth përveç të qenit qendër administrative e rajonit, këtu kanë prezencën e tyre kompanitë më të njohura prodhuese dhe tregtare të vendit si: Glina, Fresh Kompani, Elka, Uji i Ftohtë Tepelenë, Harri Lena Grup, Feruni, SAM 0-13 Baby Clothes etj. Është gjithashtu edhe qendra më e madhe bankare në jug të Shqipërisë, ku kanë selinë e tyre: Banka e Shqipërisë, Banka Kombëtare Tregtare, Raiffaisen Bank, Intesa SanPaolo Bank, ABI-Bank, Alpha Bank, Tirana Bank, NBG Bank, Emporiki Bank, UNION BANK, Banka Popullore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim. Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

- *-njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;*
- *-respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;*
- *-zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;*
- *- ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;*
- *-realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;*
- *- dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;*
- *-realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.*

Bashkia Gjirokastër, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji Nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" dhe Ligji Nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar dhe përputhshmërisë të Bashkisë Gjirokastër për periudhën e aktivitetit 2023, 2024 dhe 2025, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese

dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT, SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT.

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.

Bashkia Gjirokastër, është e organizuar dhe funksionon në bazë Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" *dhe* Ligjit Nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes Vendore*", Rregullorja mbi Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Gjirokastër, etj. Aktet ligjore dhe nënligjore të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Gjirokastër.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

Si pjesa më e rëndësishme e raportimit të auditimit, në të përfshihen përshkrimet narative dhe gjetjet e auditimit të vlerësuara për sa i përket materialitetit, ligjshmërisë dhe evidencës faktike të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti nën auditim.

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

-Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-së.
-Organizimi dhe vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

I. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-së.

Ky auditim u krye në zbatim të Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- Mbrojtjes së informacionit e të aktiveve;

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Gjirokastër si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK-së nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e MFK-së kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm.
Konkluzioni në lidhje me vlerësimin e komponentëve të MFK-së në mënyrë të detajuar argumentohet si më poshtë:

I. Komponenti "Mjedisi i kontrollit":

Në lidhje me parimin 1 "Angazhimi për integritet dhe vlerat etike"
-Bashkia Gjirokastër nuk ka hartuar dhe miratuar Kodin e Etikës, por rregullat e etikës janë përfshirë në Rregulloren e Brendshme, në të cilat përcaktohen parimet që duhet të respektojë çdo punonjës në punën e tij, si dhe rastet e konfliktit të interesit për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në ketë. Institucion. Njohja e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, por nuk ka trajnime për këto raste.

-Në Rregulloren e Brendshme janë përcaktuar veprimet që parandalohen, të gjitha detyrimet dhe normat e sjelljes, ndërsa për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për Shërbimin Civil dhe Kodin e Punës.
-Ankesat nga jashtë depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (zyrën e marrëdhënieve me publikun), duke iu adresuar Kryetarit të Bashkisë dhe përgjigja kthehet nga drejtoritë përkatëse.
Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip, 1 herë në 6 muaj, ndërsa për punonjësit me Kod pune 1 herë në vit.
Në lidhje me parimin 2 "Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje"
-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse, që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë saj. Theksojmë se rregullorja e brendshme duhet të ndryshojë me qëllim përfshirjen e detyrave të reja për gjithë punonjësit sipas strukturës së miratuar.
- Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme, në detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha niveleve janë përcaktuar mënyra e raportimit të realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtorët e Njësive të Varësisë drejtuar Nënkryetarëve të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë. Për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse, janë mbajtur procesverbale.
-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.
-Është hartuar "Plani i veprimit për MFK-në në Bashkinë Gjirokastër", për vitin 2025 me nr. 1625 prot. , datë 29.02.2025,si dhe ka një raport "Mbi zbatimin e masave të marra në planin e veprimit për MFK në Bashkinë Gjirokastër", Memo me nr.4403 prot. datë 27.05.2024 e sekretares së GMS znj. A. K., dërguar Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër.
Ky plan nuk është zbatuar në kohë në të gjitha pikat e tij.
- Titullari merr opinione për përformancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese, Njësia e Harmonizimit në MFE.
- Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.
Në lidhje me parimin 3 "Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë".
- Është hartuar "Rregullorja e Brendshme e bashkisë Gjirokastër", referuar Vendimit nr. 65, datë 07.07.2021 "Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Gjirokastër", e ndryshuar me vendimin nr.16, datë 16.03.2023.
-Referuar formatit të "Manualit për MFK", përsa i përket pjesës për Rregulloren e Brendshme të Njësisë Publike, vihet re se përgjithësisht është hartuar bazuar në këtë manual dhe mbështetët në legjislacionin përkatës, duke përfshirë disa nga elementët thelbësore që një rregullore duhet të ketë.
Konstatohet se pas shkrirjes së Drejtorisë së Kulturës, Trashëgimisë, Turizmit dhe Sporteve, janë krijuar :
Agjencia për Aktivitete e Turizëm ,si dhe Agjencia e Trashëgimisë Kulturore, por nuk janë pasqyruar në Rregulloren e brendshme detyrat konkrete të punonjësve të këtyre agjencive.

- Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe plan veprimet e menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.
- Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e PBA-së, konfirmohet se kanë marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve (menaxherët e programeve), për të cilat janë mbajtur procesverbale të takimeve të tyre, apo procesverbale të takimeve me grupet e interesit, si dhe për dëgjesat me publikun.
- Mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën shkresore dhe elektronike.
- Është hartuar "Plani i veprimit për menaxhimin financiar "për periudhën e auditimit të vitit 2025 për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilin përfshihen aktivitetet, plan veprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.
- Për periudhën objekt auditimi është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë. Organi grama e Bashkisë Gjirokastër është e ndërtuar në mënyrë të tillë qënën/Kryetarët, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i Kabinetit, Drejtori i Auditit të Brendshëm dhe Administratorët e NJA varen direkt nga Kryetari, ku edhe llogaridhënia është direkt tek Kryetari i Bashkisë.

Për vitin 2023-2024 me Urdhër të Kryetarit nr. 945, datë 07.12.2022 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2023" që ka funksionuar deri në periudhën Janar-Tetor 2025me 604 punonjës të miratuar dhe strukturë: Kabineti dhe Drejtoritë përkatëse ndarë sipas sektorëve nga të cilët: 95 Nëpunës Civil dhe 509 punonjës që trajtohen me Kod Pune.

-Në periudhën 30 Tetor – 31 Dhjetor 2024 me Urdhër nr.730,datë 27.09.2024 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2024", rezultojnë 66 Nëpunës Civil dhe 557 punonjës që trajtohen me Kod Pune, gjithsej 623 punonjës.

Hyrjet e punonjësve për vitin 2024 janë 69, nga të cilët: 18 janë pozicione të Shërbimit Civil e 51 janë me Kod Pune.

-Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë baza ligjore, që i përket gjithë fushave të veprimtarisë saj. Për çdo Drejtori janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist, si dhe janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë. Po kështu edhe në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, kurse objektivat për secilin punonjës janë të pasqyruara në vlerësimet e punës.

-Bashkia Gjirokastër ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën janë paraqitur dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore (gjirokastër.gov.al) .

-Vlerësimin e punës së strukturës organike, bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performance.

Në lidhje me parimin 4 "Njësia publike demonstron angazhimin në realizimin e kompetencave"

- Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune dhe janë rishikuar për çdo vit. Janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nënndarjeve dhe fushave përkatëse.

Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit. Për çdo punonjës të rekrutuar është krijuar dosja personale, e cila përmban të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: certifikata e gjendjes familjare; diploma e shkollës së lartë, lista e notave; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera.

-Për bashkinë, nëpunësi autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organi gramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit. Me Vendim të KB nr. 113, datë 14.12.2023,është miratuar nga Këshilli Bashkiak "Buxheti për vitin 2025" dhe "Programi Buxhetor Afatmesëm 2024-2026". NA për vitin 2025 ka nxjerrë Urdhrin nr. 370, datë 16.05.2024 "Për një ndryshim në urdhrin nr.299 datë 15.05.2020, mbi ngritjen e GMS në Bashkinë Gjirokastër "
Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.
Në lidhje me parimin 5 "Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale"
Në Rregulloren e Brendshme janë parashikuar "funksionet/detyrat që delegohen" në zbatim të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokolli i institucionit rezulton se për periudhën objekt auditimi ka patur Urdhëresa për delegime detyrash.
Në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2019 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhra për ngritjen e GMS:
Nga verifikimi rezulton se GMS nuk ka kryer detyrat si:
-Nuk është mbledhur për të hartuar dhe miratuar "Planin Strategjik 5 vjeçar", veprim në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 8,pika 8,germa"b",neni 24,pika 2.
-Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar
-Janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS për hartimin e planit strategjik dhe PBA.

II. Komponenti "Menaxhimi i Riskut"

Në lidhje me parimin 6"Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva"
Bashkia Gjirokastër në hartimin e PBA-ve ka vendosur objektiva në planet operacionale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat sektoriale si edhe me vizionin dhe misionin e njësisë të përcaktuara në "Planin e përgjithshëm Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Gjirokastër". Këto objektiva bëhen të njohura, si në stafin e bashkisë nëpërmjet shkresave drejtuara Drejtorive dhe duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në këshillin Bashkiak, si dhe në dëgjesat me publikun.
-Bashkia Gjirokastër ka hartuar dhe miratuar "Regjistrin e Riskut në Bashkinë Gjirokastër", është hartuar sipas formatit që përcaktohet në "Manualin e MFK" dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë, më shkresën nr.12237 prot. datë 27.12.2023. Në përgjithësi është i plotësuar për të gjitha kategoritë që përmban një Regjistër Risku. Në këtë Regjistër janë përshkruar disa nga risqet kryesore, duke krijuar një pamje analitike të situatave, duke përcaktuar edhe nivelin e secilit prej risqeve, para dhe pas kontrollit. Gjithashtu janë përcaktuar nevojat për kontrollet e mëtejshme, veprimet për të zgjidhur mangësitë, duke identifikuar në të njëjtën kohë edhe zotëruesit e riskut.
Në lidhje me parimin 7 "Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave"

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen.
Në nenin 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, përcaktohet se "Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësive të tij, nëpunësi autorizues mund t'i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës".
Me Urdhër të Titullarit për përcaktimin e kordinatorit të MFK dhe koordinatorit të Riskut datë 16.05.2025 me urdhrin nr. 373, detyrë e deleguar znj. E. Ll.
Duke u përcaktuar kordinatori i riskut dhe grupi i menaxhimit të riskut si pasojë e veprimtarisë së tij, krijohen kushte për të identifikuar e vlerësuar të gjitha risqet e mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut
Në lidhje me parimin 8 "Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime"
Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.
-Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit tëriskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.
Në lidhje me parimin 9 "Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm".
-Bashkia Gjirokastër në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj nuk ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi ose riorganizimi i këtij institucioni, nga ndryshimet në menaxhim, duke mos marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

III. Komponenti "Aktivitetet e Kontrollit"

Në lidhje me parimin 10 "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli"
-Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave janë identifikuar pak a shumë edhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative etj).
-Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.
-Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës dhe Buxhetit (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Nëpunësi Zbatues/Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA.
-Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimit të mallit. Detyrat dhe përgjegjësit e NJHDT dhe KVO janë parashikuar edhe në kapitullin V të Rregullores së Brendshme.

-Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh dhe objekte prokurimesh.
-Ka delegim të NA të zv/kryetari me urdhrin nr. 981, datë 17.12.2024 ”Mbi delegimin e përgjegjësisë të NA pranë Bashkisë Gjirokastër”.
-Në Rregulloren e Brendshme “Specialist i Protokoll-Arkivit” përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit, ndërsa për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.
-Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivet afatgjata dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet i këtyre aktiveve.
Në lidhje me parimin 11“Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”
-Bashkia Gjirokastër nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Ruajtja e të dhënave bëhet në mënyrë shkresore dhe elektronike.
-Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up)apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikthimin e të dhënave.
Nga AB ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare kryhet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr.8, datë 09.08.2018 “Për hartimin e PF”). Nga auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

IV. Komponenti “Informimi dhe komunikimi”

Në lidhje me parimin 13 “Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor” Drejtuesit në Bashkinë Gjirokastër kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacionale, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.
-Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe dërgohen në MFE. Ka raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit fondeve dhe analiza faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.
-Në lidhje me parimin 14 “Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm, sistemin elektronik dhe shkresor”.
-Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.
-Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.
Në lidhje me parimin 15 “Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm” ka faqen e saj zyrtare.
Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në “Marrëdhëniet me mediat”, “Afishimi i akteve juridike”, “Praktika shkresore”.

Në lidhje me parimin 12 “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”

- Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, ku përgjegjësitë janë të identifikuara në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë.

-Në rregulloren e brendshme janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për të gjitha nivelet në të gjitha aktivitet e përfshira, duke eliminuar riskun që i njëjti person të mos kryejë dy detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar si hartim, miratim, zbatim, monitorim. “Marrëdhëniet me të tretët” “Marrëdhëniet me Publikun”, “ Zyra e shërbimit me një ndalesë”.

Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit herë pas here, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale dhe buxhetin e planifikuar.

Komunikimi zyrtar mes punonjësve të bashkisë realizohet me komunikim verbal e shkresor, gjithashtu kryhet edhe nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike zyrtare. Për mbledhjet e ndryshme të stafit drejtues dhe të menaxherëve me këshillin Bashkiak janë mbajtur procesverbale. Në faqen e Bashkisë Gjirokastër janë të publikuar dokumentet kryesore, broshura, planet strategjike, raportet periodike, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e Bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet, që ndodhin gjatë vitit buxhetor si edhe realizimet në fakt të shpenzimeve.

-Ka raporte periodike dhe publikime vjetore për përformancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

-Nga Bashkia Gjirokastër kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të cilat janë të evidentuara në dokumentin e konsultimit publik.

Në lidhje me komunikimin e jashtëm, Bashkia Gjirokastër ka një faqe zyrtare Ëeb në të cilën paraqiten informacione për publikun (gjirokastër.gov.al).

V. Komponenti “Monitorimi”

Në lidhje me parimin 16 “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”

-Procedurat periodike të raportimit, që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore lidhur me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efiçencës e të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

-Bashkia monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar çdo vit pranë Drejtorisë Përgjithshme e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave.

-Për vitin 2025 me shkresën datë 28.02.2025, të cilat janë dërguar Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave “Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Gjirokastër dhe Raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”.

Në këto dokumente të hartuara është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë në këto drejtime kryesore:

1. Vlerësimi i përformancës së Aparatit të Bashkisë nëpërmjet monitorimit.
2. Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas përshkrimit në pyetësorin e vetëvlerësimit. Veprimtaria e sektorit të Auditit të Brendshëm në investigimin e drejtorive të Aparatit të Bashkisë dhe njësive vartëse.
3. Rekomandimet të metat dhe mangësitë e gjetura.
4. Hartimi i plan-veprimeve për zbatimin e rekomandimeve dhe sidomos për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që përshkruhen në aktivitete e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe në përshkrimin e komponentëve të MFK.

Pjesë e Deklaratës është edhe fakti se si është realizuar ngritja dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej nëpunësit autorizues, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Kjo realizohet nëpërmjet:

Monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe të rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efiçencës e të efektivitetit.

Realizimit të "gjurmës së auditimit" që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Mbikëqyrjes së ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit. Udhëzimeve të dhëna dhe kryerjes së trajnimeve të nevojshme për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna, të cilat duhet të kuptohen dhe të arrihen nga punonjësit.

- Për periudhën objekt auditimi Bashkia Gjirokastër nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmët e auditimit në papajtueshmëri për vitin 2025.

-Për sistemin e kontrollit të brendshëm janë dhënë rekomandime nga KLSH dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të KBFP-së për vitin 2025.

-Në Bashkinë Gjirokastër aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të përfomancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

- Një nga drejtimet e monitorimit lidhet me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm.

Për vitin 2025 janë audituar nga Auditi i Brendshëm:

- Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore"
- Policia Bashkiake
- Njësitë Administrative
- Trajtimi i Studentit SH.A
- Drejtoria e Financës
- Drejtoria e Shërbimeve Komunitare, Utilitare
- Drejtoria e të Ardhurave, Taksave, Pronave dhe Licencave.

Në lidhje me parimin 17 "Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë"

-Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo të në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.
-Titullari i këtij institucioni si për rekomandimet e lëna nga KLSH edhe për ato të lëna nga Auditi i Brendshëm, është angazhuar për ndërmarrjen e masave korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.
Sa më sipër arrihet në konkluzion se:

Komponenti "Mjedisi i kontrollit".

-Bashkia Gjirokastër nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. Një problematikë tjetër e evidentuar është mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës.
Është një plan vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit por nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime.
-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.
-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 13 "Komitetit të Auditimit të Brendshëm" i cili përcakton se: "Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm."

Komponenti "Menaxhimi i Riskut".

Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Në këto kushte, evidentohet se Bashkia Gjirokastër nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

Komponenti "Aktivitetet e Kontrollit".

-Bashkia Gjirokastër nuk `ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT-së. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Ruajtja e të dhënave bëhet në mënyrë shkresore dhe elektronike. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT-së për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

Komponenti "Informimi dhe komunikimi"

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

Komponenti "Monitorimi"

-Në Bashkinë Gjirokastër mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, por është hartuar "Plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit".
-Në Bashkinë Gjirokastër aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të përfomancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.
-Njësia e Auditit të Brendshëm ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara. Bashkia Gjirokastër nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.
(Për sa më sipër, pas njohjes me projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Bashkia Gjirokastër, nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit).

II. Në zbatim të programit të auditimit nr. 515/2 prot., datë 14.05.2026, të pikës 1 të me objekt: "*Auditim mbi vlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditimit të brendshëm*", u audituа dokumentacioni si më poshtë:
1. Karta e auditimit të njësisë së AB të Bashkisë Gjirokastër;
2. Planet strategjike dhe vjetore, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Plani i auditimeve të brendshme për vitin 2025;
4. Raportimi vjetor në drejtorinë e përgjithshme të harmonizimit të auditit të brendshëm;
5. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
6. Projekt-raportet dhe raportet përfundimtare të auditimit të brendshëm të njësive publike;
7. Rekrutimi i punonjësve në njësinë e auditit të brendshëm dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

Kriteret e Vlerësimit:
1) Ligji nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*", i ndryshuar;
2) Urdhri nr.100, datë 03.02.2016i të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë "*Për miratimin e Manualin të Auditimit të Brendshëm*" i ndryshuar;
3) VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*";

<u>Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm.</u>

Në bazë të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik*" i ndryshuar, Struktura e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Gjirokastër, për vitin 2025, funksionon në nivel drejtorie, sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Gjirokastër nr. 101 datë 22.12.2025 "*Për miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2025,2026,2027*". Për sa më sipër është vepruar në përputhje me legjislacionin e brendshëm, si dhe në përputhje me Standardin Atributiv nr.1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm. Për vitin 2025, kjo Drejtori ka funksionuar me 3 punonjës në strukturë.

Struktura e Drejtorisë AB për vitin 2025

Nr.	2025	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime të vijueshme
1.	K.Q.	Drejtuese e NJAB	I lartë	37	2	jo	jo
2.	B.I.	Specialist	I lartë	22	3	jo	po

Nr.	2025	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime të vijueshme
3.	E.B.	Specialist	I lartë	1	1	jo	jo

Trajnimet e NjAB dhe çertifikimet

Audituesit e brendshëm duhet të zgjerojnë njohuritë, të rrisin aftësitë dhe zotësitë e tyre nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Përgjegjësia për trajnimin nuk është vetëm e drejtuesit të auditimit të brendshëm ose struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit, por çdo auditues duhet të përditësojë individualisht njohuritë dhe aftësitë e veta mbi zhvillimet e fundit, përmirësimet, standardet e auditimit dhe këshillat praktike mbi teknikat dhe praktikat e reja të auditimit. Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se i është kushtuar rëndësi trajnimeve të audituesve të NJAB sipas planit të trajnimeve, përpiluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.

Për vitin 2025 trajnimet e audituesve të NJAB për Bashkinë Gjirokastër pasqyrohen në tabelën e mësipërme.

- NJAB në Bashkinë Gjirokastër ka filluar procesin e çertifikimit për 1 auditues (Bashkim Isaraj).

<u>Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për periudhën 2025.</u>

Përgjatë periudhës janar-dhjetor 2025, nga DAB pranë Bashkisë Gjirokastër, janë kryer 6 auditime, miratuar me planin vjetor të punës me aktin nr. 9033/1 prot. Datë 11.10.2025.

Nr.	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT					
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit			
				Përputhshmërie	Financiare	Kombinuara	
2	Viti 2025	6	6	-	-	6	

Plani Strategjik 2025-2027 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2025 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm, me shkresën nr. 9050/1 datë 11.10.2024.

Për aktivitetin e veprimtarisë së Strukturës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2025 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm, me shkresën nr. 1428/1 datë 11.02.2025.

-Karta e auditimit të brendshëm është përgatitur dhe miratuar nga Titullari i Bashkisë Gjirokastër me shkresë nr. 548/2 prot, datë 20.01.2025.

<u>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:</u>

-Me Vendimin nr. 548/2, datë 20.01.2025, Kryetari i Bashkisë Gjirokastër, z. F.G. ka miratuar Kartën e Auditimit të Brendshëm për Bashkinë Gjirokastër. Karta e Auditimit të Brendshëm është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016";

-Plani strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, dhe është hartuar në përputhje me standardet e përcaktuar në MAB, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe aneksin me modelin përkatës në fundin e kapitullit III;

-Plani vjetor i auditimeve për vitin 2025 është përgatitur në mënyrë të rregullt, në përputhje me paragrafin 3.2 të Kapitullit III të MAB, si dhe me modelet përkatëse në po këtë kapitull;

-Struktura e projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare pjesë e dosjeve të auditimit të zhvilluar në vitin 2025, ka qenë në përputhje me urdhrin nr., 4 dt. 10.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
-Për vitin 2025, konstatohet se janë planifikuar 6 auditime, janë realizuar 6 auditime.
-Në dosjet e auditimit ndodhen konfirmimet e raporteve të bëra nga subjektet e audituara, në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga njësia e auditimit, veprime, të cilat përputhen me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe të kapitullit VI "Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese" të Manualit të Auditimit të Brendshëm , miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave me nr. 100, datë 25.10.2016.
U audituan (me zgjedhje) 3 dosje auditimi (Njësitë Administrative; Drejtoria e Shërbimeve Komunitare, Utilitare; Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore), ku rezultoi se në dosje ishte dokumentacioni:

Drejtoria e Shërbimeve Komunitare, Utilitare Gjirokastër
- Autorizimi për caktimin e grupit të punës për të kryer angazhimin e auditimit nr. 1972/2 Prot., datë 27.02.2025.
- Njoftimi paraprak për fillimin e angazhimit të auditimit nr. 1972/1 prot., datë 27.02.2025.
- Takimi fillestar për fillimin e misionit të auditimit datë 05.03.2025.
- Deklarata e konfliktit të interesit datë 10.03.2025.
- Programi i angazhimit të auditimit nr. 1972 prot., datë 27.02.2025.
- Dokumentet që lidhen me kryerjen e angazhimit të auditimit,
- Testet dhe shënimet e mbajtura nga audituesi,
- Projekt raporti i auditimit nr. 3760 prot., datë 18.04.2025.
- Raporti përfundimtar i auditimit nr. 4163/1 prot., datë 02.05.2025.
- Memo (përmbledhja e shkurtër përfundimtare) e cila i është paraqitur titullarit të institucionit nr. 4163/2 prot., datë 02.05.2025.
- Kontrolli i vlerësimit të cilësisë për monitorimin e brendshëm.
- Reagimet (feedback) e auditimit.
- Plani i veprimit i dërguar nga subjekti i audituar.

Njësitë Administrative
- Autorizimi për caktimin e grupit të punës për të kryer angazhimin e auditimit nr. 134 prot., datë 07.01.2025.
- Njoftimi paraprak për fillimin e angazhimit të auditimit nr. 134/2 prot., datë 07.01.2025.
- Takimi fillestar për fillimin e misionit të auditimit datë 10.01.2025.
- Deklarata e konfliktit të interesit datë 15.01.2025,
- Programi i angazhimit të auditimit nr. 134/1prot., datë 07.01.2025.
- Dokumentet që lidhen me kryerjen e angazhimit të auditimit.
- Testet dhe shënimet e mbajtura nga audituesi.
- Projekt raporti i auditimit nr. 1349/1 prot., datë 10.02.2025.
- Raporti përfundimtar i auditimit nr. 1597 prot., datë 17.02.2025.
- Memo (përmbledhja e shkurtër përfundimtare) e cila i është paraqitur titullarit të institucionit nr. 1597/1 prot., datë 17.02.2025.
- Kontrolli i vlerësimit të cilësisë për monitorimin e brendshëm.
- Reagimet (feedback) e auditimit.
- Plani i veprimit i dërguar nga subjekti i audituar.

Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore
- Autorizimi për caktimin e grupit të punës për të kryer angazhimin e auditimit nr. 4173/1 prot., datë 02.05.2025.
- Njoftimi paraprak për fillimin e angazhimit të auditimit nr. 4173 prot., datë 02.05.2025.

- Takimi fillestar për fillimin e misionit të auditimit datë 13.05.2025.
- Deklarata e konfliktit të interesit datë 15.05.2025.
- Programi i angazhimit të auditimit nr. 4173/2 prot., datë 02.05.2025.
- Dokumentet që lidhen me kryerjen e angazhimit të auditimit.
- Testet dhe shënimet e mbajtura nga audituesi.
- Projekt raporti i auditimit nr. 5144 prot., datë 03.06.2025.
- Raporti përfundimtar i auditimit nr. 5517 prot., datë 11.06.2025.
- Memo (përmbledhja e shkurtër përfundimtare) e cila i është paraqitur titullarit të institucionit nr. 5517/1 prot., datë 11.06.2025.
- Kontrolli i vlerësimit të cilësisë për monitorimin e brendshëm.
- Reagimet (feedback) e auditimit.
- Plani i veprimit i dërguar nga subjekti i audituar.

Për vitin 2025, janë rekomanduar gjithsej 47 rekomandime si më poshtë:
Në subjektin "Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore", 3 rekomandime;
Në subjektin "Policia Bashkiake", 15 rekomandime;
Në subjektin "Njësitë Administrative", 2 rekomandime;
Në subjektin "Trajtimi i Studentit SH.A", 6 rekomandime;
Në subjektin "Drejtoria e Financës", 6 rekomandim;
Në subjektin "Drejtoria e Shërbimeve Komunitare, Utilitare", 15 rekomandime;

Për vitin 2025 janë dhënë gjithsej 47 rekomandime dhe nga auditimii NJAB i kryer për zbatimin e rekomandimeve rezulton se 27 rekomandime janë zbatuar, 17 rekomandime janë në proces zbatimi. Zbatimi i tyre është rreth 58 %, por procesi i zbatimit të tyre vazhdon të ndiqet si nga vetë subjektet ashtu dhe nga Auditimi i Brendshëm.
Gjatë vitit 2025 është realizuar auditim i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e vitit 2024, kjo sipas programit të angazhimit me nr. 10150/2prot., datë 03.10.2025. Ky auditim ka përfunduar dhe është hartuar raporti i auditimit me shkresën nr. 11399/1prot., datë 03.11.2025.
Bazuar në UMF nr. 42, datë 27.10.2020, "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik", janë hartuar dokumentet standarde për auditimet për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve si,
a. Program i angazhimit të auditimit të verifikimittë zbatimit të rekomandimeve;
b. Autorizim për kryerjen e auditimit për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve;
c. Formulari përmbledhës për zbatimin e rekomandimeve, për secilin subjekt;
d. Raport vjetor i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve.
e. Njoftimi paraprak për fillimin e angazhimit të auditimit
f. Deklarata e konfliktit të interesit
g. Projekt raporti i auditimit
h. Memo (përmbledhja e shkurtër përfundimtare) e cila i është paraqitur titullarit të institucionit
Raportimi i zbatimit të rekomandimeve i është dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 2193 prot, datë 05.03.2026.

Për vitin 2025 janë dhënë gjithsej 47 rekomandime dhe nga auditimi i kryer për zbatimin e rekomandimeve rezulton se 27 rekomandime janë zbatuar, 17 rekomandime janë në proces zbatimi. Zbatimi i tyre është rreth 58 %, por procesi i zbatimit të tyre vazhdon të ndiqet si nga vetë subjektet ashtu dhe nga Auditimi i Brendshëm.

Vlerësimi i dokumentimit të punës audituese.
Nga njësia e AB të bashkisë, është plotësuar inventari i sugjeruar i dosjes koherente tëauditimit, si dhe dosjet e përhershme për të gjitha subjektet që auditohet nga kjo njësi, ku janë plotësuar me dokumentacionin përkatës, kjo sipas kërkesave te Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapit. VI "Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese", formati 1 "Inventari i sugjeruar i dosjes koherente të auditimit" si dhe pikës 6.3 "Dosja e përhershme".
Nga ekzaminimi i dokumentacionit, u vu re se të gjithë dosjet e evaduar janë arkivuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat" dhe në zbatim të tij "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor te Republikës së Shqipërisë". Dosjet e auditimit vlerësohen të plotësuara sipas kërkesave të manualit, dhe të gatshme për arkivim.

Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm
Programi i sigurimit të cilësisë është projektuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm me qëllimin e krijimit të shërbimit të auditimit të brendshëm si dhe për të vlerësuar nëse audituesit e brendshëm e zbatojnë Kodin e Etikës dhe Standardet. Programi i sigurimit të cilësisë, vlerëson efikasitetin, efektivitetin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, si dhe identifikon mundësitë për përmirësim.

Dosja e përhershme
Njësia e Auditimit të Brendshëm mban një dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet. Kjo dosje është plotësuar bazuar në kërkesat e manualit të auditimit të brendshëm.

Mbi veprimtarinë e Komitetit të Auditimit të Brendshëm,
Bashkia Gjirokastër ka ngritur Komitetin e Auditimit të Brendshëm, në përputhje me nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar. Nga materialet e vëna në dispozicion, raporti dërguar Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër, z. F.G. dhe procesverbalet e mbledhjeve të zhvilluar nga ky organ, rezulton se përbërja dhe veprimtaria e Komitetit të Auditimit të Brendshëm ka qenë në përputhje me Ligjin nr. 114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"si dhe me VKM nr. 160/2016, "Për mënyrat e Funksionimit, Kompetencat dhe Përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

- Në Bashkinë Gjirokastër nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm.

Sinjalizimi dhe mbrojtja e sinjalizuesve
Është hartuar rregullorja për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e kofidencialitetit në Bashki në përputhje me ligjin nr. 60/2016 "*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit*". Janë hartuar regjistri i sinjalizimit të brendshëm dhe regjistri i kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja si detyrim ligjor i njësisë së auditimit në përputhje me ligjin nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".
Sa më sipër Dokumentet e auditimit janë hartuar në përputhje me standardet dhe përcaktimet e Manualit të Auditit të Brendshëm.
(Për sa më sipër, pas njohjes me projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Bashkia Gjirokastër, nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit).

2.2. Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit buxhetor.
2.2.1 Programi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.
2.2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

2.2.3 Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.
2.2.4 Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.
2.1.5 Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrave të pa arkëtuara progresive e shpronësimeve.

2.2.1 Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Nga auditimi i procesit të hartimit të PBA-së 2025-2027 dhe dokumentimit të hapave të ndjekura rezulton se:
- Për realizimin e fazave të përgatitjes PBA është **ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik** (GMS) për PBA 2025-2027 me Urdhrin nr. 370 datë 16.05.2024 .
- Është përgatitur dhe **miratua**r **kalendari i PBA** 2025-2027 dhe buxhetin vjetor 2025 me VKB nr. 106 datë 14.12.2023 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 1053/1prot., datë 26.12.2023në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* neni 33/1.
- Janë miratuar për PBA 2025-2027 me VKB nr. 08 datë 31.01.2024 "Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2025-2027 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr.119/1 prot., datë 08.02.2024.
- Janë miratuar në Këshillin Bashkiak **tavanet përgatitore** për PBA 2025-2027 me VKB nr.18, datë 29.03.2024, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 293/1 prot., datë 04.04.2024 në kundërshtim me afatet e përcaktuara në pikën 63 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".*
-Udhëzimi i Kryetarit për përgatitjen e buxhetit afatmesëm nuk është hartuar në kundërshtim me pikën nr. 64 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".* Kryetari i Njësisë Vendore 5 ditë pas miratimit të tavaneve buxhetore duhet të miratoj udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njësisë dhe duhet ta shpërndaj atë.
- Pas miratimit të tavaneve përgatitore **për përgatitjen e PBA** 2025-2027 **është hartuar Udhëzimi i Kryetarit** të Bashkisë nr. 219, datë 11.04.2024 në kundërshtim me pikën nr. 64 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".* Kryetari i Njësisë Vendore 5 ditë pas miratimit të tavaneve buxhetore duhet të miratoj udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njësisë dhe duhet ta shpërndaj atë.
- PBA 2025-2027 Faza e parë, është dërguar në MF me shkresën me 4665, datë 31.05.2024. Nga Ministria e Financave janë dërguar rekomandimet me shkresën nr.prot. 8592, datë 19.06.2024.
Me VKB nr. 42, datë 05.07.2024 është miratuar dokumenti *"Për miratimin e dokumentit të parë PBA 2024-2026"*,dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 589/1 datë 17.07.2024.
Pas përfundimit të fazës së parë dhe pas rekomandimeve të MF, është dërguar nga MF udhëzimi plotësues nr. 8 datë 05.07.2024 "Për përgatitjen e PBA vendor 2025-2027".
- **Tavanet përfundimtare** të PBA 2025-2027 janë miratuar me VKB nr. 50, datë 31.07.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 657/1prot., datë 12.08.2024.
Në kundërshtim me ligjin nr.68/2017, neni 37, pika 1 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* dhe udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore" pika 79* "*Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim, brenda datës 15 korrik, tavanet*

përfundimtare në Këshillin e Njësive Vetëqeverisjes Vendore. Këshilli miraton tavanet përfundimtare brenda datës 20 korrik".

- Faza e dytë e PBA

Kalendari i konsultimeve publike nuk është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak në kundërshtim me udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore" pika 82 " *Pas finalizimit të projektit të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa për publikimin e tij dhe më pas organizon seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit gjatë periudhës 1-15 shtator Procesverbalet e takimeve së bashku me qëndrimet përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore, behën pjesë e dokumentit të projektit të PBA".*

Pika 84 "Pas reflektimit të sugjerimeve brenda datës 15 shtator, njësia e vetëqeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dokumentin e PBA të rishikuar, të miratuar nga këshilli i njësisë, së bashku me informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës së parë".

PBA 2025-2027 dhe buxheti i vitit 2025 për Bashkinë Gjirokastër janë miratuar me VKB nr. 86, datë 12.12.2024 i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 1010/1 datë 26.12.2024.

Në fazën përfundimtare duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor trevjeçar sipas programeve si për shpenzimet korente, ashtu edhe për investimet dhe të ardhurat.

Tabela 1: Programimi i shpenzimeve për vitin 2025-2027 Bashkia Gjirokastër dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.

000/lekë

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
		000/lekë	000/lekë	000/lekë
1	AA115 Aparati dhe Menaxhimi I Bashkise	211,565	195,732	204,657
2	AB115 Shërbimi Social dhe Shëndetësor	23,911	27,870	25,026
3	AC115 Turizmi Trashëgimia Arti Kultura dhe Sportet	95,171	84,613	85,464
4	AD115 Siguria Publike	125,634	81,210	86,940
5	AE115 Shërbimet Publike Komunitare dhe Utilitare	272,820	275,251	281,093
6	AF115 Mbështetje për arsimin	218,631	255,246	262,224
7	AG115 Zhvillimi Ekonomik, Bujqësisë dhe Pylltarise	81,938	98,376	93,391
8	AH115 Rezerva dhe fondi I kontigjences	9,000	9,090	9,180
Totali		1,038,670	1,027,388	1,047,975

Burimi: Punoi Grupi i Auditimit

Tabela 2: Planifikimi i shpenzimeve në PBA 2025-2027 sipas llogarive dhe peshës specifike që zënë ato në totalin e shpenzimeve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

000/lekë

Nr.	**Shpenzimet sipas llogarive**	**Viti 2025**		**Viti 2026**		**Viti 2027**	
		000/lekë	**% ndaj/tot**	**000/lekë**	**% ndaj/tot**	**000/lekë**	**% ndaj/tot**
1	Paga (600)	556,736	54%	452,720	52%	457,292	52%
2	Sigurime (601)	89,178	9%	71,931	8%	72,605	8%
3	Shpenzime operative (602)	186,899	18%	158,372	18%	159,792	18%
4	Shpenzime (603)	1,300	0%	1,225	0%	1,225	0%
5	Shpenzime (604)	33,140	3%	21,762	3%	21,762	2%
6	Shpenzime (606)	3,000	0%	2,336	0%	2,753	0%
7	Shpenzime (609)	9,000	1%	8,204	1%	8,286	1%
8	Shpenzime për investime (230-231)	159,417	15%	146,357	17%	162,934	18%
Totali		**1,038,670**	**100%**	**862,907**	**100%**	**886,649**	**100%**

Burimi: Punoi Grupi i Auditimit

Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2025

Buxheti **për vitin 2025** është miratuar me VKB nr. 86, datë 12.12.2024, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 1010/1 datë 26.12.2024. Plani fillestar i miratuar për vitin 2025 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 3: Të dhënat mbi buxhetin fillestar.

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani fillestar i vitit 2025	
		Të ardhurat	Shpenzimet
1	Transferta e pakushtëzuar	445,274	
2	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	291,470	
3	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore + Institucionet e varësisë	270,781	
4	Të ardhura të tjera	31,145	
1	Shpenzime për paga (600)		556,736
2	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601)		89,178
3	Shpenzime operative		186,899
4	Subvencione (603)		1,300
5	Transferta (604+606)		36,140
6	Fondi rezervë+Fondi I kontigjencës (609)		9,000
7	Shpenzimet kapitale (230+231)		159,417
8	Principali+Interesi I kredisë (166+651)		
	Total	**1,038,670**	**1,038,670**

Burimi: *Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit*

Rezulton se buxheti i konsoliduar është miratuar i balancuar dhe pa deficite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **1,038,670 mijë lekë**.

Planifikimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2025 është bërë si vijon:

Gjatë vitit 2025 sipas VKB Nr. 86, datë 12.12.2024 janë parashikuar shpenzime kapitale në vlerën 159,417 mijë lekë të cilat do të financohen nga të ardhurat e veta dhe transferta e pakushtëzuar.

-Likuidime për investime të përfunduara për të cilat janë akumuluar detyrime të prapambetura është parashikuar të likuidohet shuma 13,320 mijë lekë.

-Investime të reja të planifikuara gjatë vitit 2025 janë në vlerën 146,097 mijë lekë.

Tabela 4: Investimet e parashikuara për periudhën 2025-2027 me mbulim nga transfertat e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta.

000 lekë

Nr.	Emri i programit/objektit	Origjina e te ardhurës	2025	2026	2027
1	Projekte te Planifikimit Urban	Transf e pakushtezuar	3,000	10,000	1,000
2	Rikonstruksioni i rrugës në fshatin Zhulat, Gjirokastër Loti I	Te ardhurat e veta	5,956		
3	Rikualifikim i hapësirave publike	Te ardhurat e veta	35,000	24,291	30,000
4	Rehabilitim i rrugëve urbane	Te ardhurat e veta	9,938	4,290	25,000
5	Rivitalizim i hapësirave rreth Pallatit te Sportit Luftëtari	Te ardhurat e veta	12,555		
6	Sistemim asfaltim rruga Taroninë-Zhulat	Transf e pakushtëzuar	13,343	48,231	
7	Modernizimi i ndriçimit rrugor publik në qytet, faza e dytë	Te ardhurat e veta	7,309		
8	Rikonstruksion kanale vaditëse	Te ardhurat e veta	5,000	20,000	4,000
9	Rikonstruksion Lerash	Te ardhurat e veta	5,000		16,000
10	Masa inxhinerike për mbrojtjen e skraptës në Lagjen Cfakë (Ura e Nanxës- Ura Zerzebilit)	Transf e pakushtëzuar	40,000		

Burimi: *Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit*

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës specifike dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për

funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësimi). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.
-Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë Degës së Thesarit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.
-Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.
Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregon se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.
Gjatë vitit 2025 janë miratuar disa vendime të tjera të Këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë.
Në aneksin 2/1/1 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur tabela me të dhënat përmbledhëse për planifikimin e buxhetit dhe ndryshimet për vitin 2025 sipas VKB-ve.
Në aneksin 2/1/2 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur tabela me të dhënat përmbledhëse për planifikimin e buxhetit sipas burimeve të të ardhurave dhe ndryshimet për vitin 2025 dhe ndryshimet sipas VKB-ve.

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.
Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Gjirokastër, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv buxhetor, të miratuar me Vendim të KB, apo nga ndryshimet e transfertave të pakushtëzuara sektoriale nga pushteti qendror, nga auditimi i shkresave, evidencave të çeljeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Gjirokastër, u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

Për vitin 2025 realizimi i treguesve të buxhetit në nivel bashkie, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet **në tabelën nr. 5** si mëposhtme:

000/lekë

Institucionet	600 (paga)		601(sigurime)		602(shp.operative)		603-609(transf indivi)		230-231(investime)		166+651(kredi)		Totali	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Bashkia	554,764	496,469	89,559	82,333	235.140	163,683	66,624	55,147	305,514	181,907			1,251,601	979,538
Fonde te kushtezuara	7,932	7,869	1,403	1,273	5,167	2,953	188,229	179,000	60,178	37,664			262,909	228,760
TOTALI	**562,696**	**504,338**	**90,962**	**83,607**	**240,307**	**166,636**	**254,852**	**234,147**	**365,692**	**219,571**			**1,514,511**	**1,208,299**
Perqindja e realizimit	**90%**		**92%**		**69%**		**92%**		**60%**				**80%**	

Burimi: *Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit*

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërm, niveli i realizmit të treguesve të buxhetit:
Për **vitin 2025** fondet buxhetore janë realizuar 1,208,299 mijë lekë nga 1,514,511 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 80%. Në këtë masë realizimi ka ndikuar mosrealizimi në zërat e buxhetit:
Shpenzimet për investime llog. 230-231 janë realizuar 219,571 mijë lekë nga 365,692 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 80%.

Shpenzimet operative llog. 602 janë realizuar 166,636 mijë lekë nga 240,307 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 69%.

Realizimi i buxhetit në drejtim të shpenzimeve në mënyrë të përmbledhur për Bashkinë Gjirokastër paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabelë nr. 6: Tabela e përgjithshme buxhetit (shpenzimet) e përmbledhur:

Në 000/lekë

Shpenzimet sipas llogarive ekonomike	Plani vjetor fillestar 2025	Plani përfundimtar 2025	Plani i çelur 2025	Realizimi i shpenzimeve 2025	% e realizimit/ planit vjetor
Shpenzime për paga (600)	556,736	652,695	533,102	504,338	90%
Shp. për sig shoq e shëndetësore (601)	89,178	90,962	85,265	83,605	92%
Shpenzime operative (602)	186,899	240,307	223,646	166,636	69%
Subvencione (603)	1,300	1,800	1,586	1,636	91%
Transferta tek organizatat (604)	33,140	53,054	42,040	45,486	86%
Transferta tek individët (606)	3,000	191,295	190,000	187,025	98%
Fondi rezervë+e kontigjencës (609)	9,000	8,703	0	0	0%
Shpenzime për Oponenca teknike (230)	1,000	12,384	5,000	4,892	40%
Shpenzime për Investime (231)	158,417	353,307	312,178	214,677	61%
a.Nga te ardhurat e transf e pakushtez, specifike	158,417	293,129	252,000	177,014	60%
b.Nga Ministrite linjes		60,178	60,178	37,663	63%
Total	**1,038,670**	**1,454,329**	**1,332,639**	**1,170,632**	**80%**
Total Bashki + Institucione	**1,038,670**	**1,514,507**	**1,392,817**	**1,208,295**	

Burimi: *Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit*

-Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre:

Për vitin 2025 janë planifikuar në vlerën 305,514 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 181,906 mijë lekë ose realizuar në masën 59%. Janë planifikuar fonde për financimin e 48 projekteve të investimit, nga të cilat 13 projekte janë financuar plotësisht sipas planit të vitit.

Tabelë nr.7: Investimet e realizuara me fonde të Bashkisë Gjirokastër.

Nr.	Emri i programit/objektit	Fondi limit
1	Detyre projektimi Permisimi I rruges Kolonje Golem	3,834,777
2	Oponence teknike sipas Akt mareveshjes 2565 rik I shkolles 9 vj Urani Rumbo	118,189
3	Oponence teknike sipas Akt mareveshjes 2565 rik I shkolles 9 vj Andon Zako Cajupi	172,750
4	Projekt rivelim gjeologo inxhinerik	164,300
5	Oponence teknikerikonstruksion I rruges kolonje golem	301,697
6	Oponence TekinkeSip akt marreveshje 9299 rikonstr rruges Baba Selim	152,829
7	Oponence teknike Rikulaif I amb te tregut te produkteve buq dhe blektorale si dhe rrugen e aksit mareveshje 9469	97,826
8	Oponence gjeologo inxhinerike	50,000
9	Riveshje asfaltike ne rrugen Dhoklsat	4,535,760
10	Rehabilitim I segmenteve te ndryshme rrugore	11,570,554
11	Kolaudim Rehabilitim I segmenteve te ndryshme rrugore	47,317
12	Hidroizolim dhe riparim ulluqesh gjimnazi Siri Shapllo	257,952
13	Rikonstruksion I rruges ne fshatin Zhulat Gjirokastër	5,955,291
14	Mobilim I kinemase multifunksionale try Gjirokastër	1,391,500
15	Modernizim I ndricimit Rrugor publik faza e dyte 2024 2025	13,450,536
16	Blerje paisje zyre	475,992.
17	Rivitalizim I hapësirave rreth Pallatit te sportit	20,075,310
18	Mbikqyrje Rivitalizim I hap publike rreth pallatit te sportit	266,444
19	KolaudimRivitalizim I hap publike rreth pallatit te sportit	31,973
20	Rik I palestres shkolla e mesme Asim zeneli shk Drita	3,307,136
21	Mikqyrje Rik I palestres shkolla e mesme Asim zeneli shk Drita	391,338
22	Kolaudim Rik I palestres shkolla e mesme Asim zeneli shk Drita	53,425
23	Blerja e nje kompjuteri dhe laptopi për qendren komunitare	112,800
24	Rehabilitim I segmenteve te ndryshme rrugore	26,096,656
25	Blerje paisje dron	228,000
26	Blerje krevati fizioterapik	82,200
27	Blerje automjti zjarrfikes Loti I	11,280,000
28	Orendi Karrige	718,078
29	Rikonstruksion lerash	3,701,756
30	Mikqyrje Rikonstruksion lerash	108,532
31	Kolaudim objekti	16,279
32	Sistemim asfaltim rruga Taronine Zhulat	38,864,500
33	Rinovim paisja Qendres Komunitare utilitare	756,000

34	Mbikqyrje Masa inxhinerike për stabilizim e rreshkitjes se mases ne kodren e cfakes prane rr nacionale gjirokaster kakavi	1,324,433
35	Blerje makine teknologjike	3,600,000
36	Blerje automjeti policia	999,999
37	Fusha Stervitore Gjirokastër Situacion I pare	14,757,729
38	Kolaudim Permisimi I kushteve te banimit komunitetet e varfera te pafavorizuara	6,856
39	Mikqqyrje obj Rikonstruksion I kinemae Try Gjirokastër	106,500
40	Rikonstruksion dhe permisim I eficences energjitikene shkollen Muhamet Gjollesha	3,475,156
41	Mbikq Rikonstruksion dhe permisim I eficences energjitikene shkollen Muhamet Gjollesha	364,390
42	Mbikq Rikonstruksion dhe permisim I eficences energjitikene shkollen Muhamet Gjollesha	43,726
43	Blerje makine frigoriferike	3,000,000
44	Mbikq I obj Rikonstruksion I rruges Baba Selim	375,325
45	Blerje paisje kompjuterike	139,180
46	Mbikqyrje objketi Rikonstruksion I shkalles se emergjences dhe dhomes teknike Urni Rumbo	41,258
47	Masa inxhinerike për stabilizim e rreshkitjes se mases ne kodren e cfakes prane rr nacionale gjirokaster kakavi	4,947,296
48	Mbikqyrje Permisimi I kushteve te banimit komunitetet e varfera te pafavorizuara	57,136
Total		**181,906,690**

Burimi: *Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit*

Fondet për investime të financuara nga Ministritë e Linjës:

Për vitin 2025 janë planifikuar në vlerën 60,178 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 37,663 mijë lekë ose në masën 62 % për 3 projekte.

Tabelë nr. 8: Investimet e realizuara me fonde të buxhetit të shtetit

Projekti i investimit	Kontrata	Vlera e Kontratës	Plan 2025	Fakt 2025
Përmirësimi infrastrukturës kryesisht në zonat informale "Rikonstruksion i rrugës Baba Selimi, Zinxhira Gjirokastër"	12202 dt 21.11.2025	50,466,731	27,998,613	24,003,672
Rikonstruksion i godinës ekzistuese dhe shkallës emergjencës dhe dhomës teknike në shkollën 9-vjecare Urani Rumbo, Bashkia Gjirokastër	11467 dt 04.11.2025	73,498,636	14,794,672	3,166,542
Rikontsruksion dhe përmirësim i eficencës energjetike shkolla e mesme Muhamet Gjollesha	10565 dt 19.11.2024	17,375,781	17,384,999	10,463,291
Total		**141,341,148**	**60,178,284**	**37,633,505**

Burimi: *Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit*

Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Gjirokastër së bashku me transfertat e pakushtëzuara dhe specifike, për vitin 2025 kanë diferenca me vlerën e planifikuar.

Për vitin 2025 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 1,454,329 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 1,170,632 mijë lekë, ose në masën 80 %.

Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2025 investimet me të ardhurat e veta dhe transfertat janë planifikuar në vlerën 305,514 mijë lekë, realizuar 181,907 mijë lekë, ose në masën 59.5%

Ky mos realizim vjen si rezultat i mospasjes së fondeve në llogarinë e thesarit në momentin e lidhjes së kontratës Bashkia Gjirokastër në fillim të vitit buxhetor duhet të planifikohen angazhime buxhetore realiste.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ku citohet:

"*Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji".*

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe kontigjencës si dhe fondeve të emergjencave civile:

a. Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës.

Për vitin 2025 fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës është në total në shumën 9,000 mijë lekë, i cili është miratuar në buxhetin fillestarme VKB nr. 86 datë 12.12.2024 *"Për miratimin e Buxheti vjetor 2025 dhe PBA 2025-2027"* konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 1010/1 datë 26.12.2024.

Për vitin 2025*"Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile"* Bashkisë i është akorduar *fondi në vlerën* ***7,000 mijë lekë*** me VKB nr. 75, datë 31.10.2024 është bërë miratimi i përdorimit të fondeve të lira të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabelë nr. 9: Përdorimi i fondeve për mbrojtjen civile

Në lekë

Nr.	Emërtimi I shpenzimeve	Shuma e planifikuar	Përdorimi	Mbetja
1	Shpenzime për marrjen e masave parandaluese lehtesuese emergjencatcivile) kod 91707AG	7,000,000	763,200	6,238,800
Total		**7,000,000**	**763,200**	**6,238,800**

Burimi: *Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit*

Gjatë vitit 2025 nga fondet e bashkisë janë përdorur edhe 500,000 lekë për ndihmë financiare familjeve të dëmtuara nga zjarri. Këto fonde jepen të detajuara si më poshtë:

- Me VKB nr.25 datë 28.02.2025 për dhënien e ndihmës financiare z. V. K., për dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesën e tij në vlerën 500,000 lekë.

- *Raportet e Monitorimit.*

Për vitin 2025 janë dërguar në MFE raportet e detajuara simë poshtë:

"Raport monitorimi Janar-Prill 2025" me shkresën nr. 5032 prot datë 30.05.2025

"Raport monitorimi Janar-Gusht 2025" me shkresën nr. 10027 prot datë 30.09.2025

Raporti i monitorimit Janar-Dhjetor 2025 me shkresën nr. 2361 prot datë 10.03.2026

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Bashkia Gjirokastër në datën 01.01.2025 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta dhe granti në vlerën 2,354 mijë lekë. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2025 është planifikuar për likuidim gjatë vitit 2024 vlera 2,354 mijë lekë si më poshtë.

Në lekë

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës viti 2024	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr. /datë	Llog 602+606	Llog. 230+231
Viti 2025	2,354,462	2,354,462	VKB nr.86, datë 12.12.2024	2,354,462	

Burimi: *Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit*

Gjatë vitit 2025 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 36,544 mijë lekë dhe janë likuiduar detyrime në vlerën 34,092 mijë lekë. Totali progresiv i detyrimeve të prapambetura në datë 31.12.2025 është në vlerën 4,806 mijë lekë.

Tabelë nr. 10: Detyrimet e prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2025

Në lekë

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit I mbartur 31.12.2024	Detyrimi I krijuar në periudhën 01/01/2025 – 31.12.2025	Total detyrime	Shlyerja e detyrimeve 2025	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2025
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministritë e linjës e FZHSH	0	0	0	0	0
b. Investime nga Bashkia	0	23,000,867	23,000,867	23,000,867	0
INVESTIME :	**0**	**0**	0	**0**	0

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit I mbartur 31.12.2024	Detyrimi I krijuar në periudhën 01/01/2025 – 31.12.2025	Total detyrime	Shlyerja e detyrimeve 2025	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2025
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
Mallra dhe shërbime	1,391,500	12,605,084	13,996,584	10,153,107	3,843,477
Vendime gjyqësore	962,962	938,169	1,901,131	938,169	962,962
Totali :	**2,354,462**	**36,544,120**	**38,898,582**	**34,092,143**	**4,806,439**

Burimi: *Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit*

Referuar shkresës nr. 1971 prot., datë 27.02.2025 *"Raport vjetor i vetëvlerësimit për situatën e gjendjes financiare për periudhën janar-dhjetor 2024, Bashkia Gjirokastër*" të dërguar në MF dhe sipas publikimit në faqen e saj detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2024 paraqiten në shumën 2,354,462 lekë. Në fund të vitit 2025 detyrimet e prapambetura të raportuara me shkresën nr.prot. 2117 prot., datë 04.03.2026 dhe të publikuara në faqen e MF paraqiten në shumën 4,806,439 lekë. Gjatë vitit 2025 janë krijuar 36,544,120 lekë detyrime, dh është likuiduar vlera 34,092,143 lekë, vlera e detyrimit të mbetur të palikuiduar në fund të vitit 2025 është 4,806,439 lekë e ndarë:
- Detyrime te ministrive të linjës 0 lekë
- Detyrime Bashkia 4,806,439 lekë

Për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025 nga analiza e detyrimeve, të paraqitura në tabelën e mëposhtme rezultojnë në datë 31.12.2025 janë të palikujduara gjithsej 1 (një) faturë me vlerë **3,843,477 leke. Në aneksin 2/2/3 në anekset e raportit të auditimit** janë paraqitur detyrimet e prapambetura.

Detyrimet e prapambetura për vitin 2025 të paraqitura në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 2117 prot., datë 04.03.2026 jepen në tabelën si më poshtë:
Tabela Nr. 11: Stoku i borxhit i raportuar në MFE

Në lekë

		Viti 2025		
Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë ne fund te vitit 2025	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
I	**Borxhe (a+b)**			
a	**Hua afatgjatë**			
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
a.2	Tituj të emetuar			
a.3	Garanci për të tretë			
b	**Hua afatshkurtër**			
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
b.2	Tituj të emetuar			
b.3	Garanci për të tretë			
II	**Detyrimet e prapambetura**	**4,806,439**		**0.49%**
Llogaria ekonomi	**Emërtimi**			
4864100	Vendime Gjyqesore	962,962		
4864200	Det.Prap. Sherbime			
4864201	D.P.EneriElektirke			
4864300	Det.Prap.Mirembajtje			
4864400	Det.Prap. Investime			
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra			
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet	3,843,477		
III	**Totali (I+II)**	**4,806,439**	**979,538,582**	**0.49%**

Burimi: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit*

Tabela Nr. 12: Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore.

	Numri i vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2025	**Vlera e vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2025**	**Numri i vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2025**	**Vlera e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2025**	**Pagesa në lekë të kryera gjatë vitit 2025**	**Detyrimi në lekë më 31.12.2025**
Dëmshpërblim page për punonjësit e larguar nga puna	2	962,962	1	430,474	0	1,393,436
Te tjera	-	-	2	1,577,074	938,169	655,705
Total	**2**	**962,962**	**3**	**2,007,548**	**938,169**	**2,049,141**

Burimi: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit*

Në aneksin 2/2/4 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur lista e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë dhe likuidimet e kryera prej saj për mbi pagesat e vendimet gjyqësore për dëmshpërblim page dhe çështje të tjera të ndryshme.

Gjatë vitit 2025 janë shpenzuar 938,169 lekë për 1 (një) vendim gjyqësore me objekt mospërmbushjee detyrimeve të kontratës.
Vlera totale **938,169 lekë** e shpenzuar për periudhën 01.01.2025- 31.12.2025 nga Bashkia Gjirokastër, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, **konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet.**

Tabela Nr. 13: Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR dhe Ministritë e Linjës viti 2025

Ministria	Llog	Kodi	Investimi	Kontrata	Vlera e Kontratës	Plan 2025	Fakt 2025	% realizimit	Statusi
04	231	18Y404	Permiresimiinfrastruktures kryesisht ne zonat informale"Rikonstruksion i rruges Baba Selimi, Zinxhira Gjirokastër"	12202 dt 21.11.2025	50,466,731	27,998,613	24,003,672	86%	Proces
11	231	22AC537	Rikonstruksion i godines ekzistuese dhe shkalles emergjences dhe dhomes teknike ne shkollen 9-vjecare Urani Rumbobashkia gjirokaster	11467 dt 04.11.2025	73,498,636	14,794,672	3,166,542	21%	Proces
11	231	18BD070	Rikontsruksion dhe permiresim I eficences energjetike shkolla e mesme Muhamet Gjollesha	10565 dt 19.11.2024	17,375,781	17,384,999	10,463,291	60%	Perfunduar
Total					141,341,148	60,178,284	37,633,505		

Burimi: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:
1. Znj. F. C. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës

(Për sa më sipër, pas njohjes me projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Bashkia Gjirokastër, nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit).

2.2.6. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të paarkëtuara progressive dhe për vitin buxhetor.

1. Struktura për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:
Struktura organizative e Bashkisë Gjirokastër e aplikuar për vitin 2025 është miratuar me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 835, datë 30.10.2024, me objekt *"Për miratimin e struktures analitike të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2024"*. Rregullorja e Bashkisë Gjirokastër është miratuar në vitin 2023, gjatë vitit 2025 ka pasur ndryshime struktura organizative dhe këto ndryshime nuk janë pasqyruar në rregulloren e Bashkisë Gjirokastër në të cilën përcaktohen përgjegjësitë e pozicionit të punës.

Referuar informacionit sipas vendimit nr. 82, datë 05.12.2024 *"Për miratimin e paketës fiskale 2025 në Bashkinë Gjirokastër"* për taksat dhe tarifat si mëposhtë është ngarkuar për vjeljen Drejtoria e të Ardhurave, Pronës Publike, Lejve dhe Licencave.

-Taksë ndërtese;
-Taksë mbi truallin;
-Taksë mbi tokën bujqësore;
-Taksë tabele;
-Taksa e fjetjes në hotel;
-Tarifa e pastrimit;
-Tarifa e ndriçimit;

Sa më sipër në strukturën e miratuar me urdhër nr. 835, datë 30.10.2024, me objekt *"Për miratimin e struktures analitike të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2024"*, kjo Drejtori nuk ekziston në këtë strukturë.

Për tarifat e përkohshme për biznesin e vogël dhe të madh nuk është përcaktuar Drejtoria/ Sektori i cili do të ndjeki vjeljen e kësaj tarife.

Në aneksin 2/6/1 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur struktura e drejtorive dhe sektorëve të cilët administrojnë dhe monitorojnë taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:

Paketa fiskale e aplikuar nga Bashkia Gjirokastër për periudhën nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, është miratuar me vendimin nr. 82, datë 05.12.2024 të Këshillit Bashkiak me objekt *"Për miratimin e paketës fiskale 2025 në Bashkinë Gjirokastër"*. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2025 paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Tabela Nr.1: Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave për vitit 2025, Bashkia Gjirokastër

000 lekë

Nr.	Lloji i të ardhurës	Plan 2025	Fakt 2025	Fakt %
A	**TE ARDHURA NGA TAKSAT-TATIMET**	**96,766**	**90,295**	**93%**
1	Taksë mbi Ndërtesën	41,043	34,838	85%
	a) Biznesi i vogël	*10,106*	-	-
	b) Biznesi i madh	*8,026*	-	-
	c) Familjarët	*20,137*	-	-
	d) Debitorët	*2,773*	-	-
2	Taksa e Truallit	1,397	1,065	76%
3	Taksë Vendore mbi Bizn.Vogël	-	-	-
4	Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin	152	439	290%
5	Tat. Shitja e Pas.së Paluajtsh.	758	1,826	241%
6	Taksa Vjetore për Qarkullimin e Mjeteve të Përdorura	22,963	24,784	108%
7	Taksë mbi Tokën Bujqësore	7,279	5,186	71%
	Rezident	*3,750*	-	0%
	Jo rezident	*3,529*	-	0%
8	Taksë Fjetje në Hotel	7,015	6,162	88%
9	Taksë Ndikimi në Infrastrukturë	7,070	3,167	45%
10	Takse mbi kalimin e Pronesise	-	55	-
11	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	9,090	12,773	141%
B	**TË ARDHURA NGA TARIFAT**	**150,001**	**138,623**	-
1	Tarifa e Pastrimit	53,057	47,665	90%
	a) Biznesi i vogel	*12,393*	-	-
	b) Biznesi i madh	*14,469*	-	-
	c) Familjaret	*19,192*	-	-
	d) Debitoret	*4,701*	-	-
	e) Entet	*2,303*	-	-
2	Tarifa e Reklamës	5,547	5,077	92%
3	Tarifa e Ndriçimit Rrugor	31,345	30,199	96%
	a) Biznesi i vogël	*7,992*	-	-
	b) Biznesi i madh	*4,101*	-	-
	c) Familjarët	*14,997*	-	-

	d) Debitorët	*3,224*	-	-
	e) Entet	*1,030*	-	-
4	Tarif. Infra.Arsim, Sport, Kulture	14,881	7,483	50%
	a) Biznesi i vogël	*1,976*	-	-
	b) Biznesi i madh	*1,108*	-	-
	c) Familjarët	*10,322*	-	-
	d) Debitorët	*1,475*	-	-
5	Tarifë Gjelbërimi	7,191	11,711	163%
	a) Biznesi i vogël	*1,991*	-	-
	b) Biznesi i madh	*1,936*	-	-
	c) Familjarët	*2,901*	-	-
	d) Debitorët	*1,475*	-	-
	d) Entet	*364*	-	-
6	Tarifë Parkimi	5,522	3,004	54%
	a) Biznesi i vogël	*417*	-	-
	b) Biznesi i madh	*157*	-	-
	c)i rezervuar	*1,414*	-	-
	d)parkimi nëntokësor	*3,535*	-	-
7	Tarifë Regjistrimi	51	-	-
8	Tarifë e Shërbimit Veterinar	-	-	-
9	Tarifë Zënie Hapësire Publike	369	-	-
10	Tarifë Zënie Hapësire Publike në Zonën Muzeale	909	1,682	185%
11	Leje Transporti	388		
12	Çertifikatë Transporti	139	583	418%
13	Leje Taksi	283	-	-
14	Leje Shfrytëzim Karburanti	6,515	3,000	46%
15	Vendim Leje Ndërtimi	253	170	67%
16	Tarifë për Studim e Projektim	-	-	-
17	Vendim Shesh Ndërtimi	152	9	6%
18	Kërkesë Leje Ndërtimi	303	255	84%
19	Vërtetime Akt-Kolaudime	-	-	-
20	Çërtifikatë Përdorimi	101	65	64%
21	Tarifë nga Përpun. i Mbetjeve Urbane	-	35	-
22	Vërtetime	303	130	43%
23	Deklarata-Përkrahja Sociale	-	-	-
24	Tarifë Lidhje Kontrate	515	528	103%
25	Të ardhura të tjera	303	723	239%
26	Njoftim Fillim Punimesh	1,131	895	79%
27	Qera Trualli	2,210	2,913	132%
28	Qera Objekti	64	299	470%
29	Qera Tregu Agro-Ushqimor	2,318	2,338	101%
30	Qera Tregu industrial	4,727	4,200	89%
31	Qera Toke Bujqësore	938	796	85%
32	Tarifë për Mirëmbajtjen Varrezave	1,050	958	91%
33	Projekti Transizmik	-	-	-
34	5% Garanci Difektesh	-	-	-
35	Gjoba	1,515	318	21%
36	Shitja e Produkteve Bujqesore dhe Pyjore	5,280	4,944	94%
37	Sponsorizime	-	6,165	-
38	Tarifë për Shfrytëzimin e Lëndës Drusore	-	-	-
39	Ujë për Vaditje	117	350	299%
40	Tarifë Shërbim Varrimi	2,525	2,128	84%
C	**Të ardhurat nga Institucionet në Varësi**	**24,014**	**23,209**	**97%**
1	Drejtoria e Arsimit	8,157	6,954	85%
2	Drejtoria e Artit & Kultures	505	-	-
2	Dr.Turizmit,Trashëgimisë & Sporteve	15,150	16,089	106%
3	Drejt.e Mbrojtjes nga Zjarri	202	166	82%
Totali		**270,781**	**252,127**	**93%**

Burimi i të dhënave: Bashkia Gjirokastër

Për vitin 2025 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën **270,781 mijë lekë** dhe realizimi në vlerën **252,127 mijë lekë** referuar Akt-Rakordimit me Degën e Thesarit Gjirokastër me nr.936 prot, datë 27.01.2026. Të ardhurat janë realizuar në masën 93% me një diferencë mbirealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën

18,654 mijë lekë. Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkalim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

a. "Taksë vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura" është planifikuar në vlerën 22,963 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 24,784 mijë lekë ose realizuar në masën 108%.
b. "Tatim mbi të ardhurat personale" është planifikuar në vlerën 9,090 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 12,773 mijë lekë ose realizuar në masën 141%.
c. "Tarifë Gjelbërimi" është planifikuar në vlerën 7,191 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 11,711 mijë lekë ose realizuar në masën 163%.

Si dhe disa prej zërave fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

a. "Tarifë Infrastrukturë, Arsim, Sport, Kulturë" është planifikuar në vlerën 14,881mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 7,483 mijë lekë ose realizuar në masën 50%.
b. "Taksë mbi ndërtesën" është planifikuar në vlerën 41,043 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 34,838 mijë lekë ose realizuar në masën 85%.

Nga analiza e trajtuar më sipër për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim.

Në këtë konteks është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Gjirokastër që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"*, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar,

Agjentët tatimorë dhe rakordimet me ta:

Të ardhurat nga agjentët tatimorë (ASHK për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme; Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastër në lidhje me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe tatimin mbi të ardhurat personale, DSHTRR në lidhje me taksat vendore të qarkullimit për mjetet e përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Gjirokastër dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit duke kuadruar me akt-rakordimin e të ardhurave. Të ardhurat e arkëtuara nga agjentët tatimorë për vitin 2025 paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Tabela Nr.2: Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave për vitit 2025 nga agjentët tatimore.

000 lekë

Nr.	Emërtimi	Plani 2025	Realizimi 2025	% e Realizimit
1	Tatimi i Thjeshtë i Fitimit (DRT)	152	439	290
2	Tatimi mbi të Ardhurat Personale TAP (DRT)	9,090	12,773	141
3	Taksa e regjistri mit të automjeteve (DSHTR)	22,963	24,784	108
4	Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë (ASHK)	758	1,881	241
5	Taksa e Rentës Minerale (Dogana)	-	-	-
Totali		**32,963**	**39,877**	**121**

Burimi: Bashkia Gjirokastër

-Për vitin 2025 ndërmjet Bashkisë Gjirokastër dhe agjentëve tatimorë si Drejtoria Rajonale Tatimore, ASHK nuk janë mbajtur akt-rakordime mujore.

Për sa trajtuar më sipër Bashkia Gjirokastër i referohet vetëm vlerave të arkëtuara nga

agjentët tatimorë sipas akt-rakordimeve me Degën e Thesarit por nuk ka një bazë të dhënash për detyrimin e plotë që duhet të arkëtojnë agjentët tatimorë dhe vlerën e pa arkëtuar prej tyre.

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizikë/juridikë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Gjirokastër kryhet në programin Excel.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Bashkisë Gjirokastër për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të Bashkisë Gjirokastër.

Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për Sistemin e Taksave Vendore"* i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: "Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar".*

Për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore për abonentët familjarë Bashkia Gjirokastër ka lidhur aktmarrëveshje me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.a me nr.290 prot, datë 13.01.2025 me objekt *"Arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.a si agjent tatimor për taksat dhe tarifat vendore"* dhe aktmarrëveshjen me nr.291 prot, datë 13.01.2025 me objekt *"Mbi arkëtimin e taksave dhe tarifave lokale si tarifë pastrimi, tarifë varreze, tarifë ndriçimi, tarifë infrastrukture për arsim, sport kulturë, taksë ndërtese në Njësitë Administrative të Bashkisë Gjirokastër".*

Menaxhimi i borxhit.

Bashkia Gjirokastër nuk disponon një regjistër me të dhënat e abonentëve familjarë, referuar aktmarrëveshjes me datë 13.01.2025, Bashkia Gjirokastër ka përgjegjësi sipas pikës 1 ti vendosë në dispozicion Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.a ngarkesën mujore për të gjitha familjet rezidente/jorezidente për qytetin e Gjirokastrës.

Tabela Nr.3: Rakordimi mujore me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.a:

Nr.	Muaj	Faturuar	Pjesa takuese 3.5%	Arkëtuar	Diferenca
1	Janar	6,229,741	201,112	5,544,961	483,668
2	Shkurt	6,230,329	182,610	5,217,439	830,280
3	Mars	6,230,269	197,818	5,651,958	380,493
4	Prill	6,218,386	198,942	5,684,083	335,361
5	Maj	6,227,343	201,076	5,745,045	281,222
6	Qershor	6,121,213	202,935	5,798,152	120,126
7	Korrik	6,277,954	209,025	5,972,169	96,760
8	Gusht	6,233,956	206,953	5,912,957	114,046
9	Shtator	6,240,512	200,759	5,735,980	303,773
10	Tetor	6,235,327	193,350	5,524,293	517,684
11	Nentor	6,241,742	184,175	5,262,147	795,420
12	Dhjetor	6,188,774	203,559	5,815,996	169,219
Total		**74,675,546**	**2,382,314**	**67,865,180**	**4,428,052**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Informacioni për situatën debitorë në Bashkinë Gjirokastër paraqitet me rezerva për shkak:

Nëpërmjet Bashkisë Gjirokastër dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.a janë mbajtur aktrakordimet mujore, këto aktrakordime nuk janë shoqëruar me listën analitik për abonentët të cilët kanë paguar detyrimet mujore. Lista analitike nuk disponohet as

në formatin elektronik. Bashkia Gjirokastër nuk disponon informacion analitik për gjendjen debitore të abonentëve familjare por vetëm shumën totale të debisë si diferencë e shumës së faturuar me shumën e arkëtuar. Sa më sipër është vepruar ne kundërshtim me aktmarrëveshjen nr.290 prot, datë 13.01.2025 dhe nr.291 prot, datë 13.01.2025.

Taksa e tokës bujqësore:

Bashkia Gjirokastër për vitin 2025 ka parashikuar të arkëtoi të ardhura nga taksa për tokën bujqësore në vlerën 7,279 mijë lekë realizimi i kësaj takse për vitin 2025 është në vlerën 5,185 mijë lekë.

Sipas të dhënave që disponon Agjensia e Tatim Taksave dhe Agjensia e Bujqësisë Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit në Bashkinë Gjirokastër sipërfaqja totale e tokës bujqësore është 5,286 ha dhe sipërfaqja e ndarë e tokës është 5,412ha.

Tabelën nr.4: Paraqitet informacion mbi ndarjes e tokës bujqësore në Bashkinë Gjirokastër.

Nr.	Njësitë Administrative	Tokë bujqësore gjithsej në Ha	Kategoria e tokës e ndarë sipas Ligjit nr. 7501/në hektar							Totali i kategorive
			I	II	III	IV	V	VI	VII	
1	Njësia Lazarat		0	70	180	240	70	60	75	**695**
2	Njësia Antigone		0	45	110	245	75	114	91	**680**
3	Njësia Cepo		0	65	245	250	235	190	106	**1,091**
4	Njësia Odrie		0	45	65	155	120	100	74	**559**
5	Njësia Picar		0	0	170	205	195	115	36	**721**
6	Njësia Lunxheri		0	0	120	215	395	530	406	**1,666**
Shuma			**0**	**225**	**890**	**1,310**	**1,090**	**1,109**	**788**	**5,412**

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Tabelën nr.5: Paraqitet informacion mbi parashikimin e arkëtimeve nga kjo taksë.

Nr.	Kategoria e tokës	Totali i kategorive	Leke HA/vit	Pritshmëria vjetore
1	Kategoria I	0	2,800	0
2	Kategoria II	225	2,100	472,500
3	Kategoria III	890	1,400	1,246,000
4	Kategoria IV	1,310	1,350	1,768,500
5	Kategoria V	1,090	1,250	1,365,500
6	Kategoria VI	1,109	1,200	1,330,800
7	Kategoria VII	788	1,100	866,800
Shuma		**5,412**		**7,047,100**

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Referuar planifikimit dhe realizmit nga taksat dhe tarifat vendore për Bashkinë Gjirokastër për vitin 2025 taksa për tokën bujqësore sipas fondit total të tokës sipas kategorive është në shumën 5,412 ha dhe referuar paketës fiskale miratuar me vendimin nr.82, datë 05.12.2024 janë përcaktuar tarifat/ha sipas kategorisë së tokës. Pritshmëria maksimale është në vlerën 7,047 mijë lekë sipas planifikimit të të ardhurave vjetore kjo takës është në vlerën 7,279 lekë mbi nivelin maksimal të pritshëm.

Tabelën nr.6: Debitorët për taksën e Tokës Bujqësore.

lekë

Nr.	Njësitë Administrative	01.01.2025	Pakesuar 2025	Shtuar 2025	Numri i familjeve debitoreve	Debia 31.12.2025
1	Picar	3,911,871	758,567	627,509	495	3,780,813
2	Odrie	1,983,716	549,204	322,921	242	1,757,433
3	Antigone	526,796	645,129	305,300	212	186,967
4	Cepo	6,981,364	1,157,569	1,540,239	867	7,364,034
5	Lazarat	2,418,004	211,233	659,460	736	2,866,231
6	Lunxheri	3,118,814	1,852,608	1,164,951	894	2,431,157
Totali		**18,940,565**	**5,174,310**	**4,620,380**	**3,446**	**18,386,635**

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Referuar informacionit në tabelën e mësipërm gjendja debitorëve e abonentëve për taksën e tokës bujqësore në datën 01.01.2025 është 18,940 mijë lekë gjatë vitit 2025 ka pasur shtesa në

vlerën 4,620 mijë lekë dhe pakësime në vlerën 5,174 mije lekë. Gjendja debitore në datën 31.12.2025 është në vlerën 18,386 mijë lekë dhe i përket 3,446 abonentëve. Për vjeljen e taksës së tokës bujqësore është vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 *"Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve proceduriale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore" kap II.* "*Veprimet paraprake të mbledhjes së detyrimeve tatimore vendore me masa shtrënguese"*

Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të taksapaguesit

Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të taksapaguesit (Aneksi A - Formulari MSh003), i dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë, në të cilat taksapaguesi, mund të ketë llogaritë e tij. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare nxirret, pasi kanë kaluar 10 (dhjetë) ditë pune nga dërgimi i dokumentit Njoftim dhe kërkesë për të paguar. Ky dokument firmoset nga titullari i NJVV-së ose drejtuesi i strukturës së taksave e tarifave vendore kur kjo e fundit është e organizuar si njësi shpenzuese më vete, dhe dërgohet me: - postë; ose - në rrugë elektronike

Masa e sigurimit të detyrimit tatimor

Struktura e taksave dhe tarifave vendore, nëse konstaton se me gjithë bllokimin e llogarive bankare, detyrimet tatimore vendore nuk janë paguar, ajo kërkon sigurimin e pagimit të këtij detyrimi, nëpërmjet vendosjes së masave të sigurisë për të gjithë pasurinë e taksapaguesit. Masat e sigurimit të pasurisë merren gjithmonë me anë të një vendimi me shkrim të titullarit të NJVV-së dhe/ose nëpunësit zbatues përgjegjës. Pavarësisht se vendimi për marrjen e masave të sigurimit të pasurisë së taksapaguesit bëhet nga titullari i NJVV-së ose drejtuesi i strukturës së taksave e tarifave vendore, kur kjo e fundit është e organizuar si njësi shpenzuese më vete, ato kanë efekt për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Çdo person juridik, që ka regjistruar pasuri të taksapaguesit, është i detyruar të ekzekutojë vendimin e nxjerrë për marrjen e masave të sigurimit mbi pasurinë e taksapaguesit debitor

Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:

Bashkia Gjirokastër nuk disponon sistem elektronik për administrimin dhe regjistrimin e taksave dhe tarifave vendore për abonentët private.

Të dhënat e abonentëve privatë janë të regjistruara vetëm në exel nuk disponohet regjistër fizik në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" neni 7

Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Situata e lëvizjes se subjekteve të cilat ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Gjirokastër bazuar në ndryshimin e xhiros si dhe të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit paraqiten si më poshtë:

Në **tabelën nr. 7**: Lëvizjet e biznesit gjatë vitit 2025.

Emërtimi	Numri	Lloji i biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrimet e reja (hyrje)	Mbyllur aktiviteti (dalje)	Gjendja në fund të vitit
Qytet	1	Biznesi i Madh	2025	235	9	53	191
Qytet	2	Biznesi i Vogël	2025	1145	146	65	1226
Total 1+2				**1380**	**155**	**118**	**1417**
Njësitë administrative	3	Biznesi i Madh	2025	34	2	2	34
Njësitë administrative	4	Biznesi i Vogël	2025	147	25	10	162
Total 3+4				**181**	**27**	**12**	**196**

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Mënyra e llogaritjes dhe vlerësimi i të ardhurave sipas paketës fiskale abonentët biznes:

Referuar të dhënave të paraqitura nga Agjensia e Tatim Taksave Bashkia Gjirokastër janë verifikuar regjistrat elektronike për biznesin e madh.

Nga regjistri elektronik u verifikuan të dhënat për taksën e pastrimit, ndriçimit dhe

gjelbërimit.
Nga auditimi janë konstatuar disa subjekte të cilat nuk janë tarifuar në përputhje me paketën fiskale me vendimin nr.82, datë 05.12.2024 *"Për miratimin e paketës fiskale 2025 në Bashkinë Gjirokastër"*:

Në tabelën nr. 8: Subjekte e tarifuar në mospërputhje me paketën fiskale.

Nr.	Operatori	Nipti	Veprimtaria	Vlera e Taksuar	Vlera sipas Paketës fiskale	Shënim
1	D.O.		Tregti karburanti	50,000	100,000	Vetëm taksa e pastrimit
2	O SHPK		Ndërtim	25,000	110,000	Vetëm taksa e pastrimit
3	R-A		Prodhim Këpucësh	0	125,000	Taksë pastrimi ndriçimi dhe gjelbërimi
4	A.SHPK		Shërbim reklamash	0	40,000	Taksë pastrimi ndriçimi dhe gjelbërimi
5	I. SHPK		Shërbim reklamash	0	40,000	Taksë pastrimi ndriçimi dhe gjelbërimi
6	E.S. ALB		Objekti i aktivitetit shërbimet në lidhje me bankomatet (ATM)	0	80,000	Taksë pastrimi ndriçimi dhe gjelbërimi
Total				**75,000**	**495,000**	

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Menaxhimi i borxhit nga taksat dhe tarifat vendore:

Nga auditimi konstatohet se deri më datë 31.12.2024, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet si biznes i vogël dhe biznes i madh në vlerën **61,793,133 lekë.** Përgjatë vitit 2025 për llogari të detyrimeve që i përkasin vitit 2024 është likuiduar vlera 12,248,151 lekë si dhe janë krijuar debitorë në vlerën 7,526,195 lekë. Në total detyrimet tatimore në mënyrë progresive më datë 31.12.2025, për subjektet biznes i vogël dhe i madh janë në vlerën **57,071,177 lekë, borxhi tatimor është i kontabilizuar.**

Në tabelën nr. 9: Të dhënat në mënyrë analitike për vitin 2025 paraqiten si mëposhtë:

lekë

	Nr. i bizneseve	Debia progresive01.01.2025	Shtesa	Pakesime	Debia progresive31.12.2025
Qytet					
B.V	688	42,066,554	3,835,052	6,037,310	39,864,296
B.M	55	13,771,956	2,716,348	5,138,058	11,350,246
Totali (1)	**743**	**55,838,510**	**6,551,400**	**11,175,368**	**51,214,542**
Nj.Adm.					
B.V	80	2,766,473	468,625	492,348	2,742,750
B.M	11	3,188,150	416,120	1,183,000	2,421,270
Totali (2)	**91**	**5,954,623**	**884,745**	**1,675,348**	**5,164,020**
Totali 1+2	**834**	**61,793,133**	**7,526,195**	**12,248,151**	**57,071,177**

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Në lidhje me këtë situatë Agjensia e Tatim Taksave për asnjë nga subjektet si biznes i vogël dhe i madh, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe me vlera të kosiderueshme, janë njoftuar dhe ri njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë nisur urdhër bllokimet e llogarive, por në asnjë rast nuk është kërkuar kallëzim penal në zbatim të Ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995, "K*odi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 181 "Mos pagimi i taksës dhe tatimeve"*. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3, ku përcaktohet që: "Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit",* Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "*Për financat e qeverisjes*

vendore", neni 35 "Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore" si dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore", neni 3, pikat 9-10.*

Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:
Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Urbanistikës në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës janë dërguar zyrtarisht me shkresë listat e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi. Nga auditimi konstatohet se deri më datë 31.12.2024 vlera debitore për taksën e infrastrukturës është 2,785 mijë lekë. Gjatë vitit 2025 janë likuiduar detyrime në vlerën 1,089 mijë lekë për debitorët dhe detyrimi i krijuar gjatë vitit 2025 në vlerën 3,763 mijë lekë. Gjendja debitore në datën 31.12.2025 është në vlerën **5,534 mijë lekë.**
Në tabelën nr. 10: Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

lekë

Viti	Persona	Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë
Detyrimi 31.12.2024	82	1,824,464
Shtesa 2025	61	3,709,989
Detyrimi progresiv	**143**	**5,534,453**

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se nga Bashkia Gjirokastër për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që institucioni të jetë drejtuar ASHK për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", neni 27, pika "d"*, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 27, pika 2.1*, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, *"Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar, pika 5.*

Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:
Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të liçencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të karburantit si dhe nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit konstatohet se përgjatë vitit 2025 në territorin e Bashkisë Gjirokastër dhe njësive administrative është ushtruar aktivitet për tregtimin e karburantit nga 17 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.
Në tabelën nr.11: Të dhënat për subjektet që tregtojnë hidrokarbure paraqiten si më poshtë:

Nr.	Subjekti	Nipti	Adresa	Fillimi	Mbarimi	Detyrimi	Det i Paguar	Diferenca
1	A.O.	L.....L	Gerhot	30.01.2025	29.01.2030	1,000,000	0	1,000,000
2	A. O.	L.....L	Kordhoce	07.02.2024	06.02.2029	1,000,000	1,000,000	0
3	F.P.	L.....G	Rr.Nacionale	24.01.2025	23.01.2030	1,000,000	1,000,000	0
4	D. O.	L.....G	Punetore	16.12.2020	16.12.2025	1,000,000	1,000,000	0
5	A. O.	L.....G	Gerhot	17.12.2020	17.12.2025	1,000,000	1,000,000	0
6	K.	J.....P	Ura e Lumit	17.11.2020	17.11.2025	1,000,000	1,000,000	0
7	B.	J.....B	Ura e Lumit	28.06.2020	28.06.2025	1,000,000	1,000,000	0
8	G. C. G.	K.....T	Ish-Fabrika e Miellit	26.02.2025	26.02.2028	600,000	600,000	0
9	G. C. G.	K.....T	Mashkullore	26.06.2023	25.06.2026	600,000	600,000	0
10	O. SHPK	J.....I	Rr.Nacionale	15.01.2024	15.01.2029	1,000,000	1,000,000	0
11	E. G.	L.....E	Ura e Lumit	11.06.2023	10.06.2028	1,000,000	1,000,000	0
12	E. G. 2012	L.....B	Ura e Kardhiqit			1,000,000	300,000	700,000
13	K. S.	K.....M	Shtepez	01.01.2024	01.01.2029	1,000,000	750,000	250,000
14	L.	J.....Q	Kordhoce	17.09.2021	16.09.2026	1,000,000	1,000,000	0
15	K. S.	K.....M	SMT		02.11.2025	1,000,000	1.000.000	0
16	K. S.	K.....M	Shtepez	21.12.2021	21.12.2026	1,000,000	1,000,000	0
17	A. N.	K.....Q	Rr.Nacionale			1,000,000	0	1,000,000

Total		**16,200,000**	**13,250,000**	**2,950,000**

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, konstatohet se në fund të vitit 2025, gjithsej rezultojnë 14 subjekte të pajisura me autorizim me afat 1-5 vjeçar. Nga këto 2 (dy) subjekte kanë paguar të plotë detyrimin dhe 2 (dy) subjekte kanë paguar detyrim pjesor.
Veprimet në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 02.12.2015, *"Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, gërma "b", dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, Kapitulli II, pika 1, gërma "b" dhe pika 9 dhe 15.*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. z. F.G., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër.
2. znj. D.T., në cilësinë e Kryeinspektor i Agjencisë së Tatim Taksave.
3. z. H.P., në cilësinë e Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave dhe Performancës.

(Për sa më sipër, pas njohjes me projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Bashkia Gjirokastër, nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit).

2.3. Auditim i llogarive vjetore.

-Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.
-Vlerësimi nëse aktivet dhe pasivet janë llogaritur saktë si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.
-Inventarizimi i aktiveve për vitin e raportimit financiar.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat Financiare për vitin ushtrimor 2025;
- Ditarët e kontabilitetit për vitin ushtrimor 2025;
- Listë pagesat me zgjedhje për vitin ushtrimor 2025;
- Dokumentet e bankës dhe të arkës për vitin ushtrimor 2025;
- Aktet e rakordimit me degën e thesarit, për vitin ushtrimor 2025;
- Dokumentet e inventarizimit etj., për vitin ushtrimor 2025;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

- **Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:**

Për vitin 2025 Bashkia Gjirokastër ka hartuar pasqyrat e konsoliduar në të cilat përfshihen vetëm aparati i Bashkisë Gjirokastër sepse Bashkia Gjirokastër nuk ka njësi shpenzuese të tjera. Bashkia Gjirokastër për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Gjirokastër si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

- **Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduar.**

Për vitin 2025 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, "*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- ☐ Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- ☐ Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- ☐ Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Floë).

- ☐ Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- ☐ Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- ☐ Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- ☐ Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- ☐ Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- ☐ Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

- **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2025 janë të nënshkruara nga z. F.G. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. F. C. me detyrë Drejtor i Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit në datë 30.03.2026, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.

- **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2025 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Gjirokastër për aktivitetin ekonomiko-financiar për periudhën 01.01.2025-31.12.2025.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2025 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2025:

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejtë në pasqyrën e bilancit.

Pasqyra e pozicionit financiar të Bashkisë Gjirokastër në 31.12.2025, sipas **formatit F1**, është paraqitur më poshtë:

1.Pasqyra e pozicionit financiar (F1).

- Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=3,463,031,464 lekë.

- Aktivet3,605,998,539 lekë
- Detyrimet 142,967,075 lekë
- Aktivet Neto3,463,031,464 lekë

Aktivet afatshkurtra:

Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2025 paraqiten në vlerën **511,614,177 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" në shumën 292,030,983 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues" në shumën 113,753,827 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" në shumën 105,829,367 lekë;

Fondi i Konsoliduar:

Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar/Deficit i akumuluar)

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF1: Detajet e nënrubrikës '*Teprica*".

Zërat për të cilat pakësohet fondi	**Llogaria 101**		**Zërat për të cilat shtohet fondi**
	Debi	**Kredi**	
Pakësimet gjatë vitit	0	2,502,712,047	Çelje
Amortizim i vitit	161,059,254	418,670,501	Investime + Dhurime
		(21,385,620)	Ndryshim i gjendjes së inventarit
Shuma	**161,059,254**	**2,899,996,928**	Shuma
Shuma		**2,738,937,674**	

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Referuar pasqyrës së pozicionit financiar llogaria 101 "Teprica" është kontabilizuar për vlerën 2,775,368,537 lekë.

Sipas tabelës së mësipërme e përllogaritur dhe sipas udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" vlera e raportuar në bilanc është mbivlerësuar për vlerën 36,430,863 lekë.

Pasqyra PF2: Detajet e nënrubrikës "*Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre*".

Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	**Emërtimi i llogarive**	**Viti 2025**	**Viti 2024**	**Diferenca 2025-2024**
531	Mjete Monetare në arkë	-	-	-
512	Mjete monetare në bankë	13,800,463	15,386,500	(1,586,037)
520	Disponibilitete në thesar	278,230,520	357,836,162	(79,605,642)
50	Letra me vlerë	-	-	-
532	Vlera të tjera	-	-	-
54	Akreditiva dhe paradhënie	-	-	-
59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlerë	-	-	-
	Totali	**292,030,983**	**373,222,662**	**(81,191,679)**

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Vlera e llogarisë 512 *"Mjete monetare në bankë"* në vlerën 13,800,463 lekë dhe 520 *"Disponibilitete në thesar"* në shumën 278,230,520 lekë, llogaritë e mësipërme nuk kuadrojnë me gjendjen e llogarisë 85 *"Rezultati i vitit ushtrimor"* në shumën 219,746,193 lekë gjendja e llogarisë 466 *"Mjete në ruajtje"* në shumën 37,137,708 lekë.
Fondet e papërdorura për vitin 2025 janë si më poshtë:
1-Trasfertë e pakushtëzuar dhe specifike viti 2025 e papërdorur 168,963,312 lekë.
2-Të ardhurat viti 2025 të papërdorura72,129,498 lekë.

Totali i fondeve të papërdorura është në shumën **241,092,810 lekë** fonde të cilat do të trashëgohen për vitin 2026.
Sa më sipër llogaria 520 "*Disponibilitete në thesar"* e cila është kontabilizuar për vlerën 278,230,520 lekë është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 37,137,710 lekë në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*".

Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhet nga:
Pasqyra PF3: Detajet e nënrubrikës "*Gjendje inventari qarkullues*".

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
31	Materiale	39,824,598	61,389,252	(21,564,654)
32	Inventar i imët	73,929,229	73,750,195	179,034
33	Prodhim në proces	-	-	-
34	Produkte	-	-	-
35	Mallra	-	-	-
36	Kafshë në rritje e majmëri	-	-	-
37	Gjendje të pambëritura ose pranë të tretëve	-	-	-
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	-	-	-
39	Provigjone për zhvlerësimin e inventarëve	-	-	-
	Totali	**113,753,827**	**135,139,447**	**(21,385,620)**

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Gjirokastër në 31.12.2025 paraqitet në vlerën 113,753,827 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 39,824,598 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 "Inventar i imët " në vlerën 73,929,229 lekë.
Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën =21,385,620 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi gjendjes së inventarit" në shumën -21,385,620 lekë
Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

Llogaria 312 "Materiale" ka vlerën 39,824,590 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelat si mëposhtë:
Pasqyra PF4: Detajet e nënrubrikës ,lëvizjet e llogarisë 312 "Materiale":

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	1,783,532
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	212,731,167
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025	234,297,828
Gjendja në 31.12.2025	**39,824,590**

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Llogaria 327 "Inventar i imët", ka vlerën 73,929,229 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelat si mëposhtë:

Pasqyra PF5: Detajet e nënrubrikës ,lëvizjet e llogarisë 327 "Inventar i imët":

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	73,750,195
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	179,034
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025	179,034
Gjendja në 31.12.2025	**73,929,229**

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Inventarizimi i aktiveve:

Gjatë vitit 2025, mbështetur dhe në udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* nga ana e titullarit të bashkisë është konceptuar dhe firmosur urdhri nr. 750 datë 06.10.2025 për ngritjen e komisionit të inventarizimit, dhe vlerësimit të aktiveve për vitin 2025 të Bashkisë.

Komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit ka në përbërje:

1- K.H., Kryetar
2- I.B., Anëtar
3- J.R., Anëtar
4- O.B., Anëtar
5- E.Xh., Anëtar
6- L.S., Anëtar

Pasi është kryer inventarizimi fizik dhe vlerësimi i aktiveve të Bashkisë është hartuar memo drejtuar Kryetarit të Bashkisë për aktiveve të Institucionit.

- Llogaria 214 *"Instalime teknike, makineri dhe paisje",* materiale të dëmtuara me vlerë 1,343,055 lekë dhe materiale jashtë përdorimit me vlerë 9,182,527 lekë.
- Llogaria 218 *"Inventar ekonomik",* materiale të dëmtuara me vlerë 10,488,950 lekë dhe materiale për jashtë përdorimit me vlerë 23,860,064 lekë.
- Llogaria 327 *"Inventar i imët"* materiale të dëmtuara me vlerë 741,788 lekë dhe materiale jashtë përdorimit me vlerë 35,731,915 lekë.

Referuar udhëzimit nr.30, datë 27.11.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" pika 85 shkronja c citohet si mëposhtë.*

"Te përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik te aktiveve, për kushtet e ruajtjes se tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve te konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime te mëtejshme Nëpunësit Autorizues"

Referuar informacionit të marrë nga Komisioni i Inventarizimit dhe Vlerësimit të aktiveve me memo me nr.13351 prot, datë 29.12.2025, Kryetari i Bashkisë është informuar për gjendjen e aktiveve të Bashkisë Gjirokastër.

Nuk është ngritur komisioni vlerësimin e aktiveve për dhënien në përdorim/tjetërsimin e aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve.

Llogaritë Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme "&"Të tjera aktive afatshkurtra":

Pasqyra PF6: Detajet e nënrubrikës "*Llogari të arkëtueshme*".

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
	Llogari të arkëtueshme	**105,829,367**	**103,927,201**	**1,902,166**
411	Klientë e llogari te ngjashme	135,000	135,000	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	-	-	-

431	Tatime e taksa	-	-	-
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog. Pushtetit Loka	-	-	-
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti	-	-	-
435	Sigurime Shoqërore	-	-	-
436	Sigurime Shëndetësore	-	-	-
437,438	Organizma te tjerë shoqërore	-	-	-
44	Institucione te tjera publike	-	-	-
465	Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë	189,000	207,000	(18,000)
468	Debitorë te ndryshëm	49,213,108	50,998,526	(1,785,418)
4342	Te tjera operacione me shtetin(të drejta)	56,292,259	52,586,675	(3,705,584)
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	-	-	
49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)	-	-	
	Totali	-	-	
	Të tjera aktive afatshkurtra			
409	Furnitore(Debitore),parapagime pagesa pjesore	-	-	-
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	-	-	-
477	Diferenca konvertimi aktive	-	-	-
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	-	-	-
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	-	-	-

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 50,998,526 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 49,213,108 lekë, kjo llogari gjatë vitit 2025 ka pasur ulje neto me vlerë (1,785,418) lekë. Vlerë e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset dhe taksa e tarifa vendore familjarët .Nga analiza e llogarisë 468 ***"Debitorë të ndryshëm"*** kemi detyrimet si mëposhtë:

Pasqyra PF7: Detajet e llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*".

Lloji i Detyrimit	**Detyrim 31.12.2024**	**Shtesa viti 2025**	**Pakësim viti 2025**	**Detyrim datë 31.12.2025**
Detyrime Familjarë, Biznesi	23,733,415	-	-	23,733,415
Detyrime Kopshte MZSH	2,863,000	-	-	2,863,000
Detyrime Drejtoria Urbanistikës	4,545,112	-	-	4,545,112
Gjoba IMTV	18,967,499	2,000,000	3,844,318	17,083,181
Detyrime punonjës	889,500	3,399,550	3,308,650	980,400
Debitore nga kopshte cerdhe	-	8,000	-	8,000
Shuma	**50,998,526**	**5,407,550**	**7,192,968**	**49,213,108**

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Në llogarinë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* janë kontabilizuar detyrimet duke i grupuar sipas llojit të detyrimit informacioni për debinë sipas detyrimeve gjendet në tabelës e mësipërme:

1-Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit ka dërguar në Drejtorinë e Financës shkresat nr.2536, datë 17.03.2025 dhe nr.2968, datë 28.03.2025 për kontabilizimin e debitorëve.

2- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomi, Bujqësisë, Taksave dhe Performancës me shkresë nr.783/1 prot, datë 18.03.2026 ka dërguar për kontabilizim debitorët për abonentët biznes për vitet 2015-2024, lista analitike nuk është bashkëngjitur në shkresën përkatëse por është dërguar elektronikisht.

Kjo listë nuk është kontabilizuar nga Drejtoria e Financës në llogarinë 468 por gjendja është e mbartur e vitit 2024. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me udhëzimin nr.5 "*Për disa*

ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09/03/2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"

- Për debitorët familjarë nuk është përcjell informacion nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomi, Bujqësis, Taksave dhe Performancës. Sa më sipër llogaria 468 *"Debitorë të ndryshëm"* për shkak të mospërcjelljes së plotë të informacionit nuk pasqyron gjendjen reale të debitorëve në Bashkinë Gjirokastër.

Llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)", në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 56,292,259 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" të Pasqyrës së Performancës Financiare. Vlera prej 56,292,259 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Pasqyra PF8: Detajet e nënrubrikës "*Të tjera operacione me shtetin*".

Emërtimi i llogarive	2025	2024
Llogari 401-408	-	-
Paga personeli llog 42	34,757,566	33,977,278
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	2,482,252	2,344,476
Sigurime shoqërore llog.435	10,349,002	10,162,221
Sigurime shëndetësore llog.436	1,426,000	1,405,238
Detyrime për tu paguar për blerje letra me vlerë 464	324,000	342,000
Kreditor të ndryshëm llog.467	6,953,439	4,355,462
Totali	**56,292,259**	**52,586,675**

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 "Aktivet Afatgjata Jo materiale", përbëhen nga llog.*202 "Studime dhe Kërkime"*, dhe paraqiten me kosto historike 40,648,680 lekë, amortizim i akumuluar në vlerën 23,095,085lekë, shtesa gjatë vitit 2025 në vlerën 6,810,369lekë, amortizim i vitit 2025 në vlerën 3,654,595 lekë dhe vlerë neto në vlerën 20,709,369 lekë. Nga auditimi i llogarisë 202 *"Studime dhe Kërkime"* gjatë vitit 2025 janë kontabilizuar në këtë llogari 5(pesë) oponenca teknike me vlerë 843,291 lekë dhe 4 (katër) projekte me vlerë 5,967,078 lekë. Projektet e kontabilizuar në llogarinë 202 *"Studime dhe Kërkime"* janë përfituar me anë të procedurave të prokurimit.

-Projekti Studim *"Mbi kushtet gjeologo -+ inxhinjerike te zonës ku do te ndërhytë me masa mbrojtëse për stabilizimin e shpatit ne kodrën e "Cfakes" Gjirokastër"*, vlera e fituesit pa TVSH është 785,000 lekë, ky projekt është kontabilizuar në llogarinë e mësipërme për vlerën 164,300 lekë vlera e cila është likuiduar vetëm për vitin 2025.

- Projekt Detyre projektimi *"Permiresimi i rrugës Kolonje–Golem"* procedura e prokurimit për këtë projekt është realizuar gjatë vitit 2024 me vlerë kontrate me TVSH 3,834,777 lekë.

Sa më sipër aktivi i cili merret në dorëzim duhet të kontabilizohet në llogarinë përkatëse të klasës2 me vlerë e plotë të aktivit edhe pse nuk është shlyer i plotë detyrimi, sepse në rastin e mësipërm kemi nënvlerësim të vlerës së aktivit në kundërshtim me udhëzimin nr.5 "*Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09/03/2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*

Pasqyra PF9: Lista e projekteve të kontabilizuara në llogarinë 202 gjatë vitit 2025.

Nr.	Emri I Projektit	Vitit I regjistrimit	Vlera historike	Amortizimi	Vlera kontabël neto
1	Rel.Paraprak.Gjeo.Ing	2025	164,300	24,645	139,655
2	Det.Proj.Kolonj-Golem	2025	3,834,778	575,217	3,259,561
3	Opon.Riks.amb.Tregut	2025	97,826	14,674	83,152
4	Proj.Riks.A-Z-Çajupi	2025	970,000	145,500	824,500
5	Proj.Riks Urani Rumbo	2025	998,000	149,700	848,300
6	Opon. Urani Rumbo	2025	118,189	17,729	100,460

7	Opon. And.Zako.Çajupi	2025	172,750	25,913	146,837
8	Opon.Kolonj – Golem	2025	301,697	45,255	256,442
9	Opon.Rrug. Babaa Selimi	2025	152,829	22,925	129,904
Totali			**6,810,369**	**1,021,556**	**5,788,811**

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 "Aktivet Afatgjata Materiale", AAM sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduar të Bashkisë për vitin ushtrimor 2025, paraqiten me tepricë neto 2,694,451,850lekë. Në vitin paraardhës 2024, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 2,924,100,382 lekë. Gjatë viti 2025 kemi patur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën324,835,247 lekë, shtesa pa pagesë janë në shumën 87,024,885 lekë dhe lëvizje brenda aktiveve në vlerën 0 lekë. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2025 kanë qenë në vlerën 161,059,254 lekë dhe pakësime nga nxjerrje jashtë përdorimi ose lëvizje ndërmjet llogarive kanë qenë në shumën 0 lekë.

Pasqyra PF10: Detajet e nënrubrikës "*Aktive afatgjata materiale*".

Nr. Llog	Emërtimi	Teprica neto në 31.12.2024	Shtesa 2025	Amortizim 2025	Pakësime neto 2025	Gjendja me 31.12.2025
210	Toka, Troje, Terrene	33,306,703	45,518,898	0	0	78,825,601
211	Pyje, Kullota, Plantacione	-	-	-	-	-
212	Ndërtime e Konstruksione	870,569,043	106,920,662	48,874,485	0	928,615,219
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,413,593,629	132,828,450	77,321,104	0	1,469,100,974
214	Instalime dhe paisje	19,815,478	22,155,889	10,492,842	0	31,478,525
215	Mjete Transporti	51,851,278	86,237,540	6,904,441	0	51,539,076
218	Inventar Ekonomik	50,860,247	18,198,693	13,811,788	0	55,247,152
Shuma		**2,439,996,378**	**411,860,132**	**157,404,660**	**0**	**2,614,806,547**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 210 "*Toka, troje terrene"* është paraqitur në bilanc në vlerën 33,306,703 lekë në fund të vitit 2024. Kjo llogari ka pasur ndryshime gjatë vitit 2025 dhe është kontabilizuar në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 78,825,601 lekë.

Nga verifikimi dhe analiza llogaria 210 *"Toka, troje, terrene",* konstatohet se, nga ana e Drejtorisë së Financës, nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të; a) trojeve nën objekt, të objekteve si godina e Bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në Njësive Administrative, etj., sipas regjistrit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 "Ndërtime e konstruksione" truallit të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë, trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Gjirokastër, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse.

Nga auditimi mbi saktësinë e Llogarisë 210 *"Toka, troje terrene"* rezulton se kjo llogari nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2025. Kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llogarinë 210 *"Toka, troje terrene"* dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në PF është e paplotë, pasi mungojnë analizat për të. Kjo llogari e pa analizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 27, 30*; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, pika 30.*

Pasqyra PF11: Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 210:

Nr. Llog	Emërtimi	Lloji i aktivit	Kosto Historike	Vlera neto kontabël 31.12.2025
210	Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masësnë kodrën e Cfakës pranë rrugës nacionale Gjirokastër- Kakavie Loti 2	Truall	45,518,898	
Total			45,518,898	

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Llogaria 211 ***"Pyje, Kullota, Plantacione"*** është paraqitur në bilanc në vlerën 0 lekë në fund të vitit 2024. Kjo llogari nuk ka pasur ndryshime gjatë vitit 2025 dhe është regjistruar në bilanc në vlerën 0 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur konstatohet se në Bashkia Gjirokastër në kontabilitet nuk ka të pasqyruar vlerën e pyjeve dhe kullotave, të transferuara me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 *"Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive",* e ndryshuar, pika 6, shtojca me nr.4, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Gjirokastër,. Për këto sipërfaqe nuk është bërë verifikimi fizik i tyre me qëllim përcaktimin e vlerës kontabël të llogarisë nr. 211. Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i aseteve për llogarinë me sipër. Për llogaritë e mësipërme në Bashkinë Gjirokastër nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj. Pra, si rezultat i moszbatimit të kuadrit rregullator ligjor për transferimin e aktiveve, llogaria 211 *"Pyje Plantacione",* nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2025. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 "Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë";* Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74,* dhe Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap III, pika 30, i ndryshuar.*

Llogaria 212 ***"Ndërtesa dhe konstruksione"***. Sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduar të Bashkisë për vitin ushtrimor 2025, paraqiten me tepricë neto 928,615,219 lekë. Në vitin paraardhës 2024, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 870,569,043lekë. Gjatë viti 2025 ka patur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën 106,920,662 lekë, shtesa pa pagesë janë në shumën 0 lekë dhe lëvizje brenda aktiveve në vlerën 0 lekë Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2025 kanë qenë në vlerën 48,874,485 lekë dhe pakësime nga nxjerrje jashtë përdorimi ose lëvizje ndërmjet llogarive kanë qenë në shumën 0 lekë.

Pasqyra PF12: Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione"* gjatë vitit 2025:

Nr. Llog	Emërtimi	Kosto Historike	Amortizim i Akumuluar	Vlera neto kontabël 31.12.2025
212	Rinov.pajis.qendres Komunitare Zinxhira	756,000	37,800	718,200
212	Shkolla Asim Zeneli	85,899,478	4,294,974	81,604,504
212	Shkolla Siri Shapllo,hidroizolim riparim ulluqe	2,417,290	120,865	2,296,425
212	Shk. Mesme +Kopshti Muhamet Gjollesha	17,783,899	889,195	16,894,704
212	Permirsimi i kushteve te banesave për komunitetet e varfera dhe te pafavorizuar, Mbik+kolaud LotI	63,992	3,200	60,792
Totali		**106,920,662**	**5,346,034**	**101,574,628**

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Llogaria 213 *"Rrugë,rrjete,vepra ujore"*

Sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduar të Bashkisë për vitin ushtrimor 2025, paraqiten me tepricë neto 1,149,656,122 lekë. Në vitin paraardhës 2024, vlera kontabël neto e llogarisë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* paraqitet në shumën 1,413,593,629 lekë. Gjatë vitit 2025 kemi patur shtesë të llogarisë 213 blerje me pagesë në shumën 132,828,450 lekë. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2025 kanë qenë në vlerën 77,321,104 lekë.

Pasqyra PF13: Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 213 *"Rrugë, rrjete dhe vepra ujore"* gjatë vitit 2025:

Nr. Llog	Emërtimi	Kosto Historike	Amortizim i Akumuluar	Vlera neto kontabël 31.12.2025
213	Rikonstruksion rruga Zhulat	46,729,844	2,336,493	44,393,351
213	Riveshje asfaltim rruge Dhoksat	4,535,760	226,788	4,308,972
213	Riveshjet seg të ndryshme rrugore	26,096,656	1,304,833	24,791,823
213	Rehabilitimi i seg te ndryshme rrug,mbi+kolau	31,265,892	1,563,295	29,702,597
213	Rivitalizimi i hapësirave Pallat Sporit	20,373,728	1,018,687	19,355,041
213	Rikonstruksion lerash	3,826,568	191,329	3,635,239
Totali		**132,828,449**	**6,641,423**	**126,187,026**

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Llogaria kontabël 214 *"Instalime teknike, makineri, pajisje vegla pune".* Kjo llogari përfaqëson makineri pajisje dhe vegla pune në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë. Sipas pasqyrave financiare të konsoliduar të Bashkisë gjendja e llogarisë 214 më datë 31.12.2025 paraqitet me vlerë neto 31,478,525 lekë. Bashkia gjatë vitit 2025 ka blerë më pagesë më anë të procedurave të prokurimit materiale me vlerë 1,198,740 lekë.

Pasqyra PF14: Shtesat gjatë vitit 2025në llogarinë 214 *"Instalime teknike, makineri, pajisje vegla pune":*

			Pa pagesë		
Nr.	**Njësitë shpenzuese**	**Blerje me pagesë**	**Jashtë sistemit**	**Brenda sistemit**	**Lëvizje brenda aktiveve**
1	Paj.didakt.lab.fizikes.SiP-V		7,755,745		
2	Vegla Muzikore sipas F-D	159,600			
3	Pllakë sobe	3,000			
4	Kamera 3*19200			1,896,180	
5	Laborator Smart		4,135,932		
6	Laborator Smart		4,135,932		
7	Pomp uji elektrike	21,600			
8	Pllakë sobe1500ë	5,700			
9	Vegla Muzikore	120,840			
10	Kompresor 100/2.2	72,000			
11	Motor gjenerator ajri	198,000			
12	Kompresor 2000Ë	54,000			
13	Makine korse	67,200			
14	Motorkorse benzin	19,200			
15	Kosha metalik			3,033,360	
16	Lavazho	60,000			
17	Pajisje skenike turizmi	417,600			
Total		**1,198,740**	**16,027,609**	**4,929,540**	**-**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 215 *"Mjete transporti"*. Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve te transportit në pronësi të Bashkisë Gjirokastër.

Sipas pasqyrave financiare të konsoliduar të në datën 31.12.2025, Bashkia disponon 49 mjete me kosto historike 182,723,453 lekë, amortizim të akumuluar në shumën 51,539,076 lekë dhe me vlerë neto kontabël 131,184,377 lekë.

Gjatë vitit 2025 llogaria 215 *"Mjete Transporti"* ka pasur shtesa në vlerën 86,237,540 lekë nga të cilat blerje me pagesë janë në vlerën 21,310,000 lekë dhe shtesa pa pagesë janë në vlerën 64,927,540 lekë.

Pasqyra PF15: Mjetet e Transportit të Bashkisë:

Nr.	Drejtoria	Emërtimi	Viti i regjistrimit	Kosto Historike	Amortizim i Akumuluar	Vlera Neto
1	Pol.Bashkiake	Toyota ABXXXAA	2025	999,999	50,000	949,999
2	Sherb.Social	Wolksëagen Candy AAXXXAA,	2025	2,430,000	121,500	2,308,500
3	Sherb.Social	AB XXX XE,	2025	4,338,139	216,907	4,121,232
4	Dr.Arsimit	ABXXXXF,	2025	3,000,000	150,000	2,850,000
5	D.K.U	Mak Teknologjike Mitsubishi ABXXXVT,	2025	3,600,000	180,000	3,420,000
6	D.K.U	Mini Bus	2025	60,589,401	3,029,470	57,559,931
7	M.Z.SH	ABXXXAA	2025	11,280,000	564,000	10,716,000
Totali				**86,237,540**	**4,311,877**	**81,925,663**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Bashkia Gjirokastër gjatë vitit 2025 ka përfituar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit mjete dhe pajisje me vlerë 60,589,401 lekë.
Akt dorëzimi i mjeteve/pajisjeve te Bashkia Gjirokastër me nr.3036/2 prot, datë 09.07.2025 sipas listë së mjeteve më poshtë me vlerat përkatëse.

Nr.	Nr. fature	Përshkrimi	Sasia	Vlera me TVSH në lekë
1	112/2025	Minibus+Charger ABXXXUG	1	18,657,999
2	114/2025	Minibus+Charger ABXXXUG	1	18,657,999
3	113/2025	Minibus+Charger ABXXXUG	1	18,657,999
4	118/2025	DC Fast Charger	1	883,800
5	118/2025	Buggy 8 seaters+ Charger	2	3,338,800
6	125/2025	Transporti për Minibus dhe Karikusin	1	147,300
7	126/2025	Transporti për Buggy dhe Karikusin		98,200
		Transporti për Karikusin e shpejtë		147,300
Totali				**60,589,401**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Bashkia Gjirokastër ka përfituar në formë dhurimi dhe mjetin me markë "Volksëagen" sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Gjirokastër dhe Insitutin e Kulturës në Romë. Procesverbali i marrjes në dorëzim me nr.1137 prot, datë 27.10.2025 është firmosur nga komisioni i marrjes në dorëzim.

Llogaria kontabël 218 ***"Inventar ekonomik".*** Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Gjirokastër. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Gjirokastër gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2025 paraqitet në vlerën 55,247,152 lekë. Krahasuar me vitin 2024 llogaria 218 *"Inventari ekonomik"* është shtuar me vlerën 4,386,905 lekë.

Pasqyra PF16: Shtesat gjatë vitit 2024në llogarinë 218 "Inventar ekonomik":

			Pa pagesë		
Nr.	**Njësitë shpenzuese**	**Blerje me pagesë**	**Jashtë sistemit**	**Brenda sistemit**	**Lëvizje brenda aktiveve**
1	Emergjencat dhurat komp+tav+karrige	-	285,046	-	-
2	ZVA dhurat Dr.Arsimit Komp	-	202,350	-	-
3	Komp Lenovo	423,104	-	-	-
4	Kompjuter	-	-	244,800	-
6	Krevat fizioterapie	82,200	-	-	-
7	Set komp.Destktop	55,200	-	-	-
8	Laptop	57,600	-	-	-
9	Laptop Advanced	139,180	-	-	-
10	Kurore,elemnete kordele	3,752,400	-	-	-
11	Stola me krah gize	882,000	-	-	-
12	Stola karrige druri	361,645.1	-	-	-
13	Droni	228,000	-	-	-
14	Karrige femij,nx	1,983,847.5	-	-	-
15	Tavolina klasa	423,080	-	-	-
16	Dollap,kls,kopshte	8,547,840	-	-	-
17	Stola amb jasht kopshte	122,400	-	-	-
18	Kompjuter	-	-	408,000	-
Total		**17,058,497**	**487,396**	**652,800**	**-**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 219 *"Amortizimi i AAGJM & AAJM":* Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Gjirokastër në fund të vitit 2025, paraqitet në vlerën 1,453,351,289 lekë që ka të bëjë me amortizimin e akumuluar me datë 31.12.2025. Krahasuar me vitin 2024 llogaria 219 "Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara" paraqitet me shtesë prej 161,059,254 lekë, shtesë e cila ka të bëjë me amortizimin vjetor të vitit 2025.
Në aneksin nr. 2/3/1 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur amortizimi i AAGJ.
Përllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 05 datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*
Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Gjirokastër, janë si më poshtë:
- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- për mjetet e transportit 20%
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

Aktivet Afatgjata Financiare

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund 2025 në vlerën 0 lekë.
-Bashkia Gjirokastër në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 21,24 % të aksioneve të "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër" sh.a me NUIS "M.....L" e cila është shoqëri aksionere me objekt, *"Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të 21 furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve".*
Numri i aksioneve është 21,240 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 2,124,000 lekë.
-Bashkia Gjirokastër në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 25% të aksioneve të "KF Luftëtari" sh.a me NUIS "L.....H" e cila është shoqëri aksionere me objekt, "Organizimi i aktiviteteve sportive në fushën e futbollit".
Numri i aksioneve është 4,300 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 4,300,000 lekë.
-Bashkia Gjirokastër në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100 % të aksioneve të "Trajtimi i Studentëve" sha me NUIS "K.....E" e cila është shoqëri aksionere me objekt, "*Trajtimi I studentëve në Universitetin Eqerem Çabej me akomodim dhe shërbime të tjera"*.
Kapitali i shoqërisë është në vlerën 727,244 lekë.
Vlerat e mësipërme sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit nuk paraqiten në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2025 ,më konkretisht në llogarinë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale" pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 "Trajtimi kontabël i investimeve në Pjesëmarrje".
Sa më sipër nuk është kontabilizuar në këtë llogari vlera 7,151,244 lekë për pjesën takuese në shoqëritë si mëposhtë:

1. "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër" me vlerë takuese 2,124,000 lekë.
2. "KF Luftëtari" sha me vlerë takuese 4,300,000 lekë.

3. "Trajtimi i studentëve Gjirokastër" sha me vlerë takuese 727,244 lekë.

Investimet:
Gjendja e llogarive 230 "*Investime për aktive afatgjata jo materiale*" dhe 231 "*Investime për aktive afatgjata materiale*" në datën 31.12.2024 paraqitet në vlerën 484,104,004 lekë. Gjatë vitit 2025 kjo llogari është pakësuar për vlerën 104,880,862 lekë dhe në datën 31.12.2025 është kontabilizuar në vlerën 379,223,142 lekë.
Referuar udhëzimit nr.5, datë 21.02.2022 *"Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* këto llogari paraqesin vlerën e investimeve në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 "*Aktive afatgjata materiale*".
Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Gjirokastër u konstatua se llogaria 231 "Investimet" është mbivlerësuar për vlerën 322,612,486 lekë.
Në aneksin nr. 2/3/2 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur lista e investimeve të kontabilizuar në llogaritë e klasës 2 dhe të cilat janë të kontabilizuar edhe në llogarinë 231 *"Investime".*
Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduar të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2025 llogaritë kundërti parti të llogarisë 231 "Investime për aktive afatgjata" janë kontabilizuar si mëposhtë:
-Llog 105 "Teprica e granteve kapitale të brendshme" me vlerë 362,649,037 lekë;
-Llog 106 "Teprica e granteve kapitale të huaja" me vlerë 16,574,106 lekë;
-Llog 115 "Nga fondet e veta të investimeve" me vlerë 88,693,591 lekë;
Llogaritë e mësipërme mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante/investime janë investime në proces të papërfunduara. Llogaritë e mësipërme referuar udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 *"Disa ndryshime në udhëzimin e ministrit të financave dhe të ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* duhet të kuadrojnë me llogarinë 231 *"Investime për aktivet afatgjata".*

PASIVET (DETYRIMET)
Pasivet Afatshkurtra
Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Gjirokastër më 31.12.2025, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2025, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2025, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:
Pasqyra PF17: Detajet e nënrubrikës "*Llogari të pagueshme*".

Llogaritë		Viti 2025	Viti 2024
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	-	-
42	Detyrime ndaj personelit	34,757,566	33,977,278
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	2,482,252	2,344,476
435	Sigurime shoqërore	10,349,002	10,162,221
436	Sigurime shëndetësore	1,426,000	1,405,238
467	Kreditor të ndryshëm	6,953,439	4,355,462
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	49,537,108	51,340,526

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", e cila paraqet informacion për gjendjen e faturave të palikuiduara në fund të vitit 2025 është kontabilizuar në vlerën 0 lekë.
Llogaria 42, "Detyrime ndaj personelit", sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Gjirokastër, paraqitet në vlerën 34,757,566 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të

muajit dhjetor për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, dhe janë paguar ne muajin janar 2026 ne shumen 34,757,566 lekë.

Llogaria 431, "Detyrime ndaj shteti për tatim taksa", paraqitet në vlerën 2,482,252 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor dhe e paguar ne janar 2026.

Llogaria 435, "Sigurime shoqërore" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 10,349,002 lekë.

Llogaria 436, "Sigurime shoqërore" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 1,426,000 lekë.

Llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje", sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Gjirokastër, në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 37,137,708 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%.

Në aneksin nr. 2/3/3 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur lista e ngurtësimeve për të cilat ka kaluar afati i garancisë. Referuar informacionit të aneksit 2/3/3 janë paraqitur 32 ngurtësime me vlerë 8,947,236 lekë për të cilat ka kaluar afati i garancisë.

Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 *"Kreditore për mjete nën ruajtje"* duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Veprimet dhe mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* Kap. III, pikat 30, 50, ku përcaktohet:

Pika 30:"*Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet*",

Pika 50: "*Tepricat e llogarisë 520, "Disponibilitete në thesar" dhe të llogarisë 466, "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)*".

UKM nr. 3, datë 15.02.2011 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, Kap. II, pika 10 ku përcaktohet:

Pika 10: "*Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për difektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.*"

Llogaria 467 "Kreditor të ndryshëm", sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Gjirokastër , në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 6,953,439 lekë dhe përfaqëson vlerën e detyrimeve të prapambetura.

Pasqyra PF18: Detajet llogarisë "*Kreditorë të ndryshëm".*

Nr.	Objekti I faturës	Data dhe numri	Vlera e fatures me TVSH	Gjendja date 01.01.2025	Shtesa 2025	Pakesime 2025	Gjendja 31.12.2025
1	Paradheniet e kopshteve dhe çerdheve	Sipas lëvizjeve te regjistruara ne kontabilitet (korespodenca DA)		2,001,000	540,000	394,000	2,147,000
2	A. M.	Vendim Nr.250-123 dt13.9.2021		435,352	0	0	435,352

3	F. H.	Vendim Nr.20-2021-915/301 dt.25.11.2021		527,610	0	0	527,610
4	Mobilimi i Kinemase multifunksionale try Gjirokastra	Nr. 05 date 05.02.2024	1,391,500	1,391,500	0	1,391,500	0
5	Detyrim i prapambetur fat.nr.58 dt.31.07.2025 Shërbim Loti 1, Loti 2 sipas kont me ref nr. 8531 dt 01.10.2024	Nr. 58 dt 31.07.2025	5,195,719	0	5,195,719	1,352,242	3,843,477
Total				**4,355,462**	**5,735,719**	**3,137,742**	**6,953,439**

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën 1,484,767,426 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit paraqitet më poshtë:
Gjendja e llogarisë sintetike ***70*** **"Të ardhurat nga taksat dhe tatimet"** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 94,320,610 lekë, e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
Gjendja e llogarisë ***7020 "Tatim mbi pasurinë e paluajtshme"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 41,904,329 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.
Gjendja e llogarisë ***7035 "Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 51,938,627 lekë.
Gjendja e llogarisë ***71*** **"Të ardhurat jo tatimore"** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 114,123,542 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
Gjendja e llogarisë ***7109*** "***Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia"*** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 9,839,327 lekë, e cila përfshin, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
Gjendja e llogarisë ***711*** "***Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare"*** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 104,284,215 lekë, e cila përfshin etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën 1,265,021,233 lekë paraqitet më poshtë:
- Gjendja e llogarisë ***600 'Paga, shpërblime e të tjera personeli"*** për vitin 2025, paraqitet në pasqyrën e performancës financiare në vlerën 504,338,142 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 504,338,142 lekë.
- Gjendja e llogarisë ***601 'Kontribute për sigurime"*** për vitin 2025, paraqitet në pasqyrën e performancës financiare në vlerën 86,606,515 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 86,606,515 lekë.
- Gjendja e llogarisë ***602 "Blerje mallra e shërbime"*** paraqitet në pasqyrën e performancës financiare për vitin 2025 në vlerën 166,636,220 lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën 166,636,220 lekë.
- Gjendja e llogarisë ***603 "Blerje mallra e shërbime"*** paraqitet në pasqyrën e performancës financiare për vitin 2025 në vlerën 166,636,220 lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën 166,636,220 lekë.
- Gjendja e llogarisë ***604 "Transferime Korente"*** paraqitet në pasqyrën e performancës financiare për vitin 2025 në vlerën 45,486,454 lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën 45,486,454 lekë.
- Gjendja e llogarisë së fondeve ***606 "Transferimepër Buxhetet familjare e Individë"*** paraqitet në pasqyrën e performancës financiare për vitin 2025 në vlerën187,025,212 lekë, dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.

Për vitin 2025 totali i te ardhurave ne vlere është 1,484,767,426 lekë dhe totali shpenzimeve është 1,265,021,233 lekë. Diferenca e tyre ne vlerën 114,838,753 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 "Rezultatin e ushtrimit".
Në aneksin nr. 2/3/4 në anekset e raportit të auditimit paraqitet analiza e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 *"Pasqyra e performancën financiare"* të PF të vitit 2025.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Znj.F. Ç. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit

(Për sa më sipër, pas njohjes me projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Bashkia Gjirokastër, nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit).

2.4. Auditim i prokurimeve publike.
-Progamimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.
-Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik.
-Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave/punëve dhe shërbimeve.

Nga auditimi ka rezultuar se, janë hartuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për periudhën 01.01.2025 - 31.12.2025 të miratuara në sistem (SPE) nga APP-ja dhe të dërguara pranë degës së thesarit.
Për auditimin mbi disponimin e fondeve dhe angazhimin e tyre për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, për periudhën objekt auditimi, nga grupi i auditimit, në lidhje me AK Bashkia Gjirokastër, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:
- Regjistri i parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike për vitin 2025.
- Dokumentacioni i vënë në dispozicion nëpërmjet dosjeve fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurave si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave.

Në mënyrë të përmbledhur[2], nga të dhënat mbi procedurat e prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2025-31.12.2025, situata paraqitet si më poshtë vijon:
-Nga subjekti (AK) Bashkia Gjirokastër për periudhën 01.01.2025-31.12.2025 janë zhvilluar gjithsej, duke përfshirë të gjitha llojet, 79 procedura prokurimi, për një fond limit total pa TVSH 265,649,229 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 205,170,760 lekë pa TVSH.
Në mënyrë të detajuar, situata për vitin 2025 paraqitet si vijon:
-Për periudhën 01.01.2025-31.12.2025: Procedurat e realizuara për këtë periudhë janë specifikisht: 7 procedura të llojit "blerje nën vlerën 100 000 lekë" për një fond limit total pa TVSH 700,000 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 399,549 lekë pa TVSH; 48 procedura të llojit "Blerje me vlerë të vogël" për një fond limit total pa TVSH 19,485,355 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 14,610,075 lekë pa TVSH; 19 procedura të llojit "E hapur e thjeshtuar" për një fond limit total pa TVSH 54,207,037 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 45,367,209 lekë pa TVSH; 4 procedura të llojit "E hapur" për një fond limit total pa TVSH 168,140,169 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 123,264,485 lekë pa TVSH; 1 procedurë e llojit "E hapur mbi kufirin e lartë monetar" për një fond limit total pa TVSH 23,116,666 lekë dhe vlerë totale të kontratës së lidhur 21,529,440 lekë pa TVSH;
Për një pjesë të procedurave të prokurimit, të audituara me përzgjedhje nga grupi i auditimit (9 procedura prokurimi me vlerë FL mbi 1 milion lekë, për një fond limit total pa TVSH 179,927,363 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 133,619,358 lekë pa TVSH si dhe 5

[2] Në mënyrë të detajuar dhe tabelore, të dhënat mbi procedurat e prokurimeve publike të zhvilluara dhe të audituara për periudhën objekt auditimi 01.01.2025-31.12.2025, paraqiten në aneksin bashkëlidhur materialit.

procedura prokurimi me vlerë FL deri në 1 milion lekë, për një fond limit total pa TVSH 2,341,182 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 1,841,890 lekë pa TVSH, të specifikuara në aneksin bashkëlidhur), u konstatuan disa parregullsi në shkelje apo mospërputhje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" si dhe Udhëzimin nr. 05 datë 25.06.2021.

2.4.1. Në lidhje me auditimin e procedurave të llojit "E hapur" dhe "E hapur e thjeshtuar", me vlerë të fondit limit më të lartë se ajo "Blerje me vlerë të vogël".

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit nr. 515/2, datë 14.05.2026, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1-Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt:*"**Rikonstruksion i godinës ekzistuese dhe shkallës së emergjencës dhe dhomës teknike në shkollën 9-vjeçare "Urani Rumbo"**,* si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:
Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i godinës ekzistuese dhe shkallës së emergjencës dhe dhomës teknike në shkollën 9-vjeçare "Urani Rumbo".</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E hapur"
REF-56498-07-29-2025
Urdhri nr. 6813 prot., datë 11.07.2025</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)
Urdhri nr. 6813 prot., datë 11.07.2025
1. B.B.
2. L.Sh
3. A.P.</td><td>2. Njësia e Prokurimit
1. B.B.
2. L.Sh
3. A.P.</td><td>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 7731 prot., datë 29.07.2025
1. A.Ll
2. K.N.
3. M.Sh.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSH)
78,753,168 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSH)
61,957,475 lekë
Fitues: BOE "I. & E." SHPK</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)
16,795,639 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1. Data e hapjes së tenderit:
Data 19.08.2025
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj</td><td colspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i Shtetit
Buxheti i Bashkisë Gjirokastër</td><td>9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender Numër 3 BOE
b) Skualifikuar 2 BOE
c) Kualifikuar 1 BOE</td></tr>
<tr><td>10. Ankimime
AK-s'ka/ka: Jo
APP–s'ka/ka: Jo
KPP-s'ka/ka: Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE)):
Data: 30.09.2025 (komunikimi i renditjes)
Data: 14.10.2025 (njoftimi paraprak i fituesit)
Data: 23.10.2025 (njoftimi përfundimtar i fituesit)</td><td>12. Data e lidhjes së kontratës:
Data: 04.11.2025
12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):
Data: 04.11.2025</td></tr>
</table>

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:
a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.
Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:
Së pari, me shkresën nr. 6344 prot., datë 30.06.2025 Drejtoria e Urbanistikës, Sektori i Projekteve, ka kërkuar, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor (Personi i Autorizuar), realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i godinës ekzistuese dhe shkallës së emergjencës dhe dhomës teknike në shkollën 9-vjeçare "Urani Rumbo*", për të cilën paraprakisht ka siguruar, si dhuratë, projekt-preventivin, grafikun e punimeve, specifikimet teknike dhe relacionin përkatës. Projekt-preventivi rezulton të jetë përgatitur nga projektuesi BOE "P.C.S. C." & "H.-E. C." SHPK.
Së dyti, në lidhje me procedurën e sipërcituar, nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, rezulton të jetë pjesë e saj dhe të jetë kryer një oponencë teknike, nisur nga fakti se objekti i procedurës, në rastin konkret, është një ndërtim publik apo me akses publik. Oponenca teknike është kryer nga Instituti i Ndërtimit me nr. 269/2 prot., datë 07.05.2026. Në

rastin konkret, veprimet e AK janë në zbatim të pikës 1 të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, sipas të cilit: "*Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik*", si dhe të VKM-së nr. 9, datë 11.01.2024 "*Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste*".

AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për kualifikim":

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit*" të datës 29.07.2025 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), edhe pse pas ndryshimeve të sugjeruara nga APP, në përgjithësi, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*", për disa prej tyre, grupi i auditimit vlerëson se rezultojnë të paqartë apo të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe/ose të ekzagjeruar dhe/ose të argumentuara mbi bazën e parakushteve jorealiste. Në lidhje me këto kritere, njësia e prokurimit (NjP) është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos marrë parasysh natyrën dhe vlerën e kontratës.

Konkretisht, për sa më sipër, nga grupi i auditimit, është konstatuar sa vijon:

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.6, ndër të tjera, ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:

-"*1 (një) Arkitekt ose Ing. në restaurim me Licencë Restaurimi nga Ministri e Kulturës".*

Kërkesa e AK në lidhje me 1 (një) Arkitekt, konstatohet se nuk ka lidhje me natyrën dhe objektin e kontratës pasi kriteri në fjalë mund të konsiderohet i nevojshëm në fazën e projektimit por jo të zbatimit të objektit. Në rast se nga AK vlerësohet nevoja e një arkitekti me Licencë Restaurimi për zbatimin e punimeve me cilësi, një i tillë mund të kërkohet në procedurën e prokurimit të mbikëqyrjes dhe jo zbatimit. Nga ana tjetër, në lidhje me këtë kriter, grupi i auditimit vlerëson se në lidhje me operatorin zbatues është i mjaftueshëm kriteri i përcaktuar nga AK në pikën 2.5 sipas të cilit "*Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizmin e punimeve duhet të jetë i pajisur me Licencë për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale në Zbatim (Z)...*". Për rrjedhojë, grupi i auditimit vlerëson se, në rastin konkret, kemi të bëjmë me një kriter të paargumentuar, të ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës.

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.7, ndër të tjera, për 43 punonjësit e cituar (stafin specialist), ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:

"*Dëshmi të sigurimit teknik (të vlefshme) nga ISHTI ose ekuivalente me to të akredituara...*".

Në lidhje me këtë kriter, grupi i auditimit vlerëson se, "pajisja me Certifikatë për sigurimin teknik ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik" shërben për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike, pra nuk është në përputhje me objektin e prokurimit pasi në preventivin e këtij të fundit ekzistojnë kryesisht punime ndërtimi dhe një volum i vogël punime elektrike. Referuar dispozitave të ISHTI, dëshmitë jepen për kategoritë: Naftën dhe Gazin Natyror, Pajisje nën Presion, Instalime Elektrike dhe Laborator të Kontrolleve. Në këto kushte është e qartë se kjo dëshmi e sigurimit teknik nuk ndikon në vlerësimin e kualifikimit të stafit duke pasur parasysh për më tepër se ky kriter, përveç elektriçistëve, është

kërkuar edhe për bojaxhi, betonues, karpentier, muratorë, pllakashtrues, shtrues laminat/parketi, mekanik suvaxhi etj.

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.10, ka kërkuar, ndër të tjera, nga OE ofertues disponimin si vijon:

"*Kokore, Rripa lidhës sigurimi, Fikëse zjarri, Komplet i ndihmës së shpejtë, Uniforma/Jelek, Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt".*

Në rastin konkret, duke qenë se kemi të bëjmë me një objekt prokurimi i cili, nisur nga natyra e tij, zbatohet nga operatorë ekonomikë me eksperiencë dhe "prestigj" në treg, kërkesa për mjetet e sipërcituara vlerësohet e panevojshme. Njësia e prokurimit duhet të marrë parasysh se kërkesat dhe masat e sigurisë së një OE janë objekt kontrolli nga inspektoratet përkatës. Nga ana tjetër kërkesat e natyrës së sipërcituar, jo në përpjesëtim apo të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, rrisin në mënyrë të panevojshme volumin e punës së KVO-së gjatë procesit të vlerësimit dhe riskun që kjo e fundit të skualifikojë ofertues, eventualisht më vlerë ofertë më të ulët, për mungesa deklarimi kriteresh, që nuk ndikojnë në realizimin e objektit të kontratës.

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.10/b, ka kërkuar, ndër të tjera, nga OE ofertues disponimin si vijon:

"*Për mjetet që merren me qera duhet të paraqitet dokumenti që vërteton:...Certifikatë për transport mallrash <u>për llogari të vet</u> apo për të tretë*".

Në lidhje me këtë kriter, grupi i auditimit sjell në vëmendje të njësisë së prokurimit faktin se, në lidhje me mjetet që merren me qira, certifikata për transport mallrash duhet të jetë domosdoshmërisht për të tretë dhe jo vetëm për llogari të vet. Konkretisht, sipas njoftimit të APP nr. 4916/2 prot datë 14.07.2022 në rastin e mjeteve me qera referuar dokumentacionit, mjetet nuk duhet të rezultojnë vetëm për përdorim vetjak por edhe për përdorim nga të tretët.

Si konkluzion, veprimet apo mosveprimet e mësipërme, përveçse rezultojnë në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.05.2021 "*Për prokurimin publik*", ndikojnë negativisht mbi konkurrencën, në kundërshtim me nenin 2 të LPP-së. Njësia e prokurimit nuk ka konsideruar faktin se kriteret e sipërcituara dhe paqartësia e tyre mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët eventualisht mund të kenë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës.

Situata e sipërcituar bie në kundërshtim me përcaktimet e Nenit 39 pika 4: "*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës…*", si dhe Nenit 78 pika 2: "*Hartimi i kërkesave për kualifikim…Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht...*".

Në përfundim, në lidhje me veprimet apo mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** z. B.B, znj. L.Sh. dhe z. A.P., në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave, argumentimi i llojit të procedurës si dhe publikimet e nevojshme.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 30.09.2025 njoftimin e klasifikimit, në datën 14.10.2025 njoftimin paraprak dhe në datën 23.10.2025 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"N. & B.M-K."SHPK	51,192,903	*Skualifikuar*
2	"I. & E." SHPK	61,957,475	*Kualifikuar/Fituesi*
3	"T&J C. & V. K. & N." SHPK	65,000,000	*Skualifikuar*

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke kualifikuar 1 (një) OE dhe skualifikuar 2 (dy) OE, me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

1. ***"N. & B.M-K." SHPK:*** *Vlerat e xhiros për vitet financiare 2022-2023-2024 të OE "B.M-K" janë më te vogla se vlera e përllogaritur të kontratës. OE "B.M-K" i mungojnë kategoritë:N.P-12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit NS – 8 A Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri. Oferta e ofruar nga BOE rezulton e pasaktë. Një ofertë e vlefshme vlerësohet vetëm nëse është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Përfshirja e zërave shtesë nga OE përbën ndryshim në përmbajtjen e ofertës dhe si e tillë e kthen ofertën në të pavlefshme. OE "B.M-K" rezulton mos të ketë paraqitur në SPE tabelën për punonjësit e specializuar përkatësisht për punonjësin Specialist IT sipas deklarimit të bërë në Shtojcën 8. OE B.M-K" nuk ka paraqitur në SPE certifikata ISO. OE N. nuk ka të paraqitur Licencë për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale në Zbatim (Z) Nënkategoria Z/A/4/7 për punimet e mësipërme.*
2. ***"T&J C. & V. KON. & N." SHPK:*** *Ndryshimi i preventivit përbën mospërputhje thelbësore me kërkesat e DST dhe sjell pamundësi për krahasim të barabartë midis operatorëve ekonomikë, duke cenuar parimin e barazisë dhe transparencës në garë. OE N. SHPK nuk ka të paraqitur Licencë për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale në Zbatim (Z) Nënkategoria Z/A/4/7. OE T. & J. C. SHPK në Formularin përmbledhës të vetdeklarimit ka deklaruar punonjësin F. D. njëkohësisht dhe teknik ndërtimi dhe gurëgdhëndës (gurëpunues).*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:
Me shkresën nr. 9812 prot., datë 24.09.2025 është kërkuar nga BOE "I. & E." SHPK korrigjimi i gabimit teknik të paraqitur në ofertë. Me shkresën nr. 9939 prot., datë 29.09.2025 BOE "I. & E." SHPK ka kryer korrigjimin e gabimit teknik të paraqitur në ofertë dhe ka informuar Autoritetin Kontraktor.
-Me procesverbalin e datës 30.09.2025, ndër të tjera, KVO-ja, ka kontrolluar preventivat e ofertuesve me qëllim korrigjimin eventual të tyre, ka verifikuar ofertat anomalisht të ulëta dhe ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar nga BOE "I. & E." SHPK, i renditur i pari, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës.
-Në procesverbalin nr. 10594 prot., datë 14.10.2025, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues BOE "I. & E." SHPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".
-Me shkresën nr. 10614 prot., datë 14.10.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".
-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës nr. 11045 prot., datë 14.10.2025, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari i AK (Personi i Autorizuar z. N. N.).
-Me shkresën nr. 11013 prot., datë 23.10.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".
-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konstatohet se kontrata e sipërmarrjes nr. 11467 prot., datë 04.11.2025, është nënshkruar nga Personi i Autorizuar dhe përfaqësuesit e BOE, konkretisht "I. & E." SHPK.

Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit (nr. 11482 prot.), nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 04.11.2025 duke respektuar afatin e përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".
Në vijim, në zbatim të LPP-së, nga Personi i Autorizuar është nxjerrë "Plani i Zbatimit të Kontratës" nr. 11468 prot., datë 04.11.2025.
Së treti, për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistem (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se **KVO-ja, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, ka kryer veprime dhe mosveprime të pajustifikuara** të cilat bien ndesh me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", konkretisht si vijon:
Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se **KVO ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave**. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të ofertave është hapur në datën 19.08.2025, KVO-ja ka pasur detyrimin ligjor të kryente vlerësimin e tyre brenda datës 03.9.2025 (15 ditëve). Referuar procesverbalit të vlerësimit (paraprak) dhe SPE, rezulton se vlerësimi i ofertave dhe njoftimi përkatës është kryer në datën 30.09.2025 (komunikimi renditjes) dhe 14.10.2025 (vlerësimi paraprak). Në lidhje me shkeljen e afatit të vlerësimit nga KVO, në dosjen e prokurimit nuk rezulton të ketë një justifikim ligjor, i cili të përmbajë një nga arsyet e përcaktuara në nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 sipas të cilit: "*Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë...15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizmit të anëtarit/anëtarëve*".
Në rastin konkret, moszbatimi i dispozitave të LPP-së apo shkelja e afateve ligjore, veçanërisht gjatë fazës së vlerësimit të ofertave është problematike. Ato jo vetëm që mund të shkaktojnë shqetësime për ofertuesit, por gjithashtu mund të krijojnë hapësira për praktika abuzive ose të paktën të krijojnë një perceptim të dyshimtë dhe të dëmtojnë sigurinë dhe besimin në praktikën e prokurimit publik të AK-së dhe të gjithë sistemit të prokurimit publik.
Në përfundim, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi** znj. A. Ll., z. K. N. dhe znj. M. Sh., në cilësinë e anëtarëve të KVO-së, si dhe N.N. Personi i autorizuar.

2-Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt:*"**Rikonstruksion i rrugës «Baba Selimi» Zinxhira Gjirokastër**"*, si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:
Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*Rikonstruksion i rrugës «Baba Selimi» Zinxhira Gjirokastër*".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "E hapur" REF-60928-09-10-2025 Urdhri nr. 8674 prot., datë 27.08.2025	**1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)** Urdhri nr. 8674 prot., datë 27.08.2025 1. B.B P.P. 2. L.Sh. 3. A.P.	**2. Njësia e Prokurimit** 1. B.B 2. L.Sh. 3. A.P.	**3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri nr. 8925 prot., datë 01.09.2025 1. A.Ll. 2. K.N 3. M.Sh.

4. Fondi Limit (pa TVSH) 66,663,298 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSH)** 42,055,609 lekë Fitues: BOE "E. C. C.& C. LTD" SHPK	**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** 24,607,689 lekë
7/1. Data e hapjes së tenderit: Data 01.10.2025 **7/2 Kohëzgjatja e kontratës:** 10 muaj	**8. Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit Buxheti i Bashkisë Gjirokastër	**9. Operatoret Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender Numër 16 **BOE** b) Skualifikuar 10 **BOE** c) Kualifikuar 6 **BOE**
10. Ankimime **AK-**s'ka/ka**:-Jo** **APP**–s'ka/ka**:-Jo** **KPP-**s'ka/ka:-**Jo**	**11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (*nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE*):** Data: 20.10.2025 (komunikimi i renditjes) Data: 30.10.2025 (njoftimi paraprak i fituesit) Data: 10.11.2025 (njoftimi përfundimtar i fituesit)	**12. Data e lidhjes së kontratës:** Data: 21.11.2025 **12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):** Data: 21.11.2025

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:

Së pari, me shkresën nr. 8626 prot., datë 26.08.2025 Drejtoria e Urbanistikës, Sektori i Projekteve, ka kërkuar, ka kërkuar nga Personi i Autorizuar, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i rrugës «Baba Selimi» Zinxhira Gjirokastër*", për të cilën ka përgatitur paraprakisht projekt-preventivin, grafikun e punimeve, specifikimet teknike dhe relacionin përkatës.

Projekt-preventivi në lidhje me objektin e prokurimit, i cili ka marrë edhe miratimin e titullarit të institucionit, është hartuar nga Drejtoria e Urbanistikës, Sektori i Projekteve pranë Bashkisë Gjirokastër. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se projekt-zbatimi është punuar nga punonjësit (specialistët): Ing. A. P., Ing. G.M., Ing. F.M. dhe Ing. A.Q..

Së dyti, referuar formimit profesional si dhe dosjeve personale të secilit punonjës që ka punuar projekt-preventivin, në lidhje me objektin e prokurimit, rezulton se, grupi i projektimit është i pajisur me licencën përkatëse për projektim (K. 2654/1, T. 1238/1, K. 3638 dhe K. 0797/2) në përputhje me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", neni 5, sipas të cilit: "*Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit*".

Së treti, në lidhje me procedurën e sipërcituar, nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, rezulton se, në datën 28.08.2025, AK ka kërkuar dhe ka kryer oponencën teknike. Kjo e fundit është kryer nga Instituti i Ndërtimit me nr. 1041/2 prot., datë 27.10.2025. Në rastin konkret, veprimet e AK janë në zbatim të pikës 1 të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, sipas të cilit: "*Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik*", si dhe të VKM-së nr. 9, datë 11.01.2024 "*Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste*".

Së katërti, nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, rezulton se, Autoriteti Kontraktor është pajisur me "leje ndërtimi/infrastrukture", konkretisht lejen nr. 113 datë 14.11.2025. Në rastin konkret, veprimet e AK janë në përputhje me nenin 39 të Ligjit nr. 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, sipas të cilit: "*Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji*".

AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për kualifikim":

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit*" të datës 10.09.2025 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), edhe pse pas ndryshimeve të sugjeruara nga APP, në përgjithësi, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*", për dy prej tyre, grupi i auditimit vlerëson se rezultojnë të paqartë apo të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe/ose të ekzagjeruar dhe/ose të argumentuara mbi bazën e parakushteve jorealiste. Në lidhje me këto kritere, njësia e prokurimit (NjP) është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos marrë parasysh natyrën dhe vlerën e kontratës.

Konkretisht, për sa më sipër, nga grupi i auditimit, është konstatuar sa vijon:

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.6, ndër të tjera, për 14 punonjësit e cituar (stafin specialist dhe punonjësit e thjeshtë), ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:

"*Dëshmi të sigurimit teknik (të vlefshme) nga ISHTI ose ekuivalente me to të akredituara...*".

Në lidhje me këtë kriter, grupi i auditimit vlerëson se, "pajisja me Certifikatë për sigurimin teknik ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik" shërben për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike, pra nuk është në përputhje me objektin e prokurimit pasi në preventivin e këtij të fundit ekzistojnë kryesisht punime ndërtimi dhe një volum i vogël punime elektrike. Referuar dispozitave të ISHTI, dëshmitë jepen për kategoritë: Naftën dhe Gazin Natyror, Pajisje nën Presion, Instalime Elektrike dhe Laborator të Kontrolleve. Në këto kushte është e qartë se kjo dëshmi e sigurimit teknik nuk ndikon në vlerësimin e kualifikimit të stafit duke pasur parasysh për më tepër se ky kriter, përveç elektriçistëve, është kërkuar edhe për karpentier, hekurkthyes, pllakashtrues, murator, punëtorë të thjeshtë.

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.12, ka kërkuar, ndër të tjera, nga OE ofertues disponimin si vijon:

"*Kokore, Rripa lidhës sigurimi, Komplet i ndihmës së shpejtë, Uniforma/Jelek, Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt".*

Në rastin konkret, duke qenë se kemi të bëjmë me një objekt prokurimi i cili, nisur nga natyra e tij, zbatohet nga operatorë ekonomikë me eksperiencë dhe "prestigj" në treg, kërkesa për mjetet e sipërcituara vlerësohet e panevojshme. Njësia e prokurimit duhet të marrë parasysh se kërkesat dhe masat e sigurisë së një OE janë objekt kontrolli nga inspektoratet përkatës. Nga ana tjetër kërkesat e natyrës së sipërcituar, jo në përpjesëtim apo të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, rrisin në mënyrë të panevojshme volumin e punës së KVO-së gjatë procesit të vlerësimit dhe riskun që kjo e fundit të skualifikojë ofertues, eventualisht më vlerë ofertë më të ulët, për mungesa deklarimi kriteresh, që nuk ndikojnë në realizimin e objektit të kontratës.

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.12/b, ka kërkuar, ndër të tjera, nga OE ofertues disponimin si vijon:

"*Për mjetet që merren me qira duhet të paraqitet dokumenti që vërteton:...Certifikatë për transport mallrash <u>për llogari të vet</u> apo për të tretë*".

Në lidhje me këtë kriter, grupi i auditimit sjell në vëmendje të njësisë së prokurimit faktin se, në lidhje me mjetet që merren me qira, certifikata për transport mallrash duhet të jetë domosdoshmërisht për të tretë dhe jo vetëm për llogari të vet. Konkretisht, sipas njoftimit të APP nr. 4916/2 prot datë 14.07.2022 në rastin e mjeteve me qera referuar dokumentacionit, mjetet nuk duhet të rezultojnë vetëm për përdorim vetjak por edhe për përdorim nga të tretët.

Si konkluzion, veprimet apo mosveprimet e mësipërme, përveçse rezultojnë në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.05.2021 "*Për prokurimin publik*", ndikojnë negativisht mbi konkurrencën, në kundërshtim me nenin 2 të LPP-së. Njësia e prokurimit nuk ka konsideruar faktin se kriteret e sipërcituara dhe paqartësia e tyre mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët eventualisht mund të kenë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës.
Situata e sipërcituar bie në kundërshtim me përcaktimet e Nenit 39 pika 4: "*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës…*", si dhe Nenit 78 pika 2: "*Hartimi i kërkesave për kualifikim…Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht...*".
Në përfundim, në lidhje me veprimet apo mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** z. B.B, znj. L. Sh. dhe z. A. P., në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit.
AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":
Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave, argumentimi i llojit të procedurës si dhe publikimet e nevojshme.
b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.
Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 16 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 20.10.2025 njoftimin e klasifikimit, në datën 30.10.2025 njoftimin paraprak dhe në datën 10.11.2025 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"A.K." SHPK	46,282,990	*Kualifikuar*
2	"A.C.& XH. & I./D" SHPK	48,984,571	*Skualifikuar*
3	"A. I. & C. R. 2008" SHPK	47,257,559	*Skualifikuar*
4	"B. – I." SHPK	50,648,380	*Skualifikuar*
5	"C." SHPK	52,056,214	*Kualifikuar*
6	"D.2010" SHPK	43,331,512	*Skualifikuar*
7	"E.G." SHPK	(nuk ka ofertë)	*Skualifikuar*
8	"E. C. C.& C.LTD" SHPK	42,055,609	*Kualifikuar/Fituesi*
9	"I. & E." SHPK	54,012,529	*Skualifikuar*
10	"H." SHPK	58,159,520	*Kualifikuar*
11	"T.E C." SHPK	48,357,907	*Kualifikuar*
12	"N." SHPK	48,047,957	*Skualifikuar*
13	"N." SHPK	43,313,994	*Kualifikuar*
14	"R. C." SHPK	46,098,808	*Skualifikuar*
15	"Sh." SHPK	50,000,000	*Skualifikuar*
16	"T.-D" SHPK	48,165,879	*Skualifikuar*

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke kualifikuar 6 (gjashtë) B/OE dhe skualifikuar 10 (dhjetë) B/OE, me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

1. ***"A. C. & XH. & I./D" SHPK:*** *OE A. C. nuk plotëson punët e ngjashme pasi objektet e deklaruara nuk janë të natyrës rikonstruksion rruge por të natyrave të ndryshme; BOE nga ndarja e punimeve rezulton se llogaritja e shumatores së ndarjes së punimeve nuk është në vlerën 100% por e tejkalon në 100.84%. Ndarja e punimeve duhet të jetë as më shume dhe as më pak se 100%.*
2. ***"A.I. & C. R. 2008" SHPK:*** *OE A. I. në ndarjen e punimeve ka deklaruar se merr përsipër punimet "pemtarie" për të cilat nuk disponon licencën N.P – 12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit; BOE për pikën 2.14 nuk ka ngarkuar dokumenta në Spe nga ku AK mund të bëjë verifikimin e largësisë së Impiantit të prodhimit të betonit. OE ASI INVEST nuk plotëson pikën 2.14 pasi ka deklaruar një punë të ngjashme për rikonstruksion objekti dhe jo rikonstruksion rruge.*
3. ***"B. – I." SHPK:*** *OE nuk plotëson pikën 2.14 pasi Impianti i prodhimit të betonit është më larg se 50 km nga objekti i prokuruar.*
4. ***"D. 2010" SHPK:*** *Në pikën 2.6 OE ka deklaruar 2 puntorë të thjeshtë nga 5 që kërkon Autoriteti Kontraktor.*
5. ***"E. G." SHPK:*** *OE nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme Kapacitetin ekonomik dhe atë teknik duke mos ngarkuar në SPE asnjë dokument.*
6. ***"I. & E." SHPK:*** *OE nuk plotëson pikën 2.7 pasi ka deklaruar si drejtues teknik inxhinier hidroteknik dhe jo ndërtimi; BOE nuk plotëson numrin prej 5 manovratorësh. OE E. ka deklaruar 1 manovrator ndërsa OE I. ka deklaruar 3 manovrator. Si rrjedhojë mungon 1 manovrator; Në pikën 2.12 AK ka kërkuar mjetet në pronësi apo me qera ndër të tjera dhe një Autobot uji i cili nuk është deklaruar nga BOE; OE I. nuk plotëson pikën 2.3 Punët e ngjashme pasi ka ngarkuar në SPE një objekt për të cilin nuk është e qartë as vlera as periudha e zbatimit as preventive me çmime as faturë as situacion përfundimtar*
7. ***"N." SHPK:*** *OE nuk plotëson pikën 2.14 pasi Impianti i prodhimit të betonit është më larg se 50 km nga objekti I prokuruar dhe nga ortofoto rezulton se është 214 km larg nga objekti.*
8. ***"R. C." SHPK:*** *OE ka deklaruar një kontratë të lidhur më datën 28.09.2016 jashtë periudhës 5 vjeçare nga data e data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*
9. ***"Sh." SHPK:*** *OE nuk plotëson pikën 2.7 pasi ka deklaruar si drejtues teknik inxhinier gjeolog dhe jo ndërtimi.*
10. ***"T.-D" SHPK:*** *OE në ndarjen e punimeve ka deklaruar se merr përsipër punimet "pemtarie" për të cilat nuk disponon licencën N.P – 12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit; OE E. nuk plotëson punët e ngjashme.*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 20.10.2025, ndër të tjera, KVO-ja, ka kontrolluar preventivat e ofertuesve me qëllim korrigjimin eventual të tyre, ka verifikuar ofertat anomalisht të ulëta dhe ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar nga BOE "E. C. C. & C.LTD" SHPK, i renditur i pari, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës.

-Në procesverbalin nr. 11327 prot., datë 30.10.2025, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues BOE "E. C. C. & C. LTD" SHPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".

-Me shkresën nr. 11374 prot., datë 31.10.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".

-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës nr. 11722 prot., datë 10.11.2025, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari i AK (Personi i Autorizuar z. N.N.).

-Me shkresën nr. 11724 prot., datë 10.11.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".
-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konstatohet se kontrata e sipërmarrjes nr. 12202 prot., datë 21.11.2025, është nënshkruar nga Personi i Autorizuar dhe përfaqësuesit e BOE, konkretisht "E. C. C. & C. LTD" SHPK.
Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit, nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 21.11.2025 duke respektuar afatin e përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".
Në vijim, në zbatim të LPP-së, nga Personi i Autorizuar është nxjerrë "Plani i Zbatimit të Kontratës" nr. 12203 prot., datë 21.11.2025.
Së treti, nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se **KVO ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave**. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të ofertave është hapur në datën 01.10.2025, KVO-ja ka pasur detyrimin ligjor të kryente vlerësimin e tyre brenda datës 16.10.2025 (15 ditëve). Referuar procesverbalit të vlerësimit (paraprak) dhe SPE, rezulton se vlerësimi i ofertave dhe njoftimi përkatës është kryer në datën 20.10.2025 (komunikimi renditjes) dhe 30.10.2025 (vlerësimi paraprak). Në lidhje me shkeljen e afatit të vlerësimit nga KVO, në dosjen e prokurimit nuk rezulton të ketë një justifikim ligjor, i cili të përmbajë një nga arsyet e përcaktuara në nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, sipas të cilit: "*Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë...15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizmit të anëtarit/anëtarëve*".
Në rastin konkret, moszbatimi i dispozitave të LPP-së apo shkelja e afateve ligjore, veçanërisht gjatë fazës së vlerësimit të ofertave është problematike. Ato jo vetëm që mund të shkaktojnë shqetësime për ofertuesit, por gjithashtu mund të krijojnë hapësira për praktika abuzive ose të paktën të krijojnë një perceptim të dyshimtë dhe të dëmtojnë sigurinë dhe besimin në praktikën e prokurimit publik të AK-së dhe të gjithë sistemit të prokurimit publik.
Në përfundim, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi** znj. A. Ll., z. K. N. dhe znj. M. Sh., në cilësinë e anëtarëve të KVO-së, si dhe N.N. Personi i autorizuar.

3-Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt:*"**Rikonstruksion i kanaleve vaditëse**"*, si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:
Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*Rikonstruksion i kanaleve vaditëse*".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "E hapur e thjeshtuar" REF-57886-08-12-2025 Urdhri nr. 8094 prot., datë 07.08.2025	**1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)** Urdhri nr. 8094 prot., datë 07.08.2025 1. B.. P. 2. L. Sh. 3. A.P.	**2. Njësia e Prokurimit** 1. B.B 2. L.Sh. 3. A.P.	**3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri nr. 8244 prot., datë 12.08.2025 1. A.L. 2. K.N. 3. M.Sh.

4. Fondi Limit (pa TVSH) 4,166,357 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSH)** 3,165,117 lekë Fitues: OE "T.-D" SHPK	**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** 1,001,240 lekë
7/1. Data e hapjes së tenderit: Data 25.08.2025 **7/2 Kohëzgjatja e kontratës:** 4 muaj	**8. Burimi Financimit** Buxheti i Bashkisë Gjirokastër	**9. Operatoret Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender Numër 2 **B/OE** b) Skualifikuar 1 **B/OE** c) Kualifikuar 1 **B/OE**
10. Ankimime **AK-**s'ka/ka**: Jo** **APP**–s'ka/ka**:-Jo** **KPP-**s'ka/ka: **Jo**	**11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (*nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE*):** Data: 10.09.2025 (komunikimi i renditjes) Data: 29.09.2025 (njoftimi paraprak i fituesit) Data: 07.10.2025 (njoftimi përfundimtar i fituesit)	**12. Data e lidhjes së kontratës:** Data: 22.10.2025 **12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):** Data: 22.10.2025

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:

Së pari, projekt-preventivi në lidhje me objektin e prokurimit, i cili ka marrë edhe miratimin e titullarit të institucionit, është hartuar nga Drejtoria e Urbanistikës, Sektori i Projekteve pranë Bashkisë Gjirokastër. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se projekt-zbatimi është punuar nga punonjësit (specialistët): Ing. A.P., Ing. G. M., Ing. F.M. dhe Ing. A.Q..

Së dyti, referuar formimit profesional si dhe dosjeve personale të secilit punonjës që ka punuar projekt-preventivin, në lidhje me objektin e prokurimit, rezulton se, grupi i projektimit është i pajisur me licencën përkatëse për projektim (K. 2654/1, T. 1238/1, K. 3638 dhe K. 0797/2) në përputhje me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", neni 5, sipas të cilit: "*Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit*".

AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për kualifikim":

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit*" të datës (pa datë) dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), edhe pse, në përgjithësi, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*", për disa prej tyre, grupi i auditimit vlerëson se rezultojnë të paqartë apo të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe/ose të ekzagjeruar dhe/ose të argumentuara mbi bazën e parakushteve jorealiste. Në lidhje me këto kritere, njësia e prokurimit (NjP) është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos marrë parasysh natyrën dhe vlerën e kontratës.

Konkretisht, për sa më sipër, nga grupi i auditimit, është konstatuar sa vijon:

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.7, ndër të tjera, për 9 punonjësit e cituar (stafin specialist dhe punonjës të thjeshtë), ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:

"*Dëshmi të sigurimit teknik (të vlefshme) nga ISHTIose ekuivalente me to të akredituara...*".

Në lidhje me këtë kriter, grupi i auditimit vlerëson se, "pajisja me Certifikatë për sigurimin teknik ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik" shërben për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike, pra nuk është në përputhje me objektin e prokurimit pasi në preventivin e këtij të fundit nuk ekzistojnë punime elektrike. Referuar dispozitave të ISHTI, dëshmitë jepen për kategoritë: Naftën dhe Gazin Natyror, Pajisje nën Presion,

Instalime Elektrike dhe Laborator të Kontrolleve. Në këto kushte është e qartë se kjo dëshmi e sigurimit teknik nuk ndikon në vlerësimin e kualifikimit të stafit duke pasur parasysh për më tepër se ky kriter është kërkuar edhe për topograf, betonues, suvatues, punëtor të thjeshtë.

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.7, ndër të tjera, ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:

"*2 suvatues...*".

Në lidhje me këtë kriter, grupi i auditimit vlerëson se, rezulton i paargumentuar teknikisht dhe i ekzagjeruar pasi, preventivi i punimeve nuk përmban punime (zëra) suvatimi.

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.10, ka kërkuar, ndër të tjera, nga OE ofertues disponimin si vijon:

"*Kokore, Fikëse zjarri, Komplet i ndihmës së shpejtë, Uniforma/Jelek".*

Në rastin konkret, duke qenë se kemi të bëjmë me një objekt prokurimi i cili, nisur nga natyra e tij, zbatohet nga operatorë ekonomikë me eksperiencë dhe "prestigj" në treg, kërkesa për mjetet e sipërcituara vlerësohet e panevojshme. Njësia e prokurimit duhet të marrë parasysh se kërkesat dhe masat e sigurisë së një OE janë objekt kontrolli nga inspektoratet përkatës. Nga ana tjetër kërkesat e natyrës së sipërcituar, jo në përpjesëtim apo të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, rrisin në mënyrë të panevojshme volumin e punës së KVO-së gjatë procesit të vlerësimit dhe riskun që kjo e fundit të skualifikojë ofertues, eventualisht më vlerë ofertë më të ulët, për mungesa deklarimi kriteresh, që nuk ndikojnë në realizimin e objektit të kontratës.

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.10/b, ka kërkuar, ndër të tjera, nga OE ofertues disponimin si vijon:

"*Për mjetet që merren me qira duhet të paraqitet dokumenti që vërteton:...Certifikatë për transport mallrash <u>për llogari të vet</u> apo për të tretë*".

Në lidhje me këtë kriter, grupi i auditimit sjell në vëmendje të njësisë së prokurimit faktin se, në lidhje me mjetet që merren me qira, certifikata për transport mallrash duhet të jetë domosdoshmërisht për të tretë dhe jo vetëm për llogari të vet. Konkretisht, sipas njoftimit të APP nr. 4916/2 prot datë 14.07.2022 në rastin e mjeteve me qera referuar dokumentacionit, mjetet nuk duhet të rezultojnë vetëm për përdorim vetjak por edhe për përdorim nga të tretët.

Si konkluzion, veprimet apo mosveprimet e mësipërme, përveçse rezultojnë në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.05.2021 "*Për prokurimin publik*", ndikojnë negativisht mbi konkurrencën, në kundërshtim me nenin 2 të LPP-së. Njësia e prokurimit nuk ka konsideruar faktin se kriteret e sipërcituara dhe paqartësia e tyre mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët eventualisht mund të kenë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës.

Situata e sipërcituar bie në kundërshtim me përcaktimet e Nenit 39 pika 4: "*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës…*", si dhe Nenit 78 pika 2: "*Hartimi i kërkesave për kualifikim…Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht...*".

Në përfundim, në lidhje me veprimet apo mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** z. B.B, znj. L.Sh. dhe z. A.P., në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave, argumentimi i llojit të procedurës si dhe publikimet e nevojshme.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 10.09.2025 njoftimin e klasifikimit, në datën 29.09.2025 njoftimin paraprak dhe në datën 07.10.2025 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"A. I." SHPK	2,946,367	*Skualifikuar*
2	"T-D" SHPK	3,165,117	*Kualifikuar/Fituesi*

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke kualifikuar 1 (një) OE dhe skualifikuar 1 (një) OE, me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

1. ***"A. I." SHPK:*** *Me vlerë të ofertës së ofruar 2,946,367 (dy milion e nëntëqind e dyzet e gjashtë mijë e treqind e gjashtëdhjet e shtatë) lekë pa TVSH është në kushtet e ofertës anomalisht të ulët.*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 10.09.2025, ndër të tjera, KVO-ja, ka kontrolluar preventivat e ofertuesve me qëllim korrigjimin eventual të tyre, ka verifikuar ofertat anomalisht të ulëta dhe ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar nga OE "T-D" SHPK, i renditur i pari, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës.

-Në procesverbalin nr. 9986 prot., datë 29.09.2025, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues OE "T-D" SHPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".

-Me shkresën nr. 9988 prot., datë 29.09.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".

-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës nr. 10327 prot., datë 07.10.2025, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari i AK (Personi i Autorizuar z. N.N.).

-Me shkresën nr. 10332 prot., datë 07.10.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".

-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konstatohet se kontrata e sipërmarrjes nr. 10944 prot., datë 22.10.2025, është nënshkruar nga Personi i Autorizuar dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht "T.-D" SHPK.

Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit, nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 22.10.2025 duke respektuar afatin e përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".

Së treti, për sa më sipër, nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se **KVO ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave**. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të ofertave është hapur në datën 25.08.2025, KVO-ja ka pasur detyrimin ligjor të kryente vlerësimin e tyre brenda datës 03.9.2025 (15 ditëve). Referuar procesverbalit të vlerësimit (paraprak) dhe SPE, rezulton se vlerësimi i ofertave dhe njoftimi përkatës është kryer në datën 10.09.2025 (komunikimi renditjes) dhe 29.09.2025 (vlerësimi paraprak). Në lidhje me shkeljen e afatit të vlerësimit nga KVO-ja, në dosjen e prokurimit nuk rezulton të ketë një justifikim ligjor, i cili të përmbajë një nga arsyet e përcaktuara në nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 sipas të cilit: "*Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të*

kalojë...15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizmit të anëtarit/anëtarëve".

4-Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt:*"**Blerje automjeti zjarrfikëse**"*, si vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje automjeti zjarrfikëse"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E hapur"
REF-49573-05-29-2025
Urdhri nr. 3497 prot., datë 10.04.2025</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe FL.
Urdhri nr. 2563 prot., datë 17.03.2025
1. A.A.</td><td>2. Njësia e Prokurimit
1. B.B
2. R.A.
3. A.A.</td><td>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 4993 prot., datë 29.05.2025
1. A.L.
2. A.L.
3. M.Sh.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSH)
10,983,333 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSH)
9,400,000 lekë
Fitues: OE "T.-R" SHPK</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)
1,583,333 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1. Data e hapjes së tenderit:
Data 19.06.2025
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 1 muaj</td><td colspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i Shtetit</td><td>9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender Numër 2 B/OE
b) Skualifikuar 1 B/OE
c) Kualifikuar 1 B/OE</td></tr>
<tr><td>10. Ankimime
AK-s'ka/ka: Po (kritere)
APP–s'ka/ka: Jo
KPP-s'ka/ka: Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE)):
Data: 15.07.2025 (komunikimi i renditjes)
Data: 23.07.2025 (njoftimi paraprak i fituesit)
Data: 31.07.2025 (njoftimi përfundimtar i fituesit)</td><td>12. Data e lidhjes së kontratës:
Data: 15.08.2025
12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):
Data: 15.08.2025</td></tr>
</table>

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:

Së pari, me shkresën nr. 135 prot., datë 20.03.2025 Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, ka kërkuar nga Drejtoria e Prokurimeve Publike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje automjeti zjarrfikëse".

Me urdhrin nr. 2563 prot., datë 17.03.2025, është caktuar personi përgjegjës për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike, z. A.A. (ing.).

-Në lidhje me përllogaritjen e vlerës së fondit limit, për hartimin e preventivit personi përgjegjës citon se ka studiuar ofertat e tregut duke përllogaritur si fond limit vlerën 10,983,333 lekë pa TVSH. Theksojmë se mënyrat në lidhje me përllogaritjen e fondit limit përcaktohen në nenin 76 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021. Nga personi përgjegjës është mbajtur procesverbali nr. (pa numër) prot., datë 17.03.2025.

Gjithsesi, grupi i auditimit konstaton se, në procesverbal, përveç citimit të sipërcituar "ofertat e tregut", nga personi përgjegjës nuk janë administruar ofertat dhe as është cituar se nga cilët OE konkretë janë marrë këto oferta duke cënuar pasqyrimin e plotë të veprimtarisë, në mospërputhje me nenin 2, të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021, sipas të cilit: "*Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri te zbatimi i kontratës. Për këtë qëllim, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera*".

-Në lidhje me Hartimin e Specifikimeve Teknike, nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, procesverbali përkatës nr. (pa numër) prot., datë 17.03.2025, ka të përcaktuar në mënyrë rendore dhe variabile (me marzh) specifikimet teknike, të cilat, janë të shoqëruara me një argumentim ligjor por, edhe pse jo të ekzagjeruara, nuk shoqërohen me një argumentim teknik (*p.sh. për orientim: përse duhet teknikisht që depozita e ujit të jetë 2000-3000 litra dhe koncentrat shkume 125-200 l, apo, përse duhet autopompa jo me pak 1500 l/min, presioni 8 bar-12 bar?!*).

Për sa më sipër, grupi i auditimit konstaton se, mungesa e argumentimit teknik, rezulton në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 2, pika 2/c, ku përcaktohet se: "*Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë argumentimin e kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit*" si dhe nenin 78, pika 2, ku përcaktohet se "*…Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre*".

Si konkluzion, për sa më sipër, hartimi i specifikimeve teknike pa një argumentim teknik, mund të krijojë konfuzion dhe papërshtatshmëri në ofertat eventuale të operatorëve ekonomikë.

Në lidhje me mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohet me përgjegjësi: z. A.A.,** në cilësinë e personit përgjegjës për përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike.

AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Kritereve për kualifikim":

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e kritereve të kualifikimit*" të datës 29.05.2025 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, pas modifikimit të tyre si pasojë e ankesave dhe sugjerimeve të APP-së, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), në përgjithësi, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*".

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 15.07.2025 njoftimin e klasifikimit, në datën 23.07.2025 njoftimin paraprak dhe në datën 31.07.2025 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"S. & C. C." SHPK	8,500,000	*Skualifikuar*
2	"T.-R" SHPK	9,400,000	*Kualifikuar/Fituesi*

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke kualifikuar 1 (një) OE dhe skualifikuar 1 (një) OE, me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

1. ***"S. & C.C." SHPK:*** *OE ka bërë tërheqjen me deklaratën nr. 5945 prot, datë 20.06.2025.*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 15.07.2025, ndër të tjera, KVO-ja, ka kontrolluar preventivat e ofertuesve me qëllim korrigjimin eventual të tyre, ka verifikuar ofertat anomalisht të ulëta dhe kapasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar nga OE "T-R" SHPK, i renditur i pari, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës.
-Në procesverbalin nr. 7166 prot., datë 23.07.2025, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues OE "T-R" SHPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".
-Me shkresën nr. 7207 prot., datë 23.07.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".
-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës nr. 7818 prot., datë 31.07.2025, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullati i AK (Personi i Autorizuar z. N. N.).
-Me shkresën nr. 7824 prot., datë 31.07.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".
-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konsatatohet se kontrata e shit-blerjes së mallit nr. 8321 prot., datë 15.08.2025, është nënshkruar nga Personi i Autorizuar dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht "T.-R" SHPK.
Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit, nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 15.08.2025 duke respektuar afatin e përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".
Së treti, në vijim, me urdhrin e brendshëm nr. 8055 prot., datë 06.08.2025, Titullari i AK ka ngritur "Komisoinin për marrjen në dorëzim të mallit" të përbërë nga z. M.G., z. M. Gj. dhe z. A. M..
Grupi i auditimit, në këtë pjesë të procedurës së prokurimit, konstaton se, nga komisioni i marrjes në dorëzim nuk janë administruar apo plotësuar deklaratat e anëtarëve mbi konfliktin e interesave, ashtu sikundër kërkohet nga VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 73, pika 4, ku ndër të tjera përcaktohet se: "*Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit*". Në lidhje me këtë situatë ***ngarkohet me përgjegjësi* z. M.G., z. M. Gj.dhe z. A.M.,** në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim si dhe **z. N.N.**, në cilësinë e personit të autorizuar.
Së katërti, për sa më sipër, nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se **KVO ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave**. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të oferatave është hapur në datën 19.06.2025, KVO-ja ka pasur detyrimin ligjor të kryente vlerësimin e tyre brenda datës 04.07.2025 (15 ditëve). Referuar procesverbalit të vlerësimit (paraprak) dhe SPE, rezulton se vlerësimi i ofertave dhe njoftimi përkatës është kryer në datën 15.07.2025 (komunikimi renditjes) dhe 23.07.2025 (vlerësimi paraprak). Në lidhje me shkeljen e afatit të vlerësimit nga KVO-ja, në dosjen e prokurimit nuk rezulton të ketë një justifikim ligjor, i cili të përmbajë një nga arsyet e përcaktuara në nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 sipas të cilit: "*Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë...15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit*

pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizmit të anëtarit/anëtarëve".

Së pesti, në lidhje me dorëheqjen nga gara të operatorit ekonomik "S. & C. C." SHPK në datën 20.06.2025. Në kushtet kur braktisja e garës nga operatori ekonomik është kryer pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave (19.06.2025) dhe për sa kohë nuk rezulton që OE të jetë tërhequr përpara këtij afati, KVO-ja duhet të kishte kërkuar konfiskimin e sigurimit të ofertës, në zbatim të nenit 83, pika 3/a të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" dhe nenit 30, pika 6/a të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021.

Si konkluzion, mosveprimi i sipërcituar ka shkaktuar mungesën e përfitimit/shpërblimit dhe **cenimin e ekonomicitetit të buxhetit të AK (Bashkia Gjirokastër) në vlerën 219,666 lekë** (vlera e sigurimit të ofertës).

Në përfundim, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** znj. A. Ll., znj. A. L. dhe znj. M. Sh., në cilësinë e anëtarëve të KVO-së, si dhe N. N. Personi i autorizuar.

5-Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt:*"**Blerje automjeti**"*, si vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje automjeti"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E hapur"
REF-56827-07-31-2025
Urdhri nr. 3497 prot., datë 10.04.2025</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe FL.
Urdhri nr. 2563 prot., datë 17.03.2025
1. A.A.</td><td>2. Njësia e Prokurimit
1. B.B
2. R. A.
3. A. A.</td><td>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 7832 prot., datë 31.07.2025
1. A.Ll.
2. K. N.
3. M. Sh.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSH)
833,333 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSH)
833,333 lekë
Fitues: OE "inA." SHPK</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)
0 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1. Data e hapjes së tenderit:
Data 21.08.2025
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 30 ditë</td><td colspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i Shtetit</td><td>9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender Numër 1 B/OE
b) Skualifikuar 0 B/OE
c) Kualifikuar 1 B/OE</td></tr>
<tr><td>10. Ankimime
AK-s'ka/ka: Jo
APP–s'ka/ka: Jo
KPP-s'ka/ka: Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE)):
Data: 02.09.2025 (komunikimi i renditjes)
Data: 11.09.2025 (njoftimi paraprak i fituesit)
Data: 12.09.2025 (njoftimi përfundimtar i fituesit)</td><td>12. Data e lidhjes së kontratës:
Data: 22.09.2025
12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):
Data: 23.09.2025</td></tr>
</table>

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:

Së pari, me shkresën nr. 2246 prot., datë 07.03.2025 Policia Bashkiake ka kërkuar, nga Drejtoria e Prokurimeve Publike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje automjeti".

Me urdhrin nr. 2563 prot., datë 17.03.2025, është caktuar personi përgjegjës për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike, z. A.A.(ing.).

-Në lidhje me përllogaritjen e vlerës së fondit limit, për hartimin e preventivit personi përgjegjës citon se ka studiuar ofertat e tregut duke përllogaritur si fond limit vlerën 833,333 lekë pa TVSH. Theksojmë se mënyrat në lidhje me përllogaritjen e fondit limit përcaktohen në nenin 76 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021. Nga personi përgjegjës është mbajtur procesverbali nr. (pa numër) prot., datë 10.04.2025.

Gjithsesi, grupi i auditimit konstaton se, në procesverbal, përveç citimit të sipërcituar "ofertat e tregut", nga personi përgjegjës nuk janë administruar ofertat dhe as është cituar se nga cilët OE konkretë janë marrë këto oferta duke cënuar pasqyrimin e plotë të veprimtarisë, në mospërputhje me nenin 2, të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021, sipas të cilit: "*Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri te zbatimi i kontratës. Për këtë qëllim, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera*".

-Në lidhje me Hartimin e Specifikimeve Teknike, nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, procesverbali përkatës nr. (pa numër) prot., datë 10.04.2025, ka të përcaktuar në mënyrë rendore dhe përgjithësisht variabile (me marzh) specifikimet teknike, të cilat, janë të shoqëruara me një argumentim ligjor por, edhe pse jo të ekzagjeruara, nuk shoqërohen me një argumentim teknik (*p.sh. për orientim: përse duhet teknikisht që automjeti të jetë me kambio manuale, apo, përse duhet pesha mbajtëse 1100-1350 kg?!*).

Për sa më sipër, grupi i auditimit konstaton se, mungesa e argumentimit teknik, rezulton në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 2, pika 2/c, ku përcaktohet se: "*Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë argumentimin e kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit*" si dhe nenin 78, pika 2, ku përcaktohet se "*…Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre*".

Si konkluzion, për sa më sipër, hartimi i specifikimeve teknike pa një argumentim teknik, mund të krijojë konfuzion dhe papërshtatshmëri në ofertat eventuale të operatorëve ekonomikë.

Në lidhje me mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohet me përgjegjësi: z. A. A.,** në cilësinë e personit përgjegjës për përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike.

AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Kritereve për kualifikim":

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e kritereve të kualifikimit*" të datës 31.07.2025 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), në përgjithësi, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*".

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit ka marrë pjesë vetëm 1 OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 02.09.2025 njoftimin e klasifikimit, në datën 11.09.2025 njoftimin paraprak dhe në datën 12.09.2025 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"in.A."SHPK	833,333	*Kualifikuar/fituesi*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:
-Me procesverbalin e datës 02.09.2025, ndër të tjera, KVO-ja, ka kontrolluar preventivin e ofertuesit me qëllim korrigjimin eventual të tij, ka verifikuar ofertatën për anomalisht të ulët dhe ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar, nga OE "inA." SHPK, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës.
-Në procesverbalin nr. 9220 prot., datë 10.09.2025, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".
-Me shkresën nr. 9236 prot., datë 11.09.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".
-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës nr. 9307 prot., datë 12.09.2025, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari i AK (Personi i Autorizuar z. N.N.).
-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konstatohet se kontrata e shit-blerjes së mallit nr. 9643 prot., datë 22.09.2025, është nënshkruar nga Personi i Autorizuar dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht "inA." SHPK.
Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit, nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 23.09.2025 duke respektuar afatin e përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".
Së treti, në vijim, me urdhrin e brendshëm nr. 9426 prot., datë 16.09.2025, Titullari i AK ka ngritur "Komisoinin për marrjen në dorëzim të mallit" të përbërë nga z. V. Ç., znj. I. A. dhe z. V. D..
Grupi i auditimit, në këtë pjesë të procedurës së prokurimit, konstaton se, nga komisioni i marrjes në dorëzim nuk janë administruar apo plotësuar deklaratat e anëtarëve mbi konfliktin e interesave, ashtu sikundër kërkohet nga VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 73, pika 4, ku ndër të tjera përcaktohet se: "*Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit*". Në lidhje me këtë situatë ***ngarkohet me përgjegjësi* z. V.Ç., znj. I. A. dhe z. V.D.,** në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim si dhe **z. N.N.**, në cilësinë e personit të autorizuar.
Së katërti, për sa më sipër, nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se **KVO ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave**. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të ofertave është hapur në datën 21.08.2025, KVO-ja ka pasur detyrimin ligjor të kryente vlerësimin e tyre brenda datës 05.09.2025 (15 ditëve). Referuar procesverbalit të vlerësimit (paraprak) dhe SPE, rezulton se vlerësimi i ofertave dhe njoftimi përkatës është kryer në datën 02.09.2025 (komunikimi renditjes) dhe 11.09.2025 (vlerësimi paraprak). Në lidhje me shkeljen e afatit të vlerësimit nga KVO-ja, në dosjen e prokurimit nuk rezulton të ketë një justifikim ligjor, i cili të përmbajë një nga arsyet e përcaktuara në nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 sipas të cilit: "*Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë...15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizmit të anëtarit/anëtarëve*".

Në përfundim, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** znj. A.Ll., z. K.N. dhe znj. M.Sh., në cilësinë e anëtarëve të KVO-së, si dhe N.N. Personi i autorizuar.

6-Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt:*"**Dekor**"*, si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Dekor"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E hapur e thjeshtuar"
REF-66411-10-23-2025
Urdhri nr. 10838 prot., datë 21.10.2025</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe FL.
Urdhri nr. 10808 prot., datë 20.10.2025
1. P. N.</td><td>2. Njësia e Prokurimit
1. B.B
2. R.A.
3. L.Sh.</td><td>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 11002 prot., datë 23.10.2025
1. A.Ll.
2. K. N.
3. M.Sh.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSH)
4,165,317 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSH)
3,127,000 lekë
Fitues: OE "E.L." PF</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)
1,038,317 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1. Data e hapjes së tenderit:
Data 03.11.2025
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 20 ditë</td><td colspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i Bashkisë Gjirokastër</td><td>9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender Numër 4 B/OE
b) Skualifikuar 1 B/OE
c) Kualifikuar 3 B/OE</td></tr>
<tr><td>10. Ankimime
AK-s'ka/ka: Jo
APP–s'ka/ka: Jo
KPP-s'ka/ka: Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE)):
Data: 06.11.2025 (komunikimi i renditjes)
Data: 17.11.2025 (njoftimi paraprak i fituesit)
Data: 25.11.2025 (njoftimi përfundimtar i fituesit)</td><td>12. Data e lidhjes së kontratës:
Data: 04.12.2025
12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):
Data: 04.12.2025</td></tr>
</table>

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:
a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.
Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:
Së pari, me shkresën nr. 10807 prot., datë 20.10.2025 Drejtoria e Shërbimeve Komunitare Utilitare ka kërkuar, nga Drejtoria e Prokurimeve Publike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje Dekor".
Me urdhrin nr. 10808 prot., datë 20.10.2025, është caktuar personi përgjegjës për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike, z. P. N..
-Në lidhje me përllogaritjen e vlerës së fondit limit, për hartimin e preventivit personi përgjegjës ka studiuar ofertat e tregut duke përllogaritur si fond limit vlerën 4,165,317 lekë pa TVSH. Theksojmë se mënyrat në lidhje me përllogaritjen e fondit limit përcaktohen në nenin 76 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021. Nga personi përgjegjës është mbajtur procesverbali nr. (pa numër) prot., datë 21.10.2025 duke pasqyruar ofertat e tregut (OE: "P.A.", "I. D." dhe "S.D."), në përputhje me nenin 2, të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021, sipas të cilit: "*Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri te zbatimi i kontratës. Për këtë qëllim, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera*".
-Në lidhje me Hartimin e Specifikimeve Teknike, nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, procesverbali përkatës nr. (pa numër) prot., datë 21.10.2025, ka të përcaktuar në mënyrë rendore dhe përgjithësisht variabile (me marzh) specifikimet teknike, të cilat, janë të shoqëruara me një argumentim ligjor dhe teknik në përputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", nenin 78, pika 2, ku përcaktohet se "…*Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht,*

si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre".

AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Kritereve për kualifikim":

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e kritereve të kualifikimit*" të datës 23.10.2025 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), në përgjithësi, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*".

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 06.11.2025 njoftimin e klasifikimit, në datën 17.11.2025 njoftimin paraprak dhe në datën 25.11.2025 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"A.2018" SHPK	3,565,000	*Kualifikuar*
2	"E. L." PF	3,127,000	*Kualifikuar/Fituesi*
3	"I. D." SHPK	3,850,000	*Kualifikuar*
4	"N. T. SA" SHPK	3,364,000	*Skualifikuar*

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke kualifikuar 3 (tre) OE dhe skualifikuar 1 (një) OE, me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

1. ***"N.T. SA" SHPK:*** *Nuk plotëson kriterin e përgjithshëm të kualifikimit, a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. OE nuk ka veprimtarinë në QKB objektin e prokurimit "Dekor"; Punët e ngjashme janë me objekte "Materiale për mirëmbajtjen e ndricimit publik" dhe jo me objektin e prokurimit "Dekor".*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 06.11.2025, ndër të tjera, KVO-ja, ka kontrolluar preventivat e ofertuesve me qëllim korrigjimin eventual të tyre, ka verifikuar ofertatat anomalisht të ulëta dhe ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar, nga OE "E. L." PF, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës.

-Në procesverbalin nr. 11990 prot., datë 17.11.2025, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".

-Me shkresën nr. 11994 prot., datë 17.11.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".

-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës nr. 12348 prot., datë 25.11.2025, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari i AK (Personi i Autorizuar z. N.N.).

-Me shkresën nr. 12385 prot., datë 25.11.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".
-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konstatohet se kontrata e shit-blerjes së mallit nr. 12618 prot., datë 04.12.2025, është nënshkruar nga Personi i Autorizuar dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht "E. L." PF.
Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit, nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 04.12.2025 duke respektuar afatin e përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".
Së treti, në vijim, me urdhrin e brendshëm nr. 12590 prot., datë 03.12.2025, Titullari i AK ka ngritur "Komisoinin për marrjen në dorëzim të mallit" të përbërë nga znj. A.L. , z. T.B. dhe z. P.N.
Grupi i auditimit, në këtë pjesë të procedurës së prokurimit, konstaton se, nga komisioni i marrjes në dorëzim nuk janë administruar apo plotësuar deklaratat e anëtarëve mbi konfliktin e interesave, ashtu sikundër kërkohet nga VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 73, pika 4, ku ndër të tjera përcaktohet se: "*Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit*". Në lidhje me këtë situatë ***ngarkohet me përgjegjësi* znj. A.L., z. T.B. dhe z. P.N.,** në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim si dhe **z. N.N.**, në cilësinë e personit të autorizuar.

7-Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: *"**Shpenzime për materiale elektrike**"*, si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Shpenzime për materiale elektrike"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E hapur e tjeshtuar"
REF-57378-08-07-2025
Urdhri nr. 78452 prot., datë 01.08.2025</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe FL.
Urdhri nr. 6461 prot., datë 02.07.2025
1. B.B.
2. P.N.
3. O. B.</td><td>2. Njësia e Prokurimit
1. B.B
2. R.A.
3. L.Sh.</td><td>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 8112 prot., datë 07.08.2025
1. A. .Ll.
2. K.N
3. M. Sh.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSH)
5,247,092 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSH)
4,789,200 lekë
Fitues: OE "M." SHPK</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)
450,892 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1. Data e hapjes së tenderit:
Data 18.08.2025
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 25 ditë</td><td colspan="2">8. Burimi i Financimit
Buxheti i Bashkisë Gjirokastër</td><td>9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender Numër 3 B/OE
b) Skualifikuar 2 B/OE
c) Kualifikuar 1 B/OE</td></tr>
<tr><td>10. Ankimime
AK-s'ka/ka: Jo
APP–s'ka/ka: Jo
KPP-s'ka/ka: Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE)):
Data: 09.10.2025 (komunikimi i renditjes)
Data: 20.10.2025 (njoftimi paraprak i fituesit)
Data: 28.10.2025 (njoftimi përfundimtar i fituesit)</td><td>12. Data e lidhjes së kontratës:
Data: 17.11.2025
12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):
Data: 17.11.2025</td></tr>
</table>

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:
a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.
Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:

Së pari, me shkresën nr. 4953 prot., datë 29.05.2025 të Drejtorië së Shërbimeve Komunitare Utilitare, shkresën nr. 1311 prot., datë 07.02.2025 të Agjencisë së Trashigimisë Kulturore,shkresën nr. 282/2 prot., datë 28.01.2025 të Agjencisë për Aktivitete dhe Turizëm dhe shkresën nr. 4861 prot., datë 27.05.2025 të Drejtorisë së Arsimit, është kërkuar nga Drejtoria e Prokurimeve Publike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "Shpenzime për materiale elektrike".
Me urdhrin nr. 6461 prot., datë 02.07.2025, janë caktuar personat përgjegjës për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike: znj. B.B., z. P. N. dhe znj. O. B..
-Në lidhje me përllogaritjen e vlerës së fondit limit, për hartimin e preventivit personat përgjegjës, në procesverbalin përkatës, citojnë se kanë studiuar ofertat e tregut duke përllogaritur si fond limit vlerën mesatare 5,247,092 lekë pa TVSH. Theksojmë se mënyrat në lidhje me përllogaritjen e fondit limit përcaktohen në nenin 76 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021. Nga personat përgjegjës është mbajtur procesverbali nr. (pa numër) prot., datë 01.08.2025.
Gjithsesi, grupi i auditimit konstaton se, në procesverbal, përveç citimit të sipërcituar "ofertat e tregut", nga personat përgjegjës nuk janë administruar ofertat dhe as është cituar se nga cilët OE konkretë janë marrë këto oferta duke cënuar pasqyrimin e plotë të veprimtarisë, në mospërputhje me nenin 2, të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021, sipas të cilit: "*Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri te zbatimi i kontratës. Për këtë qëllim, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera*".
Në lidhje me mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohet me përgjegjësi: znj. B.B., z. P.N. dhe znj. O.B.,** në cilësinë e personave përgjegjës për përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike.
AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Kritereve për kualifikim":
-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e kritereve të kualifikimit*" të datës 07.08.2025 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), në përgjithësi, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*".
AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":
Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes.
b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.
Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 09.10.2025 njoftimin e klasifikimit, në datën 20.10.2025 njoftimin paraprak dhe në datën 28.10.2025 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"M." SHPK	4,789,200	*Kualifikuar/Fituesi*
2	"E. L." PF	4,658,250	*Skualifikuar*
3	"S. M." PF	4,990,200	*Skualifikuar*

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke kualifikuar 1 (një) OE dhe skualifikuar 2 (dy) OE, me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

1. ***"E.L." PF:*** *Mungojnë bilancet e vitit 2022-2023-2024; Mungon artikulli nr. 6 për mostrat; OE ka tejkaluar fondin limit të kodit V923AAB 413,455/V822AAC 49,550/ V823AAB.*
2. ***"S.M." PF:*** *Artikulli 32 nuk është sipas specifikimeve të kërkuara nga AK.*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 09.10.2025, ndër të tjera, KVO-ja, ka kontrolluar preventivat e ofertuesve me qëllim korrigjimin eventual të tyre, ka verifikuar ofertatat anomalisht të ulëta dhe ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar, nga OE "M." SHPK, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës.

-Në procesverbalin nr. 10793 prot., datë 20.10.2025, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".

-Me shkresën nr. 10795 prot., datë 20.10.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".

-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës nr. 11183 prot., datë 28.10.2025, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari i AK (Personi i Autorizuar z. N.N.).

-Me shkresën nr. 11182 prot., datë 28.10.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".

-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konstatohet se kontrata e shit-blerjes së mallit nr. 12008 prot., datë 17.11.2025, është nënshkruar nga Personi i Autorizuar dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht "M." SHPK.

Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit, nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 17.11.2025 duke respektuar afatin e përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".

Së treti, në vijim, me urdhrat e brendshëm nr. 11628 prot., datë 07.11.2025, nr. 11627 prot., datë 07.11.2025, nr. 11658 prot., datë 07.11.2025 dhe nr. 11753 prot., datë 11.11.2025 Titullari i AK ka ngritur "Komisoinin për marrjen në dorëzim të mallit" për secilën nga strukturat që ka paraqitur kërkesën për zhvillimin e procedurës. Grupi i auditimit, në këtë pjesë të procedurës së prokurimit, konstaton se, nga komisioni i marrjes në dorëzim nuk janë administruar apo plotësuar deklaratat e anëtarëve mbi konfliktin e interesave, ashtu sikundër kërkohet nga VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 73, pika 4, ku ndër të tjera përcaktohet se: "*Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit*". Në lidhje me këtë situatë ***ngarkohen me përgjegjësi*** anëtarët e komisioneve të marrjes në dorëzim si dhe z. N. N., në cilësinë e personit të autorizuar.

Së katërti, për sa më sipër, nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se **KVO ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave**. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të ofertave është hapur në datën 18.08.2025, KVO-ja ka pasur detyrimin ligjor të kryente vlerësimin e tyre brenda datës 02.09.2025 (15 ditëve). Referuar procesverbalit të vlerësimit (paraprak) dhe SPE, rezulton se vlerësimi i ofertave dhe njoftimi përkatës është kryer në datën 09.10.2025 (komunikimi renditjes) dhe 20.10.2025 (vlerësimi paraprak). Në

lidhje me shkeljen e afatit të vlerësimit nga KVO-ja, në dosjen e prokurimit nuk rezulton të ketë një justifikim ligjor, i cili të përmbajë një nga arsyet e përcaktuara në nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 sipas të cilit: "*Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë...15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizmit të anëtarit/anëtarëve*".
Në përfundim, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** znj. A.Ll, z. K.N. dhe znj. M. Sh., në cilësinë e anëtarëve të KVO-së, si dhe N.N. Personi i autorizuar.

***8*-**Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt:*"**Materiale Pastrimi**"*, si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Materiale Pastrimi"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E hapur e thjeshtuar"
REF-48143-05-19-2025
Urdhri nr. 4081 prot., datë 29.04.2025</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe FL.
Urdhri nr. 3891/1 prot., datë 23.04.2025
1. A..
2. K.Ç.
3. O.B.</td><td>2. Njësia e Prokurimit
1. B.B
2. R. A.
3. O.B.</td><td>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 4480 prot., datë 14.05.2025
1. A.Ll
2. A.L.
3. M.Sh.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSH)
3,282,465 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSH)
2,477,573 lekë
Fitues: OE "M." SHPK</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)
804,892 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1. Data e hapjes së tenderit:
Data 02.06.2025
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 20 ditë</td><td colspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i Bashkisë Gjirokastër</td><td>9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender Numër 7 B/OE
b) Skualifikuar 5 B/OE
c) Kualifikuar 2 B/OE</td></tr>
<tr><td>10. Ankimime
AK-s'ka/ka: Po
APP–s'ka/ka: Jo
KPP-s'ka/ka: Po</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE)):
Data: 13.06.2025 (komunikimi i renditjes)
Data: 20.06.2025 (njoftimi paraprak i fituesit)
Data: 05.11.2025 (njoftimi përfundimtar i fituesit)</td><td>12. Data e lidhjes së kontratës:
Data: 17.11.2025
12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):
Data: 17.11.2025</td></tr>
</table>

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:
a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.
Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:
Së pari, me shkresën nr. 1909 prot., datë 26.02.2025 Sektori i Prokurimeve Publike pranë Bashkisë Gjitrokastër ka kërkuar nga Agjencia e Shërbimit Social dhe Shëndetësor, Agjencia për Aktivitete dhe Turizëm, Drejtoria e Arsimit si dhe nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri preventivat respektivë në lidhje me objektin e prokurimit. Pas paraqitjes së tyre, me urdhrin nr. 3891/1 prot., datë 23.04.2025, janë caktuar personat përgjegjës për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike: znj. A.Ç., znj. K. Ç. dhe znj. O. B..
-Në lidhje me përllogaritjen e vlerës së fondit limit, për hartimin e preventivit personat përgjegjës, në procesverbalin përkatës, citojnë se kanë studiuar ofertat e tregut duke përllogaritur si fond limit vlerën mesatare 3,282,465 lekë pa TVSH. Theksojmë se mënyrat në lidhje me përllogaritjen e fondit limit përcaktohen në nenin 76 të VKM-së nr. 258, datë

19.05.2021. Nga personat përgjegjës është mbajtur procesverbali nr. (pa numër) prot., datë 29.04.2025.
Gjithsesi, grupi i auditimit konstaton se, në procesverbal, përveç citimit të sipërcituar "ofertat e tregut", nga personat përgjegjës nuk janë administruar ofertat dhe as është cituar se nga cilët OE konkretë janë marrë këto oferta duke cënuar pasqyrimin e plotë të veprimtarisë, në mospërputhje me nenin 2, të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021, sipas të cilit: "*Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri te zbatimi i kontratës. Për këtë qëllim, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera*".
Në lidhje me mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohet me përgjegjësi: znj. A.Ç., znj. K.Ç. dhe znj. O.B.,** në cilësinë e personave përgjegjës për përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike.
AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Kritereve për kualifikim":
-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e kritereve të kualifikimit*" të datës 22.05.2025 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), në përgjithësi, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*".
AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":
Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes.
b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.
Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 7 OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 13.06.2025 njoftimin e klasifikimit, në datën 20.06.2025 njoftimin paraprak dhe në datën 05.11.2025 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"M.D" SHPK	2,477,573	*Kualifikuar/Fituesi*
2	"A.3" SHPK	2,642,505	*Skualifikuar*
3	"B. K." PF	2,954,485	*Kualifikuar*
4	"F&O C." SHPK	3,082,094	*Skualifikuar*
5	"S. M." PF	2,619,025	*Skualifikuar*
6	"M." SHPK	2,970,005	*Skualifikuar*
7	"T&J C." SHPK	2,724,427	*Skualifikuar*

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke kualifikuar 2 (dy) OE dhe skualifikuar 5 (pesë) OE, me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

> ***"A. 3" SHPK:*** *Nuk plotëson pikën 2.6 Operatorët Ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesin nga një mostër për secilin mall të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor; Në artikullin Nr. 45 është kërkuar që të paraqitet me etiketë të ngjitur e cila tregon "emërtimin e artikullit" numrin rendor sipas preventivit të ngarkuar dhe ofertës së tyre, emrin e ofertuesit dhe vulën e operatorit ekonomik e cila mungon.*
>
> ***"F&O C." SHPK:*** *Nuk plotëson pikën 2.6 Operatorët Ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesin nga një mostër për secilin mall të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor; OE*

nuk plotëson pikën: Mostrat do të jenë me etikëtë të ngjitur e cila tregon "emërtimin e artikullit" numrin rendor sipas preventivit të ngarkuar dhe ofertës së tyre, emrin e ofertuesit dhe vulën e operatorit ekonomik; OE nuk plotëson pikën 2.2.2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024.

"M." SHPK: *OE ka tejkaluar vlerën e përcaktuar të kodit buxhetor V510AAC227,500 lekë pa TVSH në 227,940 lekë pa TVSH.*

"T. &J. C." SHPK: *Nuk plotëson pikën 2.6 Operatorët Ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesin nga një mostër për secilin mall të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.*

"S. M." PF: *Nuk plotëson pikën 2.6 Operatorët Ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesin nga një mostër për secilin mall të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Në bazë të Vendimti të Kpp-së nr 1428/2025 OE nuk përmbush specifikimet për artikullin Për Art. 44 dhe 45.*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 13.06.2025, ndër të tjera, KVO-ja, ka kontrolluar preventivat e ofertuesve me qëllim korrigjimin eventual të tyre, ka verifikuar ofertatat anomalisht të ulëta dhe ka pasqyruar fillimisht vlerësimin si vijon:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	**"M.D" SHPK**	**2,477,573**	***Kualifikuar/Fituesi***
2	"A. 3" SHPK	2,642,505	*Skualifikuar*
3	**"B.K." PF**	**2,954,485**	***Kualifikuar***
4	"F&O C." SHPK	3,082,094	*Skualifikuar*
5	**"S.M." PF**	**2,619,025**	***Kualifikuar***
6	"M." SHPK	2,970,005	*Skualifikuar*
7	"T&J C." SHPK	2,724,427	*Skualifikuar*

Për sa më sipër KVO-ja, në datën 13.06.2025, ka kërkuar, nga OE "M. D" SHPK, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës.

-Në procesverbalin nr. 5955 prot., datë 20.06.2025, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".

-Me shkresën nr. 5963 prot., datë 20.06.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".

-Në datën 02.07.3025 pranë AK Bashki Gjirokastër, është protokolluar ankesa me nr. 6465 prot., e OE "B. K." PF (më pas e njëjta situatë edhe për "S. M." PF) ankesë e cila është paraqitur njëkohësisht edhe pranë KPP-së, me të cilën OE kundërshtohet kualifikimi i "M. D" SHPK.

-Titullari i AK (Personi i Autorizuar), në datën 02.07.3025 ka marrë vendimin (urdhër) nr. 6466 prot., dhe (urdhër) nr. 6467 prot., me të cilët ka vendosur pezullimin e vazhdimit të procedures dhe ka caktuar Komisionin (anëtarin) për Shqyrtimin e Ankesës (KSHA) të përbërë nga një punonjës (z. K.N.).

-Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me ankimin, rezulton se, pas shqyrtimit, KSHA ka marrë vendim nr. 6607 prot., datë 07.07.3025 për (refuzimin) mospranimin e tij. Venidmi i është komunikuar OE "B. K." PF, brenda afateve ligjore, me shkresën nr. 6608 prot., datë 07.07.3025.

-Nga sa më sipër, procedurialisht, në lidhje me ankesën e paraqitur dhe shqyrtimin e saj, rezulton se titullari i AK dhe KSHA ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

Gjithsesi, grupi i auditimit konstaton se, në lidhje me praktikën e shqyrtimit të ankesës, nga KSHA nuk janë administruar deklaratat e anëtarëve mbi konfliktin e interesave, ashtu sikundër kërkohet nga VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të*

prokurimit publik", neni 73, pika 4, ku ndër të tjera përcaktohet se: "*Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit*", në kundërshtim me LPP ***ngarkohet me përgjegjësi*** z. K.N., në cilësinë e anëtarit të KSHA-së si dhe z. N. N. Personi i autorizuar.
-Nga ana tjetër, me shkresën nr. 1702/16 prot., datë 10.10.2025 të KPP-së, AK është njohur me vendimin nr. 1428/2025 datë 21.11.2023 të KPP-së, me të cilin, ndër të tjera, në mënyrë të përmbledhur, është vendosur: "*1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik OE "B. K." PF...për OE "M. D" SHPK".*
-Me procesverbalin e datës 16.10.2025, ndër të tjera, KVO-ja, pas vendimeve të KPP-së, ka kryer rivlerësimin e ofertatave.
-Me shkresën nr. 10699 prot., datë 16.10.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".
-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës nr. 11513 prot., datë 05.11.2025, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullati i AK (Personi i Autorizuar z. N.N.).
-Me shkresën nr. 11515 prot., datë 05.11.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".
-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konsatatohet se kontrata e shit-blerjes së mallit nr. 12005 prot., datë 17.11.2025, është nënshkruar nga Personi i Autorizuar dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht "M.D" SHPK.
Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit, nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 17.11.2025 duke respektuar afatin e përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".
Së treti, në vijim, me urdhrat e brendshëm nr. 11130 prot., datë 27.11.2025, nr. 11134 prot., datë 27.11.2025 dhe nr. 11133 prot., datë 27.11.2025 Titullari i AK ka ngritur "Komisoinin për marrjen në dorëzim të mallit" për secilën nga strukturat që ka paraqitur kërkesën për zhvillimin e procedurës (anëtarë: R.Sh., A.Ç., A. Zh., F. K., V. Xh., M K., M. G., K.H. dhe E.V.). Grupi i auditimit, në këtë pjesë të procedurës së prokurimit, konstaton se, nga komisionet e marrjes në dorëzim nuk janë administruar apo plotësuar deklaratat e anëtarëve mbi konfliktin e interesave, ashtu sikundër kërkohet nga VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 73, pika 4, ku ndër të tjera përcaktohet se: "*Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit*". Në lidhje me këtë situatë ***ngarkohen me përgjegjësi*** anëtarët e komisioneve të marrjes në dorëzim si dhe z. N.N., në cilësinë e personit të autorizuar.

9-Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt:*"**Materiale Ndërtimi**"*, si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*Materiale Ndërtimi*"			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "E hapur e thjeshtuar" REF-62569-09-25-2025 Urdhri nr. 9560 prot., datë 19.09.2025	**1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe FL.** Urdhri nr. 9535 prot., datë 18.09.2025 1. A. B.	**2. Njësia e Prokurimit** 1. B.B 2. R.A. 3. L. Sh.	**3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri nr. 9852 prot., datë 25.09.2025 1. A.Ll. 2. K. N. 3. M. Sh.
4. Fondi Limit (pa TVSH) 5,814,051 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSH)** 4,900,713 lekë Fitues: OE "T&J C." SHPK		**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** 913,388 lekë
7/1. Data e hapjes së tenderit: Data 06.10.2025 **7/2 Kohëzgjatja e kontratës:** deri në 31.12.2025	**8. Burimi Financimit** Buxheti i Bashkisë Gjirokastër		**9. Operatoret Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender Numër 2 **B/OE** b) Skualifikuar 1 **B/OE** c) Kualifikuar 1 **B/OE**
10. Ankimime **AK-**s'ka/ka**: Jo** **APP–**s'ka/ka**: Jo** **KPP-**s'ka/ka: **Jo**	**11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (*nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE*):** Data: 07.10.2025 (komunikimi i renditjes) Data: 28.10.2025 (njoftimi paraprak i fituesit) Data: 05.11.2025 (njoftimi përfundimtar i fituesit)		**12. Data e lidhjes së kontratës:** Data: 02.12.2025 **12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):** Data: 02.12.2025

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:

Së pari, me shkresën nr. 9306 prot., datë 12.09.2025 Drejtoria e Shërbimeve Komunitare Utilitare ka kërkuar, nga Drejtoria e Prokurimeve Publike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje Materiale Ndërtimi" duke bashkëlidhur nevojat (preventivin) përkatëse.

Me urdhrin nr. 9535 prot., datë 18.09.2025, është caktuar personi përgjegjës për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike, z. A. B.

-Në lidhje me përllogaritjen e vlerës së fondit limit, për hartimin e preventivit personi përgjegjës, në procesverbalin përkatës, citon se, përveç artikujve të marrë nga lista e publikuar sipas VKM 216, për pjesën tjetër ka studiuar ofertat e tregut duke përllogaritur si fond limit vlerën mesatare 5,814,051 lekë pa TVSH. Theksojmë se mënyrat në lidhje me përllogaritjen e fondit limit përcaktohen në nenin 76 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021. Nga personi përgjegjës është mbajtur procesverbali nr. (pa numër) prot., datë 18.09.2025.

Gjithsesi, grupi i auditimit konstaton se, në procesverbal, përveç citimit të sipërcituar "ofertat e tregut", nga personi përgjegjës nuk janë administruar ofertat dhe as është citur se nga cilët OE konkretë janë marrë këto oferta duke cënuar pasqyrimin e plotë të veprimtarisë, në mospërputhje me nenin 2, të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021, sipas të cilit: "*Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri te zbatimi i kontratës. Për këtë qëllim, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera*".

Në lidhje me mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohet me përgjegjësi: z. A.B.,** në cilësinë e personit përgjegjës për përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike.

AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Kritereve për kualifikim":

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e kritereve të kualifikimit*" të datës 25.09.2025 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), edhe pse në përgjithësi, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*", për një prej tyre,

grupi i auditimit vlerëson se rezulton i paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe/ose i ekzagjeruar dhe/ose i argumentuar mbi bazën e parakushteve jo realiste. Në lidhje me këtë kriter, njësia e prokurimit (NjP) është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos marrë parasysh natyrën dhe vlerën e kontratës.

Konkretisht, për sa më sipër, nga grupi i auditimit, është konstatuar sa vijon:

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.5 ndër të tjera, ka kërkuar nga OE ofertues disponimin:

"*-Subjekti duhet të ketë në pronësi ose me kontratë qira/bashkepunimi/furnizimi Nyje prodhim inertesh. Në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vertetojnë pronësinë e saj, (Akt- miratimin dhe lejen mjedisore QKL Kodi III.1.B). Në rast se është me qira ose kontratë bashkëpunimi/kontratë furnizimi duhet të paraqitet kontrata e qirasë/bashkëpunimit/furnizimit. Plotësimi i pikës 2.5 do të plotësohet duke paraqitur në SPE dokumentacionin e sipërcituar në fazën e ofertimit të ofertave dhe jo vetëm duke cituar numrin e kontratës në Formularin e Vetdeklarimit*".

Në rastin konkret, duke qenë se kemi të bëjmë me mallra të cilat gjenden lehtësisht në treg, kriteret rezultojnë të ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës, çka ndikon negativisht në konkurrencën dhe pjesëmarrjen e operatorëve në garë. Pikërisht, duke qenë se këto shërbime apo mallra gjenden lehtësisht në treg, si dhe referuar sasisë së kërkuar për objektin, nuk ka asnjë arsye që aftësia zbatuese e një ofertuesi të kushtëzohet apo të konsiderohet si e lidhur ngushtë me dokumentacionin e sipërcituar (pronësi, kontratë noteriale qiraje apo furnizimi). Çdo nevojë e AK në lidhje me cilësitë e mallrave mund të mirëpërcaktohet lehtësisht në specifikimet teknike.

Si konkluzion, veprimet apo mosveprimet e mësipërme, përveçse rezultojnë në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.05.2021 "*Për prokurimin publik*", ndikojnë negativisht mbi konkurrencën, në kundërshtim me nenin 2 të LPP-së. Njësia e prokurimit nuk ka konsideruar faktin se kriteri i sipërcituar mund të sjelli kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët eventualisht mund të kenë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës.

Situata e sipërcituar bie në kundërshtim me përcaktimet e Nenit 39 pika 4: "*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës…*", si dhe Nenit 78 pika 2: "*Hartimi i kërkesave për kualifikim…Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht...*".

Në përfundim, në lidhje me veprimet apo mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** z. B.B, znj. R.A. dhe znj. L.Sh., në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 07.10.2025 njoftimin e klasifikimit, në datën 28.10.2025 njoftimin paraprak dhe në datën 05.11.2025 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"T&J C." SHPK	4,900,713	*Kualifikuar/Fituesi*
2	"S." SHPK	5,695,696	*Skualifikuar*

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke kualifikuar 1 (një) OE dhe skualifikuar 1 (një) OE, me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

> ***"S." SHPK:*** *OE nuk ka ngarkuar në SPEdokumentacionin përkatës për nyje prodhimi inertesh por është mjaftuar vetem duke e cituar kontratën në Formularin e vetdeklarimit, si rrjedhojë OE "S." SHPK skualifikohet.*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 07.10.2025, ndër të tjera, KVO-ja, ka kontrolluar preventivat e ofertuesve me qëllim korrigjimin eventual të tyre, ka verifikuar ofertatat anomalisht të ulëta dhe ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar, nga OE "T&J C." SHPK, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës.

-Në procesverbalin nr. 11168 prot., datë 28.10.2025, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".

-Me shkresën nr. 11178 prot., datë 28.10.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".

-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës nr. 11517 prot., datë 05.11.2025, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullati i AK (Personi i Autorizuar z. N.N.).

-Me shkresën nr. 11520 prot., datë 05.11.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".

-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konsatatohet se kontrata e shit-blerjes së mallit nr. 12521 prot., datë 02.12.2025, është nënshkruar nga Personi i Autorizuar dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht "T&J C." SHPK.

Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit, nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 02.12.2025 duke respektuar afatin e përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".

Së treti, në vijim, me urdhrin e brendshëm nr. 12636 prot., datë 04.12.2025, Titullari i AK ka ngritur "Komisoinin për marrjen në dorëzim të mallit" të përbërë nga z. P.Ç., z. A.B. dhe z. A.L..

Grupi i auditimit, në këtë pjesë të procedurës së prokurimit, konstaton se, nga komisioni i marrjes në dorëzim nuk janë administruar apo plotësuar deklaratat e anëtarëve mbi konfliktin e interesave, ashtu sikundër kërkohet nga VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 73, pika 4, ku ndër të tjera përcaktohet se: "*Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit*". Në lidhje me këtë situatë ***ngarkohet me përgjegjësi* z. P.Ç., z. A.B. dhe z. A.L.,** në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim si dhe **z. N.N.**, në cilësinë e personit të autorizuar.

Së katërti, për sa më sipër, nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se **KVO ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave**. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të oferatave është hapur në datën 06.10.2025, KVO-ja ka pasur detyrimin ligjor të kryente vlerësimin e tyre brenda datës 05.10.2025 (15 ditëve). Referuar procesverbalit të vlerësimit (paraprak) dhe SPE, rezulton se vlerësimi i ofertave dhe njoftimi përkatës është kryer në datën 07.10.2025 (komunikimi renditjes) dhe 28.10.2025 (vlerësimi paraprak). Në lidhje me shkeljen e afatit të vlerësimit nga KVO-ja, në dosjen e prokurimit nuk rezulton të

ketë një justifikim ligjor, i cili të përmbajë një nga arsyet e përcaktuara në nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 sipas të cilit: "*Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë...15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve*".
Në përfundim, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** znj. A. L., z. K.N. dhe znj. M. Sh., në cilësinë e anëtarëve të KVO-së, si dhe N.N.Personi i autorizuar.

2.4.2. Në lidhje me auditimin e procedurave të llojit "Blerje me vlerë të vogël", të zhvilluara dhe realizuara gjatë vitit 2025.

-Me urdhrin nr. 329 prot., datë 13.01.2025, nga Nëpunësi i Autorizuar i Autoritetit Kontraktor (z. N.N.) janë përcaktuar personat përgjegjës për prokurimet "blerje me vlerë të vogël", konkretisht: z. B.B (kryetar), znj. M.Sh. (anëtare) dhe znj. L.Sh. (anëtare).
-Me urdhrin nr. 2300 prot., datë 10.03.2025 është ndryshuar urdhri nr. 329 prot., datë 13.01.2025, nga Nëpunësi i Autorizuar i Autoritetit Kontraktor (z. N.N.) dhe në vend të znj. L. Sh.(anëtare) është caktuar znj. A. L. (anëtare).
-Me urdhrin nr. 6725 prot., datë 09.07.2025 është ndryshuar urdhri nr. 2300 prot., datë 10.03.2025, nga Nëpunësi i Autorizuar i Autoritetit Kontraktor (z. N. N.) dhe në vend të znj. A.Ll. (anëtare) është caktuar znj. R. A. (anëtare).
-Me urdhrin nr. 6963 prot., datë 16.07.2025 është ndryshuar urdhri nr. 6725 prot., datë 09.07.2025, nga Nëpunësi i Autorizuar i Autoritetit Kontraktor (z. N.N.) dhe në vend të znj. R. A. (anëtare) është caktuar znj. M. Sh. (anëtare).
-Me urdhrin nr. 7948 prot., datë 04.08.2025 është ndryshuar urdhri nr. 6963 prot., datë 16.07.2025, nga Nëpunësi i Autorizuar i Autoritetit Kontraktor (z. N.N.) dhe në vend të znj. M. Sh. (anëtare) është caktuar znj. R. A. (anëtare).
Grupi i auditimit, duke vlerësuar riskun si dhe duke ju referuar vlerës së procedurave, ka audituar për vitin 2025 gjithësej 5 (pesë) procedura prokurimi "blerje me vlerë të vogël" (për një fond limit total pa TVSH 2,341,182 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 1,841,890 lekë pa TVSH) si vijon:

1. **Objekti: "*Shpenzime për materiale hidraulike*".**

Me shkresën nr. 1311 prot., datë 07.02.2025 nga ana e Agjencisë së Trashëgimisë Kulturore si dhe me anë të shkresës nr. 3617 prot., datë 15.04.2025 të Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare Utilitare, është paraqitur pranë zyrës së Protokoll-Arkivës kërkesa me lëndë: "*Shpenzime për matëriale hidraulike*". Në vijim të kësaj kërkese, personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve, nëpërmjet proces-verbalit, pa numër protokolli, datë 23.04.2025, ka hartuar specifikimet teknike dhe ka përllogaritur fondin limit të procedurës, duke u bazuar në çmimet referuese të tregut. Fondi limit i përcaktuar për këtë procedurë është në vlerën 352,150 lekë pa TVSH.
Me urdhrin e prokurimit nr. 3906 prot., datë 24.04.2025, është miratuar zhvillimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël. Ftesa për ofertë është hartuar me shkresën nr. 4205 prot., datë 05.05.2025.
KBVV ka konstatuar se kanë rezultuar pjesëmarrës 31 operatorë ekonomikë nga të cilët janë skualifikuar 10 operatorë ekonomikë nga ku rezulton fitues përfundimtar subjekti E. L. PF.
Gjithashtu, me urdhrin nr. 4570 prot., datë 19.05.2025, është ngritur Komisioni i Marrjes në Dorëzim të mallrave objekt i kësaj procedure (P.Sh, A.Xh.dhe B.B.).

Sipas procesverbalit pa numër protokolli, datë 28.05.2025, Komisioni i Marrjes në Dorëzim ka konstatuar se mallrat janë dorëzuar në përputhje me kushtet e kontratës dhe specifikimet e përcaktuara. Pagesa është kryer nëpërmjet urdhër-shpenzimit nr. 442, datës 24.06.2025, në vlerën 286,680 lekë me TVSH.

2. **Objekti: "*Blerje pajisje dixhitale dron*".**

Me shkresën nr. 3878 prot., datë 23.04.2025 nga ana e Agjencisë për Aktivitete dhe Turizëm, është paraqitur pranë zyrës së Protokoll-Arkivës kërkesa me lëndë: "*Blerje pajisje dixhitale dron*". Në vijim të kësaj kërkese, personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve, nëpërmjet proces-verbalit pa numër protokolli, datë 26.05.2025, kanë hartuar specifikimet teknike dhe kanë përllogaritur fondin limit të procedurës. Fondi limit i përcaktuar për këtë procedurë është në vlerën 260,000 lekë pa TVSH.
Me urdhrin e prokurimit nr. 4816 prot., datë 26.05.2025, është miratuar zhvillimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël. Ftesa për ofertë është hartuar me shkresën nr. 5140 prot., datë 03.06.2025.
KBVV (Konisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla) ka konstatuar se kanë rezultuar pjesmarrës 29 operatorë ekonomikë nga të cilët janë skualifikuar 13 operatorë ekonomikë nga ku rezulton fitues përfundimtar subjekti "D. G.LTD" SHPK.
Gjithashtu, me urdhrin nr. 5437 prot., datë 11.06.2025, është ngritur Komisioni i Marrjes në Dorëzim të mallrave objekt i kësaj procedure (A. L., A.Ll. dhe K. V.).
Sipas procesverbalit pa numër protokolli, datë 25.06.2025, Komisioni i Marrjes në Dorëzim ka konstatuar se mallrat janë dorëzuar në përputhje me kushtet e kontratës dhe specifikimet e përcaktuara. Pagesa është kryer nëpërmjet urdhër-shpenzimit nr. 518 datës 14.07.2025, në vlerën 228,000 lekë me TVSH.

3. **Objekti: "*Materiale të buta*".**

Me shkresën nr. 5242 prot., datë 04.06.2025 nga ana e Drejtorisë së Arsimit, është paraqitur pranë zyrës së Protokoll- Arkivës kërkesa me lëndë: "*Materiale të buta*". Në vijim të kësaj kërkese, personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve, nëpërmjet proces-verbalit pa numër protokolli, datë 05.06.2025, kanë hartuar specifikimet teknike dhe kanë përllogaritur fondin limit të procedurës, duke u bazuar në çmimet referuese të tregut. Fondi limit i përcaktuar për këtë procedurë është në vlerën 249,943 lekë pa TVSH.
Me urdhrin e prokurimit nr. 5279 prot., datë 05.06.2025, është miratuar zhvillimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël. Ftesa për ofertë është hartuar me shkresën nr. 5783 prot., datë 17.06.2025.
KBVV ka konstatuar se kanë rezultuar pjesmarrës 28 operatorë ekonomikënga të cilët janë skualifikuar 14 operatorë ekonomikë nga ku rezulton fitues përfundimtar subjekti "H. 2010" SHPK.
Gjithashtu, me urdhrin nr. 6516 prot., datë 03.07.2025, është ngritur Komisioni i Marrjes në Dorëzim të mallrave objekt i kësaj procedure (J. Ç., F. X. dhe M. L.).
Sipas procesverbalit pa numër protokolli, datë 08.07.2025, Komisioni i Marrjes në Dorëzim ka konstatuar se mallrat janë dorëzuar në përputhje me kushtet e kontratës dhe specifikimet e përcaktuara. Pagesa është kryer nëpërmjet urdhër-shpenzimit nr. 611 datë 11.08.2025, në vlerën 280,800 lekë me TVSH.

4. **Objekti: "*Materiale për mirëmbajtjen e godinave arsimore*".**

Me shkresën nr. 7040 prot., datë 18.07.2025 nga ana e Drejtorisë së Arsimit, është paraqitur pranë zyrës së Protokoll-Arkivës kërkesa me lëndë: "*Materiale për mirëmbajtjen e godinave arsimore*". Në vijim të kësaj kërkese, personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve, nëpërmjet proces-verbalit pa numër protokolli, datë 21.07.2025, kanë hartuar specifikimet teknike dhe kanë përllogaritur fondin limit të procedurës, duke u bazuar në çmimet referuese të tregut. Fondi limit i përcaktuar për këtë procedurë është në vlerën 833,250 lekë pa TVSH.
Me urdhrin e prokurimit nr. 7063 prot., datë 21.07.2025, është miratuar zhvillimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël. Ftesa për ofertë është hartuar me shkresën nr. 7653 prot., datë 28.07.2025.
KBVV ka konstatuar se kanë rezultuar pjesmarrës 25 operatorë ekonomikë nga të cilët janë skualifikuar 6 operatorë ekonomikë nga ku rezulton fitues përfundimtar subjekti "A.K." PF.
Gjithashtu, me urdhrin nr. 8030 prot., datë 06.08.2025, është ngritur Komisioni i Marrjes në Dorëzim të mallrave objekt i kësaj procedure (V.X., S.D. dhe M. L.).
Sipas procesverbalit pa numër protokolli, datë 15.08.2025, Komisioni i Marrjes në Dorëzim ka konstatuar se mallrat janë dorëzuar në përputhje me kushtet e kontratës dhe specifikimet e përcaktuara. Pagesa është kryer nëpërmjet urdhër-shpenzimit nr. 739 datë 12.09.2025, në vlerën 658,788 lekë me TVSH.

5. **Objekti: "*Rinovim dhe pajisja e Qendrës Sociale Komunitare "Zinxhira" për të përmbushur standartet e aksesushmërisë dhe kërkesat e ofrimit të shërbimit*".**

Me shkresën nr. 3957 prot., datë 25.04.2025 nga ana e Drejtorisë së Urbanistikës, është paraqitur pranë Sekretarit të Përgjithshëm kërkesa me lëndë dërgim dokumentacioni për objektin:"*Rinovim dhe pajisja e Qendrës Sociale Komunitare "Zinxhira" për të përmbushur standartet e aksesushmërisë dhe kërkesat e ofrimit të shërbimit*".
Me urdhrin e prokurimit nr. 4030 prot., datë 28.04.2025, është miratuar zhvillimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël. Ftesa për ofertë është hartuar me shkresën nr. 7964 prot., datë 04.08.2025.
KBVV ka konstatuar se kanë rezultuar pjesmarrës 2 operatorë ekonomikë nga të cilët janë skualifikuar 0 operatorë ekonomikë nga ku rezulton fitues përfundimtar subjekti "A. I." SHPK.
Operatori ekonomik "A. I." SHPK ka paraqitur ofertën e tij me shkresën nr. 8121 prot., datë 07.08.2025.
Sipas procesverbalit S'ka. Pagesa është kryer nëpërmjet urdhër-shpenzimit nr. 846 datë 08.10.2025, në vlerën 688,800 lekë me TVSH dhe urdhër-shpenzimit nr. 1137 datë 24.12.2025, në vlerën 67,200 lekë me TVSH.
Konkluzion i përgjithshëm.
Nga auditimi i procedurave të sipërcituara, grupi i auditimit konstaton, në mënyrë të përmbledhur, sa vijon:
-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjeve fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve tëkualifikimit*" dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK, Komisioni i Blerjeve të Vogla, në cilësinë e njësisë së prokurimit (NjP), në përgjithësi, është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim dhe është mbajtur procesverbali përkatës, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*".

-Referuar procedurave të sipërcituara, konstatohet se dosjet fizike të prokurimit, të cilat ndër të tjera përmbajnë procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., janë pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Gjithashtu në dosjet e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të KBVV (Konisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla) mbi konfliktin e interesave.
-Për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistem (SPE) si dhe në dosjet fizike, në lidhje me procedurat e sipërcituara, grupi i auditimit vlerëson se, Komisioni i Blerjeve të Vogla, në cilësinë KVO-së, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, ka vepruar përgjithësisht në përputhje me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".2
Nga auditimi, konstatohet se, në lidhje me praktikat e marrjes në dorëzim, nga komisioni përkatës nuk janë administruar apo plotësuar deklaratat e anëtarëve të Komisionit të Marrjes në Dorëzim (KMD) mbi konfliktin e interesave, ashtu sikundër kërkohet nga VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 73, pika 4, ku ndër të tjera përcaktohet se: "*Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit*". Në lidhje me këtë situatë ***ngarkohet me përgjegjësi:*** Titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtarit i autorizuar si dhe anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim.

(Për sa më sipër, pas njohjes me projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Bashkia Gjirokastër, nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit).

2.4.3. Auditim i kontratave për punë publike.

Në mënyrë të përmbledhur realizimi i kontratave për punë publike për periudhën e auditimit, 01.01.2025 deri 31.12.2025 rezultoi si më poshtë.
Në total për periudhën e auditimit, janë lidhur **8 (tetë)** kontrata për punë publike në vlerën e përgjithshme **252,419,517.16** lekë me TVSH.

Tabela nr. 1. Kontrata për punë ndërtimi të lidhura dhe të realizuara për vitin 2025

Nr.	Objekti investimit	Burimi financimit	Operatori fitues	Vlera kontratës me T.V.Sh	Data e lidhjes se kontratës
1	Riveshje në segmente të ndryshme rrugë.	Bashkia Gjirokastër	"E. B. " SHPK	26,096,658.8	25.02.2025
2	Rikonstruksion dhe përmirësimi eficences energjetike në shkollën "Muhamet Gjollesha".	Ministria e Arsimit Kultures dhe Sporteve	"N." SHPK	17,375,781.78	19.11.2024
3	Rivitalizimi i hapësirave rreth Pallatit te Sportit "Luftetari".	Bashkia Gjirokastër	"E. C.C." SHPK	20,078,730	22.01.2025
4	RiveshjeasfaltikenerugenDhoksat Bashkia Gjirokastër	Bashkia Gjirokastër	"E. C." SHPK	4,535,872.8	06.11.2024
5	Rinovim dhe paisjee Qendres komunitareSocialezinxhiraper te permbushur standartete aksesueshmerise dhe kerkesat e ofrimit tesherbimeve	Donatore	"A. i." SHPK	630,000	22.08.2025
6	Sistemim asfaltim rruga Taronine Zhulat Gjirokaster	Bashkia Gjirokaster	"L. C." SHPK	56,034,913.2	13.11.2024
7	Rikonstruksion lerash	Bashkia	"A.i." SHPK	3,702,192	06.02.2025

		Gjirokaster			
	SHUMA në lekë me TVSH			**128,454,148.58**	

Tabela nr. 2. Kontrata të lidhura në vitin 2025, por që janë në proces pune (të pambyllura për fazën e zbatimit).

Nr	**Objektiiinvestimit**	**Burimii financimit**	**Operatorifitues**	**Vlerae kontratësmeT.V. Sh**	**Datae lidhjessekontratës**
1	Rikonstruksion i rruges "BabaSelimi " Zinxhira	Bashkia + Ministia e Ekonomise	"E. C. C." SHPK & "C." SHPK	50,466,731.8	21.11.2025
2	Rikonstruksioni godines egzistuesdhe shkallese emergjencesdhe dhomes teknikene shkollen9 vjecareUrani Rumbo	Ministriae Arsimit	"E.b." SHPK & "I." SHPK	73,498,636.78	04.11.2025
	SHUMA në Lekë me TVSH			**123,965,368.58**	

Në zbatim të pikës së Programit të Auditimit, në Bashkinë Gjirokastër, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizua regjistri i investimeve për punë publike të përfunduara në periudhën e auditimit. Nga kjo analizë, u arsyetua që si objekte me risk në realizimin e punimeve, të cilat janë kërkuar për t'u audituar, janë përzgjedhur në bazë të vlerës së kontratës, llojit të punimeve të ndërtimit, zërave të punimeve të ndërtimit me risk të madh në zbatimin e veprave, të rishikimit të projekteve të zbatimit si dhe të shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve për **4 (katër)** kontrata për punë publike në vlerën e përgjithshme **119,586,083.78** lekë me TVSH. Auditimi mbuloi **93.09 %** në fushën e zbatimit të kontratave për punë publike të realizuara, të kolauduara dhe të marra në dorëzim.

Në përfundim të auditimit të zbatimit të kontratave për punë publike, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, po pasqyrojmë në mënyrë të detajuar problematikat e konstatuara, si vijon:

1. Kontrata për punë publike me objekt: "**Rivitalizimi i hapësirave rreth pallatit të sportit**", me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rivitalizimi i hapësirave rreth pallatit të sportit".		
14.Lidhja e kontratës nr. 667 prot., datë 22.01.2025 OE "E. C. C." SHPK	**15.Vlera e kontratës.** Vl e prev ofertues 20,078,730 lekë me TVSH.	**16.Likuiduar**: Sit. 1 në vlerën 9,747,660 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 2,773,800 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar - Sit përf në vlerën 7,553,850 lekë pa TVSH Vl përf e realizuar 20,075,310 lekë me TVSH	**18.Afati i kontratës në dite** Fillimi punimeve: 12.03.2025 Përfundimi punimeve: 26.08.2025	**19. Zgjatja e kontratës** ---
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "P. C." SHPK	Licenca MK.0899/20	Kontratë me nr. 270 prot., datë 13.01.2025
21. Kolaudatori i punimeve OE "BN P." SHPK	Licenca Nr.: MK. 0899/20	Kontratë nr. 11245 prot., datë 29.10.2025
22.Akt Kolaudimi. -Me akt kolaudimin me datë 03.11.2025 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i	**23.Akt i marrjes në dorëzim:** -Me shkresën me datë 04.11.2025 është mbajtur certifikata e marrjes në dorëzim të përkohshëm, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "E.C." SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "P." SHPK, kolaudatori i punimeve "NB P." SHPK, si dhe nga grupi i marrjes në dorëzim i ngritur sipas urdhrit	

punimeve OE “E. C.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve “P. C.” SHPK, kolaudatori i punimeve “NB P.” SHPK.	nr. ---, datë ---, me përbërje: B. D., F. M., E. Xh..

u konstatua problematikat si vijon.

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë Dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Gjirokastër, në vlerën **424,600 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr.	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
	Punime ndërtimi në trotuar, rrugë dhe shkallë							-
1(3.211)	Shtresë cakulli t=20 cm	m^2	900	113	113	101	12 m2	10,800
2(3.212)/b	Shtresë stabilizanti t=10cm	M2	400	113	113	101	12 m2	4,800
4(2.288)	Trotuar me pllaka pa bordurën e betonit (Pllaka vetshtrenguese t=6 cm)	M2	2000	113	113	101	12 m2	24,000
	Punime për sinjalistikën							-
Zëri 2(3.946/1)	Vizime e kalimit të këmbësorëve. Biokomponente (Pastë)	M2	5500	124	124	54	70	385,000
	Total në lekë pa TVSH							**424,600**

Përshkrimi i situatës:

1. Punime ndërtimi në trotuar, rrugë dhe shkallë.

Nga auditimi në terren mbi realizimin e punimeve të ndërtimit, përkatësisht për trotuarin, u konstatua se në volumet e situacionuara dhe të librezuara [Shtresë cakulli t=20 cm, Shtresë stabilizanti t=10cm, Trotuar me pllaka pa bordurën e betonit (Pllaka vetshtrenguese t=6 cm)], nuk janë zbritur sipërfaqet që zënë 12 copë puseta shkarkimi për 12 m2. Bazuar nga auditimi i kryer në fakt dhe nga rillogaritja e bërë, rezultojnë diferenca në volume, të argumentuara si vijon:

Tabela nr. 1

Nr.	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
1(3.211)	Shtresë cakulli t=20 cm	m^2	900	113	113	101	12 m2	10,800
2(3.212)/b	Shtresë stabilizanti t=10cm	M2	400	113	113	101	12 m2	4,800
4(2.288)	Trotuar me pllaka pa bordurën e betonit (Pllaka vetshtrenguese t=6 cm)	M2	2000	113	113	101	12 m2	24,000
	Shuma							**39,600**

Sa më sipër trajtuar, sipërmarrësi i punimeve ka përfituar në mënyrë të pa drejtë**39,600 lekë pa TVSH.**

Punime për sinjalistikën.
2. Zëri 2(3.946/1) Vizime e kalimit të këmbësorëve. Biokomponente (Pastë).
Preventivi i rishikuar pasqyron sasinë 124 m2.Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 124 m2 vizime, me çmim 5500 lekë pa TVSH.
Libreza e masave pasqyron 124.8 m2. Referuar realizimit të këtij zëri në vepër, rezulton se ku zë pune është realizuar për 3 (tre) vendkalime këmbësorësh në sipërfaqen **54 m2** [3 x (6 mx 3 m)] dhe jo **124** m2 siç është situacionuar dhe librezuar.
Sa më sipër trajtuar, nga sipërmarrësi i punimeve është përfituar tepër në vlerën **385,000 lekë** [70 (124 m2 sipas librezës – 54 m2 sipas faktit) x 5500 lekë].

Nga ana e zbatuesit të punimeve nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:
*- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 8; - **Udhëzimin Nr. 2**, datë 13.5.2005"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" Kreu I "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit", pika 3; - Kontratës për punë publike me nr. 667 prot., datë 22.01.2025]*.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve OE "P. C." SHPK si dhe, OE "BN P." SHPK e përfaqësuar nga nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas: [*- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7; - **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2; kontratë shërbimi me nr. 270 prot., datë 13.01.2025; kontratë shërbimi me nr. 11245 prot., datë 29.10.2025]*.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. **Znj. V. G.,** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.
2. **Z. A.A.,** në cilësinë e kolaudatorit të punimeve.

2. Kontrata për punë publike me objekt: "**Rikonstruksion dhe përmirësim i efiçencës energjitike në shkollën "Muhamet Gjollesha", Lazarat**", me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,

<table>
<tr><td colspan="3">13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion dhe përmirësim i efiçencës energjitike në shkollën "Muhamet Gjollesha", Lazarat.</td></tr>
<tr><td>14.Lidhja e kontratës
nr. 10565 prot., datë 19.11.2024

OE "N." SHPK</td><td>15.Vlera e kontratës.
Vl e prev ofertues
17,375,781.78 lekë me TVSH.</td><td>16.Likuiduar:
Sit. 1 në vlerën 3,437,334 lekë me TVSH
Sit. 2 në vlerën 13,938,447.78 lekë me TVSH</td></tr>
<tr><td>17- Situacioni Përfundimtar
- Sit përf në vlerën
17,375,781.78 lekë pa TVSH

Vl përf e realizuar
17,375,781.78 lekë me TVSH</td><td>18.Afati i kontratës në dite
Fillimi punimeve:
13.12.2024
Përfundimi punimeve:
09.09.2025</td><td>19. Zgjatja e kontratës
---</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
OE "P.C." SHPK</td><td>Licenca MK.0899/21</td><td>Kontratë me nr. 11295 prot., datë 12.12.2024</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve
OE "BN P." SHPK</td><td>Licenca Nr.: MK.2205/7</td><td>MBZHR nr. 9640 prot., datë 22.09.2025</td></tr>
<tr><td>22.Akt Kolaudimi.
-Me akt kolaudimin me datë 21.10.2025 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "N." SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "P. C." SHPK, kolaudatori i punimeve</td><td colspan="2">23.Akt i marrjes në dorëzim:
-Me shkresën me datë 21.10.2025 është mbajtur certifikata e marrjes në dorëzim të përkohshëm, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "N." SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "P. C." SHPK, kolaudatori i punimeve "BN P." SHPK, si dhe nga grupi i marrjes në dorëzim i ngritur sipas urdhrit nr. 761, datë 08.10.2025, me përbërje: A.L., A. P., A.Ç..</td></tr>
</table>

"BN Project" SHPK.	

u konstatua si vijon:

Përshkrimi i situatës:
Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë Dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Gjirokastër, në vlerën **186,794 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr. Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
	Punime dyer dritare							-
Zëri 22 (2.383/1).	FV Dyer të brendshme druri cilësi e I-rë	m^2	18,000	50.2	50.2	50.2 m^2 (realizuar me çmim 14,279 lekë pa TVSH)	-	186,794
	Shuma në Lekë pa TVSH							**186,794**

1. Punime dyer dritare.
Zëri 22 (2.383/1). FV Dyer të brendshme druri cilësi e I-rë.
Preventivi i ndryshuar dhe situacioni përfundimtar pasqyrojnë sasinë 50.2 m^2 me çmim 18,000 lekë pa TVSH. Libreza e masave pasqyron 50.2 m2, të trajtuar në mënyrë analitike sipas ambienteve për katin përdhe, katin i parë dhe i dytë.
Nga auditimi në objekt konstatohet se, ky zë punimi "F.V Dyer të brendshme importi cilësi e I-rë" është realizuar në kundërshtim me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) dhe me kushtet e kontratës së nënshkruar, sepse materiali i përdorur për dyert nuk është dru por dyert janë prodhuar me material tamburate të rimesuara (dhe jo material dru masiv i staxhionuar (dërrasë) siç është specifikuar dhe deklaruar për t'u zbatuar nga sipërmarrësi i punimeve). Në fakt ky zë është realizuar sipas zërit 2.388/1 "F.V Dyer të brendshme tamburate të rimesuara" me çmim 14,279 lekë tëVKM Nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre". Pra sasia prej 50.2 m2 është punë e pakryer sipas kushteve të kontratës dhe specifikimeve teknike,për pasojë, vlera 186,794 lekë pa TVSH [50.2 m2 x 3,721 (18,000 lek/m2 sipas preventivit – 14,279 lek/m2 sipas faktit] është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Nga ana e zbatuesit të punimeve nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:
- ***Ligjit nr. 8402****, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 8;* - ***Udhëzimin Nr. 2****, datë 13.5.2005"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" Kreu I "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit", pika 3;* - *kontratës për punë publike me nr. 10565 prot., datë 19.11.2024]*.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve OE "P.C." SHPK, si dhe OE "B. P." SHPK në cilësinë e kolaudimit të punimvev nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:
- ***Ligjit nr. 8402****, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7;* - ***UKM Nr. 3****, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2;* -*Kontratës shërbimit me nr.*

11295 prot., datë 12.12.2024 dhe Kontratës shërbimit të kolaudimit me nr. 9640 prot., datë 22.09.2025].

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. **Znj. V. G.,** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.
2. **Z. A.A.,** në cilësinë e kolaudatorit të punimeve.

3. Kontrata për punë publike me objekt: "**Sistemim Asfaltim Rruga Taroninë, Zhulat**", me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Sistemim Asfaltim Rruga Taroninë, Zhulat".		
14.Lidhja e kontratës nr. 10408 prot., datë 13.01.2024 OE "L.T.E C." SHPK	**15.Vlera e kontratës.** Vl e prev ofertues 56,035,013.76 lekë me TVSH.	**16.Likuiduar**: Sit. 1 në vlerën 34,710,672 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 12,819,898.80 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar - Sit përf në vlerën 8,504,342.40 lekë pa TVSH Vl përf e realizuar 56,034,913.20 lekë me TVSH	**18.Afati i kontratës në dite** Fillimi punimeve: 13.02.2025 Përfundimi punimeve: 19.11.2025	**19. Zgjatja e kontratës** ---
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "Xh. & M." SHPK	Licenca MK.1322/8	Kontratë me nr. 11365 prot., datë 12.12.2024
21. Kolaudatori i punimeve OE "BN P." SHPK	Licenca Nr: MK. 2928/18	Kontratë nr. 11187 prot., datë 22.12.2025
22.Akt Kolaudimi. -Me akt kolaudimin me datë 19.01.2026 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "LTE C." SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "XH. & M." SHPK, kolaudatori i punimeve "G & L C" SHPK.	**23.Akt i marrjes në dorëzim:** -Me shkresën me datë 19.01.2026 është mbajtur certifikata e marrjes në dorëzim të përkohshëm, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "L. C." SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "X. & M." SHPK, kolaudatori i punimeve "G & L C." SHPK, si dhe nga grupi i marrjes në dorëzim i ngritur sipas urdhrit nr. ---, datë ---, me përbërje: A., F. M., A. Ç..	

u konstatua si vijon:

Përshkrimi i situatës:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë Dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Gjirokastër, në vlerën **402,158 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

1. Punime gërmimi.

Zëri 3 (3.124/1a) Gërmim dheu mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhirë.

Preventivi ofertues pasqyron volumin 300 m^3 dhe preventivi i rishikuar pasqyron volumin 463.60 m^3 gërmim dheu. Situacioni përfundimtar pasqyron 463.6 m^3 gjithsej gërmim dheu me çmim 1,800 lekë pa TVSH. Libri i masave pasqyron në mënyrë analitike 463.6 m^3gërmim.

Në fakt, nga verifikimi i librezës së masave, rezulton se është llogaritur gabim volumi prej 463.6 m^3, sepse nga verifikimet e projektit përfundimtar të zbatimit (As-Built), të kuotave të tokës, të kuotave të projektit, të paketës së shtresave dhe sipërfaqet e seksioneve tërthore, konstatohet se volumet e gërmimit janë ndryshuar.

Nga rillogaritja i (As-Built) konstatohet se midis volumeve të gërmimit të projektit të rishikuar dhe volumeve të pasqyruara në librin e masave, rezulton volum pune i kryer 300 m^3

dhe jo 463.6 m^3 për shkak të mos pasqyrimit të kuotave të ndryshuara në As built, për rrjedhojë sipërmarrësi ka përfituar më tepër **163.6 m^3** më tepër.
Sa më sipër trajtuar, nga sipërmarrësi i punimeve, është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt në vlerën**294,480 lekë pa TVSH** (163.6 m^3 x 1800 lekë).

2. Zëri 4 (3.119/a) Gërmim shkëmbi i copëtuar me ekskavator me zinxhirë 0.5 m3, shkëmb, në themele gjerësi -2m, me shkarkim në mjet.

Preventivi ofertues pasqyron volumin 600 m^3 dhe preventivi i rishikuar pasqyron volumin 797.95 m^3 gërmim dheu. Situacioni përfundimtar pasqyron 797.95 m^3 gjithsej gërmim dheu me çmim 270 lekë pa TVSH. Libri i masave pasqyron në mënyrë analitike 797.95 m^3gërmim.
Në fakt, nga verifikimi i librezës së masave, rezulton se është llogaritur gabim volumi prej 797.95 m^3, sepse nga verifikimet e projektit përfundimtar të zbatimit (As-Built), të kuotave të tokës, të kuotave të projektit, të paketës së shtresave dhe sipërfaqet e seksioneve tërthore, konstatohet se volumet e gërmimit janë ndryshuar.
Nga rillogaritja i (As-Built) konstatohet se midis volumeve të gërmimit të projektit të rishikuar dhe volumeve të pasqyruara në librin e masave, rezulton volum pune i kryer 600 m^3 dhe jo 797.95 m^3 për shkak të mos pasqyrimit të kuotave të ndryshuara në As built, për rrjedhojë sipërmarrësi ka përfituar më tepër **197.95 m^3** më tepër.
Sa më sipër trajtuar, nga sipërmarrësi i punimeve, është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt në vlerën**53,446 lekë pa TVSH** (197.95 m^3 x 270 lekë).

3. Zëri 6 (3.158/2a) Transport dheu me auto 2.0 km.

Sa më sipër trajtuar mbi rritjen e volumit prej 361.55 m3 përkatësisht: 163.6 m3 gërmim dheu, për zërin "Zëri 3 (3.124/1a) Gërmim dheu mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhirë" dhe 197.95 m3 gërmim dheu, për zërin "Zëri 4 (3.119/a) Gërmim shkëmbi i copëtuar me ekskavator me zinxhirë 0.5 m3, shkëmb, në themele gjerësi -2m, me shkarkim në mjet" nga sipërmarrësi i punimeve duhej të zbritej ky volum.
Pra, nga sipërmarrësi i punimeve, është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt në vlerën**54,232 lekë pa TVSH** (361.55 m^3 x 150 lekë).
Nga ana e zbatuesit të punimeve nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:
*- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 8; - **Udhëzimin Nr. 2**, datë 13.5.2005"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" Kreu I "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit", pika 3; - Kontratës për punë publike me nr. 10408 prot., datë 13.01.2024]*.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve OE "X. & M." SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:
*- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7; - **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2; - Kontratës së shërbimit me nr. 11365 prot., datë 13.12.2024]*.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Znj. Xh.D., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

4. Kontrata për punë publike me objekt: "**Rehabilitim i segmenteve të ndryshme rrugore**", me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "**Rehabilitim i segmenteve të ndryshme rrugore**.		
14.Lidhja e kontratës nr. 1832 prot., datë 25.02.2025 BOE "E. & I." SHPK	**15.Vlera e kontratës.** Vl e prev ofertues 26,096,656.8 lekë me TVSH.	**16.Likuiduar**: Sit. 1 në vlerën 13,691,645 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 7,667,728.8 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar - Sit përf në vlerën 4,737,282.9	**18.Afati i kontratës në dite** Fillimi punimeve:	**19. Zgjatja e kontratës** ---

lekë pa TVSH Vl përf e realizuar 26,096,656.8 lekë me TVSH.	26.03.2025 Përfundimi punimeve: 17.06.2025	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "K. 2023 C. & (IKN)" SHPK	Licenca MK.4233 Licenca MK.1019/26	Kontratë me nr. 2594 prot., datë 18.03.2025
21. Kolaudatori i punimeve OE "M. S." SHPK	Licenca Nr.: MK. 1811/11	Kontratë nr. 8953 prot., datë 25.08.2025
22.Akt Kolaudimi. -Me akt kolaudimin me datë 23.09.2025 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "E." SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "K. 2023 C." SHPK, kolaudatori i punimeve "M. S." SHPK.	**23.Akt i marrjes në dorëzim:** -Me shkresën me datë 08.10.2025 është mbajtur certifikata e marrjes në dorëzim të përkohshëm, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "E." SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "K. 2023 C." SHPK, kolaudatori i punimeve "M. S." SHPK, si dhe nga grupi i marrjes në dorëzim i ngritur sipas urdhrit nr. ---, datë --, me përbërje: A.L., A.P., A. Ç..	

u konstatua si vijon:

Përshkrimi i situatës:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë Dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Gjirokastër, në vlerën **190,143 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr. Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
	Fshati Prongji, Njësia Administrative Cepo							-
Zëri 3(3.243).	Shtresë monolite betoni C 16/20 t=12 cm	m^3	11,100	205.5	205.5	188.37	17.13	190,143
	Shuma në Lekë pa TVSH							**190,143**

1. Fshati Prongji, Njësia Administrative Cepo.

Zëri 3(3.243). Shtresë monolite betoni C 16/20 t=12 cm.

Preventivi i ndryshuar dhe situacioni përfundimtar pasqyrojnë sasinë 205.5 m^3 me çmim 11,100 lekë pa TVSH. Libreza e masave pasqyron 205.5 m^3, të trajtuar në mënyrë analitike.

Nga auditimi në objekt konstatohet se, ky zë punimi është realizuar në volumin**188.37**m3 (685 ml x 2.5 m x 0.11 m) dhe jo në volumin **205.5** m3 siç është situacionuar.

Pra volumi prej 17.13 m^3 është punë e pakryer sipas kushteve të kontratës dhe specifikimeve teknike,për pasojë, vlera **190,143 lekë pa TVSH** [17.13 m^2 x 11,100 lekë] është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Nga ana e zbatuesit të punimeve nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

*- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 8; - **Udhëzimin Nr. 2**, datë 13.5.2005"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" Kreu I "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit", pika 3; - Kontratës për punë publike me nr. 1832 prot., datë 25.02.2025].*

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve OE "K. 2023 C. & (IKN)" SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

*- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7; - **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin*

e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2; - Kontratës së shërbimit me nr. 2594 prot., datë 18.03.2025].

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. B. D., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

Konkluzion mbi zbatimin e kontratave:

Nga Auditimi i 4 (katër) kontratave për punë publike në vlerën 119,586,084 me TVSH, u konstatuan problematikat si vijon:

*►Në **4 (katër)** raste, rezultuan zëra pune të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, në vlerën **1,203,695 lekë pa TVSH**, në mospërputhje me **Ligjin nr. 8402**, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, **Kreu III, neni 7**, si dhe Kontratat përkatëse të zbatimit, **respektivisht:***

***1. Vlera 424,600 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike me nr. 667 prot., datë 22.01.2025 me objekt: "Rivitalizimi i hapësirave rreth pallatit të sportit" të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastër dhe, sipërmarrësit të punimeve OE "E. C. C." SHPK.*

***2. Vlera 186,794 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike me nr. 10565 prot., datë 19.11.2024 me objekt: "Rikonstruksion dhe përmirësim i efiçencës energjitike në shkollën "Muhamet Gjollesha", Lazarat" të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastër dhe, sipërmarrësit të punimeve OE "N." SHPK.*

***3. Vlera 402,158 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike me nr. 10408 prot., datë 13.01.2024 me objekt: "Sistemim Asfaltim Rruga Taroninë, Zhulat" të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastër dhe, sipërmarrësit të punimeve OE "L.T.E C." SHPK.*

***4. Vlera 190,143 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë me nr. 1832 prot., datë 25.02.2025 me objekt: "Rehabilitim i segmenteve të ndryshme rrugore" të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastër dhe, sipërmarrësit të punimeve BOE "E." SHPK & OE "I." SHPK.*

Shënim: Kontratat për punë publike në shumën 123,965,368.58 lekë me TVSH, përkatësisht:

1. "Rikonstruksioni godinës egzistues dhe shkallës emergjencës dhe dhomës tekniken shkollën 9 vjeçare Urani Rumbo" me zbatues shoqërinë "E. C. C." SHPK & "C." SHPK" me vlerë kontrate 50,466,731.80 lekë me TVSH.
2. "Rikonstruksioni godinës ekzistues dhe shkallës emergjencës dhe dhomës tekniken shkollën 9-vjeçare Urani Rumbo" me zbatues BOE "E. B." SHPK & "I." SHPK me vlerë kontrate123,965,368.58 lekë me TVSH.

Do të auditohen nga KLSh në auditimin e radhës, sepse punimet e ndërtimit sipas projekt-preventivit janë në proces zbatimi dhe përfundojnë në vitin 2026, pra jashtë periudhës së auditimit.

(Për sa më sipër, pas njohjes me projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Bashkia Gjirokastër, nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit).

2.5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

- Auditim mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit.
- Auditimi mbi përllogaritjen dhe arkëtimin e taksave për pajisje me leje ndërtimi.

Në zbatim të pikës së Programit të Auditimit: "Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit", u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Dokumentacioni në sistemin *"e-lejet"*;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e urbanistikës;
- Dokumentacion i disponueshëm në drejtorinë e financës;
- Dokumentacion i disponueshëm në drejtorinë juridike;
- Dokumente të tjera nga arkiva, etj.

Bashkia Gjirokastër ka të miratuar **Planin e Përgjithshëm Vendor** (këtu e në vazhdim PPV) dhe **Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit** me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (këtu e në vazhdim KKT) nr. 01, datë 08.02.2017, ku përfshihen Plani i Zhvillimit, Rregullorja e PPV-së, Strategjia Territoriale, Vlerësim Strategjik Mjedisor, si dhe hartat e përdorimit të tokës sipas kategorive, ndarja e territorit në sisteme, infrastruktura e transportit, fazat e zbatimit të PPV-së, vizioni strategjik, ndarja e territorit në zona dhe njësi.

Auditimi konsiston në këto fusha:

- Dhënia e lejes së zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura;
- Dhënia e lejes së ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi, zbatimi i treguesve parametrikë;
- Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë;
- Dhënia e certifikatës së përdorimit.

<u>Lejet e ndërtimit / përdorimit për periudhën 01.01.2025 - 31.12.2025</u>

Referuar të dhënave në sistemin elektronik *e-lejet* për Bashkinë Gjirokastër, rezulton se për afatin e auditimit **01.01.2025 deri në 31.12.2025**, ka pasur **141** aplikime në sistem për lloje të ndryshme lejesh, të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, sipas tipologjive të lejeve të aplikuara:

Tabela nr. 1: *Aplikimet në sistemin e-lejet për periudhën 01.01.2025 - 31.12.2025*

Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar	Proces
Leje zhvillimi	20	5	14	1
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m^2	2	2	0	0
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2	1	0	1	0
Leje ndërtimi për shtesë në nd. ekzistues me sip. deri në 250 m^2	10	3	7	0
Leje ndërtimi për shtesë në nd. ekz. me sip. më të madhe se 250 m^2	1	0	1	0
Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	13	7	6	0
Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	17	7	8	2
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	44	16	28	0
Leje rind., rikonst. & ripar. të nd. së dëmt. pa shtim / ndrysh. funk.	-	-	-	-
Certifikatë përdorimi	3	1	2	0
Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	3	2	1	0
Leje për ndryshim funksioni	9	4	5	0
Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	-	-	-	-

Njoftim fillim punimesh	11	6	2	3
Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	3	1	2	0
Leje infrastrukture	4	4	0	0

Burimi: *DU, Bashkia Gjirokastër* ***Përpunoi:*** *Grupi i auditimit*

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Urbanistikës (këtu e në vazhdim DU) e Bashkisë Gjirokastër, si dhe në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e evidentuara në tabelën e mëposhtme:

Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të vogël se 250 m^2				
Nr.	**Objekti**	**Nr. vendimi**	**Data**	**Zhvilluesi**
1	Mur rrethimi	42	05.08.2025	Sh. A.
	Adresa: *Lagjja "Zinxhira", Bashkia Gjirokastër*			
2	Magazinë produktesh bujqësore	75	03.09.2025	L. Ç.
	Adresa: *Fshati "Arshi Lengo", Bashkia Gjirokastër*			

Certifikata përdorimi				
Nr.	**Objekti**	**Nr. aplikimit**	**Data**	**Zhvilluesi**
3	Ndërtim industrial magazinë	AN221120240058	21.01.2025	B. S.
	Adresa: *Rruga Nacionale Gjirokastër – Tepelenë*			
4	Ndërtim industrial magazinë industriale + rrethim	AN171220240064	10.03.2025	"A.G." ShPK
	Adresa: *Rruga Nacionale Gjirokastër – Tepelenë, KM 2*			
5	Rikonstruksion banese dhe rehabilitim i sheshit përreth	AN301220240023	03.04.2025	S. L.
	Adresa: *Lagjja "Partizani ", Gjirokastër*			
6	Rikonstruksion objekti me ndryshim funksioni	AN220320250005	08.04.2025	K. A.
	Adresa: *Lagjja "18 Shtatori", Gjirokastër*			

Nga auditimi i rasteve të mësipërme, janë konstatuar problematikat si më poshtë vijon:

➢ Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit është konstatuar se në të gjitha rastet e audituara, pra në 6 (gjashtë) raste, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë. Gjithashtu, në 3 (tre) raste është konstatuar se shqyrtimi i aplikimeve është kryer me afate të tejzgjatura. Më konkretisht, këto parregullsi janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m^2 me objekt ***"Mur rrethimi"***, miratuar me Vendim nr. 42, datë 05.08.2025, në favor të subjektit "Sh.A." PF, me adresë në lagjen "Zinxhira", Bashkia Gjirokastër, me problematika si më poshtë vijon:

- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 103 ditësh pune;

2. Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m^2 me objekt ***"Magazinë produktesh bujqësore"***, miratuar me Vendim nr. 75, datë 03.09.2025, në favor të subjektit "L. Ç." PF, me adresë në fshatin "Arshi Lengo", Bashkia Gjirokastër, me problematika si më poshtë vijon:

- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 84 ditësh pune;

- Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungojnë: **i.** plani i piketimit të strukturës; **ii.** plani i organizimit të punimeve; **iii.** plani i sistemimeve; **iv.** plani i mbulimit nuk është i plotësuar me kuotat dhe pjerrësitë e çatisë; **v.** fasadat teknike nuk janë të materializuara, kuotuara dhe dimensionuara;
- Mungon projekti i mbrojtjes nga zjarri, së bashku me dokumentacionin shoqërues (relacioni teknik, deklarata dhe polica e përgjegjësisë profesionale, licenca);
- Mungon projekti i auditimit të efiçencës së energjisë, ose së paku, deklarata sipas Shtojcës nr. 1, sipas formatit të miratuar në VKM-në nr. 274, datë 04.05.2023 *"Për përcaktimin e kategorive të tjera të ndërtesave që përjashtohen nga Ligji nr. 116/2016 "Për performancën e energjisë në ndërtesa"*;

3. Certifikatë përdorimi për objektin ***"Ndërtim industrial magazinë"***, miratuar me Vendim nr. 07, datë 21.01.2025, në favor të subjektit "B.S." PF, me adresë në rrugën nacionale Gjirokastër – Tepelenë, me problematika si më poshtë vijon:
- Mungojnë deklaratat e përgjegjësisë profesionale për hartimin e akteve të kontrollit nga subjekti / personi fizik / juridik që i ka hartuar, sipas fazave të grafikut të punimeve dhe afatit të lejes;
- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë së ndërtuesit për dëmtime të objektit të përfunduar;
- Mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane;
- Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit, i cili duhet të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve;

4. Certifikatë përdorimi për objektin ***"Ndërtim industrial magazinë industriale + rrethim"***, miratuar me Vendim nr. 19, datë 10.03.2025, në favor të subjektit "A. G." ShPK, me adresë në rrugën nacionale Gjirokastër – Tepelenë, KM 2, me problematika si më poshtë vijon:
- Shqyrtimi i aplikimit për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit (AN290420250128) është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 102 ditësh pune;
- Mungojnë dy prej akteve të kontrollit sipas fazave të ndërtimit, më konkretisht: a. "Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues" dhe ç. "Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin. Gjithashtu, mungojnë deklaratat e përgjegjësisë profesionale për hartimin e këtyre akteve;
- Akti i kontrollit ç. "Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin" nuk është konfirmuar nga funksionarët e Bashkisë Gjirokastër;
- Mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane;
- Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit, i cili duhet të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve;

5. Certifikatë përdorimi për objektin ***"Rikonstruksion banese dhe rehabilitim i sheshit përreth"***, miratuar me Vendim nr. 30, datë 03.04.2025, në favor të subjektit "S. L." PF, me adresë në lagjen "Partizani ", Gjirokastër, me problematika si më poshtë vijon:
- Mungojnë katër nga gjashtë aktet e kontrollit gjatë zbatimit të punimeve. Në sistemin elektronik të lejeve është ngarkuar akti i kontrollit për përfundimin e karabinasë për të gjithë objektin dhe akti për përfundimin e sistemimit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, ndërkohë që mungojnë aktet për: **i.** ngritjen e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues; **ii.** piketimi i strukturës; **iii.** përfundimin e themeleve dhe kuotës 0.00; **iv.** përfundimin e fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik. Gjithashtu mungojnë deklaratat e përgjegjësisë profesionale për hartimin e këtyre akteve, përveç aktit për përfundimin e karabinasë për të gjithë objektin;

- Mungon vërtetimi nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, i cili vërteton se objekti është marrë në dorëzim. Në sistemin elektronik të lejeve është ngarkuar një kopje e librezës në favor të subjektit "E. T." dhe një kopje e mandat-pagesës mujore. Këto dokumente nuk i kanë të gjithë elementët e nevojshëm për të identifikuar nëse objekti për të cilin janë paguar këto fatura është i njëjtë me objektin nën shqyrtim;
- Mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane;
- Mungon plani i vendosjes së objektit të miratuar;
- Mungon kontrata midis zhvilluesit dhe shoqërisë ndërtuese;
- Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit, i cili duhet të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve;
- Mungon dokumenti që vërteton ndërlidhjen midis përfituesit të lejes së ndërtimit dhe përfituesit të certifikatës së përdorimit. Leja e ndërtimit për këtë objekt është miratuar në favor të znj. Ë. T.. Certifikata e përdorimit është miratuar në favor të z. S. L., znj. V. T., z. Q.T.. Në sistemin elektronik të lejeve nuk është ngarkuar asnjë dokumentacion në lidhje me kalimin e të drejtave të pronësisë / zhvillimit të këtij objekti nga përfituesi i lejes së ndërtimit tek përfituesit e certifikatës së përdorimit;

6. Certifikatë përdorimi për objektin ***"Rikonstruksion objekti me ndryshim funksioni"***, miratuar me Vendim nr. 33, datë 08.04.2025, në favor të subjektit "K. A." PF, me adresë në lagjen "18 Shtatori", Gjirokastër, me problematika si më poshtë vijon:
- Një pjesë e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve nuk është i nënshkruar elektronikisht, si: akti i kontrollit përfundimtar; akti i kolaudimit; deklarata e përputhshmërisë së mbikëqyrësit të punimeve; fotot e objektit; kontrata e sipërmarrjes midis zhvilluesit dhe subjektit ndërtues; licencat e subjektit ndërtues, mbikëqyrësit të punimeve dhe kolaudatorit; relacioni i mbikëqyrësit të punimeve; etj.

<u>Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me:</u>
- Ligjin nr. 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar, neni 39; neni 44, pika 2;
- VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"*, i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika ç), e), ë), g); neni 15, pika 1/1, nënpika i), ii), iii), iv), v); neni 20, pika 2, nënpika a); neni 21; neni 27/2, pika 1, nënpika e), ë), g), gj), h), i), j), l), ll); neni 45/1, pika 3.

Për gjetjet e konstatuara në lidhje me procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit të trajtuara më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
- **Z. F.G.,** me funksion Kryetar i Bashkisë Gjirokastër *(për rastet 1-6)*;
- **Znj. B.D.,** me funksion drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës *(për rastet 1-6)*;
- **Znj. A.L.,** në cilësinë e kontrollueses në sistemin *e-lejet (për rastet 1-6)*;
- **Z. F. M.,** në cilësinë e nëpunësit në sistemin *e-lejet (për rastet 1-6)*.

➢ Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, është konstatuar se në 1 rast (për lejen e ndërtimit me objekt *"Magazinë produktesh bujqësore"*, miratuar me Vendim nr. 75, datë 03.09.2025, në favor të subjektit "L. Ç." PF), Drejtoria e Urbanistikës, Bashkia Gjirokastër nuk ka kërkuar / respektuar mendimin e të gjithë autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Gjatë shqyrtimit të këtij aplikimi, Drejtoria e Urbanistikës nuk ka kërkuar mendimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), Agjencisë së Eficencës së Energjisë (AEE), Policisë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe për Shpëtimin (PMNZSH), veprim ky në kundërshtim me nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores*

së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, pika 6. Gjithashtu, Drejtoria e Urbanistikës është mjaftuar me miratim në heshtje nga ana e Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, edhe pse në dispozitat ligjore specifikohet se kjo drejtori nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë / kartelat e pasurive.

Për gjetjet e konstatuara në lidhje me mendim-marrjen nga autoritetet që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, ngarkohen me përgjegjësi:
- **Z. F.G.,** me funksion Kryetar i Bashkisë Gjirokastër;
- **Znj. B.D.,** me funksion drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës;
- **Znj. A.L.,** në cilësinë e kontrollueses në sistemin *e-lejet*;
- **Z. F.M.,** në cilësinë e nëpunësit në sistemin *e-lejet*.

➢ Nga auditimi i procedurave të miratimit të certifikatave të përdorimit është konstatuar se, në 3 (tre) raste (nga katër raste të audituara), Drejtoria e Urbanistikës në bashkëpunim me IMTV nuk kanë marrë të gjitha masat për kryerjen e verifikimeve përpara pajisjes me certifikatë përdorimi. Më konkretisht, këto parregullsi kanë të bëjnë me:

3. Certifikatë përdorimi për objektin ***"Ndërtim industrial magazinë"***, miratuar me Vendim nr. 07, datë 21.01.2025, në favor të subjektit "B.S." PF, me adresë në rrugën nacionale Gjirokastër – Tepelenë, me problematika si më poshtë vijon:
- Objekti është vendosur në përdorim përpara miratimit të certifikatës së përdorimit. Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve konstatohet se objekti është vendosur në përdorim përpara miratimit të certifikatës së përdorimit. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 42 të Ligjit 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 2, si dhe është i dënueshëm sipas përcaktimeve të nenit 52 të këtij ligji, pika 1, nënpika f);

5. Certifikatë përdorimi për objektin ***"Rikonstruksion banese dhe rehabilitim i sheshit përreth"***, miratuar me Vendim nr. 30, datë 03.04.2025, në favor të subjektit "S. L." PF, me adresë në lagjen "Partizani ", Gjirokastër, me problematika si më poshtë vijon:
- Objekti është vendosur në përdorim përpara miratimit të certifikatës së përdorimit. Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve konstatohet se objekti është vendosur në përdorim përpara miratimit të certifikatës së përdorimit. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 42 të Ligjit 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 2, si dhe është i dënueshëm sipas përcaktimeve të nenit 52 të këtij ligji, pika 1, nënpika f);
- Zhvilluesi dhe ndërtuesi nuk i kanë përfunduar punimet brenda afatit të përcaktuar në lejen e ndërtimit. Zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi me nr. 35, datë 15.12.2017. Nisja e fillimit të punimeve është konfirmuar në datë 30.04.2018. Referuar lejes së ndërtimit, afati për përfundim e punimeve është 24 muaj, pas konfirmimit të fillimit të punimeve, pra deri në datë 30.04.2020. Referuar aktit të kontrollit nr. 6 *"Përfundimi i sistemimit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturat publike ekzistuese (akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit)"*, konstatohet se punimet kanë përfunduar në datë 28.07.2020, në tejkalim të grafikut të punimeve. Nga ana e Drejtorisë së Urbanistikës nuk janë marrë masa për të bashkëpunuar me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, me qëllim kryerjen e verifikimeve për tejkalimin e afatit të përfundimit të punimeve, në zbatim të nenit 42 të Ligjit 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 1 dhe nenit 52 të këtij ligji, pika 1, nënpika dh), ose së paku ky informacion nuk është pasqyruar në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve;

6. Certifikatë përdorimi për objektin ***"Rikonstruksion objekti me ndryshim funksioni"***, miratuar me Vendim nr. 33, datë 08.04.2025, në favor të subjektit "K.A." PF, me adresë në lagjen "18 Shtatori", Gjirokastër, me problematika si më poshtë vijon:

- Zhvilluesi dhe ndërtuesi nuk i kanë përfunduar punimet brenda afatit të përcaktuar në lejen e ndërtimit. Zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi me nr. 86, datë 09.09.2024. Nisja e fillimit të punimeve është konfirmuar në datë 17.10.2024. Referuar lejes së ndërtimit, afati për përfundim e punimeve është 10 javë, pas konfirmimit të fillimit të punimeve, pra deri në datë 26.10.2024. Referuar aktit të kontrollit përfundimtar marrim informacionin se punimet kanë përfunduar në datë 08.01.2025, në tejkalim të grafikut të punimeve. Nga ana e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor nuk janë marrë masa për kryerjen e inspektimeve dhe nxjerrjen e vendimeve përkatëse (vendim për pezullimin e punimeve; vendim për dënim me masë administrative gjobë), ose së paku ky informacion nuk është pasqyruar në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve. Nga ana e IMTV nuk janë marrë masa për mos-përfundimin në afat të punimeve, ndaj zhvilluesit, sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika dh).

Për gjetjet e konstatuara në lidhje me procedurat e miratimit të certifikatave të përdorimit të trajtuara më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
- **Z. F.G.,** me funksion Kryetar i Bashkisë Gjirokastër *(për rastet 3, 5, 6)*;
- **Znj. B.D.,** me funksion drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës *(për rastet 3, 5, 6)*;
- **Znj. A.L.,** në cilësinë e kontrollueses në sistemin *e-lejet (për rastet 3, 5, 6)*;
- **Z. F.M.,** në cilësinë e nëpunësit në sistemin *e-lejet (për rastet 3, 5, 6)*.

Konkluzion i përgjithshëm mbi miratimin e lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit:

1. Nga auditimi i procedurave për miratimin e lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit rezultoi se në të gjitha rastet e audituara (6 raste) dokumentacioni teknik dhe administrativ nuk është i plotë dhe nuk përmbush kërkesat e legjislacionit në fuqi. U konstatuan mangësi në projektet arkitektonike dhe dokumentacionin teknik shoqërues, mungesë të projekteve të mbrojtjes nga zjarri, auditimit të eficiencës së energjisë, akteve të kontrollit sipas fazave të ndërtimit, deklaratave të përgjegjësisë profesionale, policave të sigurimit, projekteve të mirëmbajtjes së objektit, akteve për menaxhimin e mbetjeve urbane, kontratave dhe dokumenteve që vërtetojnë kalimin e të drejtave nga përfituesi i lejes së ndërtimit tek përfituesi i certifikatës së përdorimit. Gjithashtu, u evidentuan raste të dokumentacionit të panënshkruar elektronikisht, mungesë të dokumenteve që provojnë marrjen në dorëzim të objektit nga operatorët përkatës, si dhe akte kontrolli të pakonfirmuara nga autoriteti përgjegjës. Në 3 raste, shqyrtimi i aplikimeve është kryer me tejkalim të afateve ligjore, duke evidentuar mangësi edhe në respektimin e afateve procedurale gjatë trajtimit të kërkesave.

2. Nga auditimi i procedurave për miratimin e lejeve të ndërtimit rezultoi se në 1 nga rastet e audituara nuk janë kërkuar dhe respektuar mendimet e të gjitha autoriteteve përgjegjëse. Konkretisht, procedura është zhvilluar duke marrë në konsideratë miratimin në heshtje të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, pa u siguruar dokumentacioni mbi statusin e pronësisë, si dhe pa u kërkuar mendimet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Agjencisë së Efiçencës së Energjisë dhe Policisë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi, duke mos garantuar shqyrtimin e plotë ndërinstitucional të aplikimit për leje ndërtimi.

3. Nga auditimi i procedurave për miratimin e certifikatave të përdorimit rezultoi se në 3 nga 4 rastet e audituara, Drejtoria e Urbanistikës, në bashkëpunim me IMTV, nuk ka kryer verifikimet e plota dhe nuk ka marrë të gjitha masat e parashikuara nga legjislacioni përpara pajisjes së objekteve me certifikatë përdorimi. U konstatuan raste të vendosjes në përdorim të objekteve përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, si dhe raste kur punimet janë përfunduar përtej afateve të përcaktuara në lejet e ndërtimit, pa u marrë nga IMTV masat administrative përkatëse, si inspektimi në terren, pezullimi i punimeve apo vendosja e sanksioneve administrative.

(Për sa më sipër, pas njohjes me projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Bashkia Gjirokastër, nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit)

2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).

- Auditim mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi dhe mbi procedurat e ndjekura lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimkt dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit.

Në zbatim të pikës 6 (gjashtë) *"Auditim mbi organizimin dhe funksionimin eInspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV),për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025"*, të programit të auditimit nr. 515/2 prot., datë 14.05.2026, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Procesverbalet e konstatimit të kundërvajtjes;
- Vendimet e masave administrative (gjobave);
- Vendimet e pezullimeve të punimeve;
- Vendimet për prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme;
- Planet mujore, tremujore dhe/ose vjeçare të punës;
- Dokumentacioni i IMTV-së në lidhje me gjobat e vendosura, arkëtimet, urdhrat ekzekutivë, vendimet e gjykatës etj;
- Dokumentacioni financiar në lidhje me kontabilizimin dhe arkëtimet e gjobave;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga IMTV dhe Drejtoria e Financës.

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) ushtron aktivitet bazuar në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 *"Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme"*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 *"Për kundërvajtjet administrative"*;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 *"Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore"*;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 *"Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël".*

Për kryerjen e aktivitetit të tij, IMTV, Bashkia Gjirokastër disponon vetëm një automjet për nevoja të inspektimit ditor. Për ekzekutimin e vendimeve të prishjes, Bashkia Gjirokastër nuk disponon mjet. Për ekzekutimin e këtyre vendimeve, IMTV, Bashkia Gjirokastër ka kërkuar bashkëpunimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, dhe përputhshmërisë me dispozitat ligjore, konstatohet se:

2.6.1 Mbi strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor:

Referuar strukturës organizative të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2025 dhe informacionit të kërkuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore**,** në lidhje me organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit Vendor, rezulton se: është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar. Struktura e miratuar e IMTV ka në përbërjen e saj 4 pozicione pune, nga të cilët 1 Kryeinspektor dhe 3 inspektorë. Për vitin 2025, struktura organizative e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor është miratuar me Vendimin nr. 85, datë 12.12.2024 *"Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2025"*.

Për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025, IMTV ka pasur në strukturën e tij, punonjësit sipas tabelës në vijim:

Tabela nr. 1: *Struktura e IMTV, Bashkia Gjirokastër*

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni	Lloji i arsimit/dega	Data e emërimit	Data e largimit
1	E.Sh.	Kryeinspektor	Matematikë / Fizikë	12.10.2021	Vijon
2	A. M.	Inspektor	Arkitekturë	21.04.2020	Vijon
3	K.N.	Inspektor	Kontabilitet / Financë	25.03.2022	Vijon
4	E.G.	Inspektor	Kontabilitet / Financë	11.06.2025	Vijon
5	G.Z.	Inspektor	Kimi / Biologji	06.12.2024	11.06.2025

Burimi: *Bashkia Gjirokastër* ***Përgatiti:*** *Grupi i auditimit*

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me arsimin e nevojshëm profesional rezulton se në IMTV Bashkia Gjirokastër, para periudhës objekt auditimi dhe gjatë periudhës në auditim, janë punësuar punonjës që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 11 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, i cili përcakton se:

Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.

Në IMTV Bashkia Gjirokastër janë punësuar punonjës me profil arsimor si: Matematikë / Fizikë; Kontabilitet / Financë; Kimi / Biologji. Mungesa e stafit të kualifikuar sipas profilit përkatës, përbën element risku për cilësinë e kryerjes së punës të IMTV-së, për përcaktimin dhe përshkrimin teknik në aktet e kontrollit respektive të situatave të konstatuara gjatë inspektimit në terren.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. F.G., me funksion Kryetar i Bashkisë Gjirokastër;

- Znj. M. Sh., me funksion Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me plotësimin e strukturës me numrin minimal të nevojshëm të punonjësve, konstatohet se IMTV në Bashkinë Gjirokastër nuk ka në strukturën e tij numrin e nevojshëm të personelit (aktualisht ka 4 punonjës në strukturë), në kundërshtim me përcaktimet e nenit 14 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, i cili përcakton se:

Autoritetet e qeverisjes vendore sigurojnë që për kryerjen e funksioneve të përcaktuara në këtë ligj, të kenë profesionistë të kualifikuar dhe me eksperiencë pune në fushat përkatëse. Numri minimal i profesionistëve që duhet të sigurojë çdo njësi e qeverisjes vendore

*përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, në bazë të numrit të popullsisë së njësisë së qeverisjes vendore, dhe është në çdo rast jo më i vogël se **6 profesionistë**.*

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. F.G., me funksion Kryetar i Bashkisë Gjirokastër.

2.6.2 Mbi planifikimin e inspektimeve dhe raportimin periodik:

2.6.2.1 Mbi planifikimin e inspektimeve:

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor duhet t'i ushtrojë detyrat e tij funksionale në bazë të planeve mujore, tremujore dhe / ose vjeçare të punës, sipas planifikimit, i cili hartohet nga kryeinspektori i IMTV-së, në zbatim të VKM-së nr. 894, datë 01.11.2015, *"Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore",* nënpika b.ii. Nga grupi i auditimit është kërkuar dokumentacion dhe informacion mbi hartimin e tyre, në mënyrë periodike dhe përcjelljen tek strukturat e varësisë.

Nga IMTV Bashkia Gjirokastër janë vendosur në dispozicion të grupit të auditimit planet e punës për periudhën Janar 2025 – Maj 2025, ndërkohë që për periudhën Qershor 2025 – Dhjetor 2025 planet e punës nuk janë hartuar.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. E.Sh., me funksion kryeinspektor i IMTV.

6.2.2 Mbi raportimin periodik:

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor duhet të përgatisë dhe t'i japë të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, si p.sh. vendimet e marra ndaj kundërvajtjeve të konstatuara (pezullim, gjobë, prishje të objektit të kundërligjshëm), kallëzimet penale, si dhe kërkesat për heqje të licencave profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, sipas përcaktimeve të nenit 5 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* pika f). Nga ana e IMTV nuk është vendosur në dispozicion asnjë raportim për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025. Si konstatohet, raportimi nuk është kryer, për të gjithë periudhën nën auditim.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. E.Sh., me funksion kryeinspektor i IMTV.

2.6.3 Mbi ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit të pezullimit të punimeve:

Vendimi për pezullimin e punimeve në ndërtim nxirret në rastin kur është i nevojshëm një afat kohor paraprak, për marrjen e vendimit, për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe të urbanistikës, ose për marrjen e vendimit për prishjen e objektit. Pezullimi i punimeve në ndërtim ka afat deri në 60 ditë.Një vendim i tillë merret në rastet kur:

- subjekti i kontrolluar mungon në objekt ose nuk i paraqet grupit të inspektimit dokumentacionin teknik e/ose ligjor të punimit/ndërtimit;
- mungojnë masat e sigurimit teknik në objekt dhe mjetet mbrojtëse të jetës së punëtorëve;
- plotësimi i dokumentacionit tekniko-ligjor kërkon proces miratimi nga autoriteti përgjegjës i planifikimit;
- vendimi i pezullimit të punimeve të ndërtimit për plotësimin e dokumentacionit teknik e/ose ligjor ka rezultuar i pamjaftueshëm dhe subjekti ndërtues kërkon zgjatjen e afatit, duke e argumentuar në mënyrë zyrtare.

Nga ana e kryeinspektorit janë nxjerrë shtatë vendime për pezullimin e punimeve. Nga auditimi i shtatë procedurave të mbajtura nga IMTV përgjatë vitit 2025, si dhe referuar përcaktimeve të mësipërme, konstatohet se:

- Në 3 (tre) raste është nxjerrë vendimi i pezullimit të punimeve, kur ky vendim nuk parashikohet në dispozitat ligjore, në raport me shkeljen e konstatuar. Këto kundërvajtje kanë të bëjnë me punime pa leje, kur kundërvajtësi ka qenë i pranishëm. Kjo parregullsi është konstatuar në rastet e mëposhtme:

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja e konstatuar
	Nr. serie	Data		
1	000092	21.03.2025	N.Gj.	Ndërtim pa leje me blloqe betoni në një sipërfaqe 3.2 m x 18 msi dhe mbulesë sanduiçi 7.2 me 3.2
2	000093	12.05.2025	N. M.	Punime pa njoftim si shtresa betoni të hollë dhe bordura betoni
3	000095	02.06.2025	H.L.	Ndërtim pa leje si objekt me konstruksion metalik dhe mbuluar me panele sanduiçi e gjitha ndërtuar mbi një platformë betoni me përmasa 10.8m x7.25m.04 m dhe lartësi 2.7 metra

- Në 1 (një) rast, nuk është nxjerrë vendimi për pezullimin e punimeve, kur ky vendim do të duhej të ishte nxjerrë, në raport me shkeljen e konstatuar. Kjo kundërvajtje ka të bëjë me shkeljen e afatit të përfundimit të punimeve. Kjo parregullsi është konstatuar në rastin e mëposhtëm:

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja e konstatuar
	Nr. serie	Data		
1	000097	09.09.2025	"A. G." ShPK	Shtyrje e afatit të lejes

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. E.Sh, me funksion kryeinspektor i IMTV.

<u>2.6.4 Mbi ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit të dënimit me masë administrative gjobë:</u>
Vendimi për dënimin e kundërvajtësit me masë administrative gjobë merret për të gjitha rastet kur konstatohen shkelje në veprimtarinë ndërtimore. Ky vendim bashkë-shoqëron gjithmonë vendimin për pezullimin e punimeve dhe vendimin për prishjen e objektit të kundërligjshëm. Vlera e masës administrative përcaktohet sipas dispozitave ligjore, ndërsa për objektet e ndërtuar pa marrë paraprakisht miratimin e autoriteteve vendore ose qendrore, gjoba përcaktohet në raport të drejtë me vlerën e investimit.
Nga ana e kryeinspektorit të IMTV, Bashkia Gjirokastër janë nxjerrë në total <u>7 (shtatë) vendime</u> për dënimin e kundërvajtësit me masë administrative gjobë, me vlerë totale **2,650,000 lekë**. Nga auditimi i përllogaritjes së vlerës së masës administrative është konstatuar se është llogaritur e pasaktë në 5 (pesë) raste. Rastet kur vlera e masës administrative është llogaritur e gabuar janë si vijon:

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja	Vlera e gjobës
	Nr. serie	Data			
1	000091	17.03.2025	N. B.	Ndërtim pa leje si plinta betoni, kadron druri si dhe tra lidhës në krye të kadroneve	500,000 lekë
Vlera e masës administrative nuk është përllogaritur e saktë, pasi, sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika e), marrim informacionin se: *"kryerja e punimeve pa leje dënohet me **gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje**, por në çdo rast jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi"*. Gjoba e vendosur nga kryeinspektori është një vlerë, e cila nuk është e parashikuar në dispozitat ligjore. Vlera e saktë e masës administrative do të ishte shumatorja e punimeve të kryera pa leje, referuar përcaktimeve të manualit të punimeve (e-albania), në raport me volumet e punimeve. Duke qenë se volumet e punimeve nuk janë përshkruar në konstatimin e IMTV, nuk është e mundur që nga ana e grupit të auditimit të përllogaritet vlera e saktë e gjobës.					

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja	Vlera e gjobës
	Nr. serie	Data			
2	000092	21.03.2025	N.Gj.	Ndërtim pa leje me blloqe betoni në një sipërfaqe 3.2 m x 18 msi dhe mbulesë sanduiçi 7.2 me 3.2	500,000 lekë
Vlera e masës administrative nuk është përllogaritur e saktë, pasi, sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika e), marrim informacionin se: *"kryerja e punimeve pa leje dënohet me **gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje**, por në çdo rast jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi"*. Për këtë rast, përllogaritja e saktë e vlerës së masës administrative do të ishte shumatorja e vlerës së investimit për ndërtimin e murit dhe mbulesën, më konkretisht: (3.2 m * 1.8 m * 0.2 m * 12,602.94 lekë/m^3) + (7.2 m * 3.2 m * 3,595.78 lekë/m^2) = 97,365 lekë. ***Vlera e gjobës e vendosur nga IMTV është 402,635 lekë më e madhe se ajo e llogaritur nga grupi i auditimit.*** ***Shënim:*** Vlerat për njësi janë marrë nga manuali i çmimeve në portalin *e-albania*.					

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja	Vlera e gjobës
	Nr. serie	Data			
3	000094	26.05.2025	D.C.	Ndërtimi i një ballkoni me parapet me mur me tullë me dimensione 3.8m x 1.9 m dhe lartësi 1.1 m i dhe mbuluar me konstruksion metalik	500,000 lekë
Vlera e masës administrative nuk është përllogaritur e saktë, pasi, sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika e), marrim informacionin se: *"kryerja e punimeve pa leje dënohet me **gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje**, por në çdo rast jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi"*. Gjoba e vendosur nga kryeinspektori është një vlerë, e cila nuk është e parashikuar në dispozitat ligjore. Vlera e saktë e masës administrative do të ishte shumatorja e punimeve të kryera pa leje, referuar përcaktimeve të manualit të punimeve (e-albania), në raport me volumet e punimeve. Duke qenë se volumet e punimeve nuk janë përshkruar në konstatimin e IMTV, nuk është e mundur që nga ana e grupit të auditimit të përllogaritet vlera e saktë e gjobës.					

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja	Vlera e gjobës
	Nr. serie	Data			
4	000095	02.06.2025	H.L.	Ndërtim pa leje si objekt me konstruksion metalik dhe mbuluar me panele sanduiçi e gjitha ndërtuar mbi një platformë betoni me përmasa 10.8m x7.25m.04 m dhe lartësi 2.7 metra	500,000 lekë
Vlera e masës administrative nuk është përllogaritur e saktë, pasi, sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika e), marrim informacionin se: *"kryerja e punimeve pa leje dënohet me **gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje**, por në çdo rast jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi"*. Gjoba e vendosur nga kryeinspektori është një vlerë, e cila nuk është e parashikuar në dispozitat ligjore. Vlera e saktë e masës administrative do të ishte shumatorja e punimeve të kryera pa leje, referuar përcaktimeve të manualit të punimeve (e-albania), në raport me volumet e punimeve. Duke qenë se volumet e punimeve nuk janë përshkruar në konstatimin e IMTV, nuk është e mundur që nga ana e grupit të auditimit të përllogaritet vlera e saktë e gjobës.					

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja	Vlera e gjobës
	Nr. serie	Data			
5	000096	09.07.2025	E.R.	Shkelje e projektit të miratuar nga 8m x 7m në 8.34m x7m	500,000 lekë
Vlera e masës administrative nuk është përllogaritur e saktë, pasi, sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika d), marrim informacionin se: *"mosdeklarimi i punimeve që përjashtohen nga detyrimi i pajisjes me leje, sipas nenit 41 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 lekë deri në 150 000 lekë"*. Gjoba e vendosur nga kryeinspektori është një vlerë, e cila nuk është e parashikuar në dispozitat ligjore. Vlera e saktë e masës administrative do të ishte 50,000 lekë – 150,000 lekë. ***Vlera e gjobës e vendosur nga IMTV është 350,000 lekë – 450,000 lekë më e madhe se ajo e llogaritur nga grupi i auditimit.***					

Për llogaritjen e gabuar të vlerës së masës administrative dënim me gjobë, ngarkohet me përgjegjësi:
- Z. E.Sh, me funksion kryeinspektor i IMTV.

2.6.5 Mbi nisjen e procedurave për të kallëzuar penalisht kundërvajtësit:
Në respektim të nenit 5 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, pika dh), si dhe nenit 52 i Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 7, kryeinspektori i IMTV ka detyrimin e përgatitjes së kallëzimit penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe të paraqitjes së tij pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi. Grupi i auditimit i kërkoi informacion IMTV Bashkia Gjirokastër mbi nisjen e indicies së veprës penale pranë organeve ligjzbatuese, për të gjithë rastet, që në zbatim të përcaktimeve të nenit 199/a të Kodit Penal, përbëjnë vepër penale. Nga auditimi konstatohet se nga ana e IMTV Bashkia Gjirokastër nuk është vendosur në dispozicion dokumentacion zyrtar, justifikues dhe vërtetues, për procedurën e nisjes së indicies së veprës penale pranë organeve ligjzbatuese, për asnjë nga rastet që përbëjnë vepër penale.

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja e konstatuar
	Nr. serie	Datë		
1	000091	17.03.2025	N.B.	Ndërtim pa leje si plinta betoni, kadron druri si dhe tra lidhës në krye të kadroneve
2	000092	21.03.2025	N.G.	Ndërtim pa leje me blloqe betoni në një sipërfaqe 3.2 m x 18 msi dhe mbulesë sanduiçi 7.2 me 3.2
3	000094	26.05.2025	D.C.	Ndërtimi i një ballkoni me parapet me mur me tullë me dimensione 3.8m x 1.9 m dhe lartësi 1.1 m i dhe mbuluar me konstruksion metalik
4	000095	02.06.2025	H.L.	Ndërtim pa leje si objekt me konstruksion metalik dhe mbuluar me panele sanduiçi e gjitha ndërtuar mbi një platformë betoni me përmasa 10.8m x7.25m.04 m dhe lartësi 2.7 metra

Për mos-nisjen e indicies së veprës penale pranë organeve ligjzbatuese, për rastet që përbëjnë vepër penale, ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. E.Sh, me funksion kryeinspektor i IMTV.

2.6.6 Mbi arkëtimin e masave administrative:
Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të Bashkisë Gjirokastër për periudhën 01.01.2025 deri më 31.12.2025, rezulton se janë vendosur ***7 gjoba*** në vlerën

2,650,000 lekë, dhe është arkëtuar një prej tyre (ose 14.2%) në vlerën ***100,000 lekë*** (ose 3.8%). Ky rast është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja e konstatuar
	Nr. serie	Data		
1	000097	09.09.2025	"A. G." ShPK	Shtyrje e afatit të lejes

Rastet kur masa administrative nuk është paguar janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja e konstatuar
	Nr. serie	Data		
1	000091	17.03.2025	N.B.	Ndërtim pa leje si plinta betoni, kadron druri si dhe tra lidhës në krye të kadroneve
2	000092	21.03.2025	N. Gj.	Ndërtim pa leje me blloqe betoni në një sipërfaqe 3.2 m x 18 msi dhe mbulesë sanduiçi 7.2 me 3.2
3	000093	12.05.2025	N.M.	Punime pa njoftim si shtresa betoni të hollë dhe bordura betoni
4	000094	26.05.2025	D. C.	Ndërtimi i një ballkoni me parapet me mur me tullë me dimensione 3.8m x 1.9 m dhe lartësi 1.1 m i dhe mbuluar me konstruksion metalik
5	000095	02.02.2025	H.L.	Ndërtim pa leje si objekt me konstruksion metalik dhe mbuluar me panele sanduiçi e gjitha ndërtuar mbi një platformë betoni me përmasa 10.8m x7.25m.04 m dhe lartësi 2.7 metra
6	000096	09.07.2025	E.R.	Shkelje e projektit të miratuar nga 8m x 7m në 8.34m x7m

Nga ana e IMTV, Bashkia Gjirokastër, nuk janë marrë të gjithë hapat për arkëtimin e këtyre gjobave. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve"*, i ndryshuar, pika a), ku përcaktohet se: *"Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë,* ***deri në një muaj****. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas Ligjit".*

Për mos-marrjen e hapave për arkëtimin e masave administrative, ngarkohet me përgjegjësi:
- Z. E.Sh, me funksion kryeinspektor i IMTV.

Konkluzion i përgjithshëm mbi aktivitetin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor:

1. Nga auditimi u konstatua se në strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), Bashkia Gjirokastër, janë punësuar kryeinspektorë dhe inspektorë të cilët nuk plotësojnë kriteret e arsimit të lartë profesional të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, struktura e IMTV nuk plotëson numrin minimal të profesionistëve të kërkuar me ligj për ushtrimin e funksioneve të inspektimit dhe mbrojtjes së territorit.

2. IMTV, Bashkia Gjirokastër, nuk ka përmbushur detyrimet ligjore për planifikimin dhe raportimin periodik të veprimtarisë së tij, pasi nuk ka hartuar planet e punës për të gjithë periudhën objekt auditimi dhe nuk ka kryer raportimin tremujor të të dhënave statistikore pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

3. IMTV, Bashkia Gjirokastër, nuk ka zbatuar në mënyrë të saktë procedurat për nxjerrjen e vendimeve të pezullimit të punimeve, pasi në 3 raste ka nxjerrë vendime për pezullimin e punimeve në kundërshtim me parashikimet ligjore, ndërsa në 1 rast nuk ka nxjerrë vendimin e pezullimit, megjithëse ky veprim ishte i detyrueshëm sipas legjislacionit në fuqi.

4. IMTV, Bashkia Gjirokastër, nuk ka përllogaritur në mënyrë të saktë vlerën e masës administrative me gjobë, pasi në 5 nga 7 rastet e audituara gjobat janë vendosur në kundërshtim me kriteret dhe metodologjinë e përcaktuar në legjislacionin në fuqi, duke mos u bazuar në natyrën e shkeljes dhe vlerën e punimeve të kryera pa leje, sipas rasteve të parashikuara nga ligji. Në tre raste, duke qenë se volumet e punimeve nuk janë përshkruar në konstatimin e IMTV, nuk është e mundur që nga ana e grupit të auditimit të përllogaritet vlera e saktë e gjobës. Në dy raste, vlera e gjobave të vendosur nga IMTV është ***752,635 – 852,635 lekë*** më e madhe se ajo e llogaritur nga grupi i auditimit.

5. IMTV, Bashkia Gjirokastër, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për paraqitjen e kallëzimeve penale pranë organeve ligjzbatuese, pasi për asnjë nga rastet e audituara që përbënin indicie të veprës penale nuk u vu në dispozicion dokumentacion që provon nisjen e procedurës së kallëzimit penal, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

6. Nga auditimi u konstatua se Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), Bashkia Gjirokastër, nuk ka ndjekur në mënyrë efektive procedurat për arkëtimin e gjobave të vendosura, pasi nga 7 masa administrative me vlerë totale 2,650,000 lekë është arkëtuar vetëm 1 gjobë, ndërsa për 6 rastet e tjera nuk janë marrë të gjitha masat e parashikuara nga legjislacioni për sigurimin e ekzekutimit dhe arkëtimit të tyre.

(Për sa më sipër, pas njohjes me projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Bashkia Gjirokastër, nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit).

2.7. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.

-Auditim mbi statusin e pronave të transferuara me VKM dhe regjistrimin e tyre në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës.

-Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likujdimi i detyrimeve për kontratat e lidhura.

2.7.1 Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Për Bashkinë Gjirokastër, lista e pronave është miratuar me VKM 1684, datë 24.12.2008 *"Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Gjirokastër, të Qarkut Gjirokastër"*, i është miratuar lista inventarit me 240 fletë dhe përfundon me numër rendorë 1713.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB nr. 28, datë 13.10.2017, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Gjirokastër. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr. 1700 (njëmijë shtatëqind) dhe përbëhet me 242 (dyqind e dyzet e dy) fletë, vendim ky i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër, me shkresë nr. 969/1, datë 19.05.2017 dhe ky vendim me shkresë nr. 3376, datë 14.06.2017 është dërguar, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike.

Në total, nga 1699 pasuri që i janë transferuar "në pronësi" Bashkisë Gjirokastër, pa përfshirë ish-komunat, të cilat nuk rezultojnë me dokumentacion pronësor.

Nr	Bashkia/Njësitë	Nr. Pronave në Inventar	Në pronësi	Në përdorim	Prona të regjistruara në Kadastër
1	Bashkia Gjirokastër	1,699	-	1,699	-
2	NJA. Lazarat	172	-	172	-
3	NJA. Cepo	612	-	612	-
4	NJA. Picar	409	-	409	-
5	NJA. Antigone	259	-	259	-
6	NJA. Odrie	102	-	102	-
7	NJA. Lunxheri	102	-	102	-

Totali	**3,355**	-	**3,355**	-

Burimi: Bashkia Gjirokastër

1. Për ish-Komunën Lazarat:

Me VKM nr. 1467, datë 05.11.2008 *"Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Lazarat, të Qarkut Gjirokastër"*, i është miratuar lista inventarit me 31 fletë dhe përfundon me numër rendorë 157.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB nr. 28, datë 13.10.2017, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Lazarat, në Bashkinë Gjirokastër. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr. 157 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë) dhe përbëhet me 31 (tridhjetë e një) fletë, vendim ky i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër, me shkresë nr. 969/1, datë 19.05.2017 dhe ky vendim me shkresë nr. 3376, datë 14.06.2017 është dërguar, Ministrisë së Punëve të Brendshme , Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike.

2.Për ish-Komunën Cepo:

Me VKM nr. 244, datë 31.03.2011 *"Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Cepo, të Qarkut Gjirokastër",* i është miratuar lista inventarit me 83 fletë dhe përfundon me numër rendorë 612.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB nr. 28, datë 13.10.2017, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Cepo, në Bashkinë Gjirokastër. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr. 612 (gjashtëqind e dymbëdhjetë) dhe përbëhet me 83 (tetëdhjetë e tre) fletë, vendim ky i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër, me shkresë nr. 969/1, datë 19.05.2017 dhe ky vendim me shkresë nr. 3376, datë 14.06.2017 është dërguar, Ministrisë së Punëve të Brendshme , Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike.

3. Për ish-Komunën Picar:

Me VKM nr. 22, datë 12.01.2011 *"Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Picar të Qarkut të Gjirokastër",* i janë kaluar 439 prona. Numrat rendorë, 1-4 prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore, në pronësi, me sipërfaqe 1501 m^2. Numrat rendorë, 5-8 prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik, në pronësi, me sipërfaqe 269 m^2. Numrat rendorë,10,20-25,27,28,30,34-38,302- 406 Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike), rrugë vendore, në pronësi, shesh me sipërfaqe 79,629 m^2. Numrat rendorë 11-19,26,29,31-33,39 troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji, në përdorim, me sipërfaqe 10,329 m^2. Numrat rendorë, 40-50, 55-58, 60-67, 69-70, 72-79 prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik, në pronësi, me sipërfaqe ndërtese 3,986 m^2. Numrat rendorë, 81-85 prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administratës, në pronësi, me sipërfaqe ndërtese 469 m^2. Numrat rendorë, 86-87 prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive, në pronësi, me sipërfaqe totale 5,181 m^2, nga kjo ndërtesë 113 m^2 Numrat rendorë, 88-92 Varrezat publike, në pronësi. Numrat rendorë, 263-271 Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive arë , vreshta dhe pemëtore), në përdorim, me sipërfaqe 233.6 ha. Numrat rendorë 272-276, 281, 282, 285, 286, 294, 295,299 (vetëm kanale të treta) Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta), në pronësi, me sipërfaqe 546 ha. Numrat rendorë 408-409 Prona që përdoren në fushën e ujësjellës- kanalizimeve, në pronësi.

4. Për ish-Komunën Antigone:

Me VKM nr. 506, datë 13.07.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Antigone të Qarkut të Gjirokastër", i janë kaluar 259 prona.

Numri rendor, 20-27, 252 Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore, në pronësi, me sipërfaqe totale 12,225 m2, nga kjo ndërtesë 1,408 m2.

Numri rendor, 28-30 Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore , në pronësi, me sipërfaqe totale 5,720 m2, nga kjo ndërtesë 440 m2.

Numri rendor, 31-33 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik në pronësi, me sipërfaqe totale 340 m2, nga kjo ndërtesë 300 m2.

Numri rendor, 34 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative, në pronësi, me sipërfaqe totale 220 m2, nga kjo ndërtesë 216 m2.

Numri rendor, 35, 36, 38 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik, në pronësi, me sipërfaqe totale 690 m2, nga kjo ndërtesë 270 m2.

Numri rendor, 37 Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji, në përdorim, me sipërfaqe 480m^2.

Numri rendor, 39 Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike), në pronësi, me sipërfaqe 4250 m^2.

Numri rendor, 40-43 Varrezat publike, në pronësi, me sipërfaqe 13815m^2.

Numri rendor, 45-55 Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive). Sip. 24.9 ha i është dorëzuar AKKP-së, në përdorim, me sipërfaqe 770.5 ha.

Numri rendor, 56-60, 64, 72, 75 Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive), në pronësi, me sipërfaqe 370 ha.

Numri rendor, 80-220 Infrastrukturë (rrugë vendore), në pronësi.

Numri rendor, 221-226, 253-259 Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi.

5. Për ish-Komunën Odrie:

Me VKM nr. 1044, datë 14.10.2009 *"Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Odrie të Qarkut të Gjirokastër",* i janë kaluar 136 prona.

Numrat rendorë 1,2,4,5,6,8,9,11,12,13,15,16 Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive), në përdorim, me sipërfaqe 791 ha.

Numrat rendorë 3,7,10,14,17,75,76,83,84, 89, 92, 95, 96, (vetëm kanalet e treta) Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta), në pronësi, me sipërfaqe 375 ha. Numrat rendorë 18-23 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik, në pronësi, me sipërfaqe ndërtese 563 m^2.

Numrat rendorë 24-26 Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive, në pronësi, me sipërfaqe ndërtese 696 m^2.

Numrat rendorë 27-29 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik, në pronësi, me sipërfaqe 329 m^2.

Numrat rendorë 30 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administratës, në pronësi , me sipërfaqe 250 m^2.

Numrat rendorë 31-38 Varrezat publike, në pronësi.

Numrat rendorë 39-44 Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore, në pronësi, me sipërfaqe 1218 m^2.

Numrat rendorë 45-62 (vetëm trojet) Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji, në përdorim.

Numrat rendorë 45-62 (vetëm sheshet) Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike), në pronësi, me sipërfaqe 39958 m^2Numrat rendorë 98-100 Infrastrukturë (rrugë vendore), në pronësi.
Numrat rendorë 101-102 Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi.

6. Për ish-Komunën Lunxhëri:

Me VKM nr. 567, datë 27.06.2013 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Lunxheri të Qarkut të Gjirokastër", i janë kaluar 701 prona.
Numrat rendorë 1-5, 701 Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën arsimore, në pronësi, me sipërfaqe totale 16953 m^2, nga kjo ndërtesë 1670 m^2
Numrat rendorë ,6-7 Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e kulturës, në pronësi, me sipërfaqe totale 6928 m^2, nga kjo ndërtesë 88 m^2.
Numrat rendorë , 8 Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e shëndetit publik, në pronësi, me sipërfaqe ndërtesë 32 m^2.
Numrat rendorë ,10-14 Varrezat publike, në pronësi, me sipërfaqe 13763 m^2.
Numrat rendorë , 15-19, 21, 29, 30, 38, 62, 63, 66-68, 80-82, 85, 89, 91-101, 113-116, 147, troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji, në përdorim, me sipërfaqe 43607 m^2
Numrat rendorë , 20, 24, 25, 28, 34-37, 39-46, 48-53, 57-59, 61, 64, 65, 69-79, 83, 84, 86-88, 90, 102-112, 118, 121-146, 149, 150, 154-446 Infrastrukturë (rrugë vendore, sheshe, lulishte dhe shërbime publike), në pronësi, sheshe me sipërfaqe 202969 m^2.
Numrat rendorë, 22, 23, 26, 27, 31-33, 47, 54-56, 60, 117, 148, 151-153 Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e zhvillimit ekonomik, në pronësi, me sipërfaqe totale 15952 m^2, nga kjo ndërtesë 2704 m^2
Numrat rendorë , 447-449 Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e mbrojtjes civile, në pronësi, me sipërfaqe totale 1520 m^2, nga kjo ndërtesë 834 m^2
Numrat rendorë 450-451 Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi.
Nga pasuritë e mësipërme nuk rezulton të jetë e regjistruar asnjë pasuri në regjistrat publike të pasurive të paluajtshme.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në Bashkinë Gjirokastër nuk administrohet baza e të dhënave të pasurive të paluajtshme të ish-komunave, aktualisht njësi administrative, në formatin e një regjistri të integruar të inventarit të pronave të bashkisë.Ushtrimi i funksioneve në lidhje me inventarin dhe regjistrimin bëhet vetëm përmes një specialisti dhe nuk ka një strukturë të posaçme funksionale me qëllim mbulimin e një fushe komplekse sikurse është inventari i pasurive të paluajtshme.
Bashkia Gjirokastër nuk disponon dokument pronësie për asnjë nga pronat e transferuara, çka nënkupton se për to nuk ka kartelë pasurie në regjistrat publike dhe se nuk është aplikuar në ASHK për kalimin nga sistemi i vjetër hipotekor në sistemin e ri të certifikimit, për zona kadastrale ku ka mbaruar procesi i regjistrimit fillestar.
Nga verifikimi i evidencave, rezulton se:
Në bashkinë Gjirokastër nuk është krijuar Sektori i Menaxhimit dhe Administratimit të Aseteve, nuk janë ngritur grupe pune ku të përcaktohet misioni dhe detyra e tyre për administrimin e aseteve si dhe struktura për ndjekjen e tyre.

Fondi Pyjor, Kullosor:

Auditim mbi procedurat e dhënies me qira dhe likuidimin e kontratave të lidhura

Bashkia Gjirokastër ka në administrim një fond pyjor dhe kullosor prej 22,260 ha, i ndarë në 11 ekonomi pyjore sipas VKM nr.433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave, *"Për*

transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhetë ish komunave/bashkive", të ndryshuar.

Ekonomia pyjore/ kullosore	Sip/total ha	Shkëmbore	pyll	kullote
Bashkia Gjirokaster	1,429.28		-	1,429.28
Nj.A Cepo	1,959.41		-	1,959.41
Nj.A Antigone	747.34		-	747.34
Nj.A Lazarat	1,471.47		-	1,471.47
Nj.A Picar	4,418.39		-	4,418.39
Nj.A Lunxheeri	1,282.94		-	1,282.94
NJ.A Odrie	1,141.17		-	1,141.17
Ek. Pyjore Mali Gjerë	496		496	
EK.pyjore Kardhiqe	4,067		4067	
Ek.Pyjore Lunxheri	2,354		2354	
EK.Pyjore Picar	3,035		3035	
Totali	**22,620**	**218**	**9,952**	**12,450**

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Në mënyrë të detajuar paraqiten pronat të cilat janë aplikuar për regjistrim në ASHK për periudhën 01.01.2025-31.12.2025 si vijon:

Nr.	Emertimi i Pasurisë	Zona kadastral	Nr Pasurise	Indeksi i hartës	Nr. rregjis	Siperfaqia sipas V.K.M.		Data e aplikimit Nr. Dt.	Vertetim ose certifikate Hipoteke	Siperfaqia sipas Faktit	
						Truall	Ndërt			Truall	Ndërt
1	Truall	8542	10/175	J-7-K-7		906.27 m²	256.8 m²	Nr 01 date 15.04.2026			
2	Kullote	8541	201/151	A-1/1						695.5m²	695.5m²

Burimi: Bashkia Gjirokastër. përpunoi grupi i auditimit

Nga auditimi rezultoi se:

- Në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, sipas detyrimeve të nenit 17 të Ligjit nr. 57/2020 "*Për Pyjet*", Bashkia Gjirokastër nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonomitë pyjore.
- Në kundërshtim me pikën 66 të VKM nr. 443/2016, nuk ka regjistruar në regjistrat kadastralë sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullosor publik nuk është regjistruara asnjë sipërfaqe pyjore e transferuar.
- Në kundërshtim me VKM nr. 171, datë 18.3.2022 "*Për ngritjen e bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjor dhe regjistrin e fondit kullosor, përcaktimin e strukturës, kritereve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve*", Bashkia Gjirokastër nuk ka ngritur dhe përditësuar regjistrin për fondin pyjor brenda juridiksionit të saj administrativ.

2.7.2. Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhur.

Bashkia Gjirokastër për krijimin e të ardhurave ka lidhur kontrata për dhënie me qira të aseteve në pronësi apo në përdorim të bashkisë.

Gjatë vitit 2025 Bashkia Gjirokastër ka pasur në administrim 83 kontrata qiraje nga të cilat 80 janë kontrata për tokat bujqësore të lidhura nga ish-komunat dhe 3 kontrata janë kontrata për antenat.

<u>Qiradhënia e aseteve</u>

Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2025 nuk janë lidhur kontrata për tokën bujqësore. Kontrata të lidhura lidhura sipas njësive administrative si mëposhtë:

-Njësia Administrative Cepo ka 23 kontrata të lidhura në periudhën 2013-2022.

-Njësia administrative Lunxheri janë lidhur 43 kontrata në periudhën 2013-2023.
-Njësia Aministrative Antigone janë lidhur 7 kontrata në periudhën 2013-2018.
-Njësia Aministrative Odrie janë lidhur 3 kontrata në periudhën 2013-2019.
-Njësia Aministrative Picar janë lidhur 4 kontrata në periudhën 2013.

Kontrata me Bashkinë Gjirokastër:
1-Kontratë qiraje me T. A. Sh.a me afat 9 vjecar datë lidhje kontrate 01.04.2016 me vlerë kontrate 540,000 lekë.
2-Kontratë qeraje me V. Al.Sh.a me afat 9 vjeçar me datë lidhje kontratë 15.10.2023 me vlerë kontrate 250,000 lekë.
3-Kontratë qeraje me EU G. E. me afat 10 vite me datë kontrate 12.07.2024.

- ***Subjektet që ushtrojnë aktivitet në Fond Pyjor dhe kullosor të cilët janë pajisur me leje nga ministria, por nuk kanë nënshkruar kontrat me Bashkinë Gjirokastër.***

Bashkia Gjirokastër nuk ka vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerave dhe leje koncesionare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë si dhe nga Ministria e Mjedisit, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi.
Në lidhje me auditimin e të ardhurave nga asetet, grupi i auditimit bëri kërkesë drejtuar Agjensisë së Tatim Taksave, Sektorit të pronave publike dhe licencave dhe Agjensisë së Bujqësisë Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit për vendosjen në dispozicion të kontratave të qirave të fondit pyjor/kullosor të cilat ushtrojnë aktivitet në sektorin e burimeve minerare në territorin që administron Bashkia Gjirokastër.
Duke u bazuar në të dhënat e pasqyruara në Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, në Regjistrin e Lejeve Minerare të muajit shkurt të vitit 2023, Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, konstatohet se për periudhën nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025, në territorin e Bashkisë Gjirokastër ushtrojnë aktivitet dy subjekte, të cilat nuk paguajnë detyrime për aktivitetin që kryejnë, pasi nuk janë të evidentuara nga Bashkia Gjirokastër.
Këto subjekte janë:
1. Subjekti "B." me NIPT K. i regjistruar në AKBN i pajisur me lejen nr. 1168/1, datë 19.03.2008, për shfrytëzimin e vendburimit Lazarat për llojin e mineralit gëlqeror pllakor me sipërfaqen 0.032 km^2.
2. Subjekti "N." SHPK me NIPT K. i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1931, datë 04.05.2022, për shfrytëzimin e vendburimit Lazarat për llojin e mineralit gëlqeror me sipërfaqen 0.808 km^2.
Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 57/2020 *"Për pyjet" neni 23, pika 2,* VKM nr.888, datë 27.12.2022 *"Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre".*

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e energjetikës:
Nga të dhënat e siguruara nga grupi i auditimit për subjekte të pajisura me kontratat e koncesionit sipas regjistrit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se përgjatë periudhës2025 , në territorin e Bashkisë Gjirokastër, kanë ushtruar aktivitet në në fushën e energjitikës 4 subjekte, për të cilat Agjensia e Tatim Taksave, Sektori i pronës publike dhe licencave dhe Agjensia e Bujqësisë Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimitnuk administrojnë dosje të tyre (raporti teknik, kontratë qiraje, etj). Subjkte të cilat ushtronjë aktivitet në fushën e energjitikës paraqiten si mëposhtë:

Nr.	Qarku	HEC-i	Shoqeria Koncesionare	Nr. I Heceve
1	Gjirokastër	Lengarica	"L.& E." SHPK	1
2	Gjirokastër	Picar 1	"P. P. 1" SHPK	1
3	Gjirokastër	Langarica 3: Gostivisht, Langarica 3, Ura e Dashit	"I. E. P."SHPK	3
4	Gjirokastër	Ferko 1,2	S. sh.p.k	1

Burimi: Faqe zyrtare e AKBN

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 57/2020 *"Për pyjet" neni 23, pika 2*, VKM nr.888, datë 27.12.2022 *"Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre".*
(Gjerësisht problemet mbi shkeljet janë trajtuar në akt-konstatimi Nr.5, datë 30.06.2026, dorëzuar me protokoll në Bashkinë Gjirokastër).

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. z.F.G. me detyrë Kryetar i Bashkisë Gjirokastër;
2. znj. A.Ll. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve Publike;
3. z. I. M. me detyrë Drejtor i Agjencisë së Bujqësisë, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit;
4. znj. B. G. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Pronave Publike dhe Licencave;

(Për sa më sipër, pas njohjes me projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Bashkia Gjirokastër, nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit).

2.8. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
Në zbatim të pikës 8 të programit të auditimit nr. 515/2, datë 14.05.2026, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Shkresa përcjellëse e Raportit dhe Vendimit të Kryetarit të KLSH-së;
- Plani i masave 20 ditor i dërguar në KLSH;
- Raportimi 6 mujor mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dërguar në KLSH;
- Dokumentacion i subjektit mbi zbatimin e rekomandimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se:
Auditimi mbi **"Bashkinë Gjirokastër"** është zhvilluar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën objekt auditimi financiar nga data 01.01.2024 deri në 31.12.2024 dhe të përputhshmërisë nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2024, me Programin e Auditimit nr. 321/1, datë 10.03.2025, "Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërisë ushtruar në Bashkinë Gjirokastër", për të cilin Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes i janë dërguar subjektit të audituar.

Nga auditimi janë lënë23 rekomandime sipas llojit të masave paraqitur si më poshtë:

Lloji i masave	Rekomandime gjithsej	Pa pranuar	Pranuar
Masa organizative	14	-	14
Masa për shpërblim dëmi	5	-	5
Masa për ulje borxhi (të ardhura të munguara)	3	-	3
Masa disiplinore për (vlerësim titullari)	1	-	1
Totali	**23**	**-**	**23**

Statusi i zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet, si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar plotësisht	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar	Në proces	Pa zbatuar

		(numër)	plotësisht	pjesërisht	zbatimi	
1	Masa Organizative	14	3	2	1	8
2	Masa Shpërblim dëmi	5	-	-	-	5
3	Masa për ulje borxhi (të ardhura të munguara)	3		1		2
4	Masa disiplinore për (vlerësim titullari)	1	-	-	-	1
5	Totali	23	3	3	1	16

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga APD-ja, u konstatua se:

1. Mbi hartimin e **programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH-së,** për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

Nga auditimi ka rezultuar:

- Në lidhje me hartimin e "Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH" dhe dërgimin e tij në KLSH, bazuar në Ligjin nr. 154/2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",* neni 15, gërma (j) ku cilësohet se: *"KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës"*, ka rezultuar se Bashkia Gjirokastër ka kthyer përgjigje në Kontrollin e Lartë të Shtetit, brenda afatit 20 ditor nga marrja e RPA-së.
- Në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 30 "Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit" pika 2, ku cilësohet se: *"Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna",* Bashkia Gjirokastër nuk ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, nga marrja e RPA-së,

2. Mbi zbatimin e rekomandimeve për **Masat me karakter Organizativ.** Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuara dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vlerësimin e nivelit të implementimit të komponentëve të MFK në Bashkinë Gjirokastër, rezulton se strukturat përgjegjëse nuk kanë marrë masa për evidentimin e mangësive në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese. Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë; nuk është hartuar dhe miratuar "Gjurma e unifikuara e auditimit". Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 9, pika 1/1 germa 'b'; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 4, pika 20. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 1, faqe 11-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër, nëpërmjet Struktuarave përgjegjëse, të marrin masa për të ngritur një sistem efektiv mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, duke hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim. Strukturat drejtuese të ndjekin nivelin e implementimit të parimeve respektive sipas komponentëve të MFK për plotësimin e mangësive të konstatuara.

Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: *Subjekti i audituar Bashkia Gjirokastër nuk ka paraqitur qëndrim për rekomandimin e mësipërm.*
Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e subjektit Bashkia Gjirokastër nuk u paraqit asnjë dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Pa zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Auditit të Brendshëm për vitin 2023 dhe 2024, rezulton se kjo njësi ka funksionuar me **3** punonjës, nga të cilëtpërgjegjësi i njësisë dhe 1 specialist të pa certifikuar dhe një specialist në proces certifikimi. Po kështu, rezulton se nuk janë ndjekur në mënyrë të vazhdueshme trajnimet për kualifikimin profesional, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 11 "Punësimi i audituesit të brendshëm", neni 19 "Certifikimi i audituesve të brendshëm" dhe neni 20 "Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm". *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 1, faqe 11-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër, nëpërmjet Njësisë së Auditit të Brendshëm të marrë masa për vijueshmërinë e trainimeve vjetore për kualifikimin profesional, si dhe të kryejë procesin e certifikimit të audituesve të pacertifikuar.
Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: Gjatë vitit 2024 dhe 2025 nuk ka patur thirrje të hapura për procesin e certifikimit të audituesve të pacertifikaur. Janë hapur në vitin 2026 për të cilën ka marrë pjesë specialisti z. B. I.. Përsa i përket trajnimeve për kualifikim profesional ju bëjmë me dije se gjatë vitit 2024 nuk ka patur, por janë ndjekur në vitin 2025 nga të tre nëpunësit e Njësisë së Auditimit të Bashkisë Gjirokastër.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Deri në momentin e mbajtjes së këtij akt verifikimi, pavarësisht masave të marra nga Bashkia Gjirokastër, rekomandimi i sipërcituar nuk është zbatuar plotësisht.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Zbatuar pjesërisht.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i taksave dhe tarifave vendore rezulton se për vitin 2024 planifikimi i të ardhurave është në vlerën 268,100 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 250,246 mijë lekë ose në masën 93% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 17,854 mijë lekë. Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave konstatohet se:
- Për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta si:
taksa mbi tokën bujqësore në masën 70%, *taksa e fjetjes në hotel* masën 64%, *tarifa e reklamës* në masën 75%, *taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja* në masën 69%, *leje transporti* në masën 46%, *leje taksi* në masën 21%, *leje për tregti hidrokarburesh* masën 52%, *tarifa për vërtetime* në masën 35%, *vendim shesh ndërtimi* në masën 57%, *kërkesë leje ndërtimi* në masën 40%, *certifikatë përdorimi* në masën 15%, *Qira trualli* në masën 37%, *Qira toke bujqësore* në masën 42%, *Gjoba* në masën 68%.
- Për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet mbi planin në masa të konsiderueshme si:
Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin në masën 209%, *Tatim nga shitja e pasurive të paluajtshme* në masën 126%, *Certifikate transporti* në masën 247%, *Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura* në masën 129%, *Tarifë zënie hapësire publike* në masën 655%, *Tatimi mbi të ardhurat personale* në masën 152%, *Tarifë gjelbërimi* në masën 153%, *Tarifë për qira objektesh* në masën 271%, *Tarifa nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri* në masën 187%, *Tarifë regjistrimi* në masën 134%, *Tarifë për ujë për vaditje* në masën 176%.
Ky fakt tregon se planifikimi i të ardhurave në disa zëra të ardhurash nuk është bërë mbi baza reale dhe realizimi i viteve të mëparshme nuk është marrë në konsideratë në planifikim.

Gjithashtu për një pjesë të ardhurash nuk është bërë punë e mjaftueshme për arkëtimin e tyre, gjë që ka sjellë ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore**.** Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"*Për financat e vetëqeverisjes vendore", nenet 5/a, dhe 6**.** *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2, faqe 32-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave dhe Performancës, Angjencia e Tatim Taksave (DZHEBTP) të marrë masa që në planifikimin e të ardhurave të marrënë konsideratë realizimin faktik të vitit paraardhës dhe të kryejë procedurat për përfshirjen e gjithë kapaciteteve tatimore në planifikim.

Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: *Subjekti i audituar Bashkia Gjirokastër nuk ka paraqitur qëndrim për rekomandimin e mësipërm.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e subjektit Bashkia Gjirokastër, pavarësisht se gjatë intervistave me stafin, këta të fundit janë shprehur verbalisht se janë "në proces", nuk u paraqit asnjë dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimit të lënë nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Pa zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Gjirokastër rezulton se llogaria ***468 "Debitorë të ndryshëm",*** në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 50,998,526 lekë. Nga analiza e kësaj llogari konstatohet se nuk është bërë përditësimi dhe rakordimi midis Drejtorisë së Financave dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave dhe Performances, Angjencia e Tatim Taksave (DZHEBTP) pranë bashkisë, ku gjendja debitore e pa kontabilizuar është në vlerën 146,065,114 lekë, si dhe nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërkimit, në kundërshtim me Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë" nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nenet 21-33 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 42-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave dhe Performances, Angjencia e Tatim Taksave (DZHEBTP), të marrin masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore gjendje 31.12.2024, në vlerën 146,065,114 lekë.

-Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitore.

Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: *Subjekti i audituar Bashkia Gjirokastër nuk ka paraqitur qëndrim për rekomandimin e mësipërm.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e subjektit Bashkia Gjirokastër, pavarësisht se gjatë intervistave me stafin, këta të fundit, janë shprehur verbalisht se janë "në proces", nuk u paraqit asnjë dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimit të lënë nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Pa zbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Gjirokastër, rezulton se llogaria 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 42,957,758 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5% të ngurtësuara në Degën e Thesarit Gjirokastër. Drejtoria e financës nuk ka marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës, si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin sipas aneksit nr. 8 pika 3 raportit të auditimit.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 3.3. "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarie të të tretëve (klasa 4)" i ndrzshuar*, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 42-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrin masa për të njoftuar të gjitha subjektet për paraqitjen e dokumentacionit për likuidim, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: USH nr. 734 datë 11.09.2025 "Rikonstruksion i Ujësjellësit Lazarat" vlera 12.371.415 lekë; USH nr. 783 datë 25.09.2025 "Rikonstruksion rruga "Zeman Haska" Loti 1 Vlera 1.181.188 lekë; USH nr. 898 datë 27.10.2025 "Zgjerimi i ndricimit rrugor në fshatra" vlera 282761 lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i pasqyrave financiare të subjektit Bashkia Gjirokastër për vitin 2025 u konstatua se në llogarinë 466*"Kreditorë për mjete në ruajtje"* rezultojnë të kontabilizuara 32 ngurtësime me vlerë 8,947,326 lekë për të cilat ka kaluar afati i garancisë.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Në proces zbatimi.

6. Gjetje nga auditimi: Në 4 (katër) raste, nga auditimi në SPE dhe dosjet fizike përprocedurat e prokurimit me objekt:

- "*Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara Loti 2*",
- "*Rehabiltim në segmente të ndryshme rrugore*",
- "*Rivitalizim i hapësirave rreth pallatit të sportit Luftëtari*",
- *"Sistem asfaltim rruga Taroninë Zhulat",* rezultoi se, projektet e zbatimit, janë hartuar nga Drejtoria e Urbanistikës (sektori i projekteve), Bashkia Gjirokastër, nga disa Inxhinier pjesë e grupit të punës, ***të pa pajisur me licencën e projektimit***. Ky veprim, është në kundërshtim me neni 5 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", *neni 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 53-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1.Rekomandimi: Bashkia Gjirokastër të marrë masa, që të gjithë projektet e zbatimit të hartohen nga Inxhinierë të pajisur me licencën përkatëse për projektim, ose në mungesë të inxhinierëve të liçensuar, projektet e zbatimit t'i nënshtrohen procedurave të prokurimit publik, duke siguruar hartimin me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: Zbatuar me anë të Urdhërit nr. 873 datë 21.11.2025 "*Për pajisjen me licencat përkatëse të projektimit të inxhinierëve të Sektorit të Projekteve*".

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i dosjeve personale të punonjësve të sektorit të urbanistikës si dhe nga projektet e hartuara gjatë vitit 2025 konstatohet se të gjithë punonjësit hartues të projekteve janë të pajisur me licencën përkatëse për projektim.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Zbatuar.

7. Gjetje nga auditimi: Në 5 (pesë) raste, nga auditimi i procedurave të prokurimit publik dhe zbatimit të kontratave për punë publike, u konstatua se, nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Gjirokastër, nuk është kryer oponenca teknike për projektet e zbatimit me objekte:

- "*Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara Loti 2*",
- "*Rehabiltim në segmente të ndryshme rrugore*",
- "*Rivitalizim i hapësirave rreth pallatit të sportit Luftëtari*",

- "*Rikonstruksion dhe përmirësimi i eficencës energjitike në shlollën "Muhamet Gjollesha",*
- "*Sistem asfaltim rruga Taroninë Zhulat".*

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 120/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", neni 6, VKM nr. 610, datë 22.9.2022 "*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të Përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe Mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të Punimeve*", neni 41, pika 1, germa (c), si dhe Vendimin Nr. 9, datë 11.01.2024 "*Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 53-129 të Projekt Raportit të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastër të marrë masa që të pajisë me *Oponencë Teknike* çdo projekt zbatimi, për të siguruar hartimin e tyre me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: Zbatuar me anë të Urdhërit nr. 873/2 datë 21.11.2025 "*Për sigurmin e kontrollit teknik dhe cilësisë së projekteve të zbatimit nëpërmjet pajisjes me oponence teknike*".

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i projekteve të zbatimit të hartuara gjatë vitit 2025 konstatohet janë kryer oponencat teknike.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Zbatuar.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 13 procedurave të prokurimi të zhvilluara në Bashkinë Gjirokastër për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2024, me fond limit 387,392,128 lekë pa TVSH dhe vlerë kontratë 287,127,069 lekë pa TVSH, u konstatuan parregullsi në argumentimin e kritereve dhe në vendosjen e kritereve jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet si më poshtë:

- Tenderi me objekt: "*Rikonstruksion i pallatit të sportit Gjirokastër*", me vlerë kontrate 59,308,815 pa TVSH;
- Tenderi me objekt: "*Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara",* me vlerë kontrate 11,012,845 lekë pa TVSH.
- Tenderi me objekt: "*Konstruksion i tregut lokal Rom Gjirokastër, Roma on Market*", me vlerë kontrate 15,396,409 lekë pa TVSH.
- Tenderi me objekt: "*Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në kodrën e Cfakës pranë rrugës nacionale Gjirokastër Kakavie Loti 2*", me vlerë kontrate 28,784,588 lekë pa TVSH.
-. Tenderi me objekt: *"Rehabilitim i segmenteve të ndryshme rrugore".* me vlerë kontrate 36,309,280 pa TVSH;
- Tenderi me objekt: *Karburant" Loti I Nafte benzenë dhe Loti II Lëndë djegëse për Kaldajën"* me vlerë kontrate 30,808,468 pa TVSH;
- Tenderi me objekt: "*Blerje mjeti skrep*", me vlerë kontrate 4,150,000 lekë pa TVSH;
- Tenderi me objekt: "*Rehabilitim në segmente të ndryshme rrugore*", me vlerë kontrate 21,747,214 lekë pa TVSH;
- Tenderi me objekt: "*Rivitalizim i hapësirave rreth pallatit të sportit Luftëtari*", me vlerë kontrate 16,732,275 lekë pa TVSH;
- Tenderi me objekt: "*Sistemim asfaltim rruga Tarininë Zhulat*", me vlerë kontrate 46,695,844 lekë pa TVSH.
- *Tenderi me objekt: "Rikonstruksion dhe përmirësimi i eficencës energjitike në shlollën "Muhamet Gjollesha"* me vlerë kontrate 14,479,818 lekë pa TVSH.

- Në 6 procedura nga 13 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 163,199,764 lekë pa TVSH, ose 42% e fondit të procedurave të audituara u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Gjirokastër, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kritereve të vendosura në DT.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nenin 26 pikat 1, nenin 6; nenin 36, nenin 39, pika 5; nenin 45 pika 1; nenin 67, nenin 78, pika 4, nenin 82, paragrafi i fundit dhe nenin 85 "Lidhja e kontratës", pika 2, etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 53-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër, të marrë të gjithë masat që nga njësitë e prokurimit të argumentohet vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim dhe se këto kritere të jenë në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.
Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: *Zbatuar me anë të Proces – verbalit nr 11066/1 datë 05.11.2025 mbajtur nga ana e Njësisë së Prokurimit.*
Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2025 konstatohet problematika e sipërcituar, edhe pse jo në të gjitha rastet e audituara, vijon të jetë prezentë, për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Pa zbatuar.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave për punë publike në 1 (një) rast për investimin me objekt: "Rikonstruksioni i pallatit të sportit, Gjirokastër" Bashkia Gjirokastër, është lidhur kontrata për kryerjen e shërbimit të kolaudimit me nr. 7873 prot., datë 14.08.2024 ndërmjet Bashkisë Gjirokastër, përfaqësuar nga zyrtari i Autorizuar i AK dhe OE "F. S." SHPK, ndërkohë që punimet e ndërtimit për kontratën për punë publike kanë përfunduar më datë 16.04.2023, pra, rreth 15 (pesëmbëdhjetë) muaj me vonesë.
Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, nenet 12 dhe 15. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4/4.4 faqe 129-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
9.1.Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastër, të marrë masa që për çdo kontratë për punë publike, të emërojë kolaudatorin apo grupin e kolaudimit brenda 30 ditëve nga njoftimi i përfundimit të punimeve të ndërtimit, me qëllim kolaudimin e investimit në përputhje me projektin e zbatimit, me dokumentet e planifikimit të kontrollit dhe të zhvillimit, me rregullat teknike të ndërtimit, kushtet teknike dhe standardet shqiptare në fuqi ose standardet evropiane kur mungojnë standardet shqiptare të përdorura në projekt, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, dhe në përputhje me destinacionin e tyre.
Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: *Për cdo objekt të cilit i ka përfunduar afati i zbatimit të punimeve do të njoftohet Sektori i Prokurimeve nga ana e Drejtorisë së Urbanistikës për të vijuar menjëherë me zhvillimin eprocesit të prokurimit për objektet përkatëse për të realizuar në kohë dhe brenda dispozitave ligjore kolaudimin e tyre.*
Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i procedurave të kontratave të zbatimit, të zhvilluara gjatë vitit 2025, konstatohet se emërimi i kolaudatorit apo grupit të kolaudimit është kryer brenda 30 ditëve nga njoftimi i përfundimit të punimeve të ndërtimit.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Zbatuar.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, për pronat që i janë transferuar me VKM në pronësi dhe në përdorim Bashkisë Gjirokastër, me VKM nr. 1684, datë 24.12.2008, Njësisë Administrative Cepo, me VKM nr. 244, datë 31.03.2011 dhe Njësisë Administrative Lazarat, me VKM nr. 1467, datë 05.11.2008 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të

paluajtshme shtetërore të Komunave, të Qarkut Gjirokastër", i janë miratuar listat inventarit, ndërsa Njësisë Administrative Lunxheri, me VKM nr. 567, datë 27.06.2013, Njësisë Administrative Picar, me VKM nr. 22, datë 12.01.2011, Njësisë Administrative Antigone, me VKM nr. 506, datë 13.07.2011 dhe Njësisë Administrative Odrie, me VKM nr. 1044, datë 14.10.2009 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunave të Qarkut të Gjirokastër", të kaluara në pronësi dhe përdorim. Për pronat e transferuara në pronësi Sektori i Lejeve, Licencave dhe Administrimit të Pronave Publike, nuk ka bërë regjistrimin e tyre në ASHK, nuk janë inventarizuar, nuk disponohet informacion në lidhje me gjendje reale të këtyre pronave, se sa prej tyre janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë, në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, me pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", si dhe të Ligjit nr. 20/2020, datë 05.03.2020, *"Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"*, neni 37, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 5, faqe 132-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër të marrë masa të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin e pronave të Bashkisë Gjirokastër të kaluar me VKM, mbi gjendjen fizike, si dhe për hartimin e regjistrit fizik të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar, me qëllim uljen e riskut të shpërdorimeve materiale të pasurive dhe mirë menaxhimin e tyre.

Gjithashtu, Kryetari i Bashkisë Gjirokastër, në përfundim të procesit të regjistrimit fizik të aktiveve të marrë masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: *Subjekti i audituar Bashkia Gjirokastër nuk ka paraqitur qëndrim për rekomandimin e mësipërm.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e subjektit Bashkia Gjirokastër, pavarësisht se gjatë intervistave me stafin, këta të fundit, janë shprehur verbalisht se janë "në proces", nuk u paraqit asnjë dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimit të lënë nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Pa zbatuar.

11. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e siguruara nga grupi i auditimit për subjekte të pajisura me kontratat e koncesionit sipas regjistrit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se përgjatë periudhës 2023-2024, në territorin e Bashkisë Gjirokastër, ushtrojnë aktivitet 3 (tre) subjekte kariere, për shfrytëzim "Mineral" dhe 4 (katër) subjekte në fushën e energjetikës, të cilat nuk paguajnë detyrime për aktivitetin që kryejnë, si dhe nuk administrohen dosje të tyre (raporti teknik, kontratë qiraje, etj), respektivisht:

Subjektet që ushtrojnë veprimtari karriere në shfrytëzimin e "Mineraleve të ndryshme"

1. Subjekti "A. G." pa NIPT, i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1907, datë 21.01.2021, për shfrytëzimin e vendburimit Zhulat-Picar për llojin e mineralit litium dhe me sipërfaqen 1 km^2.
2. Subjekti "B." me NIPT K. i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1168/1, datë 19.03.2008, për shfrytëzimin e vendburimit Lazarat për llojin e mineralit gëlqeror pllakor me sipërfaqen 0.032 km^2.
3. Subjekti "N." SHPK me NIPT K., i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1931, datë 04.05.2022, për shfrytëzimin e vendburimit Lazarat për llojin e mineralit gëlqeror me sipërfaqen 0.808 km^2.

Subjektet që ushtrojnë veprimtari kariere në fushën e energjetikës "HEC"

- Hec Lengarica, administruar nga shoqëria koncesionare "L. & E." SHPK
- Hec Picar 1, administruar nga shoqëria koncesionare "P. P. 1" SHPK
- Hec Langarica 3, Gostivisht, Ura e Dashit, administruar nga shoqëria koncesionare "I. E.P."SHPK
- Hec Ferko 1,2, administruar nga shoqëria koncesionare "S." SHPK

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Neni 17, të Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligji nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për Fondin kullosor", pikat 3, 7, 9,10,11, dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, "Për rregullat dhe procedurat qe ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullosor". *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 5, faqe 132-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit, të marrin masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: *Subjekti i audituar Bashkia Gjirokastër nuk ka paraqitur qëndrim për rekomandimin e mësipërm.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e subjektit Bashkia Gjirokastër, pavarësisht se gjatë intervistave me stafin, këta të fundit, janë shprehur verbalisht se janë "në proces", nuk u paraqit asnjë dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimit të lënë nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Pa zbatuar.

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, u konstatua se në 3 raste, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë. Më konkretisht, këto parregullsi janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Miratimi i lejes së ndërtimit me Vendim nr. 04, datë 12/01/2024, për objektin "Konstruksioni i tregut lokal Rom, Gjirokastër-Roma On Market", me adresë Gjirokastër, me subjekt zhvillues Bashkia Gjirokastër, mungon projekti arkitektonik në formatin DWG si dhe policat e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për: **i.** hartuesin e projektit arkitektonik (afati i mbulimit për këtë policë është 12.05.2022 – 11.05.2023); **ii.** hartuesin e projektit konstruktiv (afati i mbulimit për këtë policë është 14.04.2022 – 14.04.2023); **iii.** hartuesin e projektit elektrik (afati i mbulimit për këtë policë është 09.04.2022 – 28.04.2023); **iv.** hartuesin e projektit hidraulik dhe mbrojtjes ndaj zjarrit (afati i mbulimit për këtë policë është 05.11.2021 – 04.10.2022), në raport me datën e aplikimit për pajisje me leje ndërtimi (05.01.2024) në Kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, nënpika g);

2. Miratimi iCertifikatës së përdorimi miratuar me Vendim nr. 54, datë 13/06/2023, për objektin "Shtesë kati mbi objekt ekzistues, Papafingo", me adresë në lagjen "18 Shtatori", Bashkia Gjirokastër, me subjekt zhvillues z. G. A. ,dhe Certifikatës së përdorimi miratuar me Vendim nr. 127, datë 15/11/2023, për objektin "Godinë në funksion të agroturizmit 2k + 1 kat

bodrum", me adresë në Golem, Bashkia Gjirokastër, me subjekt zhvillues znj. J. B., rezulton se:
- Aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit nuk janë përpiluar dhe dorëzuar elektronikisht, pasi mungon një nga aktet e kontrollit:*"1. Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, të ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik"*;
- Mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane;
- Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenet 27/1 dhe 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, nënpika gj). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 143-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1.Rekomandimi: Drejtoria e Urbanistikës, Bashkia Gjirokastër, të marrë të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi dhe certifikatë përdorimi:
- të verifikojë afatin e mbulimit të policave për të gjithë hartuesit e projekteve ndërtimore, në raport me datën e aplikimit për pajisje me leje;
- të kërkojë plotësimin dhe saktësin e dokumentacionit të nevojshëm me aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit, të nënshkruar elektronikisht;
- të kërkojë plotësimin e dokumentacionit me aktin përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane;
- të kërkojnë plotësimin e dokumentacionit me projektin përkatës për mirëmbajtjen e objektit, së bashku me afatet periodike.

Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: *Zbatuar me anë të Urdhërit nr. 873/1 datë 21.11.2025 "Për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të KLSH-së për Drejtorinë e Urbanistikës".*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i procedurave të shqyrtimit / miratimit të lejeve të ndërtimit gjatë vitit 2025:
- nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me afatet e policave të përgjegjësisë profesionale përhartuesit e projekteve ndërtimore, për këtë arsye kjo pjesë e rekomandimit konsiderohet e zbatuar;
- janë konstatuar parregullsi në lidhje me aktet e kontrollit, për objektet që aplikojnë për t'u pajisur me certifikatë përdorimi, për këtë arsye kjo pjesë e rekomandimit konsiderohet e pazbatuar. Parregullsitë e konstatuar (në auditimin e aktivitetit të vitit 2025) kanë të bëjnë mangësi në aktet e kontrollit, mungesa në nënshkrimin elektronik, mungesa në datat e mbajtjes së akteve të kontrollit, etj.;
- janë konstatuar parregullsi në lidhje me aktin për menaxhimin e mbetjeve urbane (ky akt nuk është ngarkuar në asnjë nga rastet e audituara gjatë vitit 2025), për këtë arsye kjo pjesë e rekomandimit konsiderohet e pazbatuar;
- nuk janë konstatuar parregullsi në lidhje me projektin përkatës për mirëmbajtjen e objektit, për këtë arsye kjo pjesë e rekomandimit konsiderohet e zbatuar;.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Zbatuar Pjesërisht.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Gjirokastër, rezulton se për 5 raste, është mbajtur procesverbal prishje objekti dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, ndajë kundërvajtësve për të cilat vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm nuk është ekzekutuar nga IMTV. *Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", pika a dhe nenin 51 të ligjit*

107/2017 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit". (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 143-149 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1.Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndaj të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, të vijojë me vendimin e prishjes së objektit. Në rast kundërshtimi, ndaj personave përgjegjës, të ndiqen procedurat ligjore, duke kërkuar bërjen e kallëzimit penal ndajë shkelësve.

Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: *Subjekti i audituar Bashkia Gjirokastër nuk ka paraqitur qëndrim për rekomandimin e mësipërm.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i procedurave të mbajtura nga IMTV, Bashkia Gjirokastër, gjatë vitit 2025, është konstatuar se, edhe pse janë nxjerrë vendime për prishjen e objekteve të kundërligjshëm, këto vendime nuk janë ekzekutuar. Gjithashtu, në asnjë rast nuk është dokumentuar nisja e indicies së veprës penale drejt organeve ligjzbatuese. Për këtë arsye, ky rekomandim konsiderohet i pa zbatuar.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Pa zbatuar.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se:

Bashkia Gjirokastër ka respektuar afatin 20 ditor për përgatitjen e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve, dërguar me shkresën nr. *7552 prot., datë 28.08.2024*, nuk ka kthyer përgjigje brenda gjashtë muajve, si dhe nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak,në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", Neni 50-Auditimi i jashtëm.

Nga auditimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve, rezulton si më poshtë*:*

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 9 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 9 masa. Nga masat e pranuara është zbatuar plotësisht 1 masë, në proces zbatimi 4 masa, zbatuar pjesërisht 1 masë dhe pa zbatuar 3 masa nga të cilat rekomandimi 2.1, 2.2 dhe 3.2 nuk rikërkohen pasi janë pjesë e gjetjeve të sipërcituara.

b. për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, është rekomanduar 1 masë në vlerën 3,450,000 lekë e cila është në proces arkëtimi.

c. Për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, me efekt mungesë të ardhurash, janë rekomanduar 2 masa në vlerën **183,969,063** lekë të cilat janë në proces arkëtimi.

d. Është rekomanduar 1 masë disiplinore, e cila nuk është zbatuar. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 7, faqe 149-163, të Raportit të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

a. Për 1 masë organizative

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 519/7 prot., datë 11.10.2023 dhe regjistruar në regjistrin e protokollit të bashkisë me nr. 9728 prot., datë 12.10.2023 si dhe Akt Verifikimit nr. 1 të datës 07.06.2024, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të atyre pjesërisht të zbatuara dhe të pazbatuara si vijon:

B. Për masat shpërblim dëmi të lëna në auditimet e mëparshme:

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Gjirokastër në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për kontabilizim dhe arkëtimin e vlerës prej **43,300 lekë** në ngarkim të **J. "N. -86" & "K." SHPK,** si diferencë punimesh të pakryera në referencë të zërave të punimeve të preventivit.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastër të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të të zbatuara në vlerën **7,831,423 me TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve në situacionin pjesor nr. 5, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore. Gjithashtu nëse deri në fazën e mbylljes së punimeve këto zëra nuk realizohen të kërkohet arkëtimi i vlerës së punimeve të likuiduara por të parealizuara.

Për 2 masa shpërblim dëmi me vlerë 1,422,101 lekë si vijon:

15/1.1. Rekomandimi (*rikërkuar****):*** *Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit, të marrë masa për llogaritjen e saktë të detyrimeve nga taksa e infrastrukturës në masën 0.1% për investimet që janë jo me fondet e Bashkisë Gjirokastër, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjor për arkëtimin e detyrimit në vlerën* ***1,125,649*** *lekë, respektivisht:*

-Vlera ***1,121,650 lekë****, për investimin në objektin "Rikonstruksioni i Rrjetit të Furnizimit me Ujë dhe Sistemit të Kanalizimeve në Qytetin e Gjirokastrës" me vlerë preventivi prej 1,121,650,665 lekë.*

-Vlera ***3,999,401 lekë****, për investimit në objektin "Rikonstruksioni i Shkollës së Bashkuar" me vlerë preventivi 3,999,401 lekë.*

15/2.1. Rekomandimi (*rikërkuar****):*** *Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike,Bashkia Gjirokastër të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej* ***296,447 lekë pa TVSH*** *nga OE* ***"A."*** *SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 520 prot datë 18.01.2021, me objekt "Rikonstruksion i fushës së vjetër", duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë kjo e cila përfaqëson punimeve të pakryera.*

Gjithashtu të fillojë procedura e dhënies së masave disiplinore sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm.

Për 2 Masa për shpërblim dëmi në vlerën totale 20,358,645 lekë si vijon:

15/1.1. Rekomandimi (*rikërkuar****):*** *Bashkia Gjirokastër të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej* ***17,195,325 lekë pa TVSH*** *nga BOE "B. II" SHPK & "A. K." SHPK & "M." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 4803 prot., datë 22.06.2020, me objekt: "Ujësjellësi Lazarat". Vlera e mësipërme përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.*

15/2.1. Rekomandimi (*rikërkuar****):*** *Bashkia Gjirokastër të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej* ***3,163,320 lekë pa TVSH*** *nga BOE "N. S." SHPK & "Sh." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 11585 prot datë 15.10.2021 me objekt: "Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në Kodrën e Çafkës pranë rrugës nacionale Gjirokastër-Kakavi".*

Menjëherë

Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: *Subjekti i audituar Bashkia Gjirokastër nuk ka paraqitur qëndrim për rekomandimin e mësipërm.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e subjektit Bashkia Gjirokastër nuk u paraqit asnjë dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Pa zbatuar.

3. Mbi zbatimin e rekomandimeve për **Masat për shpërblim dëmi.** Ecuria e zbatimit dhe

analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuara dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit, të kontratës për punë publike me nr. 1363 prot., datë 13.02.2023, lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Gjirokastër dhe BOE "E." SHPK (50%) dhe OE "I." SHPK (50%) me vlerë të kontratës 45,956,077.2 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 4 (katër) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [*Zëri 1 (3.138) Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3 me themele gjerësi, tok e zak, kategoria III, me shkarkim në tokë*], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Gjirokastër , në vlerën 110,000 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 129-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Gjirokastër, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **110,000 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga BOE "E." SHPK & "I." SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 1363 prot., datë 13.02.2023 me objekt "Rikonstruksion i rrugës Zhulat Gjirokastër Loti I".
Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: *Subjekti i audituar Bashkia Gjirokastër nuk ka paraqitur qëndrim për rekomandimin e mësipërm.*
Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e subjektit Bashkia Gjirokastër, pavarësisht se gjatë intervistave me stafin, këta të fundit janë shprehur verbalisht se janë "në proces", nuk u paraqit asnjë dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimit të lënë nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Pa zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 4235 prot., datë 03.05.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Gjirokastër dhe BOE "L. K." SHPK (51.5%), dhe "E. K." SHPK (48.5 %) me vlerë të kontratës 70,677,778.28 lekë me TVSH dhe afat të realizimit 4 (katër) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [*Zëri 3 (An-17) Prishje suvatim nga brenda mure; Zëri 3 (2.31) Suva mur tulle h-4m me krah, llaç përzier M25; Zëri 3 (Analizë) FV Kompiuter, përfshirë programin, i kompletuar për punë*], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Gjirokastër, në vlerën **173,012** lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 129-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Gjirokastër në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **173,012 lekë** pa TVSH përfituar padrejtësisht nga BOE "L. K." SHPK & "E. K." SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 4235 prot., datë 03.05.2023 me objekt "Rikonstruksioni i pallatit të sportit, Gjirokastër".
Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: *Subjekti i audituar Bashkia Gjirokastër nuk ka paraqitur qëndrim për rekomandimin e mësipërm.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e subjektit Bashkia Gjirokastër, pavarësisht se gjatë intervistave me stafin, këta të fundit janë shprehur verbalisht se janë "në proces", nuk u paraqit asnjë dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimit të lënë nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Pa zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 11950 prot., datë 15.12.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Gjirokastër, dhe shoqëria "L." SHPK me vlerë të kontratës 34,541,506 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 5 (pesë)muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [*Suvatim me llaç çimento të perdes me pilota të Masës Inxhinierike Nr. 1; F.V Akacie 2 vjeçare bashkë me mbushjen me dhe vegjetal*], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Gjirokastër , në vlerën 142,200 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 129-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Gjirokastër në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **142,200 lekë** pa TVSH përfituar padrejtësisht nga shoqëria "Ll." SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 11950 prot., datë 15.12.2023 me objekt "Rikonstruksioni i pallatit të sportit, Gjirokastër".
Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: *Subjekti i audituar Bashkia Gjirokastër nuk ka paraqitur qëndrim për rekomandimin e mësipërm.*
Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e subjektit Bashkia Gjirokastër, pavarësisht se gjatë intervistave me stafin, këta të fundit janë shprehur verbalisht se janë "në proces", nuk u paraqit asnjë dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimit të lënë nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Pa zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 11757 prot., datë 28.10.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Gjirokastër, dhe shoqëria "E." SHPK me NIPT K... dhe, Lic. Nr. NZ. 4611/5, me vlerë të kontratës 10,549,810.8 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 77 ditë, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [*Zëri 4 (3.211 Shtresë cakulli mbeturinë kave t=20 cm për bankina*], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Gjirokastër , në vlerën **60,000 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 129-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Gjirokastër në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **60,000 lekë** pa TVSH përfituar padrejtësisht nga shoqëria "E." SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 11757 prot., datë 28.10.2022 me objekt "Punime mirëmbajtje rruga e fshatit Zhulat".
Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: *Subjekti i audituar Bashkia Gjirokastër nuk ka paraqitur qëndrim për rekomandimin e mësipërm.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e subjektit Bashkia Gjirokastër, pavarësisht se gjatë intervistave me stafin, këta të fundit janë shprehur verbalisht se janë "në proces", nuk u paraqit asnjë dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimit të lënë nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Pa zbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 10732 prot., datë 10.11.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Gjirokastër dhe shoqëria "F." SHPK me vlerë të kontratës 18,475,691 lekë me TVSH dhe, fat të realizimit të kontratës 7 (shtatë) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [*Mur guri në lartësi deri 3m me llaç përzier M 15; F.V bordura betoni parafabrikat, 20x35 cm*], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Gjirokastër , në vlerën **109,232 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 129-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Gjirokastër në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **109,232 lekë** pa TVSH përfituar padrejtësisht nga shoqëria "F." SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 10732 prot., datë 10.11.2023 me objekt "Rikonstruksion i tregut lokal Rome Gjirokastër "Roma on Market".
Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: *Subjekti i audituar Bashkia Gjirokastër nuk ka paraqitur qëndrim për rekomandimin e mësipërm.*
Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e subjektit Bashkia Gjirokastër, pavarësisht se gjatë intervistave me stafin, këta të fundit janë shprehur verbalisht se janë "në proces", nuk u paraqit asnjë dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimit të lënë nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Pa zbatuar.

4. Mbi zbatimin e rekomandimeve për **masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).** Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuara dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të të dhënave të dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave dhe Performances, Angjencia e Tatim Taksave (DZHEBTP) në Bashkinë Gjirokastër, rezulton se gjendja debitorë në fund të vitit 2023 është 180,824,397 lekë, dhe fund të vitit 2024 në shumën 161,996,949 lekë, e cila përbëhet nga, -detyrimet debitore nga 845 subjekte të biznesit të madh e të vogël në shumën 16,960,106 lekë, detyrimet debitore nga 11794 familje në shumën 44,833,026 lekë si dhe detyrime debitore nga 3472 familje fermere për taksën e tokës në shumën 18,940,565 lekë.
Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Gjirokastër për vjeljen e detyrimeve janë mjaftuar vetëm me nxjerrjen e njoftim-vlerësim detyrimin dhe nuk është aplikuar asnjë masë tjetër shtrënguese, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90,

91 dhe 93 dhe me VKB nr. 104, datë 04.12.2023 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe kundërvajtjet administrative për vitin 2024"
Gjithashtu nga vlera e debitorëve progresiv është kontabilizuar vetëm vlera prej 15,931,835 lekë dhe diferenca prej 146,065,114 lekë nuk është kontabilizuar në llog. 468 *"Debitorë të ndryshëm"* në aktiv të Formati 1 "Pasqyra e pozicionit financiar" të pasqyrave financiare, me pasojë të ardhura të munguara. Nga DAPPLL nuk është dërguar asnjë informacion me shkresë Drejtorisë së Financës për debitorët e rezultuar nga kontabilizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me UMFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kap. III, pika 3.2, paragrafi "Vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve" faqe 28-30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2,6 faqe 32-41, të Raportit Perfundimtar të Auditimit).*
1.1. Rekomandim: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave dhe Performances, Angjencia e Tatim Taksave (DZHEBTP), të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët dhe në vijim të ndjekë të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve debitore në vlerën 161,996,949 lekë nga subjektet e biznesit dhe taksapaguesit familjarë, si dhe të bashkëpunojë me Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e debitorëve në mbyllje të vitit 2025.
Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: *Subjekti i audituar Bashkia Gjirokastër nuk ka paraqitur qëndrim për rekomandimin e mësipërm.*
Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e subjektit Bashkia Gjirokastër, pavarësisht se gjatë intervistave me stafin, këta të fundit janë shprehur verbalisht se janë "në proces", nuk u paraqit asnjë dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimit të lënë nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Pa zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të subjekteve që operojnë në territorin e Bashkisë Gjirokastër në fushën e tregëtimit të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tij, u konstatua se, për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 4 subjekte të pajisura me autorizim me afat me 5 vjet,, nga të cilat kanë kryer pagesa pjesore 3 subjekte dhe 1 subjekt nuk e ka shlyer tarifën, duke rezultuar me detyrime të pashlyera në vlerë totale 2,700,000 lekë, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë. Kjo vlerë nuk është evidentuar në kontabilitet në llogarinë e debitorëve. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, Ligjin nr. 71/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, nenet 4,15 dhe 20/2" dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", kreu II, pika 3, pika 15.1 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2,6 faqe 32-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave dhe Performancës, Angjencia e Tatim Taksave (DZHEBTP), të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve në ushtrimin e aktivitetit të shitjes së hidrokarbureve, të papaguara nga 4 subjektet në vlerën 2,700,000 lekë përkatësisht:
- vlera 1,000,000 lekë nga subjekti "A.N." SHPK.
- vlera 500,000 lekë nga subjekti "K. SA" SHPK.
- vlera 700,000 lekë nga subjekti "E. Gj. 2012" SHPK.
- vlera 500,000 lekë nga subjekti "A. O." SHPK (Kordhoce).

Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: - *subjekti "A. N." SHPK pa informacion; - subjekti "K.SA" SHPK. Pa informacion; - subjekti "E. Gj. 2012"*

SHPK pa informacion; - subjekti "A.S.R O." SHPK (Kordhoce). Detyrim i paguar ne vleren totale me anë të Mandateve te pagesave te datës 03.06.2024/ 13.09.2024/ 17.07.2025/23.09.2025.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e subjektit Bashkia Gjirokastër, pavarësisht se për një nga katër subjektet e sipërcituara ka përmbushur rekomandimin, pët tre të tjerët nuk u paraqit asnjë dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimit të lënë nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Zbatuar pjesërisht.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit financiar të pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve informale, rezulton se në fund të vitit 2023 janë debitorë 85 individë në vlerën 1,903,345 lekë, gjatë vitit 2024 janë krijuar debitorë 19 individë në vlerën 881,817 lekë dhe në fund të vitit 2024 rezultojnë debitorë për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet 103 individë në vlerë progresive 2,785,163 lekë, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gjirokastër, si pasojë e mos dërgimit pranë zyrës së financës për kontabilizim. Drejtoria e Urbanistikës nuk ka marrë të gjithë masat e nevojshme për arkëtimin e (TNI) nga legalizimet, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,"*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*" pika 5, me VKB nr.104, datë 04.12.2023 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Gjirokastrës, si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin ushtrimor". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2,6 faqe 32-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Urbanistikës në Bashkinë Gjirokastër, në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave dhe Performancës, Angjencia e Tatim Taksave (DZHEBTP) të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 103 debitorë në vlerën 2,785,163 lekë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen.

Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: *Subjekti i audituar Bashkia Gjirokastër nuk ka paraqitur qëndrim për rekomandimin e mësipërm.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e subjektit Bashkia Gjirokastër, pavarësisht se gjatë intervistave me stafin, këta të fundit janë shprehur verbalisht se janë "në proces", nuk u paraqit asnjë dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimit të lënë nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Pa zbatuar.

5. Mbi zbatimin e rekomandimeve për **masa disiplinore.** Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuara dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", nenin 15 germat (b, c, ç); nenin 58 "*Llojet e masave disiplinore*", në Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar neni 37, si dhe në kontratën individuale të punës dhe në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*", i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së.

Qëndrimi i Bashkisë Gjirokastër për rekomandimin e mësipërm: *Nuk është marrë asnjë masë.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga informacioni i vënë në dispozicion dhe i verifikuar nga grupi i auditimit, rezulton se nisur nga fakti që rekomandimi nuk lë në diskrecion të subjektit (titullarit) inicimin/ fillimin e procedurës për llojin e masës disiplinore por në diskrecion të Komisionit Disiplinor pranë Institucionit rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.
Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pranuar dhe Pa zbatuar.
(Për sa më sipër, pas njohjes me projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Bashkia Gjirokastër, nuk janë paraqitur observacione mbi këtë të fundit).

2.9. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.
Gjatë procesit të auditimit në Bashkinë Gjirokastër, nuk u konstatuan problematika jashtë projektit të auditimit, për periudhën 01.01.2025 deri 31.12.2025.

V. REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vlerësimin e nivelit të implementimit të komponentëve të MFK në Bashkinë Gjirokastër, u konstatua se strukturat përgjegjëse nuk kanë marrë masa për evidentimin e mangësive në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese. Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë, nuk është hartuar dhe miratuar "Gjurma e unifikuar e auditimit". Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" neni 9, pika 1/1 germa 'b'; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 4, pika 20. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.1, faqe 19-25 të Raportit të Auditimit).*
1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër, të marrë masa për të ngritur një sistem efektiv mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, duke hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim. Strukturat drejtuese të ndjekin nivelin e implementimit të parimeve respektive sipas komponentëve të MFK për plotësimin e mangësive të konstatuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se struktura organizative e Bashkisë Gjirokastër e aplikuar gjatë vitit 2025, e miratuar me Urdhrin e Kryetarit nr. 835, datë 30.10.2024, nuk përputhet me strukturën faktike dhe me përcaktimet e paketës fiskale për administrimin dhe vjeljen e taksave e tarifave vendore. Konkretisht, ndryshimet strukturore të kryera gjatë vitit 2025 nuk janë pasqyruar në Rregulloren e Bashkisë, ndërsa Drejtoria e të Ardhurave, Pronës Publike, Lejeve dhe Licencave, e ngarkuar me vjeljen e disa taksave dhe tarifave sipas paketës fiskale 2025, nuk rezultoi në strukturën organizative të miratuar. Gjithashtu, për tarifat e përkohshme për biznesin e vogël dhe të madh nuk është përcaktuar struktura përgjegjëse për ndjekjen dhe vjeljen e tyre.
Sa më sipër në strukturën e miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 835, datë 30.10.2024, me objekt "*Për miratimin e strukturës analitike të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2024*", kjo Drejtori nuk ekziston në këtë strukturë.
Për tarifat e përkohshme për biznesin e vogël dhe të madh nuk është përcaktuar Drejtoria/ Sektori i cili do të ndjekë vjeljen e kësaj tarife.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar neni 8 dhe neni 12, Ligjin nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar neni 64. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.3., faqe 51-65 të Raportit të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për përditësimin dhe harmonizimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit dhe paketës fiskale me strukturën organizative në fuqi, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe strukturat përgjegjëse për administrimin dhe vjeljen e taksave e tarifave vendore.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Auditit të Brendshëm për vitin 2025, rezulton se kjo njësi ka funksionuar me **3** punonjës, nga të cilët përgjegjësi i njësisë dhe 1 specialist të pa certifikuar dhe një specialist në proces certifikimi. Po kështu, rezulton se nuk janë ndjekur në mënyrë të vazhdueshme trajnimet për kualifikimin profesional, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet ligjore të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*", neni 11, neni 19 dhe, neni 20. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.1., faqe 25-32 të Raportit të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Gjirokastër, në bashkëpunim me Koordinatorin për MFK-në dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për të hartuar një program trajnimi, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të të gjithë punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit;

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të hartimit të PBA-së dhe dokumentimit të hapave të ndjekura rezulton se:

- Janë miratuar në Këshillin Bashkiak **tavanet përgatitore** për PBA 2025-2027 me VKB nr. 18, datë 29.03.2024, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 293/1 prot., datë 04.04.2024 në kundërshtim me afatet e përcaktuara në pikën 63 të Udhëzimit nr. 23, datë 30.12.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".

-Udhëzimi i Kryetarit për përgatitjen e buxhetit afatmesëm nuk është hartuar në kundërshtim me pikën nr. 64, të Udhëzimit nr. 23, datë 30.12.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore". Kryetari i Njësisë Vendore 5 ditë pas miratimit të tavaneve buxhetore duhet të miratoj udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njësisë dhe duhet ta shpërndaj atë.

- Tavanet përfundimtare të PBA 2025-2027 janë miratuar me VKB nr. 50, datë 31.07.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 657/1prot., datë 12.08.2024 në kundërshtim me

udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore" pika 79.

- Kalendari i konsultimeve publike nuk është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak.

Veprime dhe mosveprime janë në mospërputhje me Udhëzimin nr.23, datë 30.12.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore" pikat 63, 64, 79. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 35-50, të Raportit të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër, Drejtoria e Financës, Sektori i Buxhetit të marrin masat e nevojshme për të ndjekur të gjithë fazat e planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor duke e miratuar brenda afateve ligjore.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Gjirokastër së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2025, ka devijime me vlerën e planifikuar.
Për vitin 2025, planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken ka vlerën 1,251,601 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 979,538 mijë lekë ose në masën 78.2%.
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore u planifikuan në vlerën 270,781 mijë lekë dhe u realizuan në vlerën 252,127 mijë lekë ose në masën 93%. Sipas zërave të të ardhurave u konstatuan nivele të ulëta realizimi, si dhe tejkalime të planit, duke evidentuar mospërputhje ndërmjet planifikimit dhe kapaciteteve reale të arkëtimit.
Mosrealizimi i buxhetit u evidentua veçanërisht në zërin e investimeve, ku llogaritë 230-231 u planifikuan në vlerën 305,514 mijë lekë dhe u realizuan në vlerën 181,907 mijë lekë ose në masën 59.5%, me mosrealizim në vlerën 123,607 mijë lekë.
Në nivelin e ulët të realizimit të investimeve ndikuan dy faktorë kryesorë: mosrealizimi i të ardhurave të planifikuara, si dhe mosfinalizimi brenda vitit buxhetor i disa procedurave të investimeve për shkak të afateve të nevojshme për realizimin e tyre. Kjo e fundit evidentohet edhe nga fakti se në fund të vitit rezultuan të papërdorura fonde nga transferta e pakushtëzuar dhe specifike në vlerën 278,230 mijë lekë.
Sa më sipër evidentohen mangësi në planifikimin dhe realizimin e treguesve buxhetorë, të cilat kanë ndikuan në nivelin e realizimit të investimeve të planifikuara për vitin 2025.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 39; Ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", neni 9, pika 1.3, shkronjat "c" dhe "ç"; Ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", nenet 2 dhe 3, pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", i ndryshuar, pikat 79, 80 dhe 81, si dhe VKB-të përkatëse.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 , faqe 32-50, të Raportit të Auditimit).
5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Gjirokastër, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime reale. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Llogarisë 101 "Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar" u konstatua se, më datë 31.12.2024, kjo llogari paraqitej në vlerën 2,502,712 mijë lekë. Gjatë vitit 2025, llogaria është kredituar me shumën 397,284 mijë lekë dhe debituar me shumën 161,059 mijë lekë, duke rezultuar në shtesa neto në vlerën 236,225 mijë lekë. Nga analiza e kreditimeve/debitimeve dhe çeljes së vitit ushtrimor, llogaria 101 "Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar" duhej të paraqitej në vlerën 2,738,937 mijë lekë. Referuar pasqyrës së pozicionit financiar, kjo llogari është kontabilizuar në vlerën 2,775,368 mijë lekë, duke rezultuar e mbivlerësuar me shumën 36,431 mijë lekë. Sa më sipër veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*", i ndryshuar pika 1.1 trajtimi kontabël dhe funksionimi i klasës 1. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3 , faqe 51-65, të Raportit të Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë sistemimet kontabël të llogarisë 101 "Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar" për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 85 "*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore*" u konstatua se, në pasqyrën e pozicionit financiar, kjo llogari është paraqitur në vlerën 219,746,193 lekë, ndërkohë që fondet e papërdorura për vitin 2025 rezultojnë në vlerën 241,092,810 lekë, nga të cilat 168,963,312 lekë përbëjnë transferta të pakushtëzuara dhe specifike dhe 72,129,498 lekë të ardhura të papërdorura. Referuar udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", në këtë llogari kontabilizohen fondet e papërdorura dhe të trashëguara për vitin pasardhës. Për rrjedhojë, llogaria 85 rezulton e nënvlerësuar me 37,137,708 lekë, duke sjellë mospërputhje në paraqitjen e fondeve të papërdorura në pasqyrat financiare. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3 , faqe 50-65, të Raportit të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë sistemimet kontabël të llogarisë 85 "Rezultat i vitit ushtrimor" për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" rezultoi se gjendja në datën 31.12.2024 ishte 50,998,526 lekë. Gjatë vitit 2025 janë regjistruar shtesa në vlerën 5,407,550 lekë dhe pakësime në vlerën 7,192,968 lekë, duke rezultuar me gjendje përfundimtare në datën 31.12.2025 në shumën 49,213,108 lekë, e përbërë nga: detyrime të debitorëve familjarë dhe bizneseve në vlerën 23,733,415 lekë, detyrime për kopshte dhe MZSH në vlerën 2,863,000 lekë, detyrime të Drejtorisë së Urbanistikës në vlerën 4,545,112 lekë, gjoba të IMT-së në vlerën 17,083,181 lekë, detyrime të punonjësve në vlerën 980,400 lekë dhe detyrime të kopshteve e çerdheve në vlerën 8,000 lekë.

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit ka përcjellë pranë Drejtorisë së Financës, me shkresat nr. 2536, datë 17.03.2025 dhe nr. 2968, datë 28.03.2025, të dhënat për kontabilizimin e debitorëve nga gjobat. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave dhe Performancës ka përcjellë me shkresën nr. 783/1, datë 18.03.2026, listën analitike të debitorëve të biznesit për periudhën 2015–2024, pa dokumentacionin mbështetës përkatës. Për debitorët familjarë nuk është përcjellë në Drejtorinë e Financës informacion i plotë dhe i rakorduar.

Për pasojë, vlera prej 23,733,415 lekë, e paraqitur e grupuar për debitorët familjarë dhe bizneset, nuk është e ndarë dhe e rakorduar sipas kategorisë së debitorit, periudhës dhe llojit të detyrimit, duke mos garantuar plotësinë dhe saktësinë e gjendjes së llogarisë 468 në pasqyrat financiare. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*".

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 55-65, të Raportit të Auditimit)

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave dhe Performancës në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të marrë masa për evidentimin, rakordimin dhe përcjelljen periodike të të dhënave të plota analitike mbi debitorët e taksave dhe tarifave vendore.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime" u konstatua se gjatë vitit 2025 janë kontabilizuar në këtë llogari 5 (pesë) oponenca teknike me vlerë 843,291 lekë dhe 4 (katër) projekte me vlerë 5,967,078 lekë.
Projekti i studimit "Mbi kushtet gjeologo-inxhinierike të zonës ku do të ndërhyhet me masa mbrojtëse për stabilizimin e shpatit në kodrën e Çfakës, Gjirokastër", me vlerë kontrate 785,000 lekë pa TVSH, është kontabilizuar në llogarinë përkatëse për vlerën 164,300 lekë, shumë e cila përfaqëson pagesën e kryer gjatë vitit 2025.
Për projekt-detyrën e projektimit "Përmirësimi i rrugës Kolonjë–Golem", procedura e prokurimit është zhvilluar gjatë vitit 2024, me vlerë kontrate 3,834,777 lekë me TVSH, ndërsa kontabilizimi në llogarinë 202 është kryer gjatë vitit 2025, në momentin e kryerjes së pagesës së faturës.
Sa më sipër aktivi i cili merret në dorëzim duhet të kontabilizohet në llogarinë përkatëse të klasës 2 të aktiveve me vlerën e plotë të aktivit edhe pse nuk është shlyer i plotë detyrimi, sepse në rastin e mësipërm kemi nënvlerësim të vlerës së aktivit në kundërshtim me Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, pika 16, shkronjat "b" dhe "d". *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 51-65, të Raportit të Auditimit).*
<u>9.1. Rekomandimi</u>: Drejtoria e Financës të marrë masa për kryerjen e rregullimeve kontabël, duke bërë të mundur njohjen dhe regjistrimin e vlerës së plotë të aktiveve të marra në dorëzim, në përputhje me periudhën kontabël që i përket njohjes së tyre, pavarësisht shlyerjes së plotë të detyrimit ndaj kontraktorit.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2025, lidhur me inventarizimin, vlerësimin dhe kontabilizimin e aktiveve afatgjata materiale, u konstatuan mangësi në pasqyrimin e pasurive në llogaritë 210 "Toka, troje, terrene" dhe 211 "Pyje, kullota, plantacione", konkretisht:
a) Llogaria 210 "Toka, troje, terrene", në datën 31.12.2025, paraqitet në vlerën 78,825,601 lekë, nga 33,306,703 lekë në fund të vitit 2024. Nga auditimi u konstatua se në këtë llogari nuk janë evidentuar dhe kontabilizuar plotësisht vlerat e trojeve nën objektet publike, si godina e Bashkisë, ndërtesat e shkollave dhe zyrat e njësive administrative, trojet e regjistruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) në pronësi të Bashkisë, si dhe trojet e transferuara në pronësi me vendime të Këshillit të Ministrave. Për këto pasuri nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i plotë, si dhe mungojnë evidencat analitike dhe dokumentacioni mbështetës për rakordimin e gjendjes fizike me regjistrat kontabël. Për rrjedhojë, gjendja e llogarisë 210 nuk pasqyron në mënyrë të plotë dhe të saktë vlerën e trojeve që Bashkia Gjirokastër ka në pronësi ose administrim.
b) Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione", në datën 31.12.2025, paraqitet me vlerën 0 (zero) lekë, megjithëse Bashkisë Gjirokastër i janë transferuar në pronësi pasuri pyjore dhe kullosore me VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar, sipas shtojcës nr. 4, e cila përmban 658 zëra të inventarit të pyjeve dhe kullotave. Nga auditimi u konstatua se për këto pasuri nuk është kryer inventarizimi fizik dhe vlerësimi i tyre, si dhe nuk është hartuar regjistri analitik me të dhënat për identifikimin, vendndodhjen, sipërfaqen, dokumentacionin e pronësisë dhe vlerën kontabël. Për rrjedhojë, vlera e pasurive pyjore dhe kullosore të transferuara nuk është evidentuar dhe kontabilizuar në llogarinë përkatëse.
Mangësitë e konstatuara kanë ardhur si rezultat i moskryerjes së plotë të procedurave të inventarizimit, vlerësimit dhe rakordimit të pasurive nga strukturat përgjegjëse, si dhe mungesës së regjistrave analitikë të plotë. Këto mangësi ndikojnë në plotësinë dhe

besueshmërinë e informacionit kontabël, duke sjellë mosparaqitjen e saktë të vlerës së aktiveve afatgjata materiale në pasqyrat financiare të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2025.
Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar; si dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar. *(Më hollësisht, gjetjet janë trajtuar në pikën 2.3, faqet 51–64, të Raportit të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të ngrenë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin dhe vlerësimin e pronave të Bashkisë Gjirokastër të kaluar me VKM për llogarinë 210 "Toka, troje terrene". Gjithashtu, nga ana e Drejtorisë së Financës të merren masa për kontabilizimin e saktë të kësaj llogarie.
Menjëherë dhe në vijimësi

10.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin dhe vlerësimin e pronave të Bashkisë Gjirokastër për llogarinë 211 "Pyje Plantacione" në lidhje me gjendjen fizike për hartimin e regjistrit fizik të aktiveve që Bashkia zotëron.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar të pasqyrës së konsoliduar u konstatua që Llogaria 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" në datën 31.12.2024, është paraqitur në vlerën 0 (zero) lekë dhe në datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 0 (zero) lekë.
Nga verifikimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit Bashkia Gjirokastër paraqitet aksionare në shoqëritë si më poshtë:
- Bashkia Gjirokastër në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 21,24 % të aksioneve të "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër" sh.a me NUIS "M23329601L" e cila është shoqëri aksionere me objekt, "Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të 21 furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve".
Numri i aksioneve është 21,240 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 2,124,000 lekë.
- Bashkia Gjirokastër në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 25% të aksioneve të "KF Luftëtari" sh.a me NUIS "L63404601H" e cila është shoqëri aksionere me objekt, "Organizimi i aktiviteteve sportive në fushën e futbollit".
Numri i aksioneve është 4,300 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 4,300,000 lekë.
- Bashkia Gjirokastër në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100 % të aksioneve të "Trajtimi i Studentëve" sha me NUIS "K43128662E" e cila është shoqëri aksionere me objekt, "Trajtimi I studentëve në Universitetin Eqerem Çabej me akomodim dhe shërbime të tjera". Kapitali i shoqërisë është në vlerën 727,244 lekë.
Sa më sipër nuk është kontabilizuar në këtë llogari vlera 7,151,244 lekë për pjesën takuese në shoqëritë si më poshtë:
"Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër" me vlerë takuese 2,124,000 lekë.
"KF Luftëtari" sha me vlerë takuese 4,300,000 lekë.
"Trajtimi i studentëve Gjirokastër" sha me vlerë takuese 727,244 lekë.
Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura" kreu II pika 14, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për

menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*" i ndryshuar, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 52-65, të Raportit të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa që të saktësojë të dhënat në pasqyrën e pozicionit financiar, me qëllim pasqyrimin e drejtë të vlerës prej 7,151,244 lekë në llogarinë 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet", që i përket pjesëmarrjes në shoqërinë "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër" sh.a., me NIPT M23329601L, në shoqërinë "KF Luftëtari" me NIPT L63404601H dhe në shoqërinë "Trajtimi i studentëve Gjirokastër" me NIPT K43128662E.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2026

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Gjirokastër rezultoi se gjendja e llogarive 230 "Investime për aktive afatgjata jomateriale" dhe 231 "Investime për aktive afatgjata materiale", në datën 31.12.2024, paraqitet në vlerën 484,104,004 lekë. Gjatë vitit 2025, gjendja e këtyre llogarive është pakësuar me vlerën 104,880,862 lekë, duke rezultuar në datën 31.12.2025 në vlerën 379,223,142 lekë.

Nga auditimi u konstatua se 25 (njëzet e pesë) investime për aktive afatgjata materiale, me vlerë të likuiduar prej 322,612,486 lekësh, megjithëse janë kontabilizuar në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata, konkretisht në llogaritë 212 "Ndërtesa dhe konstruksione", 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" dhe 215 "Mjete transporti", vijojnë të rezultojnë të kontabilizuara edhe në llogarinë 231 "Investime për aktive afatgjata materiale".

Mosrealizimi i sistemimeve përkatëse kontabël ka sjellë evidentimin e dyfishtë të vlerës së këtyre investimeve në pasqyrat financiare, duke mbivlerësuar gjendjen e llogarisë 231 dhe aktivet afatgjata të Bashkisë Gjirokastër në vlerën 322,612,486 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar.

(Më hollësisht, gjetjet janë trajtuar në pikën 2.3, faqet 55–62, të Raportit të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës e Bashkisë Gjirokastër të marrë masa për analizimin dhe rakordimin e investimeve të kontabilizuara në llogarinë 231 "Investime për aktive afatgjata materiale" me llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata, duke kryer sistemimet e nevojshme kontabël për eliminimin e regjistrimeve të dyfishta dhe pakësimin e gjendjes së llogarisë 231 në vlerën 322,612,486 lekë, me qëllim paraqitjen e saktë dhe të besueshme të aktiveve afatgjata në pasqyrat financiare.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të Bashkisë Gjirokastër rezultoi se llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje", në fund të vitit 2025, paraqitet në vlerën 37,137 mijë lekë dhe përfaqëson garancitë e kontratave të mbajtura në masën 5%. Në këtë llogari janë konstatuar 32 kontrata me vlerë 8,947 mijë lekë, për të cilat ka përfunduar afati i garancisë. Drejtoria e Urbanistikës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, nuk ka kryer verifikimin rast pas rasti të përfundimit të periudhës së garancisë, realizimit të kolaudimit dhe marrjes përfundimtare në dorëzim, ekzistencës së pretendimeve ndaj sipërmarrësve dhe plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për zhbllokimin ose vijimin e mbajtjes së këtyre fondeve. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë*

e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 51-63 të Raportit të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Urbanistikës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të verifikojnë për secilën kontratë përfundimin e afatit të garancisë, kryerjen e kolaudimit dhe marrjes përfundimtare në dorëzim, ekzistencën e pretendimeve ndaj sipërmarrësit dhe dokumentacionin përkatës, duke kryer zhbllokimin e garancive vetëm për kontratat që plotësojnë kushtet ligjore dhe kontraktore.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Gjirokastër ka lidhur aktmarrëveshje me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.a me nr. 290 prot, datë 13.01.2025 me objekt "Arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.a si agjent tatimor për taksat dhe tarifat vendore" dhe aktmarrëveshjen me nr. 291 prot., datë 13.01.2025 me objekt "*Mbi arkëtimin e taksave dhe tarifave lokale si tarifë pastrimi, tarifë varreze, tarifë ndriçimi, tarifë infrastrukture për arsim, sport kulturë, taksë ndërtese në Njësitë Administrative të Bashkisë Gjirokastër*".

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion Bashkia Gjirokastër nuk disponon një regjistër me të dhënat e abonentëve familjarë, referuar aktmarrëveshjes me datë 13.01.2025, Bashkia Gjirokastër ka përgjegjësi sipas pikës 1 të aktmarrëveshjes ti vendosë në dispozicion Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.a ngarkesën mujore për të gjitha familjet rezidente/jorezidente për qytetin e Gjirokastrës.

Nëpërmjet Bashkisë Gjirokastër dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.a janë mbajtur aktrakordimet mujore, këto aktrakordime nuk janë shoqëruar me listën analitike për abonentët të cilët kanë paguar detyrimet mujore. Lista analitike nuk disponohet as në formatin elektronik. Bashkia Gjirokastër nuk disponon informacion analitik për gjendjen debitore të abonentëve familjare, por vetëm shumën totale të debisë si diferencë e shumës së faturuar me shumën e arkëtuar. Sa më sipër është vepruar ne kundërshtim me aktmarrëveshjen nr. 290 prot, datë 13.01.2025 dhe nr.291 prot, datë 13.01.2025. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në nënpikën 2.7., faqe 124-129, të Raportit të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Agjencia e Tatim Taksave në bashkëpunim me Gjendjen Civile Gjirokastër të marrin masa për krijimin dhe administrimin e një regjistri të plotë për abonentët familjarë

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se janë miratuar listat e inventarit dhe listat përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim, përkatësisht: për Njësinë Administrative Cepo, me VKM nr. 1684, datë 24.12.2008; për Njësinë Administrative Lazarat, me VKM nr. 1467, datë 05.11.2008; për Njësinë Administrative Lunxhëri, me VKM nr. 567, datë 27.06.2013; për Njësinë Administrative Picar, me VKM nr. 22, datë 12.01.2011; për Njësinë Administrative Antigone, me VKM nr. 506, datë 13.07.2011; dhe për Njësinë Administrative Odrie, me VKM nr. 1044, datë 14.10.2009.

Për pronat e transferuara në pronësi, Sektori i Pronave Publike dhe Licencave nuk ka kryer regjistrimin e tyre në ASHK dhe inventarizimin fizik, si dhe nuk disponon informacion të plotë mbi gjendjen faktike të tyre, konkretisht sa prej tyre janë të zëna, funksionale apo nuk ekzistojnë më në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 "*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*", ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", të ndryshuar, me pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", si dhe

të Ligjit nr. 20/2020, datë 05.03.2020, "*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*", neni 37, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.7, faqe 123-129 të Raportit të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës, i cili të verifikojë dhe identifikojë pronat e transferuara në favor të Bashkisë me VKM, të vlerësojë gjendjen fizike të tyre dhe t'i klasifikojë sipas titullit juridik të pronësisë apo të drejtës së përdorimit. Për pronat në pronësi të Bashkisë të ndiqen procedurat për regjistrimin në ASHK, ndërsa për pronat vetëm në përdorim të plotësohet dokumentacioni përkatës sipas statusit juridik. Njëkohësisht të hartohet dhe të përditësohet regjistri fizik i aktiveve sipas formatit të miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga kryqëzimi i të dhënave të administruara nga AKBN-ja dhe QKB-ja rezultoi se gjatë periudhës 2025 në territorin e Bashkisë Gjirokastër kanë ushtruar aktivitet 2 (dy) subjekte në fushën minerare dhe 4 (katër) subjekte në fushën e prodhimit të energjisë. Nga auditimi u konstatua se Agjencia e Bujqësisë Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit nuk disponon informacion dhe dokumentacion për sipërfaqet e përdorura nga këto subjekte, statusin e tyre në raport me fondin pyjor/kullosor, ndryshimin e kategorisë së përdorimit ose heqjen nga ky fond, kontratat e përdorimit dhe tarifat e paguara.

Subjektet që ushtrojnë veprimtari karriere në shfrytëzimin e "Mineraleve të ndryshme":

1. Subjekti "B." sh.p.k me NIPT K. i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1168/1, datë 19.03.2008, për shfrytëzimin e vendburimit Lazarat për llojin e mineralit gëlqeror pllakor me sipërfaqen 0.032 km^2.
2. Subjekti "N." sh.p.k me NIPT K., i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1931, datë 04.05.2022, për shfrytëzimin e vendburimit Lazarat për llojin e mineralit gëlqeror me sipërfaqen 0.808 km^2.

Subjektet që ushtrojnë veprimtari karriere në fushën e energjetikës "HEC":

- Hec Lengarica, administruar nga shoqëria koncesionare "L.& E." sh.p.k.
- Hec Picar 1, administruar nga shoqëria koncesionare "P. P. 1" sh.p.k.
- Hec Langarica 3, Gostivisht, Ura e Dashit, administruar nga shoqëria koncesionare "I. E. P." sh.p.k.
- Hec Ferko 1,2, administruar nga shoqëria koncesionare "S." sh.p.k.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 57/2020 "Për pyjet" neni 23, pika 2, VKM nr. 888, datë 27.12.2022 "*Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre*". *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.7, faqe 124-129 të Raportit të Auditimit).*

16.1.Rekomandimi: Agjencia e Bujqësisë, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit të marrë masa për verifikimin e statusit juridik dhe kategorisë së përdorimit të sipërfaqeve të shfrytëzuara nga subjektet "B." sh.p.k, "N." sh.p.k, "L. & E." sh.p.k, "P. P. 1"sh.p.k, "I.E. P." sh.p.k dhe "S." sh.p.k, në territorin e Bashkisë Gjirokastër, në raport me fondin pyjor dhe kullosor. Për secilin rast, të evidentojë sipërfaqet përkatëse dhe të verifikojë dokumentacionin ligjor për dhënien në përdorim, ndryshimin e kategorisë së përdorimit ose heqjen nga fondi pyjor/kullosor, duke marrë masat përkatëse për plotësimin e dokumentacionit, përditësimin e bilancit të fondit pyjor e kullosor dhe llogaritjen e arkëtimin e tarifave përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Në 4 (katër) nga 9 (nëntë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", të specifikuara në aneksin "Për prokurimet", pjesë e raportit përfundimtar, është konstatuar se, disa prej kritereve për kualifikim të cilët

kryesisht lidhen me kapacitetin teknik (staf dhe mjete pune) rezultojnë të paqartë apo të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe/ose të ekzagjeruar dhe/ose të argumentuara mbi bazën e parakushteve jo realiste. Në lidhje me këto kritere, njësia e prokurimit (NjP) është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos marrë parasysh natyrën dhe vlerën e kontratës. Mungesa e një argumentimi teknik, i cili do të justifikonte dhe ligjëronte vendosjen e secilit kriter të kërkuar, vjen si rezultat i moszbatimit të plotë të kuadrit ligjor, në fazën e hartimit dhe argumentimit të kritereve nga personat përgjegjës, në kundërshtim me nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", (i ndryshuar), si dhe nenet 2, 40, 39 dhe 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 65-109 të Raportit të Auditimit).
17.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Gjirokastër (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), të marrë masa që, në procedurat e prokurimit, çdo kërkesë, specifikim teknik dhe kriter kualifikimi të jetë i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si dhe të dokumentohet në procesverbalin përkatës nga personat përgjegjës për përgatitjen e tyre.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Në 7 (shtatë) nga 9 (nëntë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", të specifikuara në aneksin "Për prokurimet", pjesë e raportit përfundimtar, është konstatuar se, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave, duke kaluar afatin 15-ditor pa dhënë një justifikim ligjor. Shkak i problematikës (gjetjes) është moszbatimi i plotë i kuadrit ligjor në fazën e vlerësimit, në kundërshtim me nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 65-108 të Raportit të Auditimit).*
18.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Gjirokastër ose Personi i Autorizuar të marrë masa për të angazhuar një numër më të madh dhe të ndryshëm punonjësish në Komisionet e Vlerësimit të Ofertave. Autoriteti Kontraktor (Komisionet e Vlerësimit të Ofertave), në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë, për vlerësimin e tyre, nuk duhet të kalojë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Në 6 (gjashtë) nga 9 (nëntë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël" si dhe 5 (pesë) procedurat e prokurimit "Blerje me vlerë të vogël" të audituara dhe të zhvilluar gjatë vitit 2025, është konstatuar se, nga anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave apo Komisionit të Marrjes në Dorëzim, nuk janë plotësuar deklaratat mbi konfliktin e interesave, mosveprim i cili bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 13, pika 5, si dhe neni 73, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 65-108 të Raportit të Auditimit).*
19.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Gjirokastër (Personi i Autorizuar) në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë, të marrë masa që çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, të nënshkruajë një deklaratë përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Në 2 (dy) nga 9 (nëntë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", konkretisht në procedurat e prokurimit të

zhvilluara gjatë vitit 2025 me objekt "*Blerje automjeti zjarrfikëse*", me fond limit 10,983,333 lekë dhe atë me objekt "*Blerje automjeti*", me fond limit 833,333 lekë, është konstatuar se, nga anëtarët e Komisionit të Përcaktimit të Specifikimeve Teknike, edhe pse specifikimet janë përcaktuar në mënyrë rendore dhe variabile (me marzh), ato janë të shoqëruara me një argumentim ligjor por jo me atë teknik, në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 65-110 të Raportit të Auditimit).*

20.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Gjirokastër (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të specifikimeve teknike, përveç renditjes dhe argumentimit ligjor të tyre, duhet të shoqërojë këto të fundit edhe me një argumentim teknik.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Në 5 (pesë) nga 9 (nëntë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", konkretisht në procedurat e prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2025 me objekt "Blerje automjeti zjarrfikëse", "Shpenzime për materiale elektrike", "Materiale Pastrimi", "Materiale ndërtimi" dhe atë me objekt "Blerje automjeti", është konstatuar se, nga anëtarët e Komisionit të Përllogaritjes së Fondit Limit, në procesverbalin përkatës, përveç citimit "ofertat e tregut", nuk janë administruar ofertat dhe as është cituar se nga cilët OE konkretë janë marrë këto oferta, duke cënuar pasqyrimin e plotë të veprimtarisë, në mospërputhje me nenin 2 dhe 76, pika 2, të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 65-110 të Raportit të Auditimit).*

21.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Gjirokastër (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë, gjatë përcaktimit dhe përllogaritjes së fondit limit, të marrë masa, të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës duke administruar të gjithë dokumentacionin e përdoruar për këtë qëllim si dhe duke e pasqyruar atë në procesverbalin përkatës.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për miratimin e lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit u konstatua se, në 6 (gjashtë) rastet e audituara, dokumentacioni teknik dhe shoqërues nuk ishte i plotë, ndërsa në 3 (tre) raste shqyrtimi i aplikimeve ishte kryer me tejkalim të afateve të përcaktuara. Konkretisht:

- Për lejen e ndërtimit, miratuar me Vendim nr. 42, datë 05.08.2025, në favor të subjektit "Sh. A." PF, me objekt *"Mur rrethimi"*, shqyrtimi i aplikimit është kryer me tejkalim të afatit me 103 ditë pune;
- Për lejen e ndërtimit, miratuar me Vendim nr. 75, datë 03.09.2025, në favor të subjektit "L. Ç." PF, me objekt *"Magazinë produktesh bujqësore"*, krahas tejkalimit të afatit të shqyrtimit me 84 ditë pune, dokumentacioni teknik paraqitet i paplotë, konkretisht për projektin arkitektonik, projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe dokumentacionin për efiçencën e energjisë;
- Për certifikatën e përdorimit, miratuar me Vendim nr. 07, datë 21.01.2025, në favor të subjektit "B.S." PF, me objekt *"Ndërtim industrial magazinë"*, mungojnë aktet e kontrollit, sigurimi i përgjegjësisë së ndërtuesit, dokumentacioni për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mirëmbajtjen e objektit;
- Për certifikatën e përdorimit, miratuar me Vendim nr. 19, datë 10.03.2025, në favor të subjektit "A.G." SHPK, me objekt *"Ndërtim industrial magazinë industriale + rrethim"*, është konstatuar tejkalim i afatit të shqyrtimit të aplikimit për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit me 102 ditë pune, si dhe mungesë e akteve të kontrollit dhe deklaratave të

përgjegjësisë profesionale, konfirmimit të akteve nga funksionarët e Bashkisë Gjirokastër, dokumentacionit për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mirëmbajtjen e objektit;
- Për certifikatën e përdorimit, miratuar me Vendim nr. 30, datë 03.04.2025, në favor të subjektit "S.L." PF, znj. V.T. dhe z. Q.T. , me objekt *"Rikonstruksion banese dhe rehabilitim i sheshit përreth"*, mungojnë aktet e kontrollit, dokumentacioni për energjinë elektrike, menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mirëmbajtjen e objektit, plani i vendosjes, kontrata ndërmjet zhvilluesit dhe shoqërisë ndërtuese, si dhe dokumentacioni që provon kalimin e të drejtave nga përfituesi i lejes së ndërtimit te përfituesit e certifikatës së përdorimit;
- Për certifikatën e përdorimit, miratuar me Vendim nr. 33, datë 08.04.2025, në favor të subjektit "K.A." PF, me objekt *"Rikonstruksion objekti me ndryshim funksioni"*, një pjesë e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve nuk rezulton e nënshkruar elektronikisht, përfshirë aktet e kontrollit, aktin e kolaudimit, deklaratat, kontratat, licencat dhe dokumentacionin teknik shoqërues.
Veprimet dhe mangësitë e konstatuara nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 39 dhe neni 44, pika 2, si dhe VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpikat ç), e), ë), g); neni 15, pika 1/1, nënpikat i), ii), iii), iv), v); neni 20, pika 2, nënpika a); neni 21; neni 27/2, pika 1, nënpikat e), ë), g), gj), h), i), j), l), ll); dhe neni 45/1, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 110-116 të Raportit të Auditimit)*
22.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Urbanistikës, Bashkia Gjirokastër, të merren të gjitha masat që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi dhe certifikatë përdorimi:
- të verifikohet plotësia, vlefshmëria dhe përputhshmëria e të gjithë dokumentacionit teknik dhe administrativ të kërkuar nga legjislacioni në fuqi, si projekti ndërtimor, aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit, deklaratat e përgjegjësisë profesionale, policat e sigurimit, projektet e mirëmbajtjes së objektit, aktet për menaxhimin e mbetjeve urbane, kontratat, dokumentet që provojnë të drejtat mbi zhvillimin e objektit, si dhe çdo dokument tjetër i kërkuar nga kuadri ligjor. Gjithashtu, të sigurohet që i gjithë dokumentacioni i ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve të jetë i plotë dhe i nënshkruar elektronikisht nga personat përgjegjës (hartuesit);
- të respektohen afatet ligjore për shqyrtimin e aplikimeve, duke organizuar procedurat administrative në mënyrë që vendimmarrja për lejet e ndërtimit, certifikatat e përdorimit dhe aplikimet e lidhura me to të kryhet brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, është konstatuar se në 1 rast (për lejen e ndërtimit me objekt *"Magazinë produktesh bujqësore"*, miratuar me Vendim nr. 75, datë 03.09.2025, në favor të subjektit "L. Ç." PF), Drejtoria e Urbanistikës, Bashkia Gjirokastër nuk ka kërkuar / respektuar mendimin e të gjithë autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Gjatë shqyrtimit të këtij aplikimi, Drejtoria e Urbanistikës nuk ka kërkuar mendimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), Agjencisë së Eficencës së Energjisë (AEE), Policisë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe për Shpëtimin (PMNZSH), veprim ky në kundërshtim me nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, pika 6. Gjithashtu, Drejtoria e Urbanistikës është mjaftuar me miratim në heshtje nga ana e Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, edhe pse në dispozitat ligjore specifikohet se kjo drejtori nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë / kartelat e pasurive. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 110-116 të Raportit të Auditimit)*

23.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Urbanistikës, Bashkia Gjirokastër, të merren të gjitha masat që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi të kërkohet dhe respektohet mendimi i të gjitha autoriteteve përgjegjëse, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, në përputhje me tipologjinë e objektit në zhvillim. Në çdo rast, lejet e ndërtimit të miratohen vetëm pas marrjes së mendimit nga DV ASHK, statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë / kartelat e pasurive.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të certifikatave të përdorimit është konstatuar se, në 3 raste (nga katër raste të audituara), Drejtoria e Urbanistikës në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor nuk kanë marrë të gjitha masat për kryerjen e verifikimeve përpara pajisjes me certifikatë përdorimi. Më konkretisht, këto parregullsi kanë të bëjnë me:

1. Certifikatë përdorimi për objektin ***"Ndërtim industrial magazinë"***, miratuar me Vendim nr. 07, datë 21.01.2025, në favor të subjektit "B.S." PF:

- Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve konstatohet se objekti është vendosur në përdorim përpara miratimit të certifikatës së përdorimit. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 42 të Ligjit 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 2, si dhe është i dënueshëm sipas përcaktimeve të nenit 52 të këtij ligji, pika 1, nënpika f);

2. Certifikatë përdorimi për objektin ***"Rikonstruksion banese dhe rehabilitim i sheshit përreth"***, miratuar me Vendim nr. 30, datë 03.04.2025, në favor të subjektit "S. L." PF:

- Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve konstatohet se objekti është vendosur në përdorim përpara miratimit të certifikatës së përdorimit. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 42 të Ligjit 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 2, si dhe është i dënueshëm sipas përcaktimeve të nenit 52 të këtij ligji, pika 1, nënpika f);
- Zhvilluesi dhe ndërtuesi nuk i kanë përfunduar punimet brenda afatit të përcaktuar në lejen e ndërtimit. Zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi me nr. 35, datë 15.12.2017. Nisja e fillimit të punimeve është konfirmuar në datë 30.04.2018. Referuar lejes së ndërtimit, afati për përfundim e punimeve është 24 muaj, pas konfirmimit të fillimit të punimeve, pra deri në datë 30.04.2020. Referuar aktit të kontrollit nr. 6 *"Përfundimi i sistemimit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturat publike ekzistuese (akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit)"*, konstatohet se punimet kanë përfunduar në datë 28.07.2020, në tejkalim të grafikut të punimeve. Nga ana e Drejtorisë së Urbanistikës nuk janë marrë masa për të bashkëpunuar me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, me qëllim kryerjen e verifikimeve për tejkalimin e afatit të përfundimit të punimeve, në zbatim të nenit 42 të Ligjit 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 1 dhe nenit 52 të këtij ligji, pika 1, nënpika dh), ose së paku ky informacion nuk është pasqyruar në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve;

3. Certifikatë përdorimi për objektin ***"Rikonstruksion objekti me ndryshim funksioni"***, miratuar me Vendim nr. 33, datë 08.04.2025, në favor të subjektit "K.A." PF:

- Zhvilluesi dhe ndërtuesi nuk i kanë përfunduar punimet brenda afatit të përcaktuar në lejen e ndërtimit. Zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi me nr. 86, datë 09.09.2024. Nisja e fillimit të punimeve është konfirmuar në datë 17.10.2024. Referuar lejes së ndërtimit, afati për përfundim e punimeve është 10 javë, pas konfirmimit të fillimit të punimeve, pra deri në datë 26.12.2024. Referuar aktit të kontrollit përfundimtar konstatohet se punimet kanë përfunduar në datë 08.01.2025, në tejkalim të grafikut të punimeve. Nga ana IMTV nuk janë marrë masa

për kryerjen e inspektimeve dhe nxjerrjen e vendimeve përkatëse (vendim për pezullimin e punimeve; vendim për dënim me masë administrative gjobë), ose së paku ky informacion nuk është pasqyruar në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika dh).
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 110-116 të Raportit të Auditimit).
24.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), Bashkia Gjirokastër, të merren masa për të forcuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit gjatë monitorimit të zbatimit të lejeve të ndërtimit dhe, në mënyrë të veçantë, përpara miratimit të certifikatave të përdorimit. Përpara pajisjes së objekteve me certifikatë përdorimi, të verifikohet nëse objekti është vendosur në përdorim në përputhje me kërkesat ligjore, nëse punimet janë përfunduar brenda afateve të lejes së ndërtimit dhe nëse IMTV ka ushtruar kompetencat e tij për inspektimin dhe marrjen e masave administrative në rastet e konstatimit të shkeljeve, duke dokumentuar dhe pasqyruar në sistemin elektronik të lejeve të gjitha veprimet e kryera.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturës organizative të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), planifikimit të programeve të punës, si dhe raportimit periodik në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), është konstatuar se:
- Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me arsimin e nevojshëm profesional rezulton se në IMTV Bashkia Gjirokastër, para dhe gjatë periudhës në auditim, është punësuar staf që nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 11 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar. Në IMTV është punësuar staf me profil arsimor si: Matematikë / Fizikë; Kontabilitet / Financë; Kimi / Biologji. Nga pesë punonjësit që kanë qenë pjesë e strukturës së IMTV për periudhën nën auditim, vetëm një prej tyre ka pasur profilin arsimor në përputhje me dispozitat ligjore (diplomë në arkitekturë). Mungesa e stafit të kualifikuar sipas profilit përkatës, përbën element risku për cilësinë e kryerjes së punës të IMTV-së, për përcaktimin dhe përshkrimin teknik në aktet e kontrollit respektive të situatave të konstatuara gjatë inspektimit në terren.
- Nga auditimi i strukturës së IMTV-së në Bashkinë Gjirokastër u konstatua se, gjatë periudhës së auditimit në terren, kjo strukturë përbëhej nga 4 punonjës, ndërkohë që numri minimal i përcaktuar nga kuadri ligjor është 6 punonjës, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 14 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar;
- Nga auditimi u konstatua se, IMTV Bashkia Gjirokastër nuk ka hartuar planet e punës për periudhën qershor–dhjetor 2025, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 894, datë 01.11.2015, *"Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore"*;
- Nga auditimi u konstatua se, IMTV Bashkia Gjirokastër nuk ka kryer raportimin periodik pranë IKMT për masat e marra gjatë periudhës 01.01.2025 deri më 31.12.2025, pasi nuk është vënë në dispozicion asnjë raportim për këtë periudhë. në kundërshtim me përcaktimet e nenit 5, pika "f", të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 116-123 të Raportit të Auditimit)*
25.1. Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të Bashkisë Gjirokastër të merren masa për plotësimin e strukturës së IMTV-së me numrin minimal të inspektorëve të parashikuar. Gjithashtu, të merren masa për plotësimin e strukturës sipas procedurave dhe kritereve ligjore, me qëllim përmirësimin e kapaciteteve profesionale të IMTV-së, garantimin e

zbatimit të kërkesave ligjore dhe rritjen e efektivitetit e cilësisë së veprimtarisë inspektuese në mbrojtjen e territorit.

Në vijimësi

25.2. Rekomandimi: Nga ana e kryeinspektorit të IMTV, Bashkia Gjirokastër të merren masa për të përgatitur planet e punës dhe raportimin në IKMT në mënyrë periodike, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, me qëllim sigurimin e planifikimit, organizimit dhe monitorimit efektiv të veprimtarisë inspektuese, garantimin e gjurmueshmërisë së aktiviteteve të kontrollit të territorit, si dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore për informimin dhe raportimin institucional ndaj IKMT.

Menjëherë dhe në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i aktivitetit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), Bashkia Gjirokastër, lidhur me masat e marra për ndërtimet pa leje, devijimet nga lejet e ndërtimit, kallëzimet penale dhe arkëtimin e gjobave, u konstatuan mangësi në zbatimin e kuadrit ligjor, konkretisht:
- Në kundërshtim me përcaktimet ligjore për pezullimin e punimeve, nga auditimi i 7 procedurave të vitit 2025 janë konstatuar parregullsi në 4 prej tyre: ***në 3 raste*** është nxjerrë vendim pezullimi kur ky vendim nuk do të duhej të ishte nxjerrë (N. Gj., PVKK nr. serie 000092, datë 21.03.2025; N. M., PVKK nr. serie 000093, datë 12.05.2025; dhe H. L., PVKK nr. serie 000095, datë 02.06.2025); ***në 1 rast*** (PVKK nr. serie 000097, datë 09.09.2025) nuk është nxjerrë vendimi për pezullimin e punimeve, ndonëse, për shkak të shkeljes së afatit të përfundimit të punimeve, ky vendim duhej të ishte nxjerrë;
- ***Në 3 raste*** vlera e gjobave nuk është përllogaritur në përputhje me nenin 52 të Ligjit nr. 107/2014, *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore përkatëse. Konkretisht, për N.B., D. C., H. L., është vendosur gjobë nga 500,000 lekë për secilin rast, ndërkohë që vlera duhej të përcaktohej mbi bazën e volumit dhe vlerës së punimeve të kryera pa leje, sipas manualit të punimeve (e-Albania). Për shkak se në aktet e konstatimit nuk janë evidentuar volumet e punimeve, nuk është mundësuar përllogaritja e saktë e masës administrative;
- Në kundërshtim me nenin 5, pika dh), të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, dhe nenin 52, pika 7, të Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, në të paktën 4 raste shkeljet e konstatuara përbënin vepër penale sipas nenit 199/a të Kodit Penal, por IMTV nuk vuri në dispozicion dokumentacion zyrtar që provonte nisjen e indicies/kallëzimit penal pranë organeve ligjzbatuese;
- Nga auditimi i arkëtimit të gjobave për periudhën 01.01.2025–31.12.2025, rezultoi se janë vendosur 7 gjoba, në vlerën totale 2,650,000 lekë, nga të cilat është arkëtuar vetëm 1 gjobë, në vlerën 100,000 lekë (14.2% e numrit të gjobave dhe 3.8% e vlerës së tyre), e paguar nga "A.G." SHPK, sipas PVKK nr. serie 000097, datë 09.09.2025. Për gjobat e tjera nuk rezultoi të ishin ndërmarrë të gjithë hapat për ekzekutimin e tyre, në kundërshtim me nenin 16, pika a), të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve"*, i ndryshuar, sipas të cilit, pas kalimit të afatit ligjor të pagesës dhe të periudhës së kamatëvonesës, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 116-123 të Raportit të Auditimit)*

26.1. Rekomandimi: Nga ana e kryeinspektorit të IMTV, Bashkia Gjirokastër, të merren të gjitha masat për:
- zbatimin e plotë dhe të njëtrajtshëm të procedurave administrative, duke nxjerrë vendimet për pezullimin e punimeve në të gjitha rastet kur konstatohet nevoja për plotësimin e

dokumentacionit teknik e ligjor, përmirësimin e kushteve të sigurisë në objekt ose kur kërkohet verifikim i mëtejshëm përpara marrjes së vendimit përfundimtar;
- përllogaritjen e masave administrative duke u bazuar në tipologjinë e ndërhyrjes (ndërhyrje që kryhen me deklaratë paraprake apo leje ndërtimi) në vlerën reale të investimit të kryer pa leje dhe metodologjitë ligjore të përllogaritjes së kostove të ndërtimit;
- ndjekjen e procedurave për referim pranë organit kompetent për vlerësim dhe ndjekje sipas legjislacionit në fuqi, për të gjitha rastet kur gjatë ushtrimit të funksioneve inspektuese konstatohen elementë të veprës penale, si dhe dokumentimin dhe administrimin në dosjet përkatëse të dokumentacionit që provon paraqitjen e indicies penale dhe ndjekjen e mëtejshme të tyre;
- marrjen e të gjitha masave administrative dhe ligjore për arkëtimin e plotë të masave administrative të vendosura, përfshirë llogaritjen e kamatëvonesave, ndjekjen e procedurave të njoftimit dhe nisjen e procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm në rastet e mos-shlyerjes së detyrimeve brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se:
Bashkia Gjirokastër ka respektuar afatin 20 ditor për përgatitjen e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve por nuk ka kthyer përgjigje brenda gjashtë muajve, si dhe nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak, në kundërshtim me nenin 50 të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".
Nivelit i zbatimit të rekomandimeve, rezulton si më poshtë:
a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 14 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 14 masa. Nga masat e pranuara janë zbatuar plotësisht 3 masa, në proces zbatimi 1 masë, zbatuar pjesërisht 1 masë dhe pa zbatuar 9 masa.
b. Për shpërblim dëmi, janë rekomanduar 5 masa, nga të cilat janë pranuar plotësisht 5 masa. Nga masat e pranuara janë pa zbatuar 5 masa.
c. Për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, janë rekomanduar 3 masa, nga të cilat janë pranuar plotësisht 3 masa. Nga masat e pranuara është zbatuar pjesërisht 1 masë dhe pa zbatuar 2 masa.
d. Është rekomanduar 1 masë disiplinore, e cila nuk është zbatuar.
Nga sa më sipër, vlerësohet të rikërkohet zbatimi i rekomandimeve, me përjashtim të atyre të zbatuara plotësisht, atyre që vijojnë të jenë pjesë e gjetjeve aktuale të auditimit si dhe atyre të cilat e kanë humbur aktualitetin.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 130-146 të Raportit të Auditimit).

27.1 Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:
a. Rekomandimet për masa organizative:
13.1.Rekomandimi*: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndaj të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, të vijojë me vendimin e prishjes së objektit. Në rast kundërshtimi, ndaj personave përgjegjës, të ndiqen procedurat ligjore, duke kërkuar bërjen e kallëzimit penal ndajë shkelësve.*
b. Rekomandimet për masa shpërblim dëmi:
1.1.Rekomandimi*: Titullari i Bashkisë Gjirokastër, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike, të marrë masa për arkëtimin e vlerës 110,000 lekë pa TVSH përfituar*

padrejtësisht nga BOE "E." SHPK & "I." SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 1363 prot., datë 13.02.2023 me objekt "Rikonstruksion i rrugës Zhulat Gjirokastër Loti I";

***2.1. Rekomandimi**: Titullari i Bashkisë Gjirokastër në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës 173,012 lekë pa TVSH përfituar padrejtësisht nga BOE "L. K." SHPK & "E. K." SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 4235 prot., datë 03.05.2023 me objekt "Rikonstruksioni i pallatit të sportit, Gjirokastër";*

***3.1. Rekomandimi**: Titullari i Bashkisë Gjirokastër në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës 142,200 lekë pa TVSH përfituar padrejtësisht nga shoqëria "Ll." SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 11950 prot., datë 15.12.2023 me objekt "Rikonstruksioni i pallatit të sportit, Gjirokastër";*

***4.1. Rekomandimi**: Titullari i Bashkisë Gjirokastër në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës 60,000 lekë pa TVSH përfituar padrejtësisht nga shoqëria "E.b." SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 11757 prot., datë 28.10.2022 me objekt "Punime mirëmbajtje rruga e fshatit Zhulat";*

***5.1. Rekomandimi**: Titullari i Bashkisë Gjirokastër në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës 109,232 lekë pa TVSH përfituar padrejtësisht nga shoqëria "F." SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 10732 prot., datë 10.11.2023 me objekt "Rikonstruksion i tregut lokal Rome Gjirokastër "R.on M.".*

b/1. Rekomandimet për masa shpërblim dëmi të rikërkuara:

***1.1. Rekomandimi (rikërkuar)**: Drejtoria e Financës Bashkia Gjirokastër në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për kontabilizim dhe arkëtimin e vlerës prej **43,300 lekë** në ngarkim të JV **"N. -." & "K." SHPK**, si diferencë punimesh të pakryera në referencë të zërave të punimeve.*

***2.1. Rekomandimi (rikërkuar)**: Bashkia Gjirokastër të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të të zbatuara në vlerën **7,831,423 me TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve në situacionin pjesor nr. 5, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore. Gjithashtu nëse deri në fazën e mbylljes së punimeve këto zëra nuk realizohen të kërkohet arkëtimi i vlerës së punimeve të likuiduara por të parealizuara.*

Për 2 masa shpërblim dëmi me vlerë 1,422,101 lekë si vijon:

***15/1.1.Rekomandimi (rikërkuar)**: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit, të marrë masa për llogaritjen e saktë të detyrimeve nga taksa e infrastrukturës në masën 0.1% për investimet që janë jo me fondet e Bashkisë Gjirokastër, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjor për arkëtimin e detyrimit në vlerën **1,125,649 lekë**, respektivisht:*

*-Vlera **1,121,650 lekë**, për investimin në objektin "Rikonstruksioni i Rrjetit të Furnizimit me Ujë dhe Sistemit të Kanalizimeve në Qytetin e Gjirokastrës" me vlerë preventivi prej **1,121,650,665** lekë.*

*-Vlera **3,999,401** lekë, për investimit në objektin "Rikonstruksioni i Shkollës së Bashkuar" me vlerë preventivi **3,999,401 lekë**.*

***15/2.1.Rekomandimi (rikërkuar):** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Gjirokastër të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 296,447 lekë pa TVSH nga OE "A." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 520 prot datë 18.01.2021, me objekt "Rikonstruksion i fushës së vjetër", duke ndjekur të gjitha procedurat*

administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë kjo e cila përfaqëson punimeve të pakryera.
Gjithashtu të fillojë procedura e dhënies së masave disiplinore sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm.
Për 2 Masa për shpërblim dëmi në vlerën totale 20,358,645 lekë si vijon:
***15/1.1. Rekomandimi (rikërkuar)**: Bashkia Gjirokastër të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **17,195,325** lekë pa TVSH nga BOE "B-. II" SHPK & "A. K." SHPK & "M." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 4803 prot., datë 22.06.2020, me objekt: "Ujësjellësi Lazarat". Vlera e mësipërme përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.*
***15/2.1. Rekomandimi (rikërkuar)**: Bashkia Gjirokastër të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej 3,163,320 lekë pa TVSH nga BOE "N.S." SHPK & "S." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 11585 prot datë 15.10.2021 me objekt: "Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në Kodrën e Çafkës pranë rrugës nacionale Gjirokastër-Kakavi".*

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" neni 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*" nenet 98-102, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" nenet 21-33 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", pika 93, **Titullari i Njësisë Publike z. F.G. në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues**, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,203,695 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 667 prot., datë 22.01.2025 me objekt: "*Rivitalizimi i hapësirave rreth pallatit të sportit*" të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastër dhe, sipërmarrësit të punimeve OE "E. C.C." SHPK me vlerë të përgjithshme të kontratës 20,078,730 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të punimeve 8 muaj nga data e lidhjes së kontratës, si dhe kontratës së shërbimit të mbikëqyrjes me nr. 270 prot., datë 13.01.2025, ndërmjet Bashkisë Gjirokastër, dhe, OE "P.C." SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërit e punimeve: [*Shtresë cakulli t=20 cm; Shtresë stabilizanti t=10cm, Trotuar me pllaka pa bordurën e betonit (Pllaka vet shtrënguese t=6 cm), Vizime e kalimit të këmbësorëve. Biokomponente (Pastë)*] me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Gjirokastër, në vlerën **424,600** lekë pa TVSH.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar si dhe kontratën e mbikëqyrjes. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3. faqe 103 të Raportit të Auditimit).*
1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike, të marrë masa në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme

administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej **424,600 lekë pa TVSH**, përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve nga OE "E.C. C." SHPK, për punime të pakryera parashikuar në kontratën me nr. 667 prot., datë 22.01.2025 me objekt: "*Rivitalizimi i hapësirave rreth pallatit të sportit*".

Brenda datës 31.12.2026

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 10565 prot., datë 19.11.2024 me objekt: "*Rikonstruksion dhe përmirësim i efiçencës energjitike në shkollën "Muhamet Gjollesha", Lazarat*" të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastër dhe, sipërmarrësit të punimeve OE "N." SHPK me vlerë të përgjithshme të kontratës 17,375,781.78 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të punimeve 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës si dhe të kontratës , si dhe kontratës së shërbimit të mbikëqyrjes me nr. 11295 prot., datë 12.12.2024, ndërmjet Bashkisë Gjirokastër, dhe, OE "P.C." SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërin e punimeve: [*FV Dyer të brendshme druri cilësi e I-rë*] me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Gjirokastër, në vlerën **186,794** lekë pa TVSH.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar si dhe kontratën e mbikëqyrjes. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3. faqe 105 të Raportit të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike, të marrë masa në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej **186,794 lekë pa TVSH**, përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve nga OE "N." SHPK, për punime të pakryera parashikuar në kontratën me nr. 10565 prot., datë 19.11.2024 me objekt: "*Rikonstruksion dhe përmirësim i efiçencës energjitike në shkollën "Muhamet Gjollesha", Lazarat*".

Brenda datës 31.12.2026

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 10408 prot., datë 13.01.2024 me objekt: "*Sistemim Asfaltim Rruga Taroninë, Zhulat*" të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastër dhe, sipërmarrësit të punimeve OE "L. C." SHPK me vlerë të përgjithshme të kontratës 56,035,013.76 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të punimeve 16 muaj nga data e lidhjes së kontratës si dhe kontratës së shërbimit të mbikëqyrjes me nr. me nr. 11365 prot., datë 13.12.2024 ndërmjet Bashkisë Gjirokastër dhe OE "X. & M." SHPK , rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve: [*Zëri 3 (3.124/1a) Gërmim dheu mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhirë, Zëri 4 (3.119/a) Gërmim shkëmbi i copëtuar me ekskavator me zinxhirë 0.5 m3, shkëmb, në themele gjerësi -2m, me shkarkim në mjet, Zëri 6 (3.158/2a) Transport dheu me auto 2.0 km*] me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Gjirokastër, në vlerën **402,158** lekë pa TVSH.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar si dhe kontratën e mbikëqyrjes. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3. faqe 106 të Raportit të Auditimit).*
3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike, të marrë masa në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej **402,158 lekë pa TVSH**, përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve nga OE "L. C." SHPK, për

punime të pakryera parashikuar në kontratën me nr. 10408 prot., datë 13.01.2024 me objekt: "*Sistemim Asfaltim Rruga Taroninë, Zhulat*".

Brenda datës 31.12.2026

4. Gjetje. Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 1832 prot., datë 25.02.2025 me objekt: "*Rehabilitim i segmenteve të ndryshme rrugore*" të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastër dhe, sipërmarrësit të punimeve BOE "E." SHPK & OE "I." SHPK me vlerë të përgjithshme të kontratës 26,096,656.8 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të punimeve 6 muaj nga data e lidhjes së kontratës si dhe kontratës së shërbimit të mbikëqyrjes nr. 2594 prot., datë 18.03.2025 lidhur ndërmjet Bashkisë Gjirokastër dhe BOE "K. 2023 C." SHPK & OE "I. i K. në N. "IKN", rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërin e punimeve [*Shtresë monolite betoni C 16/20 t=12 cm*] me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Gjirokastër, në vlerën **190,143** lekë pa TVSH.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar si dhe kontratën e mbikëqyrjes. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3. faqe 108 të Raportit të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike, të marrë masa në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej **190,143 lekë pa TVSH**, përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve nga BOE "E." SHPK & OE "I." SHPK, për punime të pakryera parashikuar në kontratën me nr. 1832 prot., datë 25.02.2025 me objekt: "*Rehabilitim i segmenteve të ndryshme rrugore*".

Brenda datës 31.12.2026

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve biznes që kanë ndaj Bashkisë Gjirokastër konstatohet se deri në datë 31.12.2024, borxhi tatimor është në vlerën 61,793 mijë lekë. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, janë paguar nga debitorët biznes detyrime të prapambetura në vlerën 12,248 mijë lekë dhe është krijuar borxhi tatimor në vlerën 7,526 mijë lekë për abonentët biznes. Borxhi tatimor progresiv për abonentë privatë në datë 31.12.2025, është në vlerën 57,071 mijë lekë dhe i përket 834 bizneseve. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, Kreu XI, nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, neni 9 ", pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, "*Për financat e qeverisjes vendore*", neni 35. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në nënpikën 2.2. faqe 33-51, të Raportit të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Agjencia e Tatim Taksave, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat administrative e ligjore, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 57,071 mijë lekë për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të administruar nga Drejtoria e Urbanistikës lidhur me legalizimet e ndërtimeve pa leje, si dhe listat për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton se Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Dega Gjirokastër, ka përcjellë zyrtarisht listat e qytetarëve të pajisur me leje legalizimi. Gjatë vitit 2025, detyrimi i krijuar për këtë taksë është në vlerën 3,709 mijë lekë. Më datë 31.12.2025 gjendja debitorë totale është 5,534 mijë lekë, shumë e cila përfaqëson të ardhura të pa arkëtuara për Bashkinë Gjirokastër. Nga dokumentacioni i paraqitur u konstatua se nga Bashkia Gjirokastër për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë, si dhe nuk u evidentuan raste që institucioni të jetë drejtuar ASHK-së Dega Gjirokastër, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 860, datë 10.12.2014, "*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*" i ndryshuar, pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqe 33-50, të Raportit të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Urbanistikës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Prokurimeve Publike dhe Agjencinë e Tatim Taksave për subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale", të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara me vlerë 5,534 mijë lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave për licencat e subjekteve të hidrokarbureve, rezultoi se 11 (njëmbëdhjetë) subjekte kanë kryer në total pagesën në vlerën 1,000,000 lekë, 1 (një) subjekt nuk ka kryer pagese ndërsa 3 (tre) subjekte kanë kryer pagesa pjesore në kundërshtim me VKM nr. 344 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj".

- "A. O." sh.p.k me NIPT L.....L me afat autorizimi me datë 30.01.2025-29.01.2030 është debitor në shumën 1,000,000 lekë.
- "G. C. G." sh.p.k me NIPT K.....T me afat autorizimi me datë 26.02.2025-25.02.2028 është debitor në shumën 400,000 lekë.
- "G. C. G." sh.p.k me NIPT K.....T me afat autorizimi me datë 26.02.2025-25.02.2028 është debitor në shumën 400,000 lekë.
- "K. S." sh.p.k me NIPT K.....M me afat autorizimi me datë 01.01.2024-01.01.2029 është debitor në shumën 250,000 lekë.

Subjekti G. C. G. i cili është i pajisur me 2 (dy) autorizime është tarifuar me detyrim 600,000 lekë për çdo autorizim në kundërshtim me "VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*", i ndryshuar." Kreu II ,pika 9. Në të cilën përcaktohet se pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.".

Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, "*Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*" Kapitulli II, pika 1, germa "b" dhe pika 9 dhe 15. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në nënpikën 2.3 , faqe 51-55, të Raportit të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Agjencia e Tatim Taksave, Bashkia Gjirokastër, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 2,050,000 lekë për subjektet.

- “A. O.” SHPK me NIPT L.....L me vlerë detyrimi 1,000,000 lekë;
- “G.C.G.” SHPK me NIPT K.....T me vlerë detyrimi 400,000 lekë;
- “G.C.G.” SHPK me NIPT K.....T me vlerë detyrimi 400,000 lekë;
- “K. S.” SHPK me NIPT K.....M me vlerë detyrimi 250,000 lekë;

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrit elektronik të biznesit të madh, lidhur me tarifat vendore për pastrimin, ndriçimin dhe gjelbërimin, të miratuara me paketën fiskale për vitin 2025, u konstatua se, nga 191 raste të audituara, në 6 raste tarifimi nuk është kryer në përputhje me përcaktimet e paketës fiskale të miratuar me VKB nr. 82, datë 05.12.2024. Diferenca e vlerës së patarifuar rezulton 425,000 lekë, të trajtuar në mënyrë analitike në Aneksin nr. 8.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me paketën fiskale me vendimin nr.82, datë 05.12.2024 “*Për miratimin e paketës fiskale 2025 në Bashkinë Gjirokastër*”. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në nënpikën 2.3 , faqe 51-65, të Raportit të Auditimit).*
4.1.Rekomandimi: Agjencia e Tatim Taksave, Bashkia Gjirokastër, për 6 subjektet e evidentuara në aneksin nr.8 të marrë masat për të ndjekur procedurat administrative dhe ligjore për njoftimin e subjekteve dhe arkëtimin e detyrimeve në përputhje me paketën fiskale të miratuar për vitin 2025.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i taksës së tokës bujqësore u konstatua se, gjendja debitore e abonentëve në fillim të vitit 2025 ishte 18,940 mijë lekë, gjatë vitit janë evidentuar shtesa në vlerën 4,620 mijë lekë dhe pakësime në vlerën 5,174 mijë lekë, duke rezultuar në një gjendje debitore në datën 31.12.2025 prej 18,386 mijë lekë, që i përket 3,446 abonentëve.
Për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura të taksës së tokës bujqësore, nuk janë ndjekur procedurat përkatëse për njoftimin dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore vendore, si dhe për marrjen e masave shtrënguese ndaj abonentëve debitorë, në kundërshtim me udhëzimin nr. 17, datë 20.06.2022, “*Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve proceduriale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore*”, Kapitulli II, “*Veprimet paraprake të mbledhjes së detyrimeve tatimore vendore me masa shtrënguese*”. *(Më hollësisht, gjetjet janë trajtuar në nënpikën 2.3, faqe 55–60, të Raportit të Auditimit).*
5.1.Rekomandimi: Agjencia e Tatim Taksave, Bashkia Gjirokastër, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 18,386 mijë lekë për debitorët për taksën bujqësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Në 1 (një) nga 9 (nëntë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të “blerjes me vlerë të vogël”, konkretisht në procedurën e prokurimit të zhvilluar gjatë vitit 2025 me objekt “*Blerje automjeti zjarrfikëse*”, është konstatuar sa vijon:
-Në fazën e vlerësimit të kësaj procedure, operatori ekonomik “I. & C. C.” SHPK, ka paraqitur dorëheqjen nga gara në datën 20.06.2025. Në kushtet kur braktisja e garës nga operatori ekonomik është kryer pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave (19.06.2025) dhe për sa kohë nuk rezulton që OE të jetë tërhequr përpara këtij afati, KVO-ja duhet të kishte kërkuar konfiskimin e sigurimit të ofertës, çka nuk e ka kryer. Nga mosveprimi i anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, është shkaktuar mungesa e përfitimit dhe cenimi i ekonomicitetit të buxhetit të bashkisë në vlerën **219,666 lekë** (vlera e sigurimit të ofertës). Mosveprimi i sipërcituar bie në kundërshtim me nenin 83, pika 3/a të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*” dhe nenin 30, pika 6/a të VKM-së nr. 258, datë

19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-110 të Raportit të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave*), për çdo procedurë prokurimi me fond limit mbi atë të "Blerjes me vlerë të vogël" që do të zhvillojë në vijim, të marrë masa për konfiskimin sigurimit të ofertës nga çdo operator ekonomik, i cili tërheq ofertën e tij pas afatit përfundimtar për paraqitjen e tyre.

Në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Nenin 15 "*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*", shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Nenin 58 "*Llojet e masave disiplinore*", të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*" dhe VKM-së nr. 115, datë 05/03/2014, "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil*", **i rekomandojmë** Bashkisë Gjirokastër, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të nisë procedurat për dhënien e masave disiplinore.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT